

Vanço Gjorgjiev • Dalibor Jovanovski • Nikolla Minov

HISTORIA

për klasën e VIII

në arsimin fillor nëntëvjeçar

Koçan, 2026

HISTORIA

PËR KLASËN E VIII NË ARSIMIN FILLOR NËNTËVJEÇAR

Autore: Prof. dr. Vanço Gjorgjiev
Prof. dr. Dalibor Jovanovski
Prof. dr. Nikolla Minov

Botues: Evropa 92, Koçan

Për botuesin: Vlatko Dimitrovski

Titulli origjinal:

Историја за осмо одделение во деветгодишно основно образование
Ванчо Ѓорѓиев, Далибор Јовановски, Никола Минов

Redaktor: M-r Done Donev

Përktheu nga maqedonishtja në shqip: M-r Manoilj Bogdanovski

Lektor: Prof. dr. Agim Poljoska

Regullimi grafik dhe teknik: Sasho Zashov

Shtypi: Evropa 92, Koçan

Tirazhi: 6 672

Vendi dhe viti i botimit: Koçan, 2026

Me Vendim për miratimin dhe përdorimin e librit mësimor për lëndën Historia për klasën e tetë në arsimin fillor nëntëvjeçar nr. 26-705/1 të datës 05.06.2026, të miratuar nga Komisioni kombëtar për libra mësimor.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

373.3.016:93/94(075.2)=18

GJORGJIEV, Vanço

Historia : për klasën e tetë në arsimin fillor nëntëvjeçar / Vanço Gjorgjiev, Dalibor Jovanovski, Nikolla Minov ; [përktheu nga maqedonishtja në shqip Manoilj Bogdanovski]. - Koçan : Evropa 92, 2026. - 184 стр. : илустр. ; 30 см

Превод на делото: Историја за осмо одделение во деветгодишно основно образование / Ванчо Ѓорѓиев, Далибор Јовановски, Никола Минов

ISBN 978-608-5035-60-1

1. Jovanovski, Dalibor [автор] 2. Minov, Nikolla [автор]

COBISS.MK-ID 69166853

Përmbajtja

Hyrje në historinë e shekullit të ri 5

TEMA 1

Evropa dhe bota nga mesi i shekullit XVII deri në mesin e shekullit XIX 9

Absolutizmi në Evropë në shekullin e ri	10
Iluminizmi dhe absolutizmi i iluminuar	14
Krijimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës	18
Revolucioni Francez	22
Luftërat e Napoleonit dhe Kongresi i Vjenës.....	26
Revolucioni i Parë Industrial	30
Kombi dhe identiteti kombëtar në Evropë	34
Shkenca dhe kultura në Evropë dhe në botë nga mesi i shekullit XVII deri në mesin e shekullit XIX	37

TEMA 2

Ballkani dhe Maqedonia nga shekulli XVIII deri në Krizën e Madhe Lindore 41

Perandoria Osmane dhe Ballkani deri në Krizën e Madhe Lindore	42
Fuqitë evropiane dhe Ballkani në shekullin XIX	46
Kryengritjet në Serbi dhe Greqi.....	50
Serbia Autonome	54
Greqia - shteti i parë i pavarur në Ballkan	58
Shqipëria nga fillimi i shekullit XIX deri në Krizën e Madhe Lindore dhe zhvillimi i idesë së Iluminizmit	62
Bullgaria nga fillimi i shekullit XIX deri në Krizën e Madhe Lindore	66
Rrethanat kishtarë-arsimore në Maqedoni në shekullin XIX	70
Kryengritja e Razlovcit	75
Kryengritja Maqedonase	79
Lidhja e Prizrenit dhe shfaqja dhe zhvillimi i lëvizjes çlirimtare shqiptare	83

TEMA 3

Evropa dhe bota nga mesi i shekullit XIX deri në Luftën e Parë Botërore 87

Pranvera e popujve dhe krijimi i shteteve kombëtare në Evropë	88
---	----

Lufta Civile në SHBA.....	92
Revolucioni i Dytë Industrial	96
Epoka e kolonializmit dhe imperializmit.....	100
Marrëdhëniet ndërkombëtare në botë (1870-1914)	104
Shkenca dhe kultura në Evropë dhe në botë nga mesi i shekullit XIX deri në Luftën e Parë Botërore	108

TEMA 4

Ballkani në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX..... 113

Perandoria Osmane deri në Traktatin e Paqes së Bukureshtit	114
Serbia nga pavarësia deri në Luftën e Parë Botërore.....	118
Greqia nga fundi i Krizës së Madhe Lindore deri në Luftërat Ballkanike.....	122
Bullgaria nga shtet autonom në shtet të pavarur	126
Shqipëria në rrugën drejt pavarësisë	130
Arsimi, kultura dhe sporti në Ballkan në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX.....	134

TEMA 5

Maqedonia në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX 139

Organizatrat dhe shoqatat maqedonase në emigracion.....	140
Organizata Revolucionare Maqedonase	144
Veprimtarë të shquar të Organizatës Revolucionare Maqedonase	148
Kryengritja e Ilindenit.....	153
Republika e Krushevës	158
Situata në Maqedoni pas Kryengritjes së Ilindenit	162
Maqedonia gjatë grushtit të shtetit dhe regjimit të xhonturqve	166
Maqedonia në Luftërat Ballkanike	170
Shfaqja dhe zhvillimi i maqedonizmit	175
Jeta në Maqedoninë Osmane.....	179

Hyrje në historinë e Shekullit të Ri

Jeta e njerëzve për shekuj me radhë, ishte e ngadaltë dhe e qetë. Ditët ishin të ngjashme me njëra-tjetrën dhe çdo brez jetonte në mënyrë të ngjashme me të mëparshmit. Jeta e përditshme kalohej kryesisht në punë, në rrethin e të afërmeve të ngushtë, fqinjëve dhe bashkëfshatarëve. Njeriu i zakonshëm udhëtonte rrallë dhe vetëm në distanca të shkurtra. Bota jashtë vendlindjes së tij dukej e panjohur dhe e largët.

Sundimtarët sundonin vetëm, sepse gjithmonë kishte qenë kështu, dhe autoriteti i tyre pranohej si diçka e natyrshme dhe e dhënë nga Zoti. Dituria përhapej ngadalë dhe udhërrëfyesi kryesor në jetë ishin zakonet dhe traditat.

Megjithatë, nga gjysma e dytë e shekullit XVII, bota e qetë dhe deri atëherë e pandryshueshme filloi të ndryshonte gradualisht. Filloi epoka e ideve dhe makinerive, e shkencëtarëve dhe mendimtarëve, e industrialistëve dhe punëtorëve, e qytetarëve dhe e kombeve. Shkenca dhe teknologjia e ndryshuan jetën e përditshme, ndërsa fabrikat i dhanë pamje të re qytetit. Zhurma e hekurudhave u përhap njëkohësisht me idetë e lirisë, barazisë dhe progresit. Kështu filloi periudha e ndryshimeve të thella që ne e quajmë **Shekulli i Ri**. Gjatë kësaj kohe, u hodhën themelet e botës, siç e njohim sot.



Shkencëtar i kohës së Iluminizmit

Shekulli i Ri në botë dhe në Evropë

Një nga ndryshimet e para të mëdha që ndodhën gjatë kësaj periudhe ishte në **mënyrën e mendimit**. Mendimtarët dhe shkencëtarët e Shekullit të Ri besonin se arsyeja dhe njohuria njerëzore mund ta ndryshonin shoqërinë. Gjithnjë e më shumë njerëz filluan të bënin pyetje të guximshme: *Pse duhet që një njeri të sundojë mbi të gjithë të tjerët? A ekziston ndonjë pushtet i drejtë? A nuk duhet që ligjet të vlejnë për të gjithë në mënyrë të barabartë?*

Këto ide e dobësuan gradualisht pushtetin e mbretërve. Ato hapën rrugën për një seri revolucionesh, prandaj Shekulli i Ri nganjëherë quhet **koha e revolucioneve**. U zhvilluan luftëra për liri, pavarësi dhe bashkim kombëtar. Edhe kur ato dështuan, revolucionet i ndryshuan përgjithmonë pikëpamjet e njerëzve për pushtetin dhe shoqërinë.

Ndërlidhi njohuritë



Në klasën e gjashtë, mësove se historinë e ndajmë në katër periudha kryesore.

Cilat janë ato periudha dhe cilat prej tyre u trajtuan në klasat e mëparshme?



Revolucioni francez

Lindën **shtete të reja** dhe ideja, që, popujt me një gjuhë, kulturë dhe histori të përbashkët duhet të krijojnë shtetet e tyre, u përhap gjithnjë e më shumë në të gjithë Evropën dhe botën.


Shekulli i ri ishte edhe koha për zhvillim ekonomik dhe teknologjik. **Revolucionet industriale** e ndryshuan thellësisht jetën e përditshme. Fabrikat i zëvendësuan punishtet e vogla, motorët me avull i lëviznin trenat dhe anijet, ndërkohë që qytetet rriteshin me shpejtësi. Miliona njerëz u zhvendosën nga fshatrat në qytete në kërkim të punës dhe të ardhurave më të mira.

Lulëzim të madh përjetuan edhe **shkenca, letërsia dhe kultura**, veçanërisht në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX. Kjo periudhë njihet edhe si **Belle Époque**.

Shekulli i Ri në Ballkan dhe në Maqedoni

Pothuajse të gjithë popujt e Ballkanit e pritën Shekullin e Ri nën sundimin e njëres prej perandorive të mëdha - Perandorisë Osmane ose Monarkisë së Habsburgëve. Gjatë kësaj kohe, ndër ta gradualisht zgjohej **vetëdija kombëtare**. Nën ndikimin e ideve evropiane të lirisë dhe barazisë, popujt e Ballkanit filluan të luftonin për çlirim dhe krijimin e **shteteve kombëtare**. Kështu, kjo periudhë u shënuar nga disa **kryengritje dhe luftëra**, të cilat i shënuan kufijtë modernë të Ballkanit. Në të njëjtën kohë, kjo ishte edhe periudha e **përparimit të madh kulturor dhe arsimit**.

Në Shekullin e Ri, territori i Maqedonisë ishte pjesë e Perandorisë Osmane. Shteti i fuqishëm osman, i cili në shekullin XVI ishte një fuqi e madhe evropiane dhe botërore, filloi gradualisht të humbiste territore. Në kushte të tilla, jeta në Maqedoni u bë gjithnjë e më e vështirë. Në të njëjtën kohë, filluan të përhapeshin idetë për **zgjim kombëtar**. Nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, popullsia e Maqedonisë nisi disa **kryengritje** kundër qeverisë osmane. Shprehje e pakënaqësisë së saj ishte krijimi i **Organizatës Revolucionare Maqedonase**, veprimtarët e së cilës luftonin për lirinë dhe autonominë e Maqedonisë. Ngjarjet që ndodhën në Maqedoni gjatë kësaj periudhe i **hodhën themelet e shtetit modern maqedonas**.



Fizikani Albert Ajnshtajn

Fjalë dhe terma të panjohur



Belle Époque - frëngj. *La Belle Époque* – ose *Epoka e bukur*. Një term që u shfaq në Francë dhe më pas u përhap në të gjithë Evropën. I referohet periudhës që nga viti 1871 deri në vitin 1914. E shënon kohën e përparimit dhe të optimizmit të madh në shoqërinë evropiane.



Kongresi i Berlinit (viti 1878)



Çetë e Organizatës Revolucionare Maqedonase

Burimet për historinë e Shekullit të Ri

Burimet historike janë gjurmë të së kaluarës, përmes të cilave historianët e studiojnë dhe e kuptojnë jetën e njerëzve gjatë një periudhe të caktuar. Për shekullin e ri, ato janë shumë më të shumta dhe më të larmishme sesa në periudhat e mëparshme, pasi shkrimi dhe leximi, shtypi dhe arsimi u përhapën dhe u bënë të disponueshëm për një rreth më të gjerë njerëzish.

Burimet e shkruara kanë rëndësi parësore. Për ta shkruar historinë e Shekullit të Ri, historianët përdorin libra, letra, kujtime, ditarë dhe dokumente të tjera të shkruara. Gjatë kësaj periudhe, shfaqja e **gazetave** të cilat na japin informacione rreth ngjarjeve politike dhe jetës së përditshme, është veçanërisht e rëndësishme.

Burime shumë të rëndësishme për historinë e Shekullit të Ri janë **burimet audiovizuale**, veçanërisht ato që u shfaqën pikërisht në këtë periudhë - fotografi, filma dhe disqe gramafoni. Vizatimet, karikaturat dhe posterat na ndihmojnë gjithashtu ta imagjinojmë jetën e njerëzve në Shekullin e Ri. Ato na tregojnë se si dukeshin qytetet, fabrikat, rrobat, revolucionet dhe luftërat.



Milton Manaki me kamerën e tij

E kaluara përmes burimeve



Lexojini me kujdes tekstet e dhëna nga burimet historike, të cilat lidhen **me hyrjen e perandorit francez Napoleon Bonaparti në Berlin** (kryeqyteti i Prusisë). Pastaj përgjigjuni pyetjeve të parashtruara.

„... Perandori dje, më 27 tetor, hyri në mënyrë solemne në Berlin. Një turmë e madhe qytetarësh thërrisnin „Rroftë Perandori“. Dita ishte madhështore. Komandantët e qytetit ia dorëzuan çelësat e qytetit Madhërisë së Tij..“

Buletini i Ushtrisë së Madhe (“Bulletin de la Grande Armée”) – 28 tetor 1806

„... Hyrja e francezëve shkaktoi shqetësim në qytet. Njerëzit shikonin në heshtje nga dritaret. Shumë dyqane mbe-tën të mbyllura, ndërsa rrugët ishin plot me ushtarë. Çfarë turpi!“

Gazeta e Berlinit (“Berlinerische Zeitung”) – 30 tetor 1806


Si është paraqitur hyrja e Napoleonit në Berlin në dy burimet?

Cilat fjalë në dy burimet ndryshojnë më shumë për nga toni dhe kuptimi? Jepni një shembull.

A mund t'i besojmë plotësisht vetëm një burimi për këtë ngjarje?

Burimet materiale luajnë, gjithashtu, një rol të rëndësishëm. Makineritë, armët, hekurudhat dhe objektet e përdorura në jetën e përditshme dëshmojnë për zhvillimet industriale dhe teknologjike në Shekullin e Ri.

Duke i studiuar dhe krahasuar me kujdes burimet e ndryshme, historianët mund të krijojnë një pamje më të qartë dhe më të saktë të periudhës, që i hodhi themelet e botës moderne.



Faqja e parë e librit
„Rrëfimi i një çetniku maqedonas“



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Çfarë ka ndryshuar në mënyrën e të menduarit të njerëzve në Shekullin e Ri?
2. Si është quajtur fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX për ta shënuar kohën e përparimit të madh në Evropë?
3. Përmend disa lloje burimesh për historinë e Shekullit të Ri!

EVROPA DHE BOTA

NGA MESI I SHEKULLIT XVII

DERI NË MESIN E SHEKULLIT XIX

1



Absolutizmi në Evropë në Shekullin e Ri

Gjatë shekullit XVII dhe fillimit të shekullit XVIII, në disa vende evropiane u vendos një formë qeverisjeje e njohur si absolutizëm. Në të, **sundimtari e kishte të gjithë pushtetin në shtet**. Ai bënte ligjet, komandonte ushtrinë, kishte fjalën e fundit në gjyqësor dhe e ndiqte politikën e jashtme. Me fjalë të tjera, sundimtari vendoste vetë për çështjet më të rëndësishme shtetërore dhe nënshtetasit nuk kishin mundësi reale për të marrë pjesë në vendim-marrje.

Ndryshe nga Mesjeta, kur pushteti ndahej midis mbretit dhe feudalëve, në Shekullin e Ri sundimtarët përpqeshin të sundonin në mënyrë të pavarur dhe pa kufizime. Në vend që çdo fisnik ta kishte ushtrinë e vet dhe ta zhvillo-nte politikën e vet, mbreti krijonte një ushtri shtetërore dhe emëronte zyrtarë që i zbatonin vendimet e tij në të gjithë shtetin.

Shembujt më të famshëm të sundimit absolutist janë **Franca në kohën e Luigjit XIV dhe Rusia nën sundimin e Pjetrit I të Madh**.

Franca në kohën e Luigjit XIV

Një nga sundimtarët më të rëndësishëm absolutistë ishte mbreti i Francës, **Luigji XIV**. Ai sundoi për më shumë se shtatëdhjetë vjet (1643–1715) dhe mbahet mend si **Mbreti Diell**. Me këtë nofkë, ai donte të tregonte se, ashtu siç është Dielli qendra e sistemit diellor, ashtu edhe mbreti është qendra e shtetit. Një qëndrim i tillë ndaj pushtetit shprehet përmes fjalisë: **“Shteti jam unë!”**, e cila shpesh i atribuohet Luigjit XIV dhe e shpreh pushtetin absolut të mbretit.

Simboli i absolutizmit ishte Pallati i **Versajës**, pranë Parisit. Ai u konceptua si një vend nga i cili mbreti kontrollonte shtetin dhe fisnikërinë. Luigji XIV ftoi fisnikët me ndikim të jetonin në Versajë, larg pronave të tyre në provinca.

Në oborrin mbretëror kishte rregulla të rrepta sjelljeje, ku fisnikët konkurronin vazhdimisht për ta fituar simpatinë e mbretit. Reputacioni dhe avancimi i tyre në karrierë vareshin nga përkrahja e tij. Në këtë mënyrë, ata gradualisht e humbnin pushtetin e tyre politik dhe bëheshin të varur nga sundimtari.



Absolutizmi (karikaturë)

E kaluara përmes burimeve



Në vitin 1709, prifti francez Jacques-Bénin Bossier shkroi: “Çdo pushtet vjen nga Zoti... Mbretërit veprojnë si shërbëtorë të Zotit dhe si përfaqësues të Tij në tokë. Përmes tyre Zoti e ushtron pushtetin e tij... Ne duhet t'i bindemi mbretit me devotshmëri dhe ndërgjegje fetare.”

A është e pranueshme që një sundimtar të jetë mbi ligjin thjesht sepse pretendon se sundon në emër të Zotit? Shpjego.



Luigji XIV, Mbreti Diell



Pallati i Versajës



Ceremoni në pallatin e Versajës

Jeta e oborrit mbretëror në Versajë ishte luksoze, por e kontrolluar rreptësisht nga mbreti. Ceremonitë dhe argëtimet në oborrin mbretëror kishin për qëllim të tregonin se Luigji XIV ishte personi më i rëndësishëm në shtet. Kultura dhe arti luanin një rol të rëndësishëm në këtë sistem, sepse përmes jetës kulturore të oborrit mbretëror, Franca e demonstronte fuqinë dhe prestigjin e saj ndaj vizitorëve të shumtë evropianë. Në këtë mënyrë, jeta në Versajë u bë shembull që e imitonin edhe sundimtarët e tjerë në Evropë.

Një shtyllë e rëndësishme e absolutizmit ishte **ushtria e përhershme**, e cila ishte në varësi të drejtpërdrejtë të mbretit. Luigji XIV zhvilloi luftëra të shumta me qëllim forcimin e Francës dhe zgjerimin e ndikimit të saj. Gjatë kohës së tij, Franca e kishte ushtrinë më të fortë në Evropë dhe u bë një nga shtetet më të fuqishme në kontinent.

Ngritja e Rusisë në kohën e Pjetrit I të Madh

Ndryshe nga Franca, Rusia në fund të shekullit XVII ishte një vend i madh që mbetej prapa shteteve të Evropës Perëndimore në shumë mënyra. Cari rus **Pjetri I i Madh** (1689–1725) besonte se kjo e kërcënonte të ardhmen e shtetit dhe se ishin të nevojshme ndryshime urgjente.

Një nga hapat e parë që ai ndërmoi ishte **Misioni i Madh**. Në vitet 1697–1698, Pjetri e vizitoi Evropën Perëndimore. Rusia deri atëherë kishte pasur kontakte të kufizuara dhe pak ndikim në shtetet evropiane, ku shpesh perceptohej si një vend i largët dhe i prapambetur. Gjatë udhëtimit, Cari rus vizitoi vende të tilla si Holanda dhe Anglia, ku u njoh nga afër me organizimin e ushtrisë, ndërtimin e anijeve dhe rolin e shkencës në forcimin e shtetit.

Mëso më shumë



Mbreti Luigji XIV filloi t'i humbiste flokët herët, kështu që mbante parukë të mëdha. Menjëherë pas kësaj, fisnikëria filloi ta imitonte dhe parukat u bënë simbol i prestigjit. Luigji XIV gjithashtu shpesh mbante taka të larta, gjë që e bënte të dukej më i gjatë dhe më mbresëlënës. Vetëm njerëzve të afërt me mbretin u lejohej të mbanin këpucë të tilla. Në fakt, banorët e Versajës jetonin sipas orarit të përditshëm të Luigjit XIV. Kur mbreti lëvizte nëpër pallat, fisnikët e ndiqnin dhe i ndërprisnin aktivitetet e tyre. Kur mbreti flinte, të tjerët heshtnin.

Bëj kërkime dhe mëso më shumë rreth jetës në Versajë gjatë kohës së Luigjit XIV dhe ndaj ndonjë informacion interesant me shokët e klasës.



Pjetri I i Madh

Pas kthimit të tij në Rusi, Pjetri zbatoi **reforma** të gje-
ra. Ai krijoi ushtri dhe marinë moderne, e vuri kishën nën
kontrollin e shtetit dhe punësoi ekspertë të huaj për ta
ndihmuar në zbatimin e reformave. Qëllimi i tij ishte që ta
konsolidonte pushtetin absolut dhe të ndërtonte një shtet
të fortë të aftë për të zhvilluar luftëra dhe për të fituar
ndikim më të madh në Evropë.

Ndryshimet shpesh imponoheshin me forcë. Pjetri nji-
het për masat e tij për t'i detyruar burrat ta rruanjnjë mjek-
rën dhe të veshin rroba në modën e Evropës Perëndimore,
duke e demonstruar simbolikisht dëshirën e tij për t'u **af-
ruar me Evropën**. Ai gjithashtu dërgoi **rusë të rinj për të
studiuar në Evropën Perëndimore**, me qëllim që më vonë
t'i zbatonin njohuritë e fituara në Rusi.

Një ngjarje kyçe e sundimit të Pjetrit I të Madh ishte
Lufta e Madhe Veriore (1700–1721), të cilën Rusia e zhvilloi
kundër Suedisë së fuqishme në atë kohë. Qëllimi i luftës
ishte të fitonte **qasje në Detin Baltik**, gjë që do t'i lejonte
Perandorisë Ruse të lidhej më lehtë me shtetet e tjera
evropiane. Pas një lufte të gjatë dhe të vështirë, Rusia
doli fitimtare, fitoi territore të reja dhe qasje në det, dhe
u shpall **perandori**. Në territoret e pushtuara në luftë, u
ndërtua kryeqyteti i ri, **Shën Petërburgu**, i cili ishte kon-
ceptuar si “dritare drejt Evropës”.

E kaluara në të tashmen



Në vendet perëndimore aq pak dihej për
Rusinë saqë në vitin 1657, mbreti fran-
cez Luigji XIV i dërgoi një letër zyrtare
Carit rus Mikael I, edhe pse ai kishte
vdekur para dymbëdhjetë vitesh.

*A do të ishte i mundur një gabim i tillë
sot? Çfarë është e ndryshme në mënyrën
se si komunikohet informacioni në botën
moderne?*



Pjetri I i Madh mori pjesë në ndërtimin e
anijeve në Holandë



Betëjë në Luftën e Madhe Veriore



Shën Petërburgu - dritare drejt Evropës

Karakteristikat e sundimit absolutist

Absolutizmi i Luigjit XIV dhe Pjetrit I të Madh tregon se në disa shtete moderne i gjithë pushteti ishte në duart e sundimtarit. Ndryshe nga monarkitë parlamentare si **Anglia**, ku pushteti i mbretit kufizohej nga **parlamenti**, në monarkitë absolutiste vetë sundimtari vendoste për çështjet më të rëndësishme shtetërore.

Absolutizmi kishte disa **përparësi**: krijim i shtetit të fortë dhe më të organizuar, pushtet i qëndrueshëm dhe aftësi për t'i zbatuar shpejt reformat. Por ai kishte edhe **mangësi serioze** - ndryshimet shpesh zbatoheshin me forcë, ndërsa mendimi i lirë dhe kritika ndaj pushtetit shtypeshin rëndë. Prandaj, në shekullin XVIII, në Evropë, gjithnjë e më shumë kërkohej kufizimi i pushtetit absolut.

Fjalë dhe terma të panjohur



Monarki parlamentare - Shtet në të cilin mbreti ose mbretëresha nuk sundon në mënyrë të pavarur, por së bashku me parlamentin, i cili ka një rol të madh në vendimmarrje.

Mëso më shumë



Në vitin 1689, parlamenti anglez nuk ia dha menjëherë kurorën sundimtarit të ri. Ata vendosën një kusht të qartë: ai do të bëhej mbret vetëm nëse prante të mos sundonte vetëm, por së bashku me parlamentin. Mbreti i ri e pranoi kushtin.

Që nga ajo kohë, u bë e qartë se mbreti në Angli nuk mund të sundonte në mënyrë arbitrare, por se pushteti i tij varej nga parlamenti.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Çfarë është absolutizmi dhe si sundonin sundimtarët absolutistë?
2. Cilat ishin tiparet kryesore të sundimit të Luigjit XIV në Francë?
3. Çfarë donte të ndryshonte Pjetri I i Madh me reformat e tij në Rusi? Përmend një ndryshim.

Iluminizmi dhe absolutizmi i iluminuar

Si reagim ndaj absolutizmit, në Evropë në shekullin XVI-II dolën ide të reja që e kritikonin mënyrën e mëparshme të sundimit dhe të të menduarit. Gjithnjë e më shumë shtroheshin pyetjet: pse mbreti kishte kaq shumë pushtet dhe a mund të kishte një pushtet që do të ishte më i drejtë ndaj të gjithëve?

Kjo mënyrë e re e të menduarit, e njohur si **Iluminizëm**, e theksonte rëndësinë e dijes dhe arsyes. Mendimtarët që i zhvillonin dhe i përhapnin këto ide quhen **iluministë** sepse besonin se dija dhe arsyeja e “ndriçojnë” njeriun dhe shoqërinë.

Iluministët evropianë

Në thelb të Iluminizmit ishte ideja se njeriu duhet të mendojë vetë. Iluministët mendonin se nuk duhet të pranoreshin verbërisht rregullat e vjetra ose gjithçka që thoshte mbreti dhe autoritetet kishtare.

Në shekullin XVIII, dija ishte e kufizuar në një numër të vogël njerëzish, ndërsa shumica e popullsisë nuk kishte mundësi të mësonte shkrim dhe lexim. Kjo është arsyeja pse iluministët i dhanë rëndësi të madhe **arsimit** dhe besonin se dija duhet të jetë e arritshme për të gjithë.

Idetë iluministe ishin kryesisht të drejtuara kundër absolutizmit. Iluministët nuk pranonin që një njeri mund të



„Guxo të dish“ ose „Ki guximin ta përdorësh arsyen tënde“ ishte motoja kryesore e Iluminizmit

Idetë e botës moderne



Filozofi francez Denis Diderot ishte kryeredaktori i Enciklopedisë - një projekt masiv që i bashkoi pothuajse të gjitha njohuritë e kohës dhe e bëri atë të arritshëm për çdo qytetar të arsimuar. Enciklopedia u botua në disa vëllime nga viti 1751 deri në vitin 1772 dhe u bë një simbol i frymës së Iluminizmit, në të cilën dija shihej si një fuqi që duhej ndarë, e jo të mbahet në duart e një pakice.

Në fakt, Enciklopedia e Diderotit dhe e bashkëpunëtorëve të tij mund të konsiderohet një lloj “Wikipedia” e shekullit XVIII.



Skenë nga një sallon parisien ku mendimtarët e Iluminizmit shkëmbenin ide

vendoste për gjithçka vetë, pa kontroll dhe përgjegjësi. Në vend të kësaj, ata mbështetën të drejtat e njeriut, ligje të drejta dhe një pushtet më të arsyeshëm.

Një nga mendimtarët më me ndikim ishte **Xhon Lok**. Ai besonte se çdo person ka të drejta natyrore, të tilla si e drejta për jetën, lirinë dhe pronën personale. Këto të drejta, sipas atij, nuk jepen nga sundimtari dhe nuk duhen hequr pa arsye. Lok theksonte se pushteti ekziston për t'i mbrojtur të drejtat e njerëzve. Nëse ai dështon ta bëjë këtë, populli ka të drejtë ta ndryshojë atë.

Një tjetër mendimtar i rëndësishëm i Iluminizmit ishte **Zhan-Zhak Ruso**. Ai mendonte se ishte gabim që mbreti të vendoste vetë për gjithçka dhe se pushteti i vërtetë duhet të vinte nga populli. Sipas Rusoit, qytetarët vendosin kolektivisht se çfarë është më e mira për shtetin. Kjo ide, sipas së cilës pushteti i përket popullit, quhet **sovrانيتet popullor**.

Sharl Monteskje paralajmëroi se kur të gjitha vendimet janë në duart e një personi të vetëm, është e lehtë të abuzohet me pushtetin dhe të shkaktohet padrejtësi. Prandaj, propozoi që pushteti të ndahet në tre pjesë: pushteti legjislativ, i cili nxjerr ligjet, pushteti ekzekutiv, i cili i zbaton ato, dhe pushteti gjyqësor, i cili i interpreton ligjet dhe merr vendime. Kjo parandalon që një person të ketë shumë pushtet.

Krahas çështjeve të pushtetit, disa nga mendimtarët e Iluminizmit i mbështetën edhe liritë personale. Një nga mbrojtësit më të zëshëm të **lirisë së mendimit, lirisë së fjalës dhe tolerancës fetare** ishte filozofi **Volter**. Ai besonte se njerëzit kishin të drejtë t'i shprehnin lirisht pikëpamjet e tyre, edhe kur ato nuk u pëlqenin pushtetarëve.

Absolutistët e iluminuar në Evropë

Në kohën kur mbreti mund të burgoste dikë për atë që thoshte, idetë e Iluminizmit ishin të rrezikshme dhe revolucionare. Volter dhe **Deni Didro** u burgosën për kritikën e tyre ndaj sundimtarëve dhe fesë.

Megjithatë, disa sundimtarë evropianë e kuptuan se shteti do të ishte më i fortë nëse do të futnin arsim më të mirë dhe ligje më të drejta. Prandaj, ata pranuan disa nga idetë e Iluminizmit, por jo ato që kërkonin kufizimin e pushtetit të tyre. Kështu, u shfaq **absolutizmi i iluminuar** - një formë qeverisjeje në të cilën sundimtari e mbante pushtetin absolut, por kërkonte të sundonte me më shumë mençuri dhe të zbatonte reforma në interes të shtetit.



Zhan-Zhak Ruso



Emili di Shatle – shkencëtare dhe mendimtare që kontribuoi në përhapjen e ideve të Iluminizmit

E kaluara në të tashmen



Thënia “Nuk pajtohem me atë që thua, por do të luftoj deri në vdekje për të drejtën tënde që ta thuash” shpesh i atribuohet Volterit. Në fakt, kjo frazë u shkrua nga autorja britanike Evelyn Holl në vitin 1906 për t'i përmbledhur pikëpamjet e tij.

Për cilën të drejtë themelore të njeriut bëhet fjalë në këtë deklaratë?

Një nga sundimtarët më të rëndësishëm të iluminuar ishte Mbreti i Prusisë, **Frederiku II i Madh** (1740-1786). Ai futi **tolerancë më të madhe fetare**, d.m.th. u lejoji anëtarëve të besimeve të ndryshme t'i praktikonin lirisht zakonet e tyre fetare. Megjithatë, ai nuk e lejoi pjesëmarrjen e popullit në pushtet dhe e mbajti të gjithë pushtetin në duart e tij. Kështu, ai sundoi si një sundimtar i iluminuar, por jo si demokrat.

Në Monarkinë e Habsburgëve, **Maria Tereza** (1740–1780) dhe djali i saj **Jozefi II** (1780–1790) zbatuan një sërë reformash arsimore. Një nga më të rëndësishmet ishte futja e **arsimit të detyrueshëm fillor**, i cili synonte ta rriste aftësinë për të shkruar dhe lexuar në mesin e popullsisë. Për shumë fëmijë, kjo ishte mundësia e parë për të mësuar të lexonin dhe të shkruanin.

Monarkia e Habsburgëve ishte një shtet i madh, i përbërë nga popuj të ndryshëm. Për ta bërë më të lehtë qeverisjen e një shteti të tillë, Jozefi II u përpoq ta fuste gjermanishten si gjuhë të përbashkët zyrtare. Kjo politikë shkaktoi rezistencë të fortë midis shumë popujve në monarki dhe pas vdekjes së tij disa nga reformat u shfuqizuan.



Frederiku II i Madh

Ndërlidhi njohuritë



Shikoje hartën e Monarkisë së Habsburgëve. Mundohu të zbulosh disa nga shtetet moderne që ishin plotësisht ose pjesërisht pjesë e kësaj monarkie.



Monarkia e Habsburgëve gjatë kohës së Maria Terezës



Katerina II e Madhe

Perandoresha ruse **Katerina II e Madhe** (1762-1796) korrespondonte me iluministë të famshëm si Volteri dhe Dideroti dhe e mbështeti kulturën dhe arsimin. Në vitin 1764, ajo ndihmoi në themelimin e **Institutit Smolnji**, i cili ishte një nga institucionet e para shtetërore arsimore për vajzat në Evropë. Megjithatë, Katerina nuk lejoi ndryshime që do ta kufizonin pushtetin e saj. Ajo vazhdoi të sundonte në mënyrë absolutiste dhe me forcë t'i shtypte kryengritjet e fshatarëve, të cilët u ngritën për shkak të kushteve të vështira të jetesës dhe pakënaqësisë ndaj pushtetit.

Absolutizmi i iluminuar ishte një përpjekje për ta modernizuar shtetin, por jo për ta futur demokracinë. Sundimtarët pranuan disa nga idetë e iluminizmit, të tilla si arsimi më i mirë dhe mbështetja për shkencën dhe kulturën, por nuk e lejuan pjesëmarrjen e popullit në pushtet. Edhe pse masa të tilla e përgatitën terrenin për ndryshimet e mëvonshme, absolutizmi i iluminuar nuk e mundësoi barazinë dhe pjesëmarrjen e popullit në pushtet.

Fjalë dhe terma të panjohur



Prusia - Shtet në Evropën verilindore, i njohur për ushtrinë e tij të fortë. Kryeqyteti i tij ishte Berlioni. Në shekullin XVIII, Prusia u bë një nga fuqitë më të rëndësishme evropiane dhe në shekullin XIX luajti një rol kyç në krijimin e Gjermanisë.

Monarkia e Habsburgëve - Termi "Monarkia e Habsburgëve", megjithëse nuk është kurrë një emër zyrtar për shtetin, përdoret shpesh për të përfshirë të gjitha vendet dhe popujt që ishin nën sundimin e dinastisë së Habsburgëve. Në vitin 1804, këto territore u riemëruan Perandoria Austriake, kurse nga viti 1867 në Austro-Hungari. Në histori, përdoret shpesh edhe termi i thjeshtuar Austri.

Mëso më shumë



Katerina II e Madhe luajti një rol të rëndësishëm në krijimin e koleksionit të artit që më vonë do të rritej në një nga muzetë më të famshëm në botë - Hermitazhi në Shën Petërburg. Në pallatin e saj, ajo filloi të mbledhë vepra arti, duke dashur ta bënte Rusinë pjesë të botës kulturore evropiane. Ky investim në art konsiderohet pjesë e politikës iluministe të Katerinës.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Çfarë është iluminizmi dhe kundër cilës forme të pushtetit drejtohej ai?
2. Çfarë mbështetnin Xhon Lok dhe Sharl Monteskje?
3. Jepni një shembull të një absolutisti të iluminuar dhe një reforme që ai zbatoi.

Krijimi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Shkaqet e Luftës Amerikane për pavarësi

Në shekullin XVIII, Britania e Madhe zotëronte trembëdhjetë koloni në bregdetin lindor të Amerikës së Veriut. Ato ishin pjesë e **Perandorisë Britanike**. Kolonitë duhej të paguanin taksa të përcaktuara nga qeveria britanike, por nuk kishin të drejtë të merrnin pjesë në vendimmarrje. Për shumë kolonistë, kjo do të thoshte se jeta e tyre e përditshme vendosej nga njerëz mijëra kilometra larg, të cilët nuk kishin jetuar kurrë në koloni dhe nuk i dinin problemet e tyre.

Të trembëdhjetë kolonitë u zhvilluan shumë shpejt. Popullsia u rrit ndërsa shumë evropianë erdhën në kërkim të punës dhe një jete më të mirë. Imigrantët ndërtuan vendbanime të reja, hapën punishte dhe tregtuan me Evropën. Me kalimin e kohës, ata filluan të ndiheshin më të pavarur dhe të sigurt në aftësitë e tyre.

Midis kolonive kishte dallime të konsiderueshme. Në **kolonitë veriore**, popullsia jetonte kryesisht në qytete dhe merrej me tregti dhe zejtari. Në **kolonitë jugore**, bujqësia luante një rol të madh. Atje kultivohej duhan, pambuk dhe oriz, ndërkohë që në plantacionet e mëdha punonin **skllëvër afrikanë**, duke jetuar në kushte të vështira dhe pa asnjë të drejtë. Pavarësisht këtyre dallimeve, kolonistët gjithnjë e më shumë e kuptonin se kishin probleme të përbashkëta, veçanërisht në marrëdhënien e tyre me qeverinë britanike.

Mëso më shumë




Britania e Madhe është një shtet i krijuar në vitin 1707, kur Anglia dhe Skocia u bashkuan në një mbretëri të vetme. Anglia që në shekujt XVI dhe XVII filloi të themelojë koloni në pjesë të ndryshme të botës. Me kalimin e kohës, këto territore u bënë pjesë e Perandorisë Britanike, e cila ishte perandoria më e madhe në histori.

Perandoria Britanike shpesh quhej “perandoria në të cilën dielli nuk perëndon kurrë”, sepse kishte koloni në të gjitha kontinentet. Prandaj, në çdo kohë të ditës dielli shkëlqente në një pjesë të territoreve të saj.



Skllëvër afrikanë në plantacion



Trembëdhjetë kolonitë britanike në Amerikën e Veriut

Pas luftërave të kushtueshme që zhvilloi në Evropë dhe në koloni, Britania filloi të vendoste taksa të reja për t'i mbuluar shpenzimet e luftës. Këto masa shkaktuan pakënaqësi të madhe midis kolonistëve. Kjo u shpreh publikisht përmes sloganit **“S’ka taksa pa përfaqësim”**. Kolonistët e konsideronin të papranueshëm pagimin e taksave pa pasur përfaqësuesit e tyre në Parlamentin Britanik në Londër. Për ta, kjo ishte çështje dinjiteti dhe e **drejtë për të votuar**. Gatishmëria për të rezistuar rritej gradualisht.

Simbol i asaj rezistence u bë **Festa e Çajit në Boston** në vitin 1773. Në atë kohë, një grup kolonistësh, anëtarë të lëvizjes Bijtë e Lirisë, të veshur si indianë, hodhën arka me çaj nga anijet britanike në portin e Bostonit.

Qeveria britanike reagoi ashpër. Ajo e mbylli portin e Bostonit dhe e rriti praninë ushtarake. Këto masa, të njohura si “Ligje të padurueshme”, e përkeqësuan më tej situatën.

Në vitin 1774, në Filadelfia u mbledh **Kongresi i Parë Kontinental**. Atje, përfaqësuesit e kolonive kërkuar heqjen e ligjeve të rrepta dhe rivendosjen e të drejtave të tyre, pa kërkuar ndarje të plotë nga Britania.

Megjithatë, konflikti u bë i pashmangshëm. Në prill të vitit 1775, përplasja e parë e armatosur ndodhi në Lexington, me çka filloi **Lufta Amerikane për Pavarësi**, në të cilën kolonitë luftuan kundër ushtrisë britanike.

Deklarata e Pavarësisë dhe krijimi i SHBA-ve

Pas përleshjeve të para të armatosura, përfaqësuesit e kolonive u mbledhën përsëri në Filadelfia për **Kongresin e Dytë Kontinental**. Ai u bë organi kryesor që i udhëhoqi kolonitë dhe mori vendime në lidhje me luftën. **Xhorxh Uashingtoni** u emërua komandant i përgjithshëm i ushtrisë koloniale dhe luajti një rol kyç në organizimin dhe udhëheqjen e rezistencës kundër Britanisë.

Në vitin 1776, Kongresi miratoi një dokument me rëndësi të jashtëzakonshme - **Deklaratën e Pavarësisë**. Me të, kolonitë njoftuan publikisht se nuk e njohnin më pushtetin e mbretit britanik. Autori kryesor i tekstit ishte **Tomas Xheferson**.

E kaluara përmes burimeve



Sipas një ligji të miratuar në koloninë e Karolinës së Jugut në vitin 1740, skllavëria ishte e trashëgueshme. Afrikanët dhe vendasit, nënat e të cilëve ishin skllavër, si dhe pasardhësit e tyre, konsideroheshin skllavër. Ligji i trajtonte ata si pronë të zotërinjve të tyre, pa të drejtën për të marrë vendime të pavarura për jetën e tyre.

Çfarë na tregon ky ligj rreth mënyrës se si jetonin skllavërit dhe çfarë të drejtash kishin ata në kolonitë britanike në Amerikë?



Festa e Çajit në Boston



Ushtar dhe oficer britanik

Në dokument theksohej se të gjithë njerëzit linden të barabartë dhe e kanë të **drejtën e jetës, lirisë dhe synimin drejt lumturisë**. Sipas Deklaratës, e cila i përfshinte idetë e iluministit Xhon Lok, qeveria ekziston për të mbrojtur këto të drejta, dhe nëse ajo dështon ta bëjë këtë, populli ka të drejtë ta ndryshojë atë.

Lufta për pavarësi zgjati disa vjet dhe nuk ishte e lehtë për kolonitë. Ushtria britanike ishte më e fortë dhe më e pajisur, por ushtria koloniale luftoi me shumë këmbëngulje. Ajo e kishte mbështetjen e popullsisë dhe e njihte shumë mirë terrenin. Me rëndësi të madhe ishte edhe vendimi i Francës për ta njohur pavarësinë e trembëdhjetë kolonive, për të lidhur një aleancë me to dhe për t'i shpallur luftë Britanisë së Madhe. Kështu, avantazhi kaloi në anën e kolonistëve, pas së cilës në vitin 1781 ushtria britanike kapitulloi në Jorktaun.

Me Traktatin e Parisit në vitin 1783, Britania e Madhe e njohu zyrtarisht **pavarësinë** e kolonive. Kështu u krijuan **Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA)** - shteti i ri, i cili u bë republikë. Kjo do të thoshte se në vend të mbretit, pushteti do të ushtrohej nga përfaqësuesit e zgjedhur nga populli.



Molly Piçer – simbol i pjesëmarrjes së grave në Luftën Amerikane për Pavarësi

Sfidë për hulumtim



Xhorxh Uashingtoni drejtonte edhe me një rrjet të fshehtë spiunazhi që mblidhte informacione rreth lëvizjeve dhe planeve të ushtrisë britanike. Spiunët përdornin metoda të ndryshme për të transmetuar fshehurazi mesazhe: ata shkruanin me bojë të padukshme dhe i fshinin mesazhet në rrobat, këpucët dhe madje edhe në flokët e tyre.

Gratë gjithashtu luanin një rol të rëndësishëm në këtë rrjet, pasi autoritetet britanike rrallë dyshonin për to. Falë këtyre informatave dhe raporteve të spiunazhit, ushtria koloniale shpesh dinte se ku do të lëvizte ushtria britanike dhe çfarë planesh po përgatiste.

Hetoje emrin e spiunit të famshëm amerikan me inicialet N. H., i cili u paraqit në mënyrë të rreme si mësues dhe lëvizte pas vijave britanike.

Njihuni me një figurë historike



Themeluesit e SHBA-ve njihen nën emrin Etërit Themelues. Njëri prej tyre ishte Benjamin Franklin. Ai ishte shkencëtar, shkrimtar dhe diplomat. Ai e shpiku rrufepritësin dhe syzet bifokale dhe luajti një rol të rëndësishëm në fitimin e mbështetjes nga Franca për luftën amerikane për pavarësi.



Benjamin Franklin

Kushtetuta e SHBA-ve

Pasi e fituan pavarësinë, amerikanët u përballën me një pyetje të rëndësishme: si të ndërtonin një shtet pa mbret dhe pushtet të trashëguar? Deri atëherë ata ishin mësuar të sundoheshin nga dikush, ndërsa tani duhej t'i vendosnin rregullat e tyre sipas të cilave do të jetonin.

Prandaj, në vitin 1787, u miratua **Kushtetuta e SHBA-ve**. Ajo përcaktoi se pushteti nuk do të ishte në duart e një personi të vetëm. Në vend të kësaj, ai u nda në tre pjesë: legjislativ (Kongresi), ekzekutiv (presidenti) dhe gjyqësor (Gjykata Supreme). Në këtë mënyrë, insistohej që asnjë person i vetëm të mos mund të vendoste për gjithçka në mënyrë të pavarur.

Në vitin 1789, u zgjodh **presidenti i parë**, Xhorxh Uashington. Në vitin 1791, Kushtetutës iu shtuan rregulla që i mbronin të drejtat themelore të njeriut, siç janë liria e fjalës dhe e drejta për gjykim të drejtë.

Lufta për pavarësinë e SHBA-ve tregoi se shteti nuk duhej të udhëhiqej nga një mbret, por nga njerëz të zgjedhur nga populli. Në shtetin e ri flitej për lirinë, barazinë dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në pushtet. Megjithatë, këto ide nuk vlenin për të gjithë. Skllavëria ekzistonte ende, gratë nuk kishin të drejtë vote dhe të drejtat politike zakonisht i gëzonin vetëm burrat e bardhë që zotëronin pronë.

Ndërlidhi njohuritë



Kujtoje mësimin e mëparshëm dhe përgjigju: cili iluminist e propozoi ndarjen e pushtetit në tre pjesë?



Xhorxh Uashington



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Cilat ishin arsyet kryesore pse trembëdhjetë kolonitë britanike filluan të luftonin për pavarësi nga Britania e Madhe?
2. Çfarë përfaqësonte Deklarata e Pavarësisë së SHBA-ve dhe cilat ide themelore janë theksuar në të?
3. Si ishte ndarë pushteti sipas Kushtetutës së SHBA-ve dhe pse u vendos një ndarje e tillë?

Revolucioni Francez

Shkaqet dhe fillimi i revolucionit

Edhe pse Franca ishte një nga shtetet më të fuqishme në Evropë, brenda vendit ekzistonte përçarje të thella. Këto shpreheshin nëpërmjet ndarjes së popullsisë në **tre klasa**. Klasa e parë përbëhej nga kleri, e dyta nga fisnikëria dhe klasa e tretë i përfshinte të gjithë banorët e tjerë.

Klasa e tretë ishte më e madhja. Në të kishte si fshatarë të varfër ashtu edhe qytetarë të pasur. Ajo që të gjithë kishin të përbashkët ishte se duhej të paguanin taksa që dy shtresat e tjera zakonisht nuk i paguanin. Këto dallime dukeshin qartë në jetën e përditshme. Kleri dhe fisnikëria jetonin më rehat, ndërsa fshatarët kishin vështirësi të mbijetonin dhe ishin të ngarkuar me taksa feudale.

Në qytete jetonte **borgjezia** - qytetarë me para dhe arsim që merrnin pjesë aktive në jetën ekonomike, por nuk kishin të drejtë ta udhëhiqnin shtetin. Me kalimin e kohës, ndarja në klasa krijonte një ndjenjë gjithnjë e më rritje të padrejtësisë.

Situata u përkeqësua më tej nga kriza e rëndë financiare në vend. Thesari i shtetit ishte pothuajse bosh për shkak të jetës luksoze të mbretit dhe të fisnikëve, si dhe pjesëmarrjes së Francës në Luftën Amerikane për Pavarësi.

Në të njëjtën kohë, fatkeqësitë klimatike dhe disa të korra të dobëta çuan në **mungesa ushqimore**. Për shumë familje, buka ishte ushqimi bazë dhe shpenzimi më i madh. Kur çmimi i saj u rrit ndjeshëm, një pjesë e popullsisë nuk mund të përballonte më të ushqehet. Për këtë arsye, shpesh thuhet se “Revolucioni Francez filloi në stomak”.

Përveç urisë dhe varfërisë, **idetë e Iluminizmit** po përhapeshin në të gjithë Francën. Njerëzit filluan të pyesnin veten pse disa lindnin me privilegje dhe të tjerë me përgjegjësi të rënda. Ideja se çdo person kishte të drejta natyrore dhe se pushteti duhet t'i mbronte ato, e jo t'i shkelte, pranohej gjithnjë e më shumë.

Për të gjetur një zgjidhje për problemet në vend, Mbreti Luigji XVI e thirri Kuvendin e klasave. Në vend të një marrëveshjeje, pasoi një konflikt i ashpër. Përfaqësuesit e klasës së tretë u shpallën si **Asamble Kombëtare** dhe deklaruan se e shprehnin vullnetin e popullit. Ata filluan ta



Tre klasat në Francë
– karikaturë



Mbreti Luigji XVI



Përfaqësuesit e klasës së tretë u betuan se do të hartonin një kushtetutë të re

hartonin kushtetutën e re, me të cilën duhej të kufizohej pushteti i mbretit.

Duke pasur frikë nga mundësia e humbjes së pushtetit, Luigji XVI dërgoi një ushtri në Paris, pas së cilës pakënaqësia u shndërrua në revoltë të hapur.

Më 14 korrik të vitit 1789, qytetarët dhe ushtarët e revoltuar e sulmuan dhe e pushtuan fortesën e **Bastijës**. Ajo shërbente si burg dhe në sytë e popullit ishte simbol i frikës dhe arbitraritetit të pushtetit. Kjo ngjarje konsiderohet si fillimi i Revolucionit Francez.

Fjalë dhe terma të panjohur



Klasë - Grup shoqëror me të njëjtat të drejta dhe detyrime.

Borgjezi - Shtresë qytetare njerëzish të angazhuar në tregti, zanate dhe profesione të lira. Borgjezia ndahej në të madhe (qytetarët më të pasur - tregtarë dhe bankierë), të mesme (avokatë, mjekë, profesorë) dhe të vogël (tregtarë dhe zejtarë të vegjël).

E kaluara përmes burimeve



Në librin e tij "Rrëfime", të shkruar në vitet '60 të shekullit XVIII, filozofi Zhan-Zhak Ruso përmend "një princeshë të madhe" e cila, pasi dëgjoi se populli nuk kishte bukë, thuhet se tha: "Atëherë le të hanë briosh", që nganjëherë përkthehet si "Atëherë le të hanë ëmbëlsira". Kjo thënie më vonë iu atribua mbretëreshës Maria Antoneta, megjithëse nuk ka prova që ajo e shqiptoi vërtet.

Çfarë na tregon kjo histori rreth ndarjes së pushtetit nga jeta e përditshme e njerëzve në Francë?



Sulmi ndaj Bastijës

Nga monarkia në republikë

Revolucioni u përhap shpejt në të gjithë vendin. Fshatarët e uritur filluan t'i sulmonin pronat e fisnikëve, duke kërkuar ushqim dhe heqjen e feudalizmit. Kjo periudhë frike masive nga uria dhe dhuna njihet si **Frika e Madhe**.

Nën presionin e popullit, Asambleja Kombëtare i shfuqizoi privilegjet feudale të klerit dhe fisnikërisë. Kjo gjithashtu i dha fund ndarjes së shoqërisë në klasa. Që nga ai moment, nuk ishte më e rëndësishmja në çfarë familjeje kishte lindur dikush, por çfarë dinte dhe çfarë mund të arrinte me punën e tij.

Në gusht të vitit 1789, u miratua **Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit**. Në të theksohej se të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë dhe se pushteti duhet të vijë nga populli. Motoja **“liri, barazi, vëllazëri”** u bë simbol i epokës së re.

Megjithatë, jeta për njerëzit e zakonshëm nuk u përmirësua menjëherë, pasi shumë familje ende nuk kishin ushqim të mjaftueshëm. Në tetor të vitit 1789, disa mijëra gra nga Parisi marshuan më këmbë drejt Versajës, duke kërkuar bukë dhe llogari nga mbreti. Kjo ngjarje, e njohur si **Marshi i Grave**, përfundoi me zhvendosjen e Luigjit XVI dhe mbretëreshës Maria Antoneta në Paris. Nëse deri atëherë mbreti i kishte kontrolluar fisnikët në Versajë, ai tani ishte nën mbikëqyrje të vazhdueshme nga populli.

Në vitin 1791, u miratua kushtetuta e parë, duke e bërë Francën **monarki kushtetuese**. Pas përpjekjes së mbretit për t'u larguar nga vendi, në vitin 1792 monarkia u shfuqizua dhe Franca u shpall **republikë**. Luigji XVI u ekzekutua më vonë në gijotinë, duke i dhënë fund simbolikisht rendit të vjetër.



Marshi i Grave në Versajë



Olimpia de Guzh – autore e „Deklaratës për të drejtat e gruas dhe qytetares“ (1791), me të cilën kërkonte të drejta të barabarta për gratë.

Ndërlidhi njohuritë



Krahasojti idetë themelore të Deklaratës për të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit me Deklaratën e Pavarësisë së SHBA-ve.

Fjalë dhe terma të panjohur



Monarki kushtetuese - Shtet në të cilin monarku sundon sipas një kushtetute dhe nuk ka pushtet të plotë, pasi një pjesë e pushtetit mbahet nga institucionet e tjera.

Gijotinë - Pajisje për ekzekutim me prerje koke. U prezantua gjatë Revolucionit Francez si një metodë “më humane” ekzekutimi, pasi besohej se vdekja ndodhte menjëherë.

Sundimi i terrorit dhe rëndësia e Revolucionit Francez

Në republikën e re, **Jakobinët**, të udhëhequr nga Maksimilian Robespieri, u bënë forca më me ndikim. Gjatë periudhës së njohur si **Sundimi i Terrorit**, mijëra njerëz u arrestuan dhe u ekzekutuan si armiq të dyshuar të revolucionit.

Në vend të lirisë dhe sigurisë, në Francë mbretëruan frika dhe dhuna. Kur Robespieri e humbi mbështetjen, ai u ekzekutua në gijotinë në vitin 1794.

Pas rënies së Robespierit, dhuna u qetësua gradualisht, por autoritetet prapë nuk arritën ta rivendosnin rendin dhe paqen. Franca ishte në luftë me disa vende evropiane, sundimtarët e të cilave kishin frikë se idetë revolucionare do të përhapeshin tek ata. Në rrethana të tilla, në vitin 1799, gjenerali i ri **Napoleon Bonaparti** e mori pushtetin. Kjo i dha fund Revolucionit Francez dhe filloi periudha e luftërave të Napoleonit.

Revolucioni Francez pati një ndikim të fortë në përhapjen e ideve të Iluminizmit në Evropë. Ai tregoi se të gjithë duhet të kenë të drejta të barabarta dhe se populli duhet ta zgjedhë pushtetin. Edhe pse u shoqërua me uri, dhunë dhe paqëndrueshmëri, ai e shfuqizoi rendin e vjetër dhe privilegjet feudale që e kishin ndarë popullsinë për shekuj me radhë.

Ndryshe nga Lufta Amerikane për Pavarësi, e cila e ndryshoi kryesisht situatën vetëm në Shtetet e Bashkuara, idetë e Revolucionit Francez u përhapën në të gjithë Evropën dhe nxitën ndryshime në shumë vende.



Maksimilian Robespieri

Mëso më shumë



Gjatë Revolucionit Francez, revolucionarët vendosën se nuk mjaftonte vetëm që ta ndryshonin pushtetin - duhej ta ndryshonin edhe kohën. Kalendar i vjetër u shfuqizua sepse u kujtonte atyre monarkinë dhe kishën. Në vend të kësaj, u prezantua një kalendar revolucionar me javë 10-ditore dhe pushim vetëm çdo të dhjetën ditë. Ditët nuk quheshin më e hënë, e martë, e premte ose e shtunë, as nuk u emëruan sipas shenjtoreve, por u emëruan sipas bimëve, kafshëve dhe veglave. Kështu, ekzistonte dita e patateve, dita e deleve dhe madje edhe dita e shatit.

Ndryshimet arritën edhe tek ora. Dita ndahej në 10 orë, dhe çdo orë kishte 100 minuta dhjetore dhe zgjaste 144 minuta të zakonshme. Por, ndërsa shteti numëronte sipas së resë, populli vazhdonte të jetonte sipas së vjetrës. Ata i festonin fshehurazi festat e vjetra, derisa vetë autoritetet hoqën dorë nga ky eksperiment.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Cilat ishin shkaqet kryesore për shpërthimin e Revolucionit Francez?
2. Pse sulmi ndaj Bastijës konsiderohet si fillimi i Revolucionit Francez?
3. Përmend disa nga ndryshimet që ndodhën me Revolucionin Francez?

Luftërat e Napoleonit dhe Kongresi i Vjenës

Lartësimi i Napoleon Bonapartit

Pas Revolucionit Francez, Evropa u trondit nga trazira dhe luftëra të shpeshta. Gjatë atyre viteve të trazuara, **Napoleon Bonaparti** u bë i famshëm, duke u bërë shpejt një nga figurat më me ndikim të kohës së tij.

Lartësimi i tij ishte e pazakontë për kushtet evropiane të kohës. Ai nuk vinte nga ndonjë familje mbretërore, por përparoi falë talentit dhe guximit të tij ushtarak. Ai u bë i famshëm fillimisht si gjeneral, dhe më vonë e mori pushtetin në Francë dhe në vitin 1804 u shpall **perandor**.

Gjatë kurorëzimit të tij, në të cilin mori pjesë edhe Papa, Napoleoni e vendosi vetë kurorën në kokën e tij. Me këtë akt, ai donte të tregonte se pushteti i tij nuk rridhte nga kisha apo traditat e vjetra, por nga ushtria dhe mbështetja e popullit.

Luftërat e Napoleonit dhe rezistenca ndaj tyre

Luftërat e zhvilluara nga Perandoria Franceze nën udhëheqjen e Napoleon Bonapartit njihen si **Luftërat e Napoleonit**. Ato zgjatën për më shumë se një dekadë dhe e përfshinë pjesën më të madhe të Evropës. Në to, Franca luftoi kundër monarkive të vjetra evropiane, të cilat donin t'i ndalonin ndryshimet e filluara nga Revolucionit Francez.

Në vitet e para të Luftërave të Napoleonit, ushtria franceze ishte fitimtare dhe përparonte me shpejtësi në të gjithë Evropën. Napoleoni luajti një rol të rëndësishëm në këtë, pasi u dallua si një komandant dhe strateg i shquar ushtarak. Ai dinte të merrte vendime të shpejta, ta vendoste me mjeshtëri ushtrinë e tij në fushën e betejës dhe shpesh i habiste kundërshtarët e tij. Për shkak të kësaj mënyre luftimi, ushtria e tij u konsiderua e pamposhtur për një kohë të gjatë.

Pushtimet franceze në Evropë u shoqëruan me ndryshime të mëdha. Në shumë vende, taksat feudale dhe privilegjet e fisnikërisë u shfuqizuan. Rëndësi të veçantë kishte **Kodi i Napoleonit**. Ai përcaktonte se njerëzit ishin të barabartë para ligjit dhe se prona e tyre nuk mund të merrej lehtë. Shumë veta ndien për herë të parë se ligji i mbronte vërtet dhe se nuk ishin thjesht të nënshtruar ndaj qeverisë.



Napoleon Bonaparti në rininë e tij



Kurorëzimi i Napoleonit

Dëshmi historike



Për gjeniun ushtarak dhe ndikimin e madh të Napoleon Bonapartit u shprehën pozitivisht ushtarët dhe oficerët e tij, por edhe kundërshtarët e tij.

Një oficer francez shkroi se pamja e Napoleonit e rriti shumë moralin e ushtarëve, duke i bërë ata të gatshëm ta ndiqnin atë edhe në betejat më të vështira.

Kundërshtari i tij i madh, gjenerali britanik, Duka i Uellingtonit, vërejt:

"Prania e Napoleonit në fushën e betejës ishte sikur të kishe dyzet mijë ushtarë të tjerë."

Me pushtimet e tij, Napoleoni e ndryshoi ndjeshëm edhe **hartën politike të Evropës**. Ai e shfuqizoi ekzistencën e disa shteteve, krijoi të reja dhe i ndryshoi kufijtë sipas interesave të Francës. Në tokat italiane dhe gjermane, si dhe në territorin e Polonisë, u krijuan shtete të reja, ndërsa zona të tjera u vunë nën sundimin francez.

Në krye të disa prej këtyre shteteve Napoleoni i vendosi të afërmit dhe bashkëpunëtorët e tij të ngushtë. Vëllezërit e tij u bënë mbretër në Spanjë, Holandë dhe vende të tjera. Për shkak të kësaj, sundimi francez shihej gjithnjë e më shumë si një fuqi e imponuar dhe e huaj.



Evropa në vitin 1810

Shumë popuj, të cilët fillimisht e mbështetën Napoleonin dhe e shihnin atë si çlirimtar, me kalimin e kohës filluan ta perceptonin Francën si **pushtuese**. Rezistenca lindi në disa vende, veçanërisht në Spanjë, ku grupet guerile luftuan ashpër kundër ushtrisë franceze. Sundimi i huaj, i imponuar nga Franca, zgjoi te disa popuj evropianë **dëshirën për shtetin e tyre**.

Fjalë dhe terma të panjohur



Guerile - Formë lufte në të cilën grupe të vogla luftëtarësh sulmojnë nga prita, shkatërrojnë rrugë, ura ose depo dhe pastaj tërhiqen shpejt. Kjo formë lufte përdoret më shpesh kundër një ushtrie më të madhe dhe më të fortë.



Napoleoni në miniaturë (karikaturë)



Napoleoni si simbol i fuqisë

E kaluara në të tashmen



Gjatë kohës së Luftërave të Napoleonit, luftë u zhvillua edhe nëpërmjet medias. Gazetat britanike e portretizuan Napoleonin si një tiran të vogël, qesharak dhe të rrezikshëm, ndërsa media franceze e portretizoi atë si udhëheqës të madh ushtarak dhe hero. Në këtë mënyrë, të dyja palët u përpoqën të ndikonin në opinionin publik.

Pse i njëjti person u portretizua ndryshe në gazetatat britanike dhe franceze?

A mund të kenë edhe sot mediat ndikim mbi opinionin publik?

Bllokada Kontinentale dhe fushata kundër Rosisë

Kundërshtari më i madh i Napoleon Bonapartit ishte Britania e Madhe. Për shkak të superioritetit të flotës britanike, Napoleoni nuk mundi ta mposhte atë në luftë detare. Prandaj, ai u përpoq ta dobësonte Britaninë ekonomikisht duke e ndaluar tregtinë me mallrat britanike, e njohur si **Bllokada Kontinentale**.

Kjo masë ishte e vështirë për t'u zbatuar dhe nuk i dha rezultatet e pritura. Në vend që ta detyronte Britaninë e Madhe të kapitullonte, bllokada kontinentale i goditi më rëndë vendet evropiane. Disa prej tyre vareshin nga tregtia me Britaninë dhe përballeshin me mungesa të tekstileve, kafesë, sheqerit dhe produkteve të tjera koloniale.

Një nga momentet përcaktuese të rënies së Napoleonit ishte **fushata e tij kundër Rosisë** në vitin 1812. Ai synonte ta detyronte Rusinë ta ndërpriste tregtinë me Britaninë e Madhe dhe të parandalonte një aleancë midis dy kombeve të fuqishme. Për këtë qëllim, ai mbledhi një ushtri masive prej rreth 600,000 ushtarësh, të njohur si **Ushtria e Madhe**.

Ushtria ruse e shmangte betejën vendimtare. Në vend të kësaj, ajo u tërhoq, duke i shkatërruar ushqimet dhe fshatrat pas vetes, duke e lënë ushtrinë franceze pa furnizime.

Kur Napoleoni arriti në Moskë, trupat e tij e gjetën qytetin të zbrazët dhe në flakë. I përballur me urinë dhe dimrin e ashpër rus, ai u detyrua të tërhiqej. Tërheqja u shndërrua në një katastrofë për shkak të motit të ftohtë, sëmundjeve dhe sulmeve të vazhdueshme ruse. Nga Ushtria e Madhe mbijetuan më pak se 100,000 ushtarë.

Disfata e ushtrisë franceze në Rusi i inkurajoi kombet evropiane të bashkohen kundër një armiku të përbashkët. Në vitin 1813, Napoleoni u mund në **Betëjën e Kombeve** në Laipcig, ndërsa vitin pasardhës ai u internua në ishullin e Elbës. Edhe pse u rikthye shkurtimisht në pushtet në vitin 1815, disfata e tij në **Betëjën e Vate-rlosë** e shënoi fundin e sundimit të tij. Ai u kap dhe u internua në ishullin e largët të Shën Helenës, ku vdiq në vitin 1821.

Njihju me një figurë historike



Pas disfatës së Prusisë nga Napoleoni në vitin 1806, disa shtete gjermane e humbën pavarësinë e tyre. Shumë prusianë e panë këtë si poshtërim.

Në kushte të tilla, u dallua **Ferdinand fon Shill**, një oficer prusian që refuzoi ta pranonte sundimin francez. Në vitin 1809, me një grup të vogël ushtarësh, ai u largua vullnetarisht nga ushtria prusiane dhe nisi një kryengritje.

Kur e pyetën pse po shkonte drejt vdekjes së sigurt, ai u përgjigj: *"Më mirë një fund i tmerrshëm sesa një tmerr i pafund!"*

Kryengritja u shtyp dhe Ferdinand fon Shill u vra në betejë.



Tërheqja e ushtrisë së Napoleonit nga Rusia



Napoleoni në Shën Helenë

Kongresi i Vjenës

Në vitin 1814, pasi Napoleoni u internua në ishullin e Elbës, përfaqësues të disa vendeve evropiane u mbledhën në **Kongresin e Vjenës**. Qëllimi i tyre ishte të vendosnin paqen në Evropë dhe ekuilibër midis shteteve, në mënyrë që asnjë vend të mos bëhej shumë i fuqishëm, siç ishte Franca gjatë kohës së Napoleonit.

Në Kongres, i cili zgjati deri në vitin 1815, u vendos që të riktheheshin në pushtet familjet mbretërore që ishin dëbuar gjatë Revolucionit Francez dhe Luftërave të Napoleonit. Në të njëjtën kohë, u bënë **ndryshime të kufijve shtetërorë në Evropë**. Franca u rikthye në afërsisht të njëjtët kufij si para Revolucionit. Nga ana tjetër, shumë territore që më parë kishin qenë nën sundimin e saj iu dhanë vendeve të tjera evropiane.

Në Kongresin e Vjenës u vendos paqja, por pa i marrë parasysh dëshirat e shumë kombeve evropiane, të cilat edhe më tej mbetën të nënshtruara.

Megjithatë, Luftërat e Napoleonit kishin rëndësi të madhe historike. Përmes tyre, idetë e përkatësisë ndaj popullit të vet dhe barazisë para ligjit u përhapën në të gjithë Evropën. Gjatë shekullit XIX, këto ide do të bëheshin baza për luftërat e shumë popujve për t'i krijuar shtetet e tyre.



Evropa pas Kongresit të Vjenës

Mëso më shumë



Kongresi që vallëzonte

Gjatë Kongresit të Vjenës (1814-1815), në Vjenë u organizuan shumë ballo, pritje dhe festa. Bashkëkohësit bënë shaka se “*Kongresi nuk mban seanca, por vallëzon*”. Pjesëmarrësit e Kongresit të Vjenës shpesh diskutonin çështje të rëndësishme në një atmosferë të relaksuar, jashtë dhomave të mbledhjeve. Ndërkohë që vallëzonin, vendosnin për fatin e shumë kombeve evropiane.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Si e ndryshuan Evropën Luftërat e Napoleonit dhe pse në shumë vende lindi rezistenca kundër sundimit francez?
2. Pse Napoleoni e sulmoi Rusinë dhe si përfundoi ajo fushatë?
3. Çfarë vendimesh u morën në Kongresin e Vjenës?

Revolucioni i Parë Industrial

Në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, filloi një nga proceset më të rëndësishme në historinë e shekullit të ri, i njohur si **Revolucioni i Parë Industrial**. Ai solli ndryshime të mëdha në mënyrën e punës, prodhimit dhe jetën e përditshme të popullsisë.

Revolucioni industrial nuk ishte një revolucion si ato që i lidhim me luftëra dhe kryengritje. Ai nuk përfshinte luftë kundër sundimtarëve dhe nuk ndodhi e gjitha menjëherë. Ndryshimet ndodhën gradualisht, gjatë shumë dekadave. Megjithatë, për shkak të rëndësisë së tij të madhe dhe pasojave afatgjata, historianët e quajnë atë revolucion.

Britania e Madhe si fuqia e parë industriale

Para fillimit të Revolucionit të Parë Industrial, ndodhën ndryshime të rëndësishme në bujqësi në Evropën Perëndimore. Duke futur mënyra të reja të kultivimit të tokës, prodhimi i ushqimit u rrit. Ky proces quhet **revolucion agrar**. Në disa zona, kjo çoi në më pak uri, por edhe në krijimin e pronave të mëdha tokësore. Si rezultat, shumë fshatarë mbetën pa tokë dhe u detyruan të **shpërnguleshin në qytete**, ku u punësuan në fabrikat e reja dhe punuan për paga të ulëta. Në këtë mënyrë, u krijuan parakushtet për shfaqjen e Revolucionit Industrial.

Ndërlidhi njohuritë



Çfarë ju vjen ndërmend kur e dëgjoni fjalën “revolucion”? Për cilat revolucione keni mësuar deri më tani?

E kaluara përmes burimeve



Uilliam Kobet “Udhëtime nëpër fshatra” (1823)

“Jeta e fshatarëve është ‘gërmo, gërmo dhe përsëri nga fillimi’... nga lindja deri në perëndim të diellit... e megjithatë vështirë se mbetet një copë proshutë për ata që e prodhojnë të gjithë ushqimin.”

Intervistë me Elizabet Bentli, punëtore e fabrikës së tekstilit (1832)

- Kur filluat të punonit në fabrikë?

E: Kur isha gjashtë vjeçe.

- Çfarë bënit?

E: Unë i ndërroja bobinat e makinave.

- Sa orë punonit?

E: Nga ora pesë e mëngjesit deri në orën nëntë të darkës.

- A kishit kohë të hani mëngjes ose të pini diçka?

E: Jo, hanim ndërkohë që mbërrinim atje.

Çfarë ishte e zakonshme në jetën e përditshme të fshatarëve dhe punëtorëve të fabrikës, edhe pse ata punonin në mjedise të ndryshme?



Fabrikë tekstili në shekullin XVIII

Revolucioni i Parë Industrial **filloi në Britaninë e Madhe**, sepse kishte kushte të favorshme që nuk ishin të disponueshme në vendet e tjera evropiane. Vendi kishte depozita të pasura **qymyri dhe hekuri**, të cilat ishin të nevojshme për funksionimin e makinerive dhe ndërtimin e fabrikave. Në të njëjtën kohë, Britania ishte një **fuqi e madhe koloniale**. Lëndët e para, veçanërisht pambuku, vinin nga kolonitë dhe produktet e gatshme shiteshin lehtësisht në tregjet e mëdha anembanë botës. Kjo e rriti nevojën për prodhim më të madh dhe më të shpejtë.

Në Britani kishte gjithashtu shumë njerëz me para që ishin të gatshëm të investonin në makineri, fabrika dhe zbulime të reja shkencore. Për të gjitha këto arsye, pikërisht në Britaninë e Madhe u krijuan **shpikjet më të rëndësishme** që e nxitën Revolucionin e Parë Industrial dhe vendi u bë i njohur si **“punishtja e botës”**.

Shpikjet më të rëndësishme

Ndryshimet e para ndodhën në prodhimin e tekstileve. **Xhon Kej** e shpiku **“Çikrikun fluturues”**, i cili e përshepteoi ndjeshëm endjen. Një endës mund të prodhonte shumë më tepër pëlhurë në të njëjtën kohë sesa më parë. Por kjo krijoi një problem të ri. Tjerrja me dorë nuk mund ta përballonte më ritmin në rritje të punës, që do të thoshte se makinat po bëheshin të nevojshme.

Në vitet '60, u shpik makina e tjerrjes e njohur si **“Xheni”**. Me të, një person mund të prodhonte shumë më tepër material në një kohë të shkurtër sesa me dorë. Shpejt u prezantua **tezgjahu mekanik**, gjë që e bëri endjen të



Makina tjerrëse „Xheni“ u krijua nga anglezi Xhejms Hargrivs



Qytet në Britaninë e Madhe gjatë Revolucionit të Parë Industrial

Mëso më shumë



Gjatë Revolucionit të Parë Industrial, u zhvillua një sistem ekonomik i quajtur **kapitalizëm**, në të cilin njerëzit me kapital (para, tokë, fabrika dhe makineri) i investonin burimet e tyre për të nxjerrë fitim. Ata quheshin kapitalistë. Në këtë sistem, fabrikat dhe prodhimi ishin në pronësi private dhe punëtorët punonin për pagë.

A ekziston kapitalizmi ende sot dhe ku mund ta dallosh atë në jetën e përditshme?




Edmund Kartrajt – shpikësi i tezgjahu mekanik

mekanizuar. Me këto ndryshime, artizanati u zëvendësuan gradualisht nga puna me makineri dhe prodhimi i tekstilit u zhvendos nga punishtet artizanale në fabrika.

Risia më e rëndësishme teknologjike e Revolucionit të Parë Industrial ishte **motori me avull**, i përsosur nga **Xhejms Vat**. Ai u mundësoi fabrikave të vepronin në mënyrë të pavarur nga fuqia e lumenjve dhe erës, sepse e përdorte avullin e prodhuar nga qymyri për shtytje. Motori me avull filloi të përdorej për herë të parë në fabrika dhe miniera. Ai e bëri prodhimin më të shpejtë, më të lirë dhe në sasi shumë më të mëdha.

Motori me avull pati gjithashtu një ndikim të fuqishëm në transport. Filluan të ndërtoreshin **vaporë**, të cilët funksiononin me motor me avull dhe, ndryshe nga anijet me vela, nuk vareshin nga era dhe kushtet e motit. Në këtë mënyrë, kohët e udhëtimit u shkurtuan ndjeshëm. Kjo i forcoi lidhjet midis vendeve të largëta dhe e mundësoi lëvizjen më të shpejtë të mallrave, njerëzve dhe ideve.

Në fillim të shekullit XIX, u arrit përparim i madh edhe në transportin tokësor. Në vitin 1825, inxhinieri anglez **Xhorxh Stivenson** e vuri në përdorim linjën e parë hekurudhore publike, në të cilën përdoreshin **lokomotiva me avull**. Me këtë filloi zgjerimi i shpejtë i hekurudhës. Në vend të mjeteve të mëparshme të transportit të ngadaltë, siç ishin qerret dhe karrocet, lokomotivat me avull e bënë të mundur udhëtimin në distanca më të gjata më shpejt, më lirë dhe më të sigurt.



„Raketa“, një nga lokomotivat e para me avull në botë (1829)

Idetë e botës moderne



Kur u shfaqën trenat e parë, popullsia nuk kishte përvoja të mëparshme me shpejtësi të larta. Deri atëherë, transporti më i shpejtë tokësor ishte karroca e tërhequr nga kuajt. Prandaj, shumë kishin frikë se trupi nuk do të ishte në gjendje t'i rezistonte shpejtësisë dhe trenat mund të shpërthenin ose të dilnin nga shinat.

Ashtu siç njerëzimi në shekullin XIX kishte frikë nga trenat, edhe sot ekziston frika nga teknologjitë moderne. Disa kanë frikë nga inteligjenca artificiale ose procedurat e reja mjekësore. Historia tregon se shpikjet e reja shpesh së pari ngjallin frikë dhe më pas bëhen pjesë e jetës së përditshme.

Nga anijet me vela te vaporët: sa është shkurtuar koha e udhëtimit?

Relacioni	Anije me vela	Vapori	Dallimi
Londër-Nju Jork	6-8 javë	10-14 ditë	3 deri në 5 herë më shpejt
Selanik-Stamboll	5-7 ditë	1.5-2 ditë	3 deri në 4 herë më shpejt

Pasojat dhe rezistenca ndaj Revolucionit të Parë Industrial

Ndryshimet industriale patën ndikim të madh në ekonomi dhe në jetën e përditshme. Zhvillimi i fabrikave mundësoi rritje të shpejtë të popullsisë urbane, një proces i njohur si **urbanizim**.

Rritja e shpejtë e qyteteve shpesh shoqërohej me kushte të vështira jetese. Në shumë qytete industriale, ajri dhe uji ndoteshin nga fabrikat dhe djegia e qymyrit. Punëtorët shpesh punonin 12 deri në 16 orë në ditë dhe merrnin paga shumë të ulëta. Shumë familje jetonin në banesa të vogla e të mbipoplluara, pa kanalizime ose kujdes të duhur shëndetësor publik. Në fabrika shpesh punësoheshin **gra dhe fëmijë**, pasi puna e tyre paguhej më pak.

Te disa nga punëtorët u shfaq frika se për shkak të makinerive do të bëheshin të panevojshëm. Në fillim të shekullit XIX, punëtorët e njohur si **ludistë** u shfaqën në Britaninë e Madhe, të cilët i shkatërronin makineritë sepse besonin se po ua merrnin vendet e punës.

Revolucioni i parë industrial solli ndryshime të mëdha në jetën e përditshme. Gjithnjë e më shumë njerëz në Britani dhe në Evropën Perëndimore po e braktisnin jetën në fshat dhe punën në arë dhe u drejtuan për në qytete dhe fabrika. Me këtë filloi tranzicioni gradual nga mënyra tradicionale e jetesës në mënyrën industriale, e cila më vonë do të përhapej në vende të tjera në Evropë dhe në botë.

Sfidë për hulumtim



Ludistët e morën këtë emër sepse, pasi i shkatërronin makineritë, linin mesazhe të shkruara në fabrika ose punishte, të nënshkruara me emrin “Ned Lud”.

Hulumto nëse Ned Lud ishte figurë e vërtetë historike.



Puna e fëmijëve në fabrikë



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Pse Revolucioni i Parë Industrial filloi në Britaninë e Madhe?
2. Renditi shpikjet më të rëndësishme të Revolucionit të Parë Industrial.
3. Pse disa punëtorë iu kundërvunë makinerive gjatë Revolucionit të Parë Industrial?

Kombi dhe identiteti kombëtar në Evropë

Populli dhe kombi

Për pjesën më të madhe të së kaluarës, **ndjenja e përkatësisë** përjetohej ndryshe nga sa përjetohej sot. Shpesh lidhej me familjen, fshatin ose qytetin, fenë ose sundimtarin. Pra, nëse dikush i pyeste “çfarë je?”, njerëzit më shpesh përgjigjen: “Unë jam i krishterë”, “Unë jam mysliman” ose “Unë jam i nënshtruar i mbretit”.

Përveç kësaj, ekzistonte edhe një ndjenjë përkatësie ndaj një populli. **Populli** është një bashkësi njerëzish që ndajnë një gjuhë, histori, kulturë dhe zakone të përbashkëta. Popujt mund të ekzistojnë pa shtetin e tyre dhe të jetonin për shekuj brenda mbretërive ose perandorive të sunduara nga sundimtarë të huaj.

Në shekujt XVIII dhe XIX, në Evropë filluan të përhapeshin ide të reja rreth shtetit dhe qeverisjes. Besohej gjithnjë e më shumë se shteti nuk ishte pronë personale e mbretërve dhe perandorëve, por se duhej të shihej si shtet i popullit. Me këtë filloi procesi në të cilin, te disa popuj, përkatësia nuk ishte më e lidhur vetëm me gjuhën ose zakonet, por edhe me shtetin.

Në kushte të tilla, u formuan gradualisht kombet. **Kombi** është një bashkësi njerëzish që e lidhin përkatësinë e tyre me idenë e shtetit të përbashkët. Ndryshe nga një popull, i cili mund të ekzistonte pa shtetin dhe institucionet e veta, te kombi, shteti bëhet pjesë e rëndësishme e përkatësisë. Krijimi i shtetit të vet, ose aspirata për ta krijuar shtetin e vet, është ajo që e dallon kombin nga populli.

Procesi i krijimit të kombeve nuk ndodhi njëkohësisht. Disa prej tyre u krijuan nga fundi i shekullit XVIII dhe gjatë shekullit XIX, ndërsa disa të tjerë në shekullin XX. Megjithatë, disa popuj ende nuk janë formuar si komb.

Kombi qytetar dhe etnik

Në Evropë, në shekullin e ri, ekzistojnë dy mënyra kryesore për krijimin e kombeve. **Kombi qytetar** krijohet kur njerëzit ndihen të lidhur sepse jetojnë në të njëjtin shtet, i respektojnë të njëjtat ligje dhe kanë të drejta e detyrime të ngjashme. Një shembull tipik i një kombi qytetar është Franca pas Revolucionit Francez. Atje, kushdo që e pranonte kushtetutën dhe ligjet konside-



Kombi si bashkësi e imagjinuar e grupeve të ndryshme të njerëzve (mural)



Kryeministri britanik Uilliam Pit i Riu (majtas) dhe Napoleon Bonaparti (djathtas) e ndajnë simbolikisht botën, pa i marrë parasysh interesat e popujve (karikaturë)

Mëso më shumë



Historiani Benedikt Anderson shpjegoi se kombi është një “bashkësi e imagjinuar”. Kjo do të thotë se nuk është diçka që mund ta shohim, por më tepër është ndjenjë përkatësie që ndahet nga disa individë. Ata shpesh nuk e njohin njëri-tjetrin personalisht, por prapëseprapë ndihen pjesë e të njëjtit komunitet. Kjo ndjenjë shpesh krijohet përmes gjuhës, arsimit, librave, simboleve dhe historisë.

rohej pjesë e kombit, pavarësisht nga origjina apo gjuha. Kështu, shteti luajti një rol kyç në krijimin e kombit qytetar.

Mënyra e dytë është **kombi etnik**. Këtu, në fillim, ekzistonte një popull me gjuhë, kulturë dhe histori të përbashkët, por pa shtetin e vet. Popuj të tillë jetonin më shpesh brenda perandorive të mëdha, ose në disa shtete. Me kalimin e kohës, zhvilluan vetëdije se ata vetë duhet ta organizonin shtetin e tyre. Kështu, së pari u krijua kombi, dhe më vonë shteti. Ky model ishte karakteristik për Gjermaninë, Italinë, shumicën e shteteve ballkanike dhe shumë vende të tjera.

Arsyet e shfaqjes së kombeve dhe identitetit kombëtar

Kombet u formuan nën ndikimin e Revolucionit Francez, Luftërave të Napoleonit dhe Revolucionit të Parë Industrial.

Revolucioni Francez e konfirmoi idenë se pushteti duhet t'i përkiste popullit, jo një sundimtari të vetëm. **Luftërat e Napoleonit** e përçollën këtë ide në të gjithë Evropën, por njëkohësisht e sollën edhe sundimin e huaj në vendet e pushtuara. Rezistenca ndaj sundimit të huaj, veçanërisht në Spanjë, në vendet gjermane dhe italiane, e forcoi bindjen se populli duhet të çlirohej prej tij dhe vetë ta qeveriste shtetin e tij.

Revolucioni Industrial e intensifikoi më tej këtë proces. Me zhvillimin e hekurudhës, anëtarët e të njëjtit popull nga rajone të ndryshme takoheshin gjithnjë e më shpesh dhe zbuluan se flisnin të njëjtën gjuhë dhe përballeshin me probleme të ngjashme. Prandaj, ideja se ata duhet të vendosnin së bashku për çështje me interes të përbashkët u forcua gradualisht, gjë që kontribuoi në krijimin e kombit.

Këto procese historike i krijuan kushtet për shfaqjen e kombeve, por **identiteti kombëtar** nuk u shfaq spontanisht. Ai u formua përmes gjuhës, kulturës, traditës dhe arsimit, dhe me kalimin e kohës nën ndikimin e **ideologjive kombëtare**. Në shekullin XIX, shumë vende e futën arsimin e detyrueshëm në gjuhën zyrtare të shtetit. Përmes teksteve shkollore, librave dhe gazetave, popullsia mësoi rreth historisë së shtetit dhe heronjve kombëtarë. Këngët, zakonet dhe festat popullore u paraqitën si simbole të përkatësisë së përbashkët ndaj kombit.



Franca – shembull tipik i kombit qytetar

E kaluara në të tashmen



Sot, Zvicra është shtëpia e njerëzve me prejardhje të ndryshme etnike. Në vend fliten gjermanisht, frëngjisht dhe italisht, por nuk ka një gjuhë të vetme të përbashkët që flitet nga të gjithë banorët. Pavarësisht kësaj, popullsia ndihet pjesë e të njëjtit komb.

Ashtu si sot, edhe në shekullin XIX, ndjenja e përkatësisë në Zvicër nuk bazohej në origjinën e përbashkët ose në një gjuhë të vetme, por në shtetin e përbashkët, ligjet e përbashkëta dhe vlerat e përbashkëta.

A është Zvicra shembull i kombit qytetar apo etnik?

Fjalë dhe terma të panjohur



Identiteti kombëtar - Ndjenja e përkatësisë ndaj një kombi.

Ideologji kombëtare - Një sërë idesh që shpjegojnë se çfarë e lidh një komb dhe pse ai e ka ose dëshiron të ketë shtetin e vet. Ideologjitë kombëtare ndonjëherë u janë imponuar popujve të tjerë, veçanërisht përmes arsimit, institucioneve kulturore dhe fetare.



Festimi i festës kombëtare në Paris në shekullin XIX



„Gjermania“ – përfaqësim simbolik i kombit gjerman në shekullin XIX

Nacionalizmi

Me shfaqjen e kombeve, u zhvillua edhe **nacionalizmi** - ideologji sipas së cilës përkatësia dhe besnikëria ndaj kombit dhe shtetit të vet vendosen para interesave të tjera personale ose grupe.

Në shumë raste, nacionalizmi ka luajtur **rol pozitiv**. Ai i ka ndihmuar njerëzit të bashkohen në luftën kundër sundimit të huaj, të ruajnë gjuhën dhe kulturën e tyre dhe të krijojnë shtete moderne.

Megjithatë, nacionalizmi pati edhe **pasoja negative**. Kur ndjenja e përkatësisë u shndërrua në besimin se kombi i vet ishte më i rëndësishëm se të tjerët, kjo çoi në jotolerancë, konflikt dhe luftë. Në Evropë, konflikte të tilla midis kombeve u bënë një nga shkaqet e luftërave të mëdha të shekullit XX.

Për shkak të shfaqjes dhe përhapjes së ideve dhe lëvizjeve kombëtare, shekulli XIX shpesh quhet **epoka e nacionalizmit**.



Piktura „2 Maj 1808“ nga Francisko Goja e përshkruan rezistencën e popullit spanjoll gjatë Luftërave të Napoleonit.

Mëso më shumë



Nacionalizmi nuk duhet ngatërruar me patriotizmin. Patriotizëm do të thotë dashuri dhe kujdes për vendin, gjuhën dhe kulturën e vet, pa dëshirën për t'ua imponuar ato njerëzve të tjerë. Nacionalizmi, nga ana tjetër, mund të shndërrohet në besim se kombi i vet duhet të jetë mbi të tjerët, gjë që shpesh çon në konflikt.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Çfarë është „kombi“ dhe çfarë e bën atë të ndryshëm nga „populli“?
2. Shpjegoje ndryshimin midis kombit qytetar dhe kombit etnik.
3. Cili ishte roli pozitiv i nacionalizmit dhe çfarë pasojash negative mund të shkaktojë ai?

Shkenca dhe kultura në Evropë dhe në botë nga mesi i shekullit XVII deri në mesin e shekullit XIX

Në Mesjetë, disa shkencëtarë, si Nikolla Koperniku dhe Galileo Galilei, shprehën dyshime rreth shpjegimeve të vjetra të natyrës dhe universit. Hulumtimet e tyre treguan se disa nga mësimet e pranuar nuk ishin të sakta, gjë që i solli ata në konflikt me kishën.

Në shekullin e ri, gradualisht u zhvillua **metoda shkencore**, e cila u bë themeli i shkencës moderne. Ajo bazohej në verifikimin e fakteve nëpërmjet vëzhgimit dhe eksperimenteve. Çdo pohim duhej të verifikohet dhe provohej më parë, dhe vetëm pastaj të pranohej si i saktë.

Kjo çoi në zhvillimin e shkencës dhe zbulimeve të reja, të cilat gjetën zbatim praktikë në industri, mjekësi dhe shumë fusha të tjera. Për shkak të ndryshimeve të mëdha që solli në shkencë dhe në jetën e përditshme, ky proces njihet si **Revolucioni Shkencor**.



Eksperiment në shekullin XVIII



Isak Njutoni

Zbulimet shkencore dhe zbatimet e tyre

Disa sundimtarë evropianë në shekullin e ri e kuptuan se njohuritë shkencore mund të kontribuonin në zhvillimin e ushtrisë, industrisë dhe ekonomisë. Në disa vende evropiane u themeluan shoqata shkencore, akademi dhe observatoriume. Si rezultat, shteti filloi të investonte në shkencë dhe shkencëtarët fituan prestigj më të madh në shoqëri.

Një nga shkencëtarët më të rëndësishëm të shekullit të ri ishte **Isak Njutoni**. Ai tregoi se natyra vepron sipas ligjeve të qarta që zbatohen kudo. Idetë e tij u bënë baza e shkencës dhe, nga fundi i shekullit XVIII dhe gjatë gjithë shekullit XIX, ato filluan të zbatoheshin gjithnjë e më gjerë në teknologji dhe industri, veçanërisht gjatë Revolucionit Industrial.

Nga fundi i shekullit XVII, filloi zhvillimi gradual i biologjisë si shkencë. Falë **mikroskopit**, studiuesit e zbuluan ekzistencën e mikroorganizmave që më parë ishin të panjohur. Këto zbulime kontribuan në shpjegimin gjithnjë e

Nëse ti do të ishe atje...



Imagjino se jeton diku në Evropë rreth vitit 1650.

Nuk ka ndriçim rrugor, as trena apo makina, as vaksina. Shtëpitë ndriçohen nga qirinj. Udhëtimi është i ngadaltë dhe i rrezikshëm. Pak njerëz udhëtojnë më larg sesa qyteti fqinj. Sëmundjet shpesh janë vdekjeprurëse. Në qytete, uji i pijshëm nuk është i pastër dhe mbeturinat hidhen në rrugë ose në një lumë aty pranë. Rrugët janë kryesisht prej dheu dhe me baltë. Fenomenet natyrore si rrufeja, thatësisht ose epidemitë shpjegohen si ndëshkim nga Zoti ose diçka mbinatyrore.

Cila do të ishte gjëja më e vështirë për ty në jetën e përditshme në vitin 1650 dhe pse?

Çfarë mendon se ka ndryshuar më shumë në dyqind vitet e fundit? Jep dy shembuj.



Eduard Xhener i bën vaksinën e parë tetëvjeçarit Xhejms (1796)

më të madh të sëmundjeve me shkaqe natyrore, në vend që të ishin pasojë e ndëshkimit hyjnor ose “ajrit të keq” që vinte nga kënetat, papastërtitë dhe mbeturinat në dekompozim.

Në gjysmën e dytë të shekullit XVIII dhe gjysmën e parë të shekullit XIX, përparimet në **kimi dhe mjekësi** mundësuan trajtim dhe parandalim më efektiv të sëmundjeve. Me rëndësi të veçantë ishte zbulimi i vaksinës së parë të suksesshme kundër lisë, e cila shpëtoi mijëra jetë.

Në shekullin XIX, shkencë kishte një zbatim masiv në jetën e përditshme. Siç e pamë në një nga mësimet e mëparshme, motori me avull dhe zhvillimi i hekurudhës mundësuan prodhim më të shpejtë dhe transport më efikas të njerëzve dhe mallrave. Shpikjet shkencore gjithashtu e mundësuan rritjen e qyteteve, të cilat u bënë qendra të arsimit, kulturës dhe arteve.



Sheshi Trafalgar në Londër rreth vitit 1835



Mikroskop i shekullit XVII

Mëso më shumë



Gjenitë dhe zbulimet e tyre

1668-1674 – Antoni van Levenhuk i ndërtoi mikroskopët e tij dhe ishte i pari që i vëzhgoi mikroorganizmat.

1687 – Isak Njutoni i publikoi tre ligjet e tij të lëvizjes dhe gravitetit universal.

1774-1777 – Antoan Lavoazje e shpjegoi dhe emërtoi oksigjenin dhe i hodhi themelet e kimisë moderne.

1796 – Eduard Xhener e kreu vaksinimin e parë të suksesshëm kundër lisë.

1800 – Alesandro Volta e krijoi baterinë e parë elektrike.

1831 – Majkël Faradei e zbuloi induksionin elektromagnetik.

Ndërlidhi njohuritë



Bisedo me mësuesin tënd të fizikës dhe mëso se si zbulimet e Isak Njutonit, Alesandro Voltës dhe Majkël Faradeit kanë kontribuar në përmirësimin e jetës në të kaluarën dhe sot.

Shkruaj të paktën dy shembuj.

Bisedo me mësuesin tënd të kimisë dhe mëso se si zbulimi i Antoan Lavoazjes ndikoi në zhvillimin e shkencës dhe të jetës së përditshme?

Përmend një shembull.

Kultura dhe arti deri në mesin e shekullit XIX

Rreth vitit 1650, kultura dhe arti në Evropë ishin të lidhura ngushtë me pushtetin dhe kishën. Veprat e artit më shpesh përshkruanin sundimtarë dhe skena fetare. Në shekujt XVIII dhe XIX, nën ndikimin e Iluminizmit dhe zhvillimin e arsimit dhe shtypit, kultura u bë më e arritshme për një rreth më të gjerë njerëzish. Ajo filloi të merrej me tema të jetës së përditshme, duke i kushtuar vëmendje gjithnjë e më të madhe njeriut të zakonshëm.

Këto ndryshime ishin më qartë të dukshme në art. Në shekullin XVIII, dominoi **klasicizmi**. Artistët u frymëzuan nga temat e antikitetit, në të cilat figurat përshkruhen pa emocione të theksuara.

Në fund të shekullit XVIII u shfaq **neoklasicizmi**. Arti përshkruante ngjarje të rëndësishme shtetërore dhe politike nga e kaluara, si dhe nga koha në të cilën jetuan artistët. Vepra të tilla u krijuan nga piktori **Zhak-Luis David**, puna e të cilit ishte e lidhur ngushtë me Revolucionin Francez.

Në shekullin XIX u zhvillua **romantizmi**. Në këtë drejtim në pikturë, artistët i vunë ndjenjat në plan të parë, kurse natyra, liria dhe njerëzit u bënë tema qendrore.

Ndryshime të mëdha ndodhën edhe në **muzikë**. Deri në fillim të shekullit XVIII, kompozitorët punonin kryesisht me porosi dhe krijonin muzikë për kishën dhe oborret mbretërore. Me kalimin e kohës, muzika u bë më e arritshme për publikun e gjerë dhe filluan të mbaheshin koncerte të hapura për audienca nga klasa të ndryshme shoqërore. Kompozitorët fituan liri më të madhe shprehjeje, e cila dëgjohet qartë në veprat e **Volfgang Amadeus Mozartit** dhe, mbi të gjitha, në muzikën e **Ludvig van Bethovenit**.

Në shekullin XVIII dhe fillimin e shekullit XIX, letërsia fitoi një audiencë të re. Për shkak të rritjes së aftësisë për të shkruar dhe lexuar, më shumë njerëz mund të lexonin. Librat u bënë më të arritshëm. Në vend që të shkruanin për sundimtarët dhe temat fetare, shkrimtarët filluan të shkruanin për jetën e përditshme dhe njeriun e zakonshëm. Romani u shfaq si një zhanër i rëndësishëm letrar dhe ngjarjet historike në romane shpesh përshkruheshin përmes historive për popullin dhe heronjtë e tij. Ndikim të madh në zhvillimin e romanit patën autorët **Daniel Defo** dhe **Valter Skot**.



Klasicizmi – „Hyrja e Aleksandërit në Babiloni“ nga Sharl Lebrun



Neoklasicizëm – „Napoleoni i kalon Alpet“ nga Zhak-Luis David

Mëso më shumë



Bethoveni fillimisht e konceptoi Simfoninë e tij të Tretë si një dedikim për Napoleon Bonapartin, të cilin e shihte si simbol të lirisë. Kur në vitin 1804 mësoi se Napoleoni e kishte shpallur veten perandor, Bethoveni e fshihi përkushtimin nga dorëshkrimi dhe thirri: “Napoleoni është thjesht një tiran”.

Çfarë na tregon shembulli i Bethovenit rreth marrëdhënies midis kompozitorëve dhe pushtetit në Shekullin e Ri?

Me përhapjen e shkrimit e leximit dhe kulturës, u zhvillua edhe jeta kulturore publike. **Gazetat** u bënë burimi kryesor i informacionit. Teatrot dhe muzetë u shndërruan në vende ku qytetarët mblidheshin, mësonin dhe shkëmbenin ide. Kështu, u krijua një **kulturë publike** në të cilën jeta kulturore nuk ishte më privilegj i pak njerëzve.

Kultura kombëtare

Kultura luajti një rol të rëndësishëm në **krijimin e kombeve**. Shumë njerëz të arsimuar besonin se çdo popull kishte “shpirtin e vet popullor”, gjë që njihej më qartë në të folurit, këngët popullore, tregimet dhe zakonet që transmetoheshin brez pas brezi. Në disa vende evropiane, filloi mbledhja dhe regjistrimi i këngëve dhe tregimeve popullore. Ajo që më parë konsiderohej art i zakonshëm popullor, gradualisht u bë pjesë e **kulturës kombëtare**.



Vëllezërit Grim



Wolfgang Amadeus Mozart me motrën e tij Maria Ana

E kaluara në të tashmen



Në fillim të shekullit XIX, vëllezërit Grim mblodhën dhe shkruan tregime popullore që ishin transmetuar gojariht brez pas brezi. Ata udhëtuan, biseduan me njerëz nga rajone të ndryshme dhe regjistruan me kujdes tregime dhe legjenda popullore. Edhe pse në atë kohë nuk kishte një shtet të bashkuar gjerman, këto tregime ndihmuan në krijimin e një lidhjeje kulturore midis gjermanëve.

Cilat tregime nga vëllezërit Grim i di?

Pse tregimet e shkruara më shumë se dyqind vjet më parë lexohen ende sot?




Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Çfarë nënkupton me termin Revolucion Shkencor?
2. Cilat ishin zbulimet më të rëndësishme shkencore nga mesi i shekullit XVII deri në mesin e shekullit XIX?
3. Çfarë ndryshimesh të mëdha ndodhën në kulturë dhe art deri në mesin e shekullit XIX?

BALLKANI DHE MAQEDONIA

NGA SHEKULLI XVIII DERI NË KRIZËN E
MADHE LINDORE

2



Perandoria Osmane dhe Ballkani deri në Krizën Lindore

Perandoria në Krizë

Gjatë shekujve XVIII dhe XIX, Perandoria Osmane u përball me një krizë të madhe si të brendshme ashtu edhe të jashtme. Për shkak të rënies së sistemit timar-spahi shteti e humbi ushtrinë e tij fitimtare. Kjo rezultoi me një **seri disfatash ushtarake dhe humbje të përhershme të territorit**.

Perandoria filloi të mbetej dukshëm prapa trendeve evropiane. Falë Revolucionit Industrial, vendet perëndimore u zhvilluan dhe u pasuruan më shumë. Ndërkohë që feudalizmi po shembej në Evropë dhe idetë e Iluminizmit po shfaqeshin, Perandoria Osmane mbeti e bllokuar në institucionet e saj mesjetare. Korpusi i jeniçerëve, i cili më parë kishte qenë forca goditëse e ushtrisë osmane, u bë pengesë për modernizimin e vetë shtetit. Jeniçerët ngrinin **revolta** dhe i zëvendësonin sulltanët që nuk u përshtateshin atyre.

Në të njëjtën kohë, **lëvizjet çlirimtare** midis popujve të nënshtruar u intensifikuan. Për shkak të dështimeve ushtarake, Perandoria vazhdimisht hynte në borxhe ndaj vendeve evropiane. Kjo rezultoi me **falimentimin e shtetit** dhe humbjen e pavarësisë së tij ekonomike. Fuqitë evropiane e përdorën dobësimin e Perandorisë për të ndërhyrë në punët e saj të brendshme. Territori i gjerë në tre kontinente filloi të shpërbëhej ngadalë dhe një shpërbërje e tillë zgjati deri në fillim të shekullit XX.

Koha e Ajanëve

Duke përfituar nga qeveria e dobët qendrore dhe kaosi në shtet, disa feudalë vendas arritën të forcoheshin dhe të pasuroheshin. Ata filluan të vepronin si sundimtarë të pavarur të zonave nën kontrollin e tyre. Këta burra të fuqishëm vendas quheshin **Ajanë** (paria). Ata kishin ushtrinë e tyre dhe luftonin me njëri-tjetrin për t'i zgjeruar territoret e tyre. Shteti nuk kishte kontroll mbi ta.

Feudalë të tillë gjysmë të pavarur vendas ekzistojnë në disa rajone. Në veriperëndim të Shqipërisë, u fuqizua familja e **Bushatllinjve**, ndërsa në jug, me qendër në Janinë, sundonte **Ali Pasha i Janinës**. Në Maqedoni, disa nga ajanët më të famshëm ishin **Xheladin Beu**,



Banketi i sulltanit në nder të jeniçerëve (miniaturë) – pranimi i ushqimit e simbolizonte besnikërinë e jeniçerëve ndaj sulltanit, kurse refuzimi shpesh e nënkuptonte fillimin e revoltës

Mëso më shumë



Për shkak të krizës në të cilën ndodhej Perandoria Osmane, cari rus Nikollaj I e përshkroi vendin si “I sëmuri i Bosforit”.

Sfidë për hulumtim



Përpiqu të gjeësh informacione në internet rreth Kalasë së Tetovës!

Hulumto dhe përgjigju:

Kujt i përkiste kalaja e Tetovës gjatë kohës së Ajanëve?

Pse dhe nga kush u shkatërrua fortesa?



Konakët e Havzi Pashës – pjesë e pronës së ajanit të Shkupit
Havzi Pasha

i cili sundonte në rajonin e Ohrit dhe **Ismail Beu** në rajonin e Serit. Shteti ndërmori disa fushata për t'u marrë me këto probleme, por të gjitha përfunduan pa sukses.

Reformat në shtet

Si rezultat i disfatave ushtarake, krizës ekonomike dhe kaosit që e përfshiu Perandorinë, sultanët osmanë filluan të zbatojnë reforma për ta përmirësuar situatën në vend. Ishte një proces i gjatë dhe kompleks, i shoqëruar nga një numër i madh revoltash dhe rezistence nga një pjesë e popullsisë. Përpjekjet e para të tilla u zhvilluan drejt fundit të shekullit XVIII. Për shkak të rezistencës ndaj reformave, Sulltan Mahmuti II i **goditi ashpër ajanët dhe i shfuqizoi trupat e jeniçerëve**.

Në vitin 1839, Sulltan Abdul Mexhiti I e shpalli të ashtuquajturin **Hatisherif i Gjulhanes**. Ky dokument për herë të parë e **shpalli barazinë e të gjithë nënshtetasve të shtetit**, pavarësisht nga feja, kombësia dhe statusi i tyre shoqëror. Kështu filloi epoka e reformave, të cilat u quajtën **Reformat e Tanzimatit**.

Për t'i thelluar reformat në Perandori, në vitin 1856 u lëshua i ashtuquajturi **Hatihumajun**. Ky dokument u miratua nën ndikimin e fuqive evropiane. Ai i zgjeroi të drejtat dhe liritë qytetare. U shpall **liria e fesë dhe liria e mendimit**. U lejua ekzistenca e institucioneve të tjera kishtarë krahas Patrikanës së Kostandinopojës.

Në frymën e këtyre reformave, popullsia e krishterë në Maqedoni filloi të organizohej në **komuna** të pavarura **kishtarë-shkolllore**. Ato u kujdesën për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e kishave, shkollave dhe ndërtesave



Sulltan Abdul Mexhiti I –
portret i vitit 1850

E kaluara përmes burimeve



“Jeta, nderi dhe prona e të gjithë nënshtetasve të shtetit tonë janë nën mbrojtjen e ligjit dhe askush nuk do të ndëshkohet ose ekzekutohet pa gjyq publik dhe procedurë të drejtë.” - Fragment nga teksti i Hatisherifit të Gjulhanes.

Cilat tre gjëra garantoj sultani se do t'i mbronte me ligj?

Si duhej të ndëshkoheshin njerëzit sipas këtij dokumenti?

Për kë zbatoheshin këto dispozita?



Parku Gjulhane („Parku i trëndafilave“)
në Stamboll - vendi ku u publikua
Hatisherifi i Gjulhanes

të tjera publike, si dhe për zhvillimin e jetës kishtare dhe arsimore të popullsisë. Në të njëjtën kohë, Hatihumajuni parashikonte edhe një sërë masash në sferën e **gjjqësorit, administratës dhe sistemit tatimor**. Megjithatë, shumë nga këto reforma nuk u zbatuan kurrë plotësisht.

Si pjesë e procesit të reformimit të shtetit, u bënë ndryshime në organizimin administrativ. Perandoria Osmane u nda në **vilajete**, të cilat u ndanë më tej në sanxhaqe dhe kaza. Me kalimin e kohës, territori i Maqedonisë Osmane u përfshi në tre vilajete: vilajeti i **Se-lanikut**, i **Manastirit** dhe i **Kosovës** (i Shkupit).

Të gjitha përpjekjet për reforma patën vetëm sukses të pjesshëm. Ato u ndërmorën kryesisht nën presionin e vendeve evropiane ose për t'i kapërcyer problemet aktuale, pa ndonjë qëllim të vërtetë për ndryshim. Si rezultat, Perandoria Osmane vazhdoi të binte.

Megjithatë, reformat krijuan kushte për hyrjen e marrëdhënieve kapitaliste në shtet. Gjithashtu, si rezultat i reformave, midis popullsisë jomyslimane doli në pah një **klasë qytetare**, e njohur shpesh si **çorbaxhinj**. Kjo klasë më vonë u bë bartëse e zgjimit kombëtar midis popujve të nënshtuar dhe e ngriti çështjen e lirive politike në vend.

Zhvillimi i sistemit të çifligjeve

Në mesin e shekullit XIX, shteti osman e shfuqizoi sistemin e mëparshëm timar-spahi dhe e legalizoi **sistemin e ri të çifligjeve**. Sipas tij, e drejta e pronësisë private mbi tokën ishte e garantuar, ndryshe nga më parë kur sulltani sundonte të gjithë vendin në emër të Zotit. Njerëzit që zotëronin tokë (çiflig) quheshin **pronarë të çifligut** ndërsa ata që e punonin tokën quheshin **çifligarë**.

Çifligarët e kultivonin tokën në këmbim të një pjese të caktuar të prodhimit ose me para, pas një marrëveshjeje paraprake me pronarët e çifligjeve. Edhe pse kishin të drejtë të largoheshin nga pronari i çifligut të tyre dhe të shkonin tek një tjetër ose në qytet, ata ishin **ekonomikisht të varur** nga pronari i çifligut dhe kjo ndodhte rrallë. Në fillim, pronarë të çifligjeve u



Mehmed Emin Ali Pasha – Vezir i Madh Osman, një nga krijuesit kryesorë të Hatihumajunit

Mëso më shumë



Brenda kuadrit të reformave të Tanzimatit, Perandoria Osmane për herë të parë mori një sërë elementësh të një shteti modern. U krijuan ministrat dhe një këshill ministror (qeveri). U krijuan edhe misionet e para të rregullta diplomatike të Perandorisë në vende të tjera. Shteti kishte flamurin dhe himnin e vet.



Çiflig

bënë ish-spahinj të, por me zhvillimin e tregtisë dhe fajdesë, pronarë të çifligjeve u shfaqën edhe në mesin e popullsisë jomyslimane.

Kriza e Madhe Lindore

Në vitet 1870, pakënaqësia e popujve të nënshtuar të Ballkanit arriti përmasa të reja. Nën ndikimin e shteteve evropiane, u intensifikuan lëvizjet çlirimtare. Filloi një krizë, e cila njihet në histori si **Kriza e Madhe Lindore** (1875-1878). Ajo preku një pjesë të madhe të Gadishullit të Ballkanit dhe u shoqërua me disa kryengritje dhe luftëra çlirimtare. Një pjesë e madhe e këtyre ngjarjeve u nxitën nga **Austro-Hungaria** dhe **Rusia**.

Kriza Lindore përfundoi me **Kongresin e Berlinit** në vitin 1878. Atje, Perandoria Osmane humbi një pjesë të konsiderueshme të sundimeve të saj në Ballkan. Serbia, Mali i Zi dhe Rumania u bënë **shtete të pavarura**. Austro-Hungarisë iu dha e drejta për ta pushtuar Bosnjën dhe Hercegovinën. Në zonën në veri të maleve Stara Pllanina u formua **Principata autonome e Bullgarisë**. Në jug të saj, u formua provinca autonome e **Rumelisë Lindore**, e cila zyrtarisht mbeti nën sundimin e Sulltanit. Sundimi osman mbeti realitet në **Maqedoni, Kosovë, Shqipëri** dhe **Odrin**.



Vilajetet osmane në Evropë para fillimit të Krizës së Madhe Lindore (1875)



Beteja e serbëve me osmanlinjtë në Luftën Serbo-Turke (1876)



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Pse Perandoria Osmane filloi përpjekjet për reforma? Rendit disa nga reformat më të rëndësishme!
2. Përshkruaje sistemin e çifligarëve!
3. Cilat ishin rezultatet e Krizës së Madhe Lindore për Perandorinë Osmane?

Fuqitë evropiane dhe Ballkani në shekullin XIX

Gadishulli i Ballkanit, me vendndodhjen e tij, ka qenë prej kohësh urë lidhëse midis Lindjes dhe Perëndimit. Për shkak të kësaj, shumë fuqi donin ta kontrollonin atë. **Ballkani** nuk ishte i rëndësishëm vetëm për shkak të vendndodhjes së tij, por edhe për shkak të historisë së tij të pasur. Prandaj, ai e tërhoqi vëmendjen e shumë udhëpërshkruesve, shkencëtarëve, gazetarëve dhe diplomatëve. Ata e vizituan për t'u njohur me situatën në rajon dhe me popujt që jetonin atje.

Në fillim të shekullit XIX, Ballkani u nda midis Perandorisë Osmane dhe Monarkisë së Habsburgëve. Dobësimi i osmanëve mundësoi përfshirje më të madhe të **Fuqive të Mëdha** në rajon. Secila prej tyre kishte interesat e veta, të cilat shpesh ishin në konflikt me njëra-tjetrën.

Kështu, **Rusia** kishte interes të kontrollonte pjesë të gadishullit për të siguruar dalje në Detin Mesdhe. Britania e Madhe donte t'i ruante zotërimet osmane në rajon për shkak të kontrollit të rrugës tokësore për në Indi. **Monarkia e Habsburgëve** nuk kishte zotërimi ose koloni jashtë Evropës, kështu që i vetmi vend ku mund ta zgjeronte ndikimin e saj ishte Ballkani. **Franca** që më herët ka pasur interesa në këtë rajon. Nga fundi i shekullit, interes për Ballkanin treguan edhe fuqitë e reja evropiane - **Gjermania** dhe **Italia**.

Mëso më shumë



Në fillim të shekullit XIX, August Zeune e përdori termin Ballkan për ta shënuar gadishullin. Kështu filloi emërtimi i kësaj pjese të kontinentit evropian. Vetë termi është me origjinë turke dhe ka interpretime të ndryshme të kuptimit të tij. Më vonë, termi Evropa Juglindore u shfaq si një emër tjetër për gadishullin.

Fjalë dhe terma të panjohur



Fuqitë e Mëdha - Shtetet më të fuqishme evropiane në shekullin XIX dhe fillimin e shekullit XIX. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, termi Fuqi të Mëdha i referohej shteteve të mëposhtme: Britanisë së Madhe, Francës, Rusisë, Gjermanisë, Monarkisë së Habsburgëve dhe Italisë.



Dubrovniku në të kaluarën (rindërtim 3D)

Napoleoni dhe Ballkani

Në fund të shekullit XVIII, ushtria franceze mbërriti në pjesët perëndimore të Gadishullit Ballkanik. Në atë kohë, u **shfuqizuan Republika Veneciane** dhe ajo e **Dubrovnikut**. Francezët pushtuan një pjesë të madhe të bregdetit Adriatik, nga Boka e Kotorrit deri në Trieste. Edhe pse ishin pushtues dhe fuqi e huaj, politikat e tyre e fituan simpatinë e popullsisë vendase, nga e cila morën njëfarë mbështetjeje.

Autoritetet e reja franceze i **shfuqizuan institucionet feudale**, gjë që i uli detyrimet e fshatarëve. U bënë gjithashtu shumë reforma që i sollën dobi pjesës më të varfër të popullsisë. Më shumë vëmendje iu kushtua **arsimit**. Ata hapën shkolla dhe punuan për ta arsimuar popullsinë, e cila ishte kryesisht analfabete. Në fushën e **shëndetësisë**, francezët e futën vaksinimin, i cili ishte një risi për këtë pjesë të Evropës. Sundimi i tyre nuk zgjati shumë, por prania franceze la një gjurmë të thellë dhe kontribuoi në përhapjen e ideve të reja në Ballkan.

Fuqitë e Mëdha Evropiane dhe Perandoria Osmane

Edhe pse ushtria franceze u largua nga Ballkani pas rënies së Napoleonit, interesi i fuqive evropiane për këtë pjesë të Evropës nuk u zhduk. Përkundrazi, dobësimi i shtetit osman krijoi përsëri kushte për ndërhyrjen e tyre në rajon.

Kryengritjet në Serbi dhe Greqi ua dhanë fuqive evropiane mundësinë për të ndikuar në mënyrë më aktive në ngjarjet në Ballkan. Rusia ndërhyri në anën e kryengritësve serbë. Si rezultat i kësaj mbështetjeje dhe presionit rus, **Serbia fitoi autonomi**, përkatësisht të drejtën e vetëqeverisjes në kuadrin e Perandorisë Osmane. Një gjë e ngjashme ndodhi me kryengritjen në Greqi. Gjatë kryengritjes greke, Britania e Madhe, Rusia dhe Franca ndërhyrën në anën e grekëve. Falë mbështetjes së tyre, **Greqia u bë shtet i pavarur** në vitin 1830.

Gjatë shekullit XIX, Fuqitë e Mëdha ndërhyrnin shpesh në punët e brendshme të Perandorisë Osmane. Në vitin 1833, Rusia u ofroi ndihmë ushtarake osmanëve gjatë konfliktit të tyre me sundimtarin egjiptian Muhamed Ali. Prandaj, Sulltani duhej të nënshkruante marrëveshje me



August de Marmont – komandant i forcave franceze në Dalmaci

Idetë e botës moderne



Gjatë sundimit francez të disa pjesëve të Ballkanit, popullsia vendase për herë të parë pa shkolla moderne dhe u njoh me procesin e vaksinimit.

Shpjego se si këto risi ndikuan në jetën e përditshme.



Fuqitë evropiane dhe ndarja e Perandorisë Osmane

Rusinë, sipas së cilës ajo merrte privilegje të mëdha në shtetin osman.

Megjithatë, marrëdhëniet midis Rusisë dhe Perandorisë Osmane filluan gradualisht të përkeqësoheshin. Njëzet vjet më vonë, shpërtheu **Lufta e Krimesë** midis këtyre shteteve. Në këtë luftë, Perandoria Osmane ishte aleate me Britaninë e Madhe dhe Francën.

Rusia pësoi disfatë, por fitorja në luftë pati edhe një çmim të lartë për Perandorinë Osmane. Për t'i mbuluar shpenzimet e luftës, asaj iu desh të bënte shumë lëshime ekonomike ndaj aleatëve të saj. Në atë kohë, u themelua **Banka Osmane**, në menaxhimin e së cilës morën pjesë aktive bankierët francezë dhe britanikë. Nëpërmjet kësaj banke, shteti osman filloi të merrte vazhdimisht borxhe dhe gradualisht u bë i varur financiarisht nga fuqitë evropiane.

Pas disfatës në Luftën e Krimesë, Rusia gradualisht u rikthye si një fuqi me ndikim në Ballkan. Mundësia tjetër për ndërhyrjen e saj në ngjarjet në rajon ishte **Kriza e Madhe Lindore**. Kryengritjet në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Bullgari çuan në një luftë të re midis Rusisë dhe Perandorisë Osmane. Rusia fitoi dhe e imponoi **Traktatin e Shën Stefanit**, i cili e parashikonte krijimin e **shtetit** të madh **bullgar**.

Traktati shkaktoi pakënaqësi të fuqitë e tjera evropiane, veçanërisht të Britania e Madhe dhe Austro-Hungaria, të cilat e kundërshtuan pushtetin e tepërt rus në Ballkan. Prandaj, në vitin 1878 u mbajt **Kongresi i Berlinit**, në të cilin u ndryshuan vendimet e Shën Stefanit.

Fuqitë evropiane dhe shtetet e reja ballkanike. Ndërhyrje dhe ndikime

Fuqitë evropiane, për interesat e tyre, ndihmuan në krijimin e Serbisë, Greqisë dhe Bullgarisë. Pas krijimit të këtyre shteteve, ato donin të kishin ndikim mbi sundimtarët e tyre. Në Greqi, një luftë e tillë u zhvillua midis Britanisë së Madhe, Francës dhe Rusisë. Me kalimin e kohës, ndikimi rus në Greqi u dobësua. Ngjashëm ishte edhe në Serbi, ku Rusia dhe Austro-Hungaria garonin për të pasur ndikim më të madh mbi politikën serbe.

Sundimtarët ballkanas ndonjëherë u rezistonin kërkesave të fuqive evropiane. Kështu, princi bullgar Ale-



Muhammed Ali

Ndërlidhi njohuritë



Kujtohu se çfarë vendimesh u morën në Kongresin e Berlinit.



Austin Henry Leard – arkeolog britanik dhe ambasador në Kostandinopojë



Princi bullgar Aleksandër Batenberg

ksandër Batenberg nuk i dëgjonte gjithmonë kërkesat ruse, megjithëse kishte ardhur në atë pozicion me ndihmën e Rusesë. Lëvizje të tilla provokuan reagime të forta nga Fuqitë e Mëdha.

Megjithatë, ndërhyrja e fuqive evropiane pati edhe pasoja pozitive. Në arsim, shtetet e reja ballkanike futën programe mësimore moderne evropiane. Shumë të rinj u arsimuan në universitetet më të mira evropiane. Pas kthimit në vendet e tyre, ata i transmetonin njohuritë e tyre atje.

E njëjta gjë vlente edhe për kulturën, e cila u ndikua fuqishëm nga Evropa. Qytetet e përvetësuan kulturën dhe modën evropiane, por traditat popullore nuk u braktisën plotësisht.



Benjamin Kalaj - burrë shteti dhe diplomat austro-hungarez

E kaluara në të tashmen



Gjatë Luftës së Krimesë, Franca dhe Britania e Madhe nuk u pajtuan me politikën e qeverisë greke. Si rezultat, ato e pushtuan portin e Pireut dhe e detyruan mbretin grek Oto ta ndryshonte qeverinë ekzistuese.

Çfarë na tregon ky shembull për marrëdhënien midis Fuqive të Mëdha dhe shteteve të vogla në Ballkan? A mendon se edhe sot, shtetet e mëdha mund të ndikojnë në vendimet e vendeve më të vogla?



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Pse Gadishulli i Ballkanit ishte i rëndësishëm për fuqitë evropiane?
2. Thuaj dy ndryshime që francezët i sollën gjatë sundimit të tyre në disa pjesë të Ballkanit.
3. Cilat shtete ballkanike u krijuan me ndihmën e Fuqive të Mëdha?

Kryengritjet në Serbi dhe Greqi

Në shekullin XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, idetë e Iluminizmit u përhapën në të gjithë Evropën. Nëpërmjet **tregtarëve** dhe **njerëzve të arsimuar**, këto ide arritën gradualisht edhe te serbët dhe grekët.

Në të njëjtën kohë, shteti osman po dobësohej dhe në Ballkan po zhvilloheshin tregtia dhe zejtaria. Popullsia jomysli-manë luante një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në to. Këta zejtarë dhe tregtarë u bënë pjesë e **klasës së pasur** dhe të arsimuar **qytetare**. Disa të rinj serbë dhe grekë, të cilët vinin nga familje më të pasura, **shkuan për studime në Evropën Perëndimore dhe Rusi**. Atje ata u njohën me ide të reja dhe filluan të mendonin për të ardhmen e popujve të tyre.

Kryengritja e parë serbe

Në fillim të shekullit XIX, shumica e serbëve nën sundimin osman jetonin në zonën e njohur si **Pashallëku i Beogradit**. Dobësimi i Perandorisë nënkuptonte gjithashtu një dobësim të kontrollit mbi territorin e shtetit. Jeniçerët përfituan nga kjo situatë, duke imponuar sundim të ashpër mbi Pashallëkun e Beogradit. Kjo çoi në pakënaqësi dhe revolta të shpeshta.

Pakënaqësia e madhe e popullsisë serbe çoi në shpërrthimin e **Kryengritjes së Parë Serbe**, e cila filloi në vitin 1804 në Orashac. Kryengritja u udhëhoq nga **Karagjorgje Petroviq**. Kryengritja fillimisht u drejtua kundër jeniçerëve, jo kundër Sulltanit.



Adamantios Korais

Mëso më shumë



Iluministët grekë dhe serbë besonin se vetëm nëpërmjet arsimit një popull mund ta fitonte lirinë dhe ta ndërtonte shtetin e vet. Iluministi më i famshëm grek ishte Adamantios Korais, ndërsa midis serbëve u dallua Dositej Obradoviç. Përveç tyre, edhe iluministë të tjerë ishin aktivë midis të dy kombeve. Ata kontribuan në përhapjen e arsimit dhe transformimin e ideve të reja evropiane midis popujve të tyre



Kryengritja e Parë Serbe - Beteja e Misharit (1806)



Karagjorgje Petroviq

Fillimisht, kryengritësit serbë arritën suksese të konsiderueshme dhe çliruan disa qytete. Kjo i inkurajoi ata që ta zgjeronin luftën dhe të përplaseshin me qeverinë qendrore. Pas disa fitoreve ushtarake, Sulltani u detyrua të pranonte negociata. Me **Paqen e Içkos** në vitin 1807, serbëve iu dha **autonomi e kufizuar**.

Rusia, e shtyrë nga interesat e veta, ndërhyri në kryengritje. Ajo ishte në luftë me osmanët dhe ishte e rëndësishme për të që kryengritësit serbë të vepron në anën e saj. Rusia i bindi kryengritësit që ta refuzonin traktatin e paqes me shtetin osman, duke u premtuar mbështetje. Karagjorgje Petroviq e pranoi propozimin rus. Kjo doli se ishte një gabim.

Në Evropë, Napoleon Bonaparti po përgatitej për fushatë kundër Rusesë. Prandaj, në vitin 1812, në Bukuresht, Rusia e nënshkroi traktatin e paqes me Perandorinë Osmane. Ushtria e Sulltanit, duke përfutur nga situata e ndryshuar, e sulmoi Serbinë kryengritëse. **Kryengritja u shtyp** dhe Karagjorgje dhe një numër i madh udhëheqësish kryengritës u larguan nga vendi.

Kryengritja e Dytë Serbe

Pasi kryengritja u shtyp, osmanët u rikthyen në sundimin e ashpër mbi serbët, i cili më parë kishte qenë shkak për revolta dhe pakënaqësi. Në të njëjtën kohë, disa nga princat që mbetën në Serbi pas Kryengritjes së Parë Serbe po prisnin ndonjë mundësi për veprime të reja kundër osmanëve. Një nga këta princa ishte **Mi-**



Jovan Raič – shkrimtar dhe historian serb i shekullit XVIII

E kaluara përmes burimeve



Millosh Obrenović ishte një politikan i aftë dhe i mençur, i cili dinte kur të tregonte forcë dhe kur t'u nënshtrohej osmanëve.

Sipas disa burimeve, guvernatori osman i Pashallëkut të Beogradit, Sulejman Pashë Skopljak, ka thënë: *“Shikojeni këtë princ të vogël. Sa i qetë dhe i nënshtuar është tani, kurse unë ia mbatha prej tij disa herë, duke mos ditur se ku të shkoja, dhe në fund edhe dorën ma lëndoi.”* Kur ia tregoi Milloshit dorën e tij të plagosur me fjalët:

“Ti ma bëre këtë”, Milloshi i ishte përgjigjur: “Do ta praroj, i nderuar pasha.”



Shpallja e Kryengritjes së Dytë Serbe në Takovo



Millosh Obrenović

Illosh Obrenoviq. Duke përfituar nga pakënaqësia me administratën osmane në vitin 1815 ai e organizoi **Kryengritjen e Dytë Serbe**, e cila filloi në Takovo.

Kryengritësit arritën disa fitore. Milloshi veproi me kujdes dhe maturi. Shteti osman, duke e kuptuar situatën e ndryshuar në Evropë dhe mundësinë e ndërhyrjes ruse në favor të serbëve, pranoi që t'i fillonte negociatat e paqes me Milloshin.

Milloshi, me dinakëri, aftësi dhe veprime të kujdeshme politike, në vitin 1830 arriti ta merrte pëlqimin e Sulltanit që Serbia të bëhej **principatë autonome e trashëgueshme**.

Kryengritja greke

Kushtet për kryengritje në tokat greke ishin më të favorshme sesa në Serbi. Grekët kishin zhvilluar tashmë një ide të qartë për çlirim nga osmanët. Një ndikim të madh në formimin e idesë çlirimtare greke kishte **Rigas Velestinlis**. Ai u ndikua fuqishëm nga Revolucioni Francez dhe në veprat e tij e mbështeti krijimin e një shteti në të cilin popujt e Ballkanit do të ishin të barabartë.

Me kalimin e kohës, u krijuan disa shoqëri sekrete me qëllim çlirimin e Greqisë. Më e famshmja dhe më me ndikim ishte **Filiki Eteria** (Shoqata e miqve), e themeluar në vitin 1814 në qytetin e Odesës. Kjo organizatë krijoi një rrjet sekret në të gjithë shtetin osman dhe po përgatitej për një kryengritje të madhe.

Kryengritja fillimisht duhej të fillonte në Peloponez, por disa anëtarë të organizatës, të udhëhequr nga **Aleksandros Ypsilantis**, fillimisht ngritën kryengritje në Vllahi dhe Moldavi. Kjo përpjekje u shtyp shpejt nga ushtria osmane.

Në mars të vitit 1821, një **kryengritje e madhe** shpërhoi në **Peloponez**. Ajo shpejt u përhap në zona të tjera. Ushtria osmane nuk ishte në gjendje ta shtypte menjëherë kryengritjen.

Ndryshe nga kryengritjet serbe, grekët morën mbështetje të fortë nga popujt evropianë. Në Evropën Perëndimore dhe Rusi u zhvillua një lëvizje e fuqishme në mbështetje të kryengritjes greke.



Rigas Velestinlis



Shpallja e Kryengritjes së Peloponezit në mars të vitit 1821

Nëse ti do të ishte atje...

Imagjino se je duke jetuar në Peloponez në vitin 1821. Atëherë nuk kishte internet, as telefona, as televizor.

Një ditë, në distancë dëgjohen të shtëna armësh. Të rriturit po flasin me zë të ulët. Disa janë të lumtur, të tjerë janë të frikësuar. Njerëzit vijnë nga fshatrat fqinje, por askush nuk e di saktësisht se çfarë po ndodh.

Si do ta zbuloje se çfarë po ndodhte? Si mendon se përhapeshin informacionet në Ballkan në vitin 1821?



Beteja e Navarinos

Osmanët nuk ishin në gjendje t'i përballonin vetë kryengritësit. Prandaj, ata kërkuan ndihmë nga Egjipti. Ushtria e përbashkët osmane-egjiptiane filloi operacione të suksesshme ushtarake kundër kryengritësve. Kryengritja ishte në prag të shtypjes, gjë që e nxiti ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha.

Në vitin 1827, flotat e kombinuara britanike, ruse dhe franceze e mposhtën flotën osmane-egjiptiane në **Navarino**. Pas kësaj ngjarjeje, nën presionin e fortë të Fuqive të Mëdha, Greqia e fitoi pavarësinë në vitin 1830 dhe u bë **shteti i parë i pavarur i krishterë në Ballkan**.

Ndërlidhi njohuritë



Organizata Filiki Eteria gradualisht i zgjeroi aktivitetet e saj në pjesë të tjera të Ballkanit. Qëllimi ishte të ngrihej, nëse ishte e mundur, një kryengritje e madhe ballkanike.

Filiki Eteria e përdori sloganin *“Liri ose vdekje”*, i njohur nga Lufta amerikane për pavarësi. I njëjti slogan u përdor më vonë nga Organizata Revolucionare Maqedonase.

Cila ide e përbashkët e shprehur përmes sloganit “Liri ose vdekje” e lidh Luftën amerikane për pavarësi, Filiki Eterijan dhe Organizatën Revolucionare Maqedonase?



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Kur, si dhe pse filloi Kryengritja e Parë Serbe?
2. Cili është ndryshimi midis Kryengritjes së Parë dhe të Dytë Serbe?
3. Me ndihmën e kujt pati sukses Kryengritja Greke?

Serbia autonome

Pas fitimit të autonomisë, në Serbi filloi organizimi dhe ndërtimi i shtetit të ri. Ajo ende nuk ishte e pavarur, sepse në letër mbetej nën sundimin e Perandorisë Osmane. Vendi drejtohej nga një **princ** trashëgues, ndërsa përveç tij kishte edhe një **Këshill** (grup njerëzish më me ndikim që e ndihmonin në sundimin e tij) si organ i rëndësishëm shtetëror.

Gjatë kësaj periudhe, një pjesë e popullsisë myslimane emigroi për shkak të ndryshimeve të pushtetit dhe pasigurisë në rajon, ndërsa një pjesë mbeti në afërsi të gjashtë garnizoneve (fortifikimeve ushtarake) osmane që ndodheshin ende në territorin e saj.

Serbia në kohën e Millosh Obrenoviqit

Serbia drejtohej nga princi **Millosh Obrenoviq**, udhëheqës i Kryengritjes së Dytë Serbe. Ai sundonte në mënyrë absolutiste: vendimet më të rëndësishme i merrte vetë dhe nuk donte ta ndante pushtetin me të tjerët. Ai shpesh i largonte kundërshtarët, gjë që shkaktonte pakënaqësi dhe trazira; ata shtypeshin, por pakënaqësia nuk zhdukej.

Serbia ishte ende një shtet i pazhvilluar dhe nuk kishte pavarësi të plotë. Shkalla e **arsimimit** të popullsisë ishte **shumë e ulët**. Princi Millosh vetë ishte analfabet, por ishte i zgjuar, praktik dhe politikisht i shkathët. Ai u lejoi serbëve që jetonin në Austri të ndihmonin në kri-



Beogradi në shekullin XIX

Mëso më shumë



Me rastin e hapjes së konsullatës austriake në Beograd, u organizua një koncert nga një orkestër e dërguar nga Vjena. Princ Milloshi i ftoi njerëzit më të shquar dhe u ul pranë konsullit austriak.

Gjatë koncertit, Milloshi u mahnit nga mënyra se si luanin muzikantët. Ai vuri re se disa po luanin, dhe disa jo në atë moment. Pastaj pyeti: pse nuk luanin të gjithë në të njëjtën kohë? Konsulli i shpjegoi se kjo ishte e zakonshme në muzikën evropiane. Milloshi u përgjigj se i kishte paguar të gjithë për të luajtur dhe se kështu duhej të ishte!

Koncerti ishte ndërprerë për pak kohë dhe më pas kishte vazhduar me të gjithë muzikantët që luanin vazhdimisht.



Millosh Obrenoviq në moshë të shkuar

Fjalë dhe terma të panjohur



Konsull - Përfaqësues i një vendi në një vend tjetër, i cili i mbron interesat e vendit të tij dhe të qytetarëve të tij para autoriteteve në vendin pritës.

Regjencë - Organ i përkohshëm në një monarki, i përbërë nga një ose më shumë persona, i cili e zëvendëson sundimtarin derisa të mbushë moshë madhore, në rast të paafësisë së përkohshme ose derisa të zgjidhet një sundimtar i ri.

jimin e institucioneve të para shtetërore dhe arsimore serbe. Ata ishin mjekë, juristë, mësues dhe oficerë, dhe me njohuritë dhe përvojën e tyre kontribuan në zhvillimin e administratës shtetërore, arsimit dhe kulturës në principatën serbe. Gjithashtu të rinj u dërguan për të studiuar në të gjithë Evropën.

Milloshi dëshmoi se ishte një politikan i aftë në situata të caktuara. Ai arriti të siguronte autonomi për **Kishën Ortodokse Serbe** në kuadër të principatës. Megjithatë, aftësitë e tij politike shpesh nuk përputheshin me mënyrën se si ai sundonte. Pati rezistencë të fuqishme në vend nga politikanë të rinj, të cilët kërkuar kufizime të pushtetit të tij. Si rezultat, Milloshi u detyrua të binte dakord për miratimin e dy kushtetutave në vetëm tre vjet. Kushtetuta e dytë, e miratuar në vitin 1838, nuk i përshtatej sepse ia kufizonte pushtetin. Prandaj, ai vendosi të tërhiqej nga froni.

Serbia në kohën e Aleksandër Karagjorgjeviqit

Tërheqja e Milloshit, dhe më pas e të birit, e hapi mundësinë që **Aleksandër Karagjorgjeviqi**, djali i udhëheqësit të Kryengritjes së Parë Serbe - Karagjorgje, të ngjitej në fronin princëror serb. Sundimi i tij ishte i paqëndrueshëm dhe varej kryesisht nga politikanët që e mbështesnin respektimin e kushtetutës. Ata nuk donin që princi të kishte shumë pushtet, por kërkonin ndarjen dhe kufizimin e pushtetit.



Aleksandër Karagjorgjeviq



Vuk Karaxhiq

Njihua me një figurë historike



Vuk Stefanović Karadžić

Ai vinte nga një familje e varfër fshatare. Që në fëmijëri, ai mësoi vetë të lexonte dhe të shkruante. Gjatë qëndrimit të tij në Vjenë, takoi shumë njerëz të arsimuar nga Evropa. Vuku filloi të mblidhte dhe të shkruante këngë, histori dhe zakone popullore, në mënyrë që ato të mos harroheshin. Puna e tij ngjalli interes të madh në Evropë. Studiuesi gjerman Jakob Grim u impresionua shumë nga vepra e Karadžićit dhe u bëri thirrje gjermanëve që ta mësonin gjuhën serbe për shkak të bukurisë së poezisë popullore.

Vuku bëri një reformë të madhe të gjuhës serbe dhe alfabetit cirilik. Ai e futi rregullin: *“Shkruaj siç flet, lexo siç është shkruar”*. Kështu, shkrimi u bë më i kuptueshëm për popullin.



Ilija Garashanin



Mihajlo Obrenović

Megjithatë, gjatë kësaj periudhe, Serbia filloi të ndërtohej dhe të zhvillohej. Qeveria filloi një proces modernizimi, por ai ishte i ngadaltë. Atëherë u krijua **ushtria e rregullt** dhe u hapën **Biblioteka Kombëtare** dhe **Muzeu Kombëtar** në Beograd. Në atë kohë, u miratua kodi i parë civil. Gjithashtu, u shfaq programi i parë politik serb për bashkimin dhe zgjerimin e Serbisë, i shkruar nga **Ilija Garashanin**.

Aleksandri u përpoq të ishte i kujdesshëm, por shumë e konsideronin atë si sundimtar të dobët. Me kalimin e kohës, në vend lindi pakënaqësi. Disa politikanë dhe populli besonin se princi mbështetej shumë te Monarkia e Habsburgëve dhe nuk e respektonte mjaftueshëm vullnetin e popullit. Në fund, me vendim të Asamblesë Kombëtare, Aleksandri u rrëzua nga fronin.

Serbia në rrugën drejt pavarësisë

Milloshi u kthye në fronin serb, por ishte i moshuar dhe vdiq shpejt. Ai u pasua nga djali i tij **Mihajloja**. Ndryshe nga i ati, Mihajloja ishte i arsimuar dhe kishte një karakter më paqësor. Ai ishte i gatshëm të bashkëpunonte me politikanët, por nuk donte ta humbiste kontrollin e pushtetit.

Gjatë kohës së tij, ushtria u forcua ndjeshëm, u hapën shumë shkolla dhe shteti filloi të modernizohej. Ai u përpoq të bashkëpunonte me popuj dhe shtete të tjera ballkanike, me qëllim çlirimin e plotë nga sundimi osman. Suksesi më i madh i Mihajllos ishte tërheqja e ushtrive të fundit osmane nga Serbia. Kështu, u hap rruga drejt pavarësisë së plotë të shtetit.

Ndërlidhi njohuritë



Profesori universitar dhe politikani serb, Slobodan Jovanović, bëri një krahasim të dy princërve të dinastisë Obrenović – Milloshit dhe djalit të tij Mihajlo:

“Mihajlo Obrenović ishte një njeri krejtësisht i ndryshëm nga i ati, Milloshi. Milloshi ishte një fshatar analfabet, ndërsa Mihajloja ishte i arsimuar mirë dhe i ndikuar nga kultura perëndimore.” [...]

Krahas këtyre dallimeve, Milloshi dhe Mihajloja i përkisnin të njëjtit lloji sundimtarësh. Të dy ishin absolutistë, të cilët e përqendruan pushtetin e shtetit tek vetja. [...]

Kujtoje absolutizmin dhe absolutizmin e iluminuar. Çfarë mendoni, cili nga dy princat ishte thjesht një absolutist dhe cili ishte një absolutist i iluminuar?



Millan Obrenović



Principata e Serbisë 1830-1878

Dëshira e tij për ta forcuar pushtetin e tij çoi në një mosmarrëveshje me politikanët serbë. **Mihajllloja u vra.**

Pas vrasjes së Mihajllos, vendi u qeveris për një kohë të shkurtër nga një regjencë, e cila sundonte në emër të Millan Obrenoviqit, nipit të Mihajllos. Në atë kohë, u miratua një kushtetutë e re, e cila kishte për qëllim të tregonte se Serbia po bëhej gjithnjë e më e pavarur nga Perandoria Osmane, por edhe ta zvogëlonte më tej pushtetin e princit. Për herë të parë, **e drejta e votës** iu dha pothuajse të gjithë meshkujve të rritur.

Serbia u përball me probleme të vazhdueshme për shkak të ekonomisë së saj të dobët, por edhe për shkak të krizave që ndodhën në Ballkan. Kriza e Madhe Lindore pati një ndikim të madh në Serbi. Edhe pse në letër ishte ende pjesë e Perandorisë Osmane, Serbia zhvilloi dy luftëra kundër saj gjatë kësaj krize. Ajo e humbi luftën e parë. Ndërhyrja ruse te Sulltani e shpëtoi vendin nga një pushtim tjetër osman. Nga ana tjetër, lufta e dytë përfundoi me fitoren e Serbisë. Me vendimet e Kongresit të Berlinit, Serbia fitoi **pavarësi dhe territore të reja.**



Millan Obrenoviqi me gruan e tij Natalija dhe djalit Aleksandër

E kaluara në të tashmen



Në gjysmën e parë të shekullit XIX, në Serbi përdorehin monedha të ndryshme - osmane dhe evropiane perëndimore. Princi Mihajllo Obrenoviq u përpoq ta fuste sistemin e tij monetar serb. Gjatë mbretërimit të pasardhësit të tij, Millan Obrenoviq, në vitin 1875 u fut në qarkullim dinari i argjendtë.

Sot, monedha zyrtare e Serbisë quhet ende dinar, gjë që tregon se vendimet e marra në shekullin XIX mund të lënë gjurmë të thella në jetën moderne.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Çfarë lloj sundimtari ishte Millosh Obrenoviqi dhe pse njerëzit ishin të pakënaqur prej tij?
2. Kush ishte Vuk Karaxhiqi dhe pse është i rëndësishëm për kulturën dhe gjuhën serbe?
3. Shpjego se si u bë Serbia shtet i pavarur.

Greqia - shteti i parë i pavarur në Ballkan

Pas fitimit të **pavarësisë**, Greqia ishte në gjendje të filloonte të organizohej dhe të zhvillohej si një shtet modern. Megjithatë, ky proces ishte i vështirë, pasi shumica e popullsisë ishte analfabete dhe mbetjet e rendit feudal ndiheshin ende në shoqëri. Vendi ishte i shkatërruar nga lufta e gjatë për pavarësi.

Greqia gjatë kohës së mbretit Oto

Është e mëdha evropiane, Britania e Madhe, Rusia dhe Franca, vendosën që Greqia të bëhej mbretëri në vend të republikës. Kështu, në vitin 1832, mbreti i parë grek u bë Oto, djali i monarkut bavarez. Përpjekjet e para për ta modernizuar shtetin dhe shoqërinë u kryen nga **zyrtarët bavarezë**, të cilët erdhën për ta mbështetur mbretin e ri grek. Përpjekjet e tyre kishin për qëllim krijimin e një administrate shtetërore moderne, por ata nuk kushtonin vëmendje të mjaftueshme për nevojat e qytetarit të zakonshëm grek. Ata i zunë pozicionet më të larta në administratën shtetërore. **Ushtria greke** ishte plotësisht nën komandën e personelit ushtarak bavarez.

Shumë pjesëmarrës në kryengritje ishin të pakënaqur me rolin e tyre në shtetin e ri. Për shkak të pakënaqësisë, disa prej tyre u arratisën në male dhe filluan të plaçkitnin.



Mbreti Oto



Greqia në vitin 1830



Theodoros Kolokotronis – politikan dhe luftëtar

Në të njëjtën kohë, u morën vendime për mënyrën e qeverisjes, arsimin dhe ligjet, dhe filloi ndërtimi i kryeqytetit të ri - **Athinës**. U arritën rezultate të caktuara në administratë, por problemet në ekonomi dhe siguri mbetën. Për këto arsye, zyrtarët bavarezë u bënë shpejt të papëlqyeshëm te populli.

Zyrtarët bavarezë donin ta ndërtonin shtetin e ri grek sipas modelit të shtetit të tyre. Në të njëjtën kohë, ata nuk i kuptonin traditat dhe zakonet greke, as lidhjen e fortë të popullit me Kishën Ortodokse, selia e së cilës ishte në kryeqytetin osman, Kostandinopojë. Prandaj, zyrtarët bavarezë, së bashku me disa udhëheqës grekë, morën vendim që ta krijonin **Kishën autoqefale greke** me seli në Athinë. Ky vendim nuk u njoh nga Patrikana e Kostandinopojës.

Shteti grek nuk i plotësonte nevojat e njeriut të zakonshëm. Me kalimin e kohës, pakënaqësia lindi tek një pjesë e madhe e popullsisë. Udhëheqësit e vjetër kryengritës ndiheshin të përjashtuar nga pushteti, ndërsa politikanët e rinj ishin të pakënaqur sepse mbreti refuzoi të lejonte që vendi të kishte **kushtetutë**. Një pjesë e madhe e popullsisë jetonte në varfëri, gjë që e rriti më tej pakënaqësinë me zhvillimin e ngadaltë të shtetit. Të gjitha këto arsye çuan në **grushtin e shtetit** në vitin 1843. Pas këtyre ngjarjeve, mbreti u detyrua të

E kaluara në të tashmen



Në Proklamantën e pavarësisë së Kishës Ortodokse Greke të vitit 1833 përmendej se zyrtarët e saj duhej t'i ishin besnikë mbretit dhe t'i respektonin ligjet e shtetit.

Ndryshe nga shekulli XIX, sot në shtetet ballkanike kishat ortodokse janë të ndara nga autoritetet shtetërore. Kleri nuk bën betim besnikërie ndaj shtetit, por vepron sipas rregullave të kishës dhe i respekton ligjet e shtetit si qytetarët.

E kaluara përmes burimeve



Gjenerali Makrianis tregon se qeveria vepronte padrejtësisht, prandaj pjesëmarrësit në kryengritje vendosën të vepronin në emër të atdheut. Ai thotë se ata u betuan ta krijonin Asamblenë Kombëtare dhe ta miratonin kushtetutën, në mënyrë që vendi të qeverisej në një mënyrë më të drejtë dhe më të qartë.

Pushteti i kujt do të kufizohej nëse do të miratohej kushtetuta?



Grushti i shtetit i vitit 1843

pranonte t'i mbante zgjedhjet e para për në Kuvendin e Greqisë, detyra kryesore e të cilit ishte ta miratonte kushtetutën e parë të shtetit të ri.

Greqia bëhet monarki kushtetuese

Në vend u mbajtën zgjedhje, pas të cilave shpejt u formua **Kuvendi**. Në të filluan debate të gjata rreth miratimit të kushtetutës së parë të shtetit. Gjatë këtyre debateve, në **fjalimin e Joanis Koletis** u përmend “**Ideja e Madhe**”, që nënkuptonte zgjerimin e shtetit në territore që ishin ende nën sundimin osman, si Kreta, Epiri, Maqedonia, Trakia dhe pjesë të Azisë së Vogël. Në vitin 1844, u miratua **kushtetuta e parë** e shtetit grek.

Mbreti Oto u përpoq të përshtatej me situatën e re në vend. Ai filloi të ndiqte një politikë të re me qëllim që ta fitonte mbështetjen e popullit. Ai bashkëpunoi me forcat politike që e dëshironin zgjerimin e Greqisë dhe bashkimin e popullit grek. Për shkak të kësaj, popullariteti i tij u rrit përkohësisht. Megjithatë, për shkak të situatës së dobët politike dhe ekonomike, u rishfaq pakënaqësia nga sundimi i tij. Në vitin 1862, **Oto u rrëzua nga pushteti** dhe iu desh të largohej nga Greqi.



Oto largohet nga Greqia



Joanis Koletis

Nëse ti do të ishte atje...

Në vitin 1862, anëtarë të pakënaqur të ushtrisë greke organizuan një grusht shteti, duke e rrëzuar mbretin Oto. Ai nuk ndodhej në Athinë në atë kohë. Pasi mësoi për kryengritjen ushtarake, Oto lëshoi një proklamata drejtuar popullit grek, në të cilën deklaroi:

“Grekë! Pas ngjarjeve të fundit që kanë ndodhur në pjesë të ndryshme të mbretërisë, veçanërisht në kryeqytet, besoj se qëndrimi im në Greqi mund të çojë në kryengritje të dhunshme. Prandaj, kam vendosur të largohem nga vendi, të cilin e doja dhe e dua ende, dhe për prosperitetin e të cilit me shumë kujdes kam investuar për tridhjetë vjet.”

Mendo pak: nëse do të ishte në vendin e mbretit Oto, a do të kishe vepruar njësoj? Shpjego pse.

Greqia në kohën e mbretit George

Pas rrëzimit të Otos, froni mbeti bosh për një farë kohe. Menjëherë pas kësaj, si **mbreti i ri grek** u zgjodh princi danez **George I**. Fuqitë kryesore evropiane: Britania e Madhe, Franca, Rusia dhe Prusia morën pjesë aktive në zgjedhjen e tij. Në fillim, ai sundoi me kujdes, duke u përpjekur të mos shkaktonte kriza të mëdha në atdheun e tij të ri. Ai e mësoi shpejt gjuhën greke dhe shfaqej shpesh në publik.

Britania e Madhe, duke synuar ta forconte ndikimin e saj në Greqi, pas ngjitjes në fron të Georges I ia lëshoi **ishujt Jonianë** shtetit grek. Kjo ngjarje u prit me entuziazëm të madh nga popullsia. Menjëherë pas kësaj, u miratua kushtetutë e re, me të cilën u zvogëluan kompetencat e mbretit.

Në vitet e para të mbretërimit të Geroges, Greqia filloi të zhvillohej me shpejtësi. Ajo mbajti marrëdhënie të mira me Perandorinë Osmane. Në vend botoheshin gazeta dhe revista, të cilat shkruanin për politikën, ekonominë, arsimin dhe kulturën. Pas konfliktit midis mbretit dhe politikanit Harillaos Trikupis, u pranua një rregull: qeveria do të formohej nga partia me më shumë përfaqësues në Kuvend.

Në kohën e Krizës së Madhe Lindore, udhëheqja greke u përpoq ta shmanjte luftën me osmanët, por në të njëjtën kohë t'i mbronte interesat e saj. Si i **vetmi shtet i pavarur në Ballkan**, Greqia mund t'ua paraqiste kërkesat e saj Fuqive të Mëdha në Kongresin e Berlinit, por nuk mori pjesë drejtpërdrejt në punimet e tij. Si rezultat i vendimeve të marra në Kongres, në vitin 1881 Greqia e **mori Thesalinë**, e cila deri atëherë kishte qenë nën sundimin osman.



George I

Mëso më shumë



Përpara se të bëhej mbret i Greqisë nën emrin George I, princi i ri George ishte më i interesuar të shërbente në marinën daneze. Pas zgjedhjes së tij si mbret i Greqisë, George u përgatit ta merrte fronin në Athinë. Ai ishte i ri dhe pa përvojë dhe nuk kishte pothuajse asnjë informacion rreth atdheut të tij të ri. Gjyshi i tij, mbreti Kristian IX i Danimarkës, e këshilloi princin e ri ta dëgjonte zërin e popullit grek, nëse donte të ishte mbret i mirë dhe të sundonte për një kohë të gjatë.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Me çfarë problemesh u përball Greqia pas fitimit të pavarësisë?
2. Si sundoi mbreti Oto dhe çfarë çoi në grushtin e shtetit në vitin 1843 dhe në futjen e kushtetutës së parë?
3. Çfarë është "Ideja e Madhe"?
4. Si u zhvillua Greqia nën mbretin George I dhe çfarë territoresh fitoi?

Shqipëria nga fillimi i shekullit XIX deri në Krizën e Madhe Lindore dhe zhvillimi i idesë së iluminizmit

Pashallëqet shqiptare

Për shkak të dobësimit të sundimit osman, **disa feudallë shqiptarë** u përpoqën ta fitonin pavarësinë.

Në veri të Shqipërisë, u shqua familja e **Bushatllinjve**. Në vitin 1757, osmanët e emëruan **Mehmet Bushatlliun** si guvernator të sanxhakut të Shkodrës me titullin **pasha**. Ai solli rregull në sanxhak, e fitoi mbështetjen e popullsisë dhe e ndoqi politikën e tolerancës fetare. Kështu, zonave malore iu dha e drejta e vetëqeverisjes.

Në vitin 1771 u krijua **Pashallëku i Shkodrës**, i cili qeverisej pothuajse në mënyrë të pavarur nga Bushatllinj-të. Mehmeti e mori titullin e vezirit dhe pushtetin mbi Shkodrën, Dukagjinin, Ohrin dhe Elbasanin. Djali i tij **Mahmud-pasha (Karamahmud)** e zgjeroi territorin e pashallëkut dhe u përpoq të çlirohej nga pushteti i sulltanit. Në luftën e tij kundër osmanëve, ai bashkëpunoi me Monarkinë Habsburge dhe Rusinë. Ai e zgjeroi sanxhakun deri në Prizren dhe Dibër, por e humbi jetën në një përleshje me malazezët.

Më vonë, pashallëku u sundua nga Ibrahim Pasha dhe Mustafa Pasha, të cilët ruajtën një shkallë të gjerë autonomie. Megjithatë, konfliktet e Bushatllinjve me pashallarët e tjerë shqiptarë e dobësuan pozicionin e tyre.

Në pjesët jugore të Shqipërisë, dobësimi i kontrollit osman u lejoi disa feudalëve vendas ta krijonin administratën e tyre. Më i famshmi prej tyre ishte **Ali Pashë Tepelena**, i njohur si pashai i Janinës. Ai e shfrytëzoi dobësinë e shtetit dhe krijoi një pashallëk të fortë në Janinë. Arriti ta vendoste rendin dhe sigurinë, dhe qyteti u zhvillua në një qendër të rëndësishme tregtare dhe artizanale. Në oborrin e Ali Pashës qëndronin mjekë dhe poetë të famshëm, të cilët e zhvilluan kulturën dhe mjekësinë.

Ali Pasha sundonte mbi një territor që shtrihej **nga Egjeu deri në detet Jon dhe Adriatik**. Në Janinë kishte edhe **përfaqësues të fuqive evropiane**. Ali Pasha i përdori me mjeshtëri marrëdhëniet e tij me Rusinë, Francën dhe Britaninë e Madhe për të ushtruar presion mbi Sulltanin. Megjithatë, pushteti i tij i shqetësoi autoritetet



Shkodra



Mahmud Pasha



Ali Pasha i Janinës

osmane. Pas dy vitesh luftimesh kundër osmanëve, ai u vra, kurse **Pashallëku i Janinës u shfuqizua**.

Revoltat dhe rezistenca kundër reformave

Pushteti osman i konsideronte bejlerët dhe pashallarët shqiptarë si kërcënim, madje edhe para reformave të Tanzimatit, ai filloi **veprime ushtarake** kundër tyre. Autoritetet ndonjëherë e përdornin edhe mashtrimin. Kështu, në vitin **1830 në Manastir**, u thirrën rreth njëqind bejlerë shqiptarë me premtimin se do të shpërblehen, por në vend të kësaj ata u vranë.

Këto masa nuk e ndaluan rezistencën. Reformat e Tanzimatit shkaktuan pakënaqësi të reja për shkak të futjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak dhe taksave të reja. Nga Vlora në **Shkodër shpërthyen revolta të armatosura**, kurse në Kosovë u ngritën banorët e Prizrenit dhe të Gjakovës.

Në Maqedoninë perëndimore shpërtheu **kryengritja e Dervish Carës**, i cili arriti të merrte një territor më të madh. Kjo kryengritje ngjalli interes te qeveritë evropiane, por edhe në Ballkan. Në Shqipërinë e Jugut, në qershor të vitit 1847, shpërtheu një kryengritje në të cilën morën pjesë shqiptarët pa dallim feje.

Edhe pse revoltat dhe kryengritjet u shtypën, ato gradualisht e hapën rrugën për krijimin e një lëvizjeje më të organizuar çlirimtare. Kësaj i parapriu zgjimi kulturor i shqiptarëve.

Sfidë për hulumtim



Në vitin 1809, një poet i famshëm evropian e vizitoi Janinën dhe u prit në oborrin e Ali Pashës. Poeti i ri u magjeps nga pasuria e qytetit dhe përzjerja e shkëlqimit oriental dhe ndikimeve evropiane. Ali Pasha, nga ana tjetër, ishte një sundimtar mizor, por jashtëzakonisht i aftë. Ai i regjistroi këto përshtypje në disa nga veprat e tij, veçanërisht në poemën *"Udhëtimet e Çajld Haroldit"*.

Hulumto se kush ishte poeti që e vizitoi oborrin e Ali Pashës?

Mëso më shumë



Ali Pasha fillimisht negocioi me francezët, por më vonë luftoi kundër tyre në Detin Jon dhe fitoi. Kjo e bëri atë interesant për britanikët, të cilët e shihnin si një aleat kundër Francës. Admirali britanik, Horatio Nelson, dërgoi një oficer për ta përgëzuar për fitoren e tij kundër francezëve. Më vonë ata shkëmbyen letra me lavdërimi.

Ali Pasha ishte temë edhe e muzikës evropiane. Për nder të tij u shkrua një operë nga kompozitori gjerman Albert Lortzing, në të cilën ai është personazhi kryesor.



Peizazh nga Shqipëria



Shqiptarë me kostume tradicionale

Iluminizmi shqiptar

Gjatë kohës së krizës në Perandorinë Osmane, shqiptarët filluan të tregonin interes për gjuhën dhe kulturën e tyre. Disa intelektualë e panë nevojën për të krijuar një alfabet, për të shtypur libra dhe për të hapur shkolla në gjuhën shqipe.

Ashtu si popujt e tjerë më të vegjël në Perandori, shqiptarët u përballën me pengesa në zhvillimin e shkrimit e leximit dhe kulturës. Edhe pse numri i njerëzve të arsimuar ishte i vogël, ata kërkuan ta forconin vetëdijen kulturore dhe t'i **kapërcenin ndarjet fetare dhe rajonale midis shqiptarëve**.

Fillimet e **iluminizmit shqiptar** ishin modeste dhe shpesh ndodhën jashtë Perandorisë Osmane, por ato kishin një rëndësi të madhe për zhvillimin e arsimit dhe të shkrimit e leximit. Intelektualët shqiptarë besonin se progresi fillonte me arsimin. Megjithatë, ata u përballën me një problem serioz - nuk kishte një alfabet shqip që do të përdorej në shkolla dhe për shtypjen e librave. Prandaj, **krijimi i një alfabeti** u bë hapi i parë në zhvillimin e kulturës shqiptare.

I pari që e mori përsipër këtë detyrë ishte **Naum Veqilharxhi**. Ai lindi në afërsi të Korçës dhe më vonë jetoi dhe u edukua në Vllahi (Rumania e sotme), ku u njoh me ide të reja. I vetëdijshëm se shqiptarët nuk kishin librat e tyre dhe shkrim të përbashkët, ai vendosi ta krijonte një alfabet shqip dhe një abetare. Ai besonte se çdo popull që e ka gjuhën e vet duhet ta ketë edhe alfabetin e vet.

Në vitin 1844 ai e botoi **abetaren e parë të vogël në gjuhën shqipe**, dhe vitin pasardhës një abetare më të madhe me tekste leximi. Këto ishin tekstet e para shkollore në gjuhën shqipe. Për këtë qëllim ai krijoi një alfabet krejtësisht të ri. Edhe pse alfabeti ishte kompleks, abetarja e tij u përhap në të gjithë Shqipërinë jugore dhe e nxiti mësimin e leximit dhe të shkrimit në gjuhën shqipe.

Një rol të rëndësishëm në zhvillimin e gjuhës shqipe dhe të nevojës për të krijuar një alfabet kishte edhe **Konstantin Kristoforidhi**, nga figurat më të rëndësishme shqiptare të shekullit XIX. Në një kohë kur librat në shqip ishin të pakët, ai filloi të përkthente dhe botonte vepra në gjuhën amtare, me qëllim që arsimit të ishte më i arritshëm për shumicën e



Pashko Vasa

E kaluara përmes burimeve



Veprimtari politik dhe kulturor shqiptar nga Shkodra, Pashko Vasa, duke iu drejtuar popullit të tij, e përshkroi gjendjen e vërtetë në të cilën ndodheshin shqiptarët. Në poemën e tij "O moj Shqypni", ai shkroi:

„Ca thonë kam fë ca thonë kam din;

Njeni: "jam turk", tjetri: "latin"

Do thonë: "Jam grek", "shkje"-disa tjerë,

Por jemi vllazën t'gjith more t'mjerë!

Priftnit e hoxhët ju kanë hutue,

Për me ju damun me ju vorfnue!."

Në poezinë "O moj Shqypni", Pashko Vasa flet për ndarjet e shqiptarëve sipas fesë dhe origjinës dhe bën thirrje për unitet.

Bisedoni me mësuesin tuaj të historisë për të shpjeguar nëse ndarje dhe thirrje të ngjashme për unitet ekzistonin edhe midis popujve të tjerë në Ballkan.



Naum Veqilharxhi



Konstantin Kristoforidhi

shqiptarëve. Përveç përkthimeve, ai përgatiti edhe **libra me të cilët fëmijët mësonin të lexonin**. Librat e tij u shpërndanë në qytete dhe fshatra dhe kontribuan në përhapjen e shkrimit dhe leximit. Në një kohë kur shumë fëmijë shqiptarë mësonin në greqisht ose në gjuhë të tjera, Kristoforidhi besonte se **mësimdhënia duhej të bëhej në gjuhën amtare**.

Veprat e tij lexoheshin si nga myslimanët ashtu edhe nga të krishterët, gjë që tregon se vepra e tij ishte e rëndësishme për të gjithë popullin shqiptar.

Arbëreshët

Një rol të rëndësishëm në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqipe, luajtën njerëzit e arsimuar, aktivitetet e të cilëve nuk u kufizuan vetëm në Ballkan. Veçanërisht i rëndësishëm ishte roli i **arbëreshëve në Itali** - shqiptarë që u shpërngulën pas pushtimeve osmane të tokave të tyre. Edhe pse jetonin larg atdheut të tyre, ata e ruajtën gjuhën dhe zakonet dhe ua transmetuan ato brezave të ardhshëm.

Në shekullin XIX, **intelektualët arbëreshë** filluan ta studionin shkencërisht gjuhën shqipe dhe origjinën e saj. Ata insistonin të tregonin se shqipja ishte një gjuhë e vjetër dhe e veçantë, ndërsa shqiptarët ishin një nga popujt e lashtë të Evropës dhe kishin gjuhën, kulturën dhe historinë e tyre. Ndër më të famshmit ishte **Dhimitër Kamarda**, i cili shkroi për historinë dhe veçoritë e gjuhës shqipe.

Intelktualët arbëreshë mblidhnin **këngë popullore**, shkruanin poezi dhe **botonin libra në gjuhën shqipe**. Duke vepruar kështu, ata kontribuan në forcimin e vetëdijes kulturore të shqiptarëve dhe krijuan lidhje me bashkatdhetarët e tyre në Ballkan. Aktivitetet e tyre e hapën rrugën për krijimin e një alfabeti shqip dhe zhvillimin e shkrimit e leximit dhe letërsisë.

Mëso më shumë



Kristoforidhi bashkëpunoi me Shoqërinë Biblike të Londrës dhe përktheu libra fetarë në **dy dialektet kryesore shqipe - gegërisht dhe toskërisht**. Për ta kryer më mirë këtë punë, ai qëndroi dhe studioi në vende të ndryshme, si në Maltë, Stamboll dhe qytete të tjera. Ai botoi abetare në gegërisht dhe toskërisht.



Valle popullore arbëreshe



Dhimitër Kamarda



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Si i përdori Ali Pasha marrëdhëniet me shtetet evropiane për ta forcuar pozicionin e tij?
2. Pse ishin të rëndësishme për shqiptarët kryengritjet dhe revoltat e shekullit XIX, edhe pse u shtypën?
3. Kush ishte Naum Veqilharxhi dhe çfarë bëri ai për shkrimin e leximin në shqip?
4. Kush ishin arbëreshët dhe si ndihmuan ata në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqipe?

Bullgaria nga fillimi i shekullit XIX deri në Krizën e Madhe Lindore

Ndryshimet në Perandorinë Osmane u ndjenë edhe nga populli bullgar, por zhvillimi i **lëvizjes popullore te bullgarët** ishte më i ngadaltë. Tokat bullgare ndodheshin më afër Kostandinopojës, që do të thoshte se qeveria qendrore po u kushtonte vazhdimisht vëmendje ngjarjeve në ato zona. Në të njëjtën kohë, trazirat e shpeshta dhe shfaqja e trupave të armatosura të parregullta krijuan pasiguri midis popullsisë.

Një problem shtesë ishte shkalla e ulët e shkrimit dhe leximit, ndërsa fuqia e dobët ekonomike e tregtarëve bullgarë nuk lejonte hapjen e më shumë shkollave dhe ndikim më të madh mbi autoritetet. Me kalimin e kohës, këto kushte filluan të ndryshonin, gjë që mundësoi një zhvillim më të fuqishëm kulturor dhe arsimor.

Iluminizmi dhe arsimi

Fillimet e **iluminizmit dhe arsimit te bullgarët** u ndikuan nga idetë e Iluminizmit Evropian. Këto ide u përhapën nëpërmjet lidhjeve të tregtarëve bullgarë me Evropën Qendrore dhe Greqinë. Në të njëjtën kohë, numri i popullsisë bullgare në disa qytete po rritej. Shumë fshatarë, në kërkim të një jete më të mirë, u zhvendosën në qytete.

Grupi i vogël i njerëzve të shkolluar dhe të ditur e kuptoi se ishte e nevojshme të shkruanin dhe botonin libra mbi historinë, kulturën dhe gjuhën bullgare. Në fillim, bartës të këtij procesi ishin **figurat kishtare**.

Fuqizimi i tregtarëve bullgarë e hapi rrugën për shfaqjen e shkollave dhe abetareve të para në gjuhën bullgare. Zhvillimi i tregtisë dhe zejtarisë e krijoi nevojën për njohuri të reja. Epoka e re kërkonte njohuri të matematikës, gjeografisë dhe gjuhëve të huaja.

Në Gabrovë u hap **shkolla e parë në gjuhën bullgare**, pas së cilës arsimi filloi të zhvillohej më shpejt. U ndërtuan shkolla të reja dhe gradualisht vajzat u përfshinë në procesin arsimor. Disa bullgarë u larguan për në vendet evropiane, ku u arsimuan, dhe më pas njohuritë dhe përvojën e fituar i transmetonin përsëri në atdheun e tyre.

Një qendër e rëndësishme për shkrimin e leximin në bullgarisht ishte kryeqyteti osman, Kostandinopoja. Më-

Mëso më shumë



Fillimet e interesit për të kaluarën, gjuhën dhe kulturën bullgare lidhen me veprat e Paisiusit të Hilendarit dhe Sofronit të Vracës.

Paisiusi i Hilendarit ishte murg në Malin Athos. Ai e shkroi librin “Historia Sllavo-Bullgarë”, në të cilin u kujtoi bullgarëve të kaluarën e tyre të lavdishme. Me këtë vepër, ai u bëri thirrje bashkatdhetarëve të tij të mos turpëroheshin për të kaluarën e tyre dhe të mësonin shkrim dhe lexim.

Sofroni i Vracës e bëri kopjen e parë të librit të Paisiusit. Më vonë ai u bë peshkop dhe në vitin 1806 e shtypi librin e parë në bullgarisht, të kuptueshëm për popullin. Ai mori pjesë edhe në një luftë ruso-osmane, ku organizoi vullnetarë bullgarë që luftuan në anën e rusëve.



Paisiusi i Hilendarit



Sofroni i Vracës

suesit luajtën një rol të madh në përhapjen e shkrimit dhe leximit. Përveç mësimdhënies, ata shkruan libra shkollorë dhe e organizuan jetën kulturore.

Megjithatë, pavarësisht zhvillimit të shpejtë të arsimit, në kohën kur u krijua shteti bullgar, vetëm një pjesë e vogël e popullsisë kishte arritur të mësonte shkrim e lexim.

Shfaqja dhe zhvillimi i lëvizjes çlirimtare dhe krijimi i shtetit bullgar

Zhvillimi dhe forcimi i ndjenjës kombëtare bullgare midis intelektualëve e ngriti çështjen e krijimit të **kishës së veçantë bullgare**. Pikëpamjet e tyre u ndikuan edhe nga shembuj nga fqinjësia, veçanërisht krijimi i kishës autonome në Serbi dhe i kishës së pavarur në Greqi.


Në atë kohë, bullgarët ishin nën **juridiksionin shpirtëror të Patrikanës së Kostandinopojës**, e cila ishte gjithnjë e më indiferente ndaj nevojave të popullsisë bullgare. Një pjesë e popullsisë së arsimuar bullgare dhe e klerikëve protestonin sepse priftërinjtë bullgarë nuk mund të merrnin poste më të larta në Patrikanë.

Një problem shtesë ishte **gjuha** e përdorur në shërbesat kishtarë. Ajo ishte greqishtja, e cila ishte e pakuptueshme për shumicën e bullgarëve. Prandaj, ata kërkuar që përdorimi i gjuhës amtare bullgare të lejohej në shërbesat kishtarë dhe që bullgarë të emëroheshin në poste më të larta kishtarë. Këto kërkesa u refuzuan nga Patrikana e Kostandinopojës.

Rezistenca ndaj Patrikanës së Kostandinopojës filloi në kryeqytetin mesjetar bullgar, Tërnovë. Më pas ajo u përhap në qytete të tjera dhe bullgarët filluan të kërkonin gjithnjë e më shumë krijimin e kishës së tyre.

Bullgarët u përpoqën të negocionin me Patrikanën e Kostandinopojës, por këto bisedime nuk sollën asnjë rezultat. Në luftën për ta krijuar kishën e veçantë bullgare ndërhyjnë edhe Fuqitë e Mëdha, kryesisht Rusia.

Në vitin 1870, Sulltani osman lëshoi një ferman me të cilin u krijua Ekzarkia Bullgare. Dy vjet më vonë, u zgjodh ekzarku i parë bullgar.



Kisha bullgare e Shën Stefanit në Kostandinopojë

Njihni me një figurë historike



Hilarion Makariopolski lindi në vitin 1812 në qytetin e Elenës, në një familje të pasur. Ai shkoi në Manastirin e Hilendarit në Malin Athos, ku u bë murg dhe iu dha emri Hilarion. Si figurë kishtarë, ai ishte shumë aktiv në luftën e bullgarëve kundër Patrikanës së Kostandinopojës. Hilarioni e mbronte idenë që bullgarët të kishin peshkopët, shkollat dhe librat e tyre në gjuhën bullgare.

Në vitin 1860, gjatë shërbesës së Pashkëve në kishën e Shën Stefanit në Kostandinopojë, Hilarioni qëllimisht nuk e përmendi emrin e patriarkut. Me këtë akt, ai tregoi simbolikisht se bullgarët nuk e njihnin më autoritetin e tij.



Hilarion Makariopolski

Shfaqja dhe zhvillimi i lëvizjes çlirimtare dhe krijimi i shtetit bullgar

Krijimi i Serbisë dhe i Greqisë, zhvillimi i arsimit dhe sukseset në luftën për kishën bullgare i frymëzuan disa bullgarë me idenë e **lëvizjes çlirimtare**. Ata besonin se lufta e armatosur ishte mënyra për t'u çliruar nga sundimi osman. Qëllimi përfundimtar ishte **krijimi i shtetit bullgar**.

Në Bullgari dhe Rumani, ku kishte një emigracion të madh bullgar, u krijuan organizata për të ndihmuar në përgatitjen e kryengritjes çlirimtare.

Georgi Rakovski ishte revolucionari i parë bullgar që punoi për të organizuar një kryengritje të tillë. Ai jetoi dhe punoi në Greqi, Serbi dhe Rumani. Në Serbi, ai organizoi çeta që duhej të hynin në Bullgari dhe të ngrinin kryengritje. Rakovski besonte se liria mund të arrihej vetëm përmes revolucionit.

Përfaqësuesit më të rinj të lëvizjes çlirimtare bullgare e vazhduan idenë e Rakovskit për liri përmes revolucionit. Pas vdekjes së tij, udhëheqësi i lëvizjes revolucionare ishte **Ljuben Karavelov**. Sipas tij, Bullgaria duhet të bëhet një republikë në të cilën do të respektohen të drejtat personale, kombëtare dhe fetare. Karavelov gjithashtu e mbështeti bashkëpunimin me popujt e tjerë të sllavëve të Jugut.

Një tjetër revolucionar i shquar bullgar ishte **Vasil Levski**. Ai e kaloi pjesën më të madhe të kohës në atdheun e tij, ku e organizoi rrjetin revolucionar dhe përgatitjet për kryengritje. Levski u arrestua dhe u ekzekutua nga autoritetet osmane.

Pas vdekjes së tij, midis revolucionarëve bullgarë lindën keqkuptime. Në atë kohë, lëvizja drejtohej nga **Hristo Botev**, i cili arriti t'i kapërcejë përçarjet dhe të vazhdojë me përgatitjet për kryengritjen.

Fillimi i Krizës së Madhe Lindore dhe kryengritja në Bosnjë dhe Hercegovinë i intensifikuan më tej aktivitetet revolucionare. Si pjesë e përgatitjeve, tokat bullgare u ndanë në disa zona kryengritëse.

Në **prill të vitit 1876**, shpërtheu kryengritja në disa rajone bullgare. Osmanët e shtypën shpejt kryengritjen, me viktima të mëdha në mesin e popullsisë



Georgi Rakovski

E kaluara përmes burimeve



Georgi Rakovski përgatiti një plan për kryengritje në Bullgari. Sipas këtij plani, parashikohej:

- Në shumë qytete dhe fshatra duhet të krijohen komitete të fshehta, të cilat do ta përgatisnin popullin për kryengritje dhe do ta prisnin shenjë të fillimit të saj.
- Një çetë e organizuar mirë të depërtojë në Ballkan, për ta ngritur popullin me armë, për t'i prerë lidhjet me qeverinë osmane dhe për të marrë qytetet të rëndësishme.
- Kryengritja duhet të përhapej shpejt dhe duhet të krijohet një administratë e përkohshme dhe një organizatë ushtarake. Sipas Rakovskit, qeveria osmane nuk do të ishte në gjendje të dërgonte trupa të mjaftueshme në kohë për ta parandaluar lëvizjen.



Ljuben Karavelov



Kryengritja e Prillit



Vasil Levski

bullgare. Kjo ngjarje shkaktoi një jehonë të fortë në Evropë, veçanërisht në Rusi dhe Britaninë e Madhe.

Vitin pasardhës, Rusia filloi luftë kundër Perandorisë Osmane. Vullnetarë të shumtë bullgarë iu bashkuan ushtrisë ruse, të cilët dhanë një kontribut të rëndësishëm në fitoren e Rusisë. Pas përfundimit të konfliktit, u nënshkrua **Traktati i Paqes i Shën Stefanit**, i cili e parashikonte krijimin e shtetit të madh bullgar.

Megjithatë, Fuqitë e tjera të Mëdha nuk u pajtuan me dispozitat e kësaj marrëveshjeje. Për të shmangur një konflikt të ri ndërkombëtar, u mbajt **Kongresi i Berlinit**. Atje u mor vendimi për krijimin e **Principatës autonome të Bullgarisë** dhe **rajonit të veçantë autonom të Rumelisë Lindore**.



Hristo Botev



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Cilët ishin dy iluministët bullgarë që ngjallën interes për të kaluarën, gjuhën dhe kulturën bullgare?
2. Pse bullgarët e kërkuan krijimin e kishës së tyre të veçantë?
3. Kush ishte Georgi Rakovski dhe çfarë lloj lufte për liri mbështeste ai?
4. Cilat ngjarje çuan në krijimin e Principatës Bullgare në vitin 1878?

Rrethanat kishtare-arsimore në Maqedoni në shekullin XIX

Rrethanat kishtare në Maqedoni në shekullin XIX

Kisha luante një rol të rëndësishëm në jetën e përditshme të njerëzve, por edhe në shoqëri. Ajo ishte mbrojtëse e traditave shpirtërore dhe vlerave morale, si dhe e shkrimit dhe leximit.

Kisha e organizonte dhe e kontrollonte arsimimin e popullsisë së krishterë ortodokse. Në Perandorinë Osmane, **kisha e njohur** konsiderohej si popull i njohur, pavarësisht nga përkatësia gjuhësore dhe etnike e besimtarëve. Nën ndikimin e nacionalizmit, gjatë shekullit XIX kisha si institucion në Perandorinë Osmane u vu **në funksion të ideologjive të caktuara kombëtare**.

Pas suprimimit të Kryepeshkopatës së Ohrit, Maqedonia ishte nën juridiksionin shpirtëror të Patrikanës së Kostandinopojës, e cila tashmë ishte në funksion të idesë kombëtare greke. Kështu, si peshkopë u emëruan grekë. Ata, pavarësisht nga përkatësia etnike dhe gjuhësore e popullsisë, i imponuan shërbesat kishtare në gjuhën greke.


E njëjta gjë ndodhi edhe në shkolla. Librat në gjuhën sllave kishtare u asgjësuan. E gjithë kjo shkaktoi pakënaqësi te popullsia maqedonase, e cila nuk e kuptonte greqishten. Situata ishte e ngjashme në Bullgari dhe në pjesë të Serbisë jugore, të cilat ishin nën **juridiksionin shpirtëror të Patrikanës së Kostandinopojës**. Prandaj, në mesin e shekullit XIX, filloi një lëvizje e fortë anti-patrikane, që synonte kryesisht emërimin e peshkopëve që do të kryenin shërbesat kishtare në gjuhën sllave.

Si rezultat i kësaj lufte kishtare, nën presionin diplomatik të Fuqive të Mëdha, para së gjithash prej Rusisë, në vitin 1870 u krijua **Egzarkia Bullgare** me seli në Kostandinopojë. Në fillim ajo kishte vetëm një peshkop në Maqedoni, por me kalimin e kohës numri i tyre u rrit. Kështu, në disa qytete maqedonase kishte njëkohësisht dy peshkopë (njëri i patrikanës, tjetri i egzarkisë).

Në kishat e egzarkisë, shërbesa kryhej në sllavishten kishtare, ndërsa në shkolla praktikohesh gjuha bullgare. Duke e ndjekur shembullin e Patrikanës së Kostandi-



Kiril Pejčinović – Tetovari



Drama „Dasma e përgjakshme maqedonase“ e shkruar në maqedonisht

nopojës, Ekzarkia u vu në **funksion të idesë kombëtare bullgare**. Prandaj, filloi një luftë për dominim midis dy kishave ortodokse.

Për shkak të afërsisë gjuhësore, Ekzarkia ishte një mundësi më e pranueshme për popullsinë maqedonase. Megjithatë, kundër saj shpërthyen **revolta të nxënësve, si dhe kërkesa për futjen e gjuhës maqedonase në shërbesat kishtare**. Patrikana e Kostandinopojës, për ta ruajtur prestigjin e saj, i lejoi shërbesat fetare dhe mësimin në serbisht dhe rumanisht në vende të caktuara nën juridiksionin e saj. Kështu, kishat nga institucione shpirtërore u transformuan në organizatore dhe bartëse të propagandave kombëtare (greke, bullgare, serbe dhe rumune).

Lëvizja Uniate dhe përpjekjet për ta rivendosur Kryepeshkopatën e Ohrit

Një pjesë e popullsisë maqedonase e shihte zgjidhjen e çështjes kishtare në **unionin me Kishën Katolike Romake**. Në këtë drejtim, kukushanët ishin në krye. Në **vitin 1859**, ata e hodhën poshtë Patrikanën e Kostandinopojës dhe kërkuar **union me Kishën Katolike**. Kjo do të thoshte se ata e njihnin Papën si udhëheqësin e tyre fetar dhe se shërbesa kishtare do të kryhej në gjuhën sllave.

Për t'i sprapsur ata nga unioni, Patrikana e largoi përkohësisht peshkopin e Dojranit, i cili ishte grek, dhe në vend të tij e vendosi **Partenij Zografskin**, një vendas i lindur në Galiçnik. Por, pasi situata u qetësua, Partenij u hoq.

Uniatizmi në Maqedoni, me tendencë për ta **rivendosur Kryepeshkopatën e Ohrit si kishë maqedonase**, mori vrull në vitet 1873/74. Dimitar Pop Georgiev Berovski luajti një rol të spikatur në këtë lëvizje. Për ta parandaluar lëvizjen, ekzarku bullgar dërgoi një emisar të posaçëm në Maqedoni.

Në filli të viteve 1890, mitropoliti i Ekzarkisë së Shkupit, **Teodosi Golloganov**, e mori iniciativën për ta **rivendosur Kryepeshkopatën e Ohrit** nën kujdesin e Kishës Katolike Romake. Duke vepruar kështu, ai shkarkoi disa zyrtarë të emëruar nga Ekzarkia dhe lëshoi dokumente pa emrin "Ekzarkia Bullgare". Për këtë arsye, ai u shkakua nga posti i mitropolitit.



Partenij Zografski



Teodosij Golloganov

E kaluara përmes burimeve



Nga raporti i ekzarkut Josif drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Bullgarisë:

"Teodosi u përpoq aq sa mundej që t'i shkëpuste lidhjet që e lidhnin me eprorët e tij. Në dioqezën e Shkupit, ai i shpalli të pavlefshme të gjitha rregulloret e shkollave dhe konvikteve të lëshuara nga Ekzarkia. Me iniciativën e tij, pa asnjë bazë ligjore, ai shtypi akte, certifikata pagëzimi dhe certifikata shkollare, duke i mënjeluar fjalët "Ekzarkia Bullgare". U fliste qytetarëve dhe mësuesve se nuk e njohte Ekzarkinë dhe se i kishte ndërprerë marrëdhëniet me të. Ai e përhapte idenë se maqedonasit duhet të çliroheshin nga bullgarët e sipërm."

Zhvillimi i arsimit

Nën ndikimin e Iluminizmit në Evropë dhe ndryshimeve në Perandorinë Osmane, arsimi në Maqedoni përjetoi një zhvillim të ndjeshëm në shekullin XIX. Në fillim, ende kishte **shkolla-qeli**, të cilat ndodheshin kryesisht në kisha dhe manastire. Ato shërbenin për shkrim dhe lexim elementar dhe përgatitnin personel për mjediset kishtare. Menjëherë pas kësaj, u shfaqën **shkollat laike**.

Në shkollat laike, mësoheshin kryesisht lëndë me **përmbytje laike**, si historia, gjeografia, matematika e të ngjashme. Qytetarët e pasur, veçanërisht tregtarët, e kuptuan se fëmijët e tyre do të kishin më shumë sukses nëse do të ndiqnin shkolla laike. Shkollat e para laike në Maqedoni ishin nën ndikimin grek. Në to, mësimi zhvillohej në greqisht. Klasa më e pasur maqedonase i dërgonte fëmijët e saj atje, sepse greqishtja konsiderohej gjuha e elitës së arsimuar dhe tregtare. Më vonë, disa nga këta nxënës të arsimuar në greqisht u bënë kritikë publikë të dominimit shpirtëror dhe kulturor grek në Maqedoni.

Me forcimin e **komunave kishtare-shkollore**, në dekadën e katërt të shekullit XIX, filluan të hapen shkolla laike në **gjuhën sllave**. Komunitatet kishtare-shkollore luajtën një rol të madh në organizimin e këtyre shkollave, në gjetjen e hapësirave dhe mësuesve. Ato mbështeteshin nga tregtarët dhe shoqatat e esnafëve. Në të njëjtën kohë, mësimdhënia u përmirësua. Nxënësit u ndanë në klasa, varësisht nga mosha dhe lëndët që studionin. Shkolla të tilla u hapën në Veles, Prilep, Shkup, Tetovë, Kumanovë dhe vende të tjera. Mësuesi më i shquar që prezantoi metoda të reja në mësimdhënien e gjuhës sllave ishte **Jordan Haxhi Konstantinov-Xhinot**. Shkolla të këtij tipi dominuan deri në fund të viteve '60 të shekullit të XIX.

Në dekadat e fundit të shekullit XIX, Patrikana e Kostandinopojës dhe Ekzarkia Bullgare luajtën një rol të madh në jetën arsimore në Maqedoni. Ata filluan një garë për të hapur më shumë shkolla në Maqedoni. Në këto shkolla, arsimi ishte në një nivel më të lartë. Përveç shkollave të rregullta dhe të mesme, u hapën edhe shkolla profesionale. Në to, mësimi zhvillohej në greqisht dhe bullgarisht. Patrikana e Kostandinopojës e lejoi hapjen e shkollave në serbisht dhe rumanisht nën mbrojtjen e saj. Në klasat e para të shkollave rumune,



Jordan Haxhi Konstantinov- Xhinot

Dëshmi historike



Në një letër në gazetën "Shumadinka" të vitit 1852, shkruhet për mësimdhënien e J.H. Konstantinov- Xhinot në Shkup:

"Dy vjet më parë morëm si mësues njëfarë Jordan Konstantinoviqi... (i cili) filloi t'i mësonte fëmijëve tanë të lexojnë në gjuhën sllave. Të gëzuar nga ky sukses, filluam me dëshirë më të madhe t'i regjistrojmë fëmijët tanë në atë shkollë të re... Por për shkak të kësaj shkollës sonë, shkolla greke mbeti bosh, sepse çdo prind dëshiron që fëmija i tij të mësojë diçka në gjuhën e vet amtare... Grekët, të ofenduar nga kjo, filluan të indinjohen publikisht kundër nesh dhe mësuesit tonë, ndërsa kjo indinjatë më në fund u shndërrua në debat publik...."

mësimi zhvillohej në vllahisht. Si misionet protestante ashtu edhe ato katolike u hapën shkollat e tyre në Maqedoni.

Tekstet shkollore dhe letërsia


Zhvillimi i arsimit ndikoi në tekstet shkollore dhe letërsinë. Librat dhe tekstet e para shkollore u shtypën me mbështetjen financiare të qytetarëve të pasur në Buda, Beograd dhe Kostandinopojë. Autorët e tyre vinin nga mjedise kishtare, prandaj në to mbizotërojnë përmbajtjet fetare. Ato u shkruan në **sllavishten kishtare** me shumë përzierje të **të folurit popullor maqedonas**. Kjo e bëri librin më të afërt me njeriun e zakonshëm. Ndër autorët e parë të tillë janë: **Joakim Kërçovski** dhe **Kiril Pejçinoviç – Tetovari**.

Situata për letërsinë dhe tekstet shkollore sllave u përmirësua në **vitin 1838**, kur **Teodosij Sinaitski** hapi një shtypshkronjë në Selanik. Atje u shtypën disa libra dhe tekste shkollore. Disa vite më vonë, shtypshkronja u dogj nga zjarri.

Dëshira për të shtypur libra dhe tekste shkollore në gjuhën amtare maqedonase vazhdoi në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Ndër shkrimtarët e teksteve shkollore të kësaj periudhe, dallohen Kuzman Shapkarev, Dimitar Uzunov dhe të tjerë. Meqenëse tekstet e tyre shkollore ishin në gjuhën amtare maqedonase, ata u quajtën **maqedonistë**.



Joakim Kërçovski



Libri „Ngushëllim për mëkatarët“ nga Kiril Pejçinoviç, përgatitur në „gjuhë të thjeshtë“

Mëso më shumë



Termi **“maqedonistë”** për autorët, që shkruan në gjuhën popullore maqedonase, u përdor për herë të parë nga aktivisti bullgar Petko Račov Sllavejkov në vitin 1871 në artikullin “Çështja Maqedonase”. Aty ndër të tjera, thuhet:

“Shpeshherë kemi dëgjuar nga maqedonistët se ata nuk janë bullgarë, por maqedonas, pasardhës të maqedonasve të lashtë... Për t'i dhënë forcë bazës së tyre arbitrarë, maqedonistët e nxjerrin në pah ndryshimin midis dialektit maqedonas dhe atij të bullgarishtes së sipërme, ku i pari është më afër gjuhës sllave...”



Kuzman Shapkarev



Vëllezërit Milladinovci



Grigor Përliçev

Në të njëjtën kohë, u krijuan vepra letrare, u shkruan poezi, përralla dhe fjalë të urta popullore nga rajoni i Maqedonisë. Nga këta autorë veçanërisht u dalluan vëllezërit **Dimitar dhe Konstantin Milladinov, Marko Cepenkov, Gjorgjija Pulevski** dhe të tjerë.

Disa autorë shkruan në gjuhë të huaja. Kështu, **Grigor Përliçev** e shkroi poemën “**Serdar**” në greqisht. Për shkak të vlerës së saj artistike, ai u shpall **Homer i dytë** në Athinë. Fundi i shekullit XIX (1900) përmbyllet simbolikisht nga Vojdan Çernodrinski dhe drama e tij “**Dasma e përgjakur maqedonase**”, e cila u shkrua në maqedonisht.

E kaluara në të tashmen



Çdo vit, në gusht, në Strugë mbahet një aktivitet ndërkombëtar poezie, i njohur si “Mbrëmjet Strugane të Poezisë”.

Hulumto se për nder të kujt mbahet kjo ngjarje dhe pse mbahet në Strugë?



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Pse Ekzarkia Bullgare ishte një opsion më i pranueshëm, sesa Patrikana e Kostandinopojës për popullsinë maqedonase?
2. Pse Ekzarkia dhe Patrikana konkurronin për të hapur sa më shumë kisha dhe shkolla në Maqedoni?
3. Përshkruaje ndryshimin midis shkollave-qeli dhe atyre laike.
4. Analizoje tekstin në seksionin “Mëso më shumë” dhe përgjigju pse Slavejkov i quajti maqedonistë autorët e këtyre teksteve shkollore?

Kryengritja e Razllovcit

Arsyet e kryengritjes

Në mesin e viteve 70 të shekullit XIX, u ndezën aspiratat çlirimtare midis popujve të Ballkanit nën sundimin osman. Së pari (1875) shpërtheu kryengritja në Bosnjë dhe Hercegovinë. Vitin pasardhës (prill) shpërtheu kryengritja në Bullgari. Në maj të vitit 1876, shpërtheu **Kryengritja e Razllovcit** në Maqedoni. Këto ngjarje shkaktuan rritje të aktivitetit diplomatik nga fuqitë evropiane, por edhe disa luftëra me Perandorinë Osmane. Kjo periudhë trazirash njihet në histori si **Kriza Lindore**.

Ekzistojnë disa arsye për shpërthimin e Kryengritjes së Razllovcit. Midis tyre janë: përkeqësimi i situatës ekonomike të popullsisë për shkak të rritjes së detyrimeve tatimore dhe çmimeve të produkteve; abuzimet nga përfaqësuesit e administratës shtetërore; rritja e dhunës ndaj popullsisë; përkeqësimi i situatës së sigurisë për jetën dhe pronën; fanatizmi fetar dhe të tjera. Këtu përfshihet edhe dëshira për solidaritet. Në fakt, sipas Dimitar Pop Georgiev Berovskit, shpërthimi i Kryengritjes së Razllovcit në Maqedoni duhej ta lehtësonte situatën e kryengritësve në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Përgatitjet për kryengritjen

Organizatori dhe udhëheqësi kryesor i Kryengritjes së Razllovcit ishte **Dimitar Pop Georgiev Berovski**. Përgatitjet për kryengritjen ishin gjithashtu nën kontrollin e tij. Një vend të rëndësishëm mbante edhe **prifti Stojan nga fshati Razllorc**, i cili ishte babai i gruas së D. Berovskit. Nga fundi i vitit 1875, Berovski formoi një **rreth sekret në Selanik**. Atje filluan edhe përgatitjet për kryengritjen.

Për të siguruar para dhe materiale të tjera të nevojshme, D. Berovski dhe prifti Stojan shitën një pjesë të pronës së tyre. Me fondet e marra, u blenë disa revolverë, pushkë dhe municione, të cilat u transportuan fshehurazi në Maleshevi. Mësueset **gjyshe Nedela** dhe **Stanislava Karaivanova**, e bënë **flamurin e kryengritjes**. Në të ishte qëndisur një luan dhe mbishkrimet “Maqedoni” dhe “Ngrihuni, t’ju çliroj”. Flamuri u bë sipas udhëzimeve të Berovskit dhe bazuar në një skicë që ai ua dha atyre.



Dimitar Pop Georgiev Berovski

Mëso më shumë



Pak para Kryengritjes së Razllovit, në fillim të majit të vitit 1876, një turmë myslimanësh në Selanik e vrau konsullin francez dhe atë gjerman. Ata u vranë sepse u përpoqën të mbronin të krishterët që kishin hyrë në konflikt me myslimanët për shkak të rrëmbimit të Stefanisë së re nga Bogdanci.



Prifti Stojan nga fshati Razllorc

Pasi përfundoi me përgatitjet themelore, D. Berovski u kthye në rajonin e Maleshevës. Atje, me një çetë të vogël, ai filloi t'i binte rreth e përqark rajonit dhe të mblidhte mbështetës që do të ngriheshin me një sinjal të caktuar. Sipas planit, kryengritja do të fillonte në fshatrat Pijanec dhe Maleshevë, dhe pastaj do të përhapej në rajonin e Radovishit, Strumicës, Petriçit dhe Mellnikut.

Fillimi dhe rrjedha e kryengritjes

Arsyeja specifike për fillimin e kryengritjes ishte keqtrajtimi i rreth dhjetë banorëve të Razllovcit nga zyrtarët e taksave që kishin ardhur në fshat. Prandaj, në mëngjesin e **20 majit të vitit 1876**, rreth gjashtëdhjetë kryengritës të udhëhequr nga D. Berovski e **sulmuan fshatin Razllovc**. Kështu, disa turq u vranë dhe të tjerë u plagosën. Pastaj fshatarët filluan të mblidheshin në mes të fshatit dhe t'i digjnin dokumentet në të cilat ishin regjistruar detyrimet e tyre. Por, të tjerët kishin frikë nga hakmarrja e mundshme. Në një situatë kaq të tensionuar, me urdhër të priftit Stojan, djali i tij e dogji hanin e vet. Me këtë akt, prifti Stojan donte t'u tregonte fshatarëve se ai vetë po sakrifikoje pronën e tij në emër të lirisë, e cila është më e shenjtë se çdo gjë.

Menjëherë pas kësaj, kryengritësit u ndanë në dy grupe. Dimitar Berovski, me grupin më të madh dhe me flamurin që valëvitej, u nis drejt rajonit të Berovës për ta përhapur kryengritjen në atë zonë. Gjatë rrugës, ai u përlesh me një njësi osmane, gjatë së cilës u plagos në kokë. Cone Spasov me disa kryengritës qëndroi në Razllovc për ta mbrojtur popullsinë dhe pronën e tyre. Ndërkohë, **Razllovc u sulmua**

Njihju me një figurë historike



D. Berovski u shkollua në Berovë, Odesa (Rusi) dhe Beograd (Serbi) ku e mbaroi shkollën ushtarake. Ai punoi për një kohë të shkurtër si mësues në Berovë, ku ishte vekil (përfaqësues) i të krishterëve dhe myslimanëve para autoriteteve. Në korrespondencën e tij, ai shpesh nënshkruhej si D. Makedonski. Ai mori pjesë në dëbimin e peshkopit të patrikanës nga Berova, dhe më pas në lëvizjen uniate. Pas ngjarjeve të trazuara të Krizës Lindore, ai emigroi në Bullgari. Më vonë, ai bashkëpunoi me Goce Dellçevin dhe ndihmoi në transportimin e armëve në Maqedoni.



Flamuri i Kryengritjes së Razllovcit



Gjyshja Nedela Karaivanova



Stanislava Karaivanova



Cone Spasov



Kryengritja e Razllovcit

dhe u dogj nga osmanët, duke vrarë rreth dhjetë fshatarë. Kjo, si dhe plagosja e D. Berovskit, e ndryshoi planin, dhe me të edhe rrjedhën e kryengritjes. Berovski nuk arriti të lidhej me kryengritësit e tjerë në rajonin e Maleshevës. Kështu, që nga fillimi kryengritja mori një rrjedhë të papara-shikueshme dhe të padëshirueshme.

Shtypja e kryengritjes

Autoritetet osmane morën masa të shpejta për ta parandaluar përhapjen e kryengritjes, por edhe për ta shtypur atë. Fillimisht, ata urdhëruan të gjithë barinj të dhe tufat e tyre të largoheshin nga rajoni i Maleshevës. Me këtë masë, kryengritësit do të izoloheheshin, duke u lënë pa burime ushqimi dhe informacioni. Në të njëjtën kohë, u rrit numri i trupave në zonat përreth, të cilat gradualisht filluan ta shtrëngonin kordonin rreth zonës së kryengritjes.

E kaluara përmes burimeve



Pas ngjarjeve të para në Razllovc, plaku Nako iu drejtua fshatit me fjalët:

"Fshatarë, pse jeni kaq të shqetësuar dhe të menduar? Nëse do të jetonit edhe njëqind vite të tjera, nuk do ta shihnit këtë me sytë tuaj. A ju kujtohet kur nuk kishim urë mbi lumë, dhe këto fëlliqësira vinin përballë fshatit dhe u bërtisnin fshatarëve t'i mbanin mbi shpinë, në vend që të kalonin mbi kuaj? – Dhe tani shikoni se si po ecin nëpër lumin e baltosur të Bregallnicës me ujin deri në gushë, sikur të ishte tokë e thatë." (P. K. Stojanov)

Gjatë këtyre aksioneve, **Razllovci u dogj dhe u plaçkit për herë të dytë**. Në të njëjtën kohë, shumë njerëz nga Malesheva dhe zonat fqinje u arrestuan dhe u burgosën. D. Berovski me bërthamën e çetës së tij arriti t'i shpëtonte rrethimit. Prifti Stojan, i cili pas shtypjes së kryengritjes u strehua përkohësisht në Manastirin e Rilës, u zbulua shpejt, por, gjatë përpjekjeve për ta dërguar në burg, kreu vetëvrasje.

Dështimi i Kryengritjes së Razllovci qendron në karakterin e saj lokal, si dhe në organizimin, armatimin dhe stërvitjen e dobët të kryengritësve. Fakti që flamuri kryengritësve mbante mbishkrimet “Maqedoni” dhe “Ngrihuni, t’ju çliroj” flet për karakterin çlirimtar të kryengritjes, megjithëse ajo kishte karakter lokal dhe nuk kishte ndikime të jashtme.

Prandaj, në fillim të shekullit XX, Kryengritja e Razllovci cilësohet si kryengritja e parë maqedonase. Për shkak të rëndësisë së saj për historinë e popullit maqedonas, me rastin e 100-vjetorit të kryengritjes, në fshatin Razllovci u ngrit një “Shtëpi-përkujtimore e Kryengritjes së Razllovci”



Kryengritja e Razllovci –pikturë artistike në Muzeun e Luftës Maqedonase për Pavarësi

Ndërlidhi njohuritë

Konsultohu me hartën gjeografike dhe zbulohet:

- Pse përmendet lumi Bregallnica në kontekstin e Kryengritjes së Razllovci?
- Analizojë relievin e rajonit të Pijanecit-Maleshevës dhe zbulohet se për çfarë lloj aktiviteti është më i përshtatshëm dhe me çfarë është i pasur? Në këtë mënyrë do ta kuptoni dhe do ta mbani mend më lehtë pse u urdhërua tërheqja e blegtorëve nga ky rajon gjatë kryengritjes!



Shtëpi-përkujtimore e Kryengritjes së Razllovci në f. Razlovci



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Përshkruaj kushtet në të cilat shpërtheu Kryengritja e Razllovci?
2. Çfarë donte të arrinte prifti Stojan me djegien e hanit të tij?
3. Pse nuk u realizua plani për ta zgjeruar kryengritjen në zonat fqinje?

Kryengritja Maqedonase

Situata në Maqedoni dhe arsyet e kryengritjes

Pas Kongresit të Berlinit (1878), Maqedonia mbeti nën sundimin osman. Sipas **nenit 23 të Traktatit të Berlinit**, në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane, së cilës i përkiste edhe Maqedonia, ishte paraparë që **të zbatoheshin reforma**. Kjo do të thoshte se këto zona do të fitonin një autonomi të caktuar administrative. Megjithatë, këto dispozita nuk u zbatuan kurrë plotësisht. Prandaj, pati pakënaqësi midis popullsisë.

Nga tokat të cilat Perandoria Osmane i humbi gjatë Krizës Lindore, një numër i konsiderueshëm myslimanësh u vendosën në territorin e Maqedonisë. Kërkimi për hapësirë jetese dhe burime të ardhurash e rriti tensionin midis kolonëve dhe vendasve. Në rritjen e frymës kryengritëse kontribuan edhe vullnetarët maqedonas që morën pjesë në luftërat antiturke. Midis tyre janë **Dimitar Berovski, Gjorgjija Pulevski, gjyshi Ilo Maleshevski** dhe të tjerë. Ndikim nxitës patën edhe nga çetat që lëviznin nëpër Maqedoni.

Ndikim pati edhe prania ruse në Principatën e Bullgarisë dhe në provincën e Rumelisë Lindore. Përveç kësaj, trupat ruse nuk ishin tërhequr ende nga Xhumaja e Epërme (Blagoevgradi i sotëm). Popullsia besonte se ata do ta mbështesnin kryengritjen.

Për kryengritje insistonin edhe peshkopët ekzarkë në mërgim nga Maqedonia, veçanërisht Natanail Kuçevishki. Frymë kryengritëse kishte edhe midis emigrantëve maqedonas në Bullgari, ku u krijuan disa komitete nën emrin **“Uniteti”**. Ata u mbështetën nga nacionalistët bullgarë të cilët besonin se Maqedonia i ishte marrë padrejtësisht Bullgarisë me vendimet e Kongresit të Berlinit.

Fillimi dhe rrjedha e kryengritjes

Plani për kryengritjen u përcaktua në një takim në Xhumaja e Epërme. Në atë kohë, u zgjodh udhëheqja e kryengritjes, e kryesuar nga **Stojan Karastillovi**. Kryengritja filloi më **17 tetor 1878**, me një **sulm ndaj garnizonit osman në fshatin Kresna**. Për këtë arsye, në historiografi shpesh quhet kryengritja e Kresnës, edhe pse **vetë kryengritësit**

Sfidë për hulumtim



Në Shkupin modern ekziston mëhalla e Maxhirit. Hulumto dhe përgjigju:

- Çfarë do të thotë fjala Maxhir/ë?
- Kur u themelua mëhalla e Maxhirit dhe nga erdhën banorët e saj të parë?



Gjyshi Ilo Maleshevski



Natanail Kuçevishki



Kryengritja Maqedonase

e quajtnë Kryengritja Maqedonase. Rrjedha e kryengritjes në mënyrë të kushtëzuar mund të ndahet në dy faza. E para: deri në dhjetor të vitit 1878, kur dominuan forcat e brendshme maqedonase të udhëhequra nga S. Karastoillovi dhe D. Berovski. Faza e dytë zgjati deri në mesin e vitit 1879, ku rolin udhëheqës e luajtën njerëzit përreth komitetit “Uniteti”.

Kryengritësit e mposhtën garnizonin osman në Kresna. Kështu, ata kapën robër mbi njëqind ushtarë osmanë dhe oficerët e tyre. Kryengritja shpejt u përhap në të dy anët e lumit Struma. Osmanët u tërhoqën drejt Petritit dhe Sere-sit. Brenda një kohe të shkurtër, u **çliruan 54 vendbanime**. Kryengritja u përhap edhe në Luginën e Razllovit. Atje u **çlirua Bansko**, por u kthye shpejt nën sundimin osman. Në dhjetor të vitit 1878, qendra e kryengritjes u zhvendos në zonën e **Karshijakut**.



Vula e Kryengritjes Maqedonase

Mëso më shumë



Kryengritësit iu drejtuan edhe peshkopit të patrikanës në Mellnik për para. Ai e informoi zëvendëskonsullin e përgjithshëm britanik në Selanik për këtë dhe deklaroi se kryengritësit e quanin veten “maqedonas” - duke premtuar se do t’i lëshonin një “vërtetim” dhe do t’ia kthenin paratë, pasi “të bëheshin zotër të tokës së tyre Maqedonisë”.

Organizimi i pushtetit kryengritës në territorin e lirë

Pas sukseseve të para, në territorin e lirë u formua **Shtabi i Kryengritjes Maqedonase**. Si **shef i Shtabit të Kryengritjes Maqedonase** u zgjodh Dimitar Berovski. Ai kishte vulën e tij. Adam Kallmikovi u zgjodh **Ataman** (udhëheqës) i kryengritjes, kurse si **Vojvoda i Parë** u zgjodh Stojan Karastoillovi. Selia e shtabit ndodhej në fshatin Vllahi.

Për ta ruajtur rendin dhe paqen në territorin e lirë, u formua një udhëheqje policore. Në çdo fshat u formuan administrata me tre prijës. Ata duhej të mbledhnin fonde për ta mbështetur ushtrinë kryengritëse. Për paratë e mbledhura, lëshoheshin certifikata, ku thuhej se fondet do t'u ktheheshin atyre pas çlirimit të Maqedonisë. Më vonë, u miratuan edhe **Rregullat e Komitetit Kryengritës Maqedonas**. Rregullat kërkonin besnikëri ndaj kryengritjes nga të gjithë maqedonasit e krishterë.

Kryengritësit e quanin veten maqedonas dhe e konsideronin Maqedoninë si atdheun e tyre. Prandaj edhe protesta zyrtare kundër "Unitetit", sepse në korrespondencën e tyre të ndërsjellë Komiteti përmbahej nga përdorimi i fjalës "maqedon".

Shtabi i Kryengritjes Maqedonase mbante kontakte me emigrantët maqedonas në Serbi dhe Rumani, nga ku merrte mbështetje morale dhe materiale. Përveç kësaj, në kryengritje u përfshinë vullnetarë dhe lavdidashës me origjinë të ndryshme. Kështu, në radhët e kryengritësve përfshiheshin rusë, polakë, slovenë, serbë, bullgarë e të tjerë. Shpesh kishte rivalitet midis këtyre aventurierëve lavdidashës.

Rënia dhe shtypja e kryengritjes

Rritja e shpejtë e kryengritjes nuk shkoi në favor të komitetit "Uniteti". Komiteti filloi ta pengonte shpërndarjen e armëve dhe vendosjen e vullnetarëve. Pastaj filluan intrigat për ta ndërmarrë udhëheqjen e kryengritjes.

Në një mjedis të tillë, u ndez një rivalitet për postin komandues midis A. Kallmikovit dhe S. Karastoillovit. Si rezultat, Kallmikovi u dëbua dhe titulli i atamanit u hoq. Ndërkohë, komiteti "Uniteti" e arrestoi **Dimitar Berovskin**. Menjëherë pas kësaj, Kallmikovi u kthye mbrapsht. Të kthyerit në kryengritje e vranë me pabesi **Stojan Karastoillovin**. Kjo shkaktoi pakënaqësi midis kryengritësve, prandaj D. Berovski u lirua për ta rivendosur rendin. Por shumë shpejt ai u burgos përsëri.

Fjalë dhe terma të panjohur



Ataman - Titull midis kozakëve që do të thotë udhëheqës, kryeplak, komandant, kreu i një bashkësie ushtarake ose shoqërore.

Ataman nuk është titull tradicional midis popujve të Ballkanit. Ky titull iu dha Adam Kallmikovit, për shkak të origjinës së tij ruse kozake.



Struktura e Kryengritjes Maqedonase



Letër nga D. P. G. Berovski, e nënshkruar si Shef i Shtabit të Kryengritjes Maqedonase, e vulosur me vulën e tij

E kaluara përmes burimeve



Ja se si Gjeorgjia Pulevski, në një letër drejtuar Despot Baxhoviqit, i cili planifikonte të vinte nga Serbia me një çetë dhe t'u bashkohej kryengritësve, e përshkruan rolin e Natanail Kuçevishkit:


“Do t'ju them të mos vini këtu me njerëz, sepse ka diçka të keqe këtu. Këtu bullgarët po luajnë me ne dhe po e kthejnë në ujë në mullirin e tyre, së bashku me Natanailin me kapelë të zezë, i cili është maqedonas, por më shumë tërheq nga bullgarët. Më lejoni t'ju them, ja ku jemi me çetën, duke pritur kaq gjatë për t'u nisur për te turqit dhe për të luftuar për lirinë tonë, por nuk po na lënë të shkojmë. Ata ndezën një zjarr dhe tani duan më shumë zhurmë përpara Evropës, ushtarët e mi po shpërbëhen ngadalë, por edhe unë nuk kam pse të pres.”

Që nga ajo kohë, udhëheqja e kryengritjes u mor përsipër nga komiteti “Uniteti”, ku Natanail Kuçevishki luajti një rol të madh. Njësitë e sapoformuara nuk u përdorën në mënyrë racionale për ta mbrojtur territorin e lirë. Ndërkohë, forcat osmane e kishin vendosur kontrollin mbi territorin e kryengritësve. Në fillim të **qershorit të vitit 1879, u lëshua urdhër për shpërbërjen e të gjitha çetave**. Kështu, formalisht përfundoi Kryengritja Maqedonase

Arsyet e dështimit të kryengritjes

Një nga arsyet e dështimit të kryengritjes maqedonase qëndron në situatën e pafavorshme ndërkombëtare. Ajo shpërtheu në një kohë kur Kriza Lindore ishte mbyllur në mënyrë diplomatike. Prandaj, nuk kishte perspektivë për të fituar mbështetje ndërkombëtare. Nga ana tjetër, kryengritja tregoi dobësi të brendshme si pasojë e mosmarrëveshjeve dhe përçarjeve që u shkaktuan nga faktorë të jashtëm.

Kjo është kryengritja e parë që vetë kryengritësit e quajtën maqedonase. Një emërtim i tillë ruhet edhe në institucionet e saj, si: Shtabi i Kryengritësve Maqedonas; si dhe Shefi i Shtabit të Kryengritjes Maqedonase. Prandaj, kryengritja zë një vend të rëndësishëm në historinë e popullit maqedonas.



Fillimi i Kryengritjes Maqedonase – pikturë artistike në Muzeun e Luftës Maqedonase për Pavarësi



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Shpjegoji arsyet e fillimit të Kryengritjes Maqedonase!
2. Përshkruaje organizimin e pushtetit kryengritës në territorin e çliruar!
3. Bazuar në tekstin e letrës së Gj. Pulevskit drejtuar D. Baxhoviqit, përpiku ta shpjegosh rolin e komitetit “Uniteti” në Kryengritjen Maqedonase.
4. Pse situata ndërkombëtare nuk ishte në favor të Kryengritjes Maqedonase?

Lidhja e Prizrenit dhe shfaqja dhe zhvillimi i lëvizjes çlirimtare shqiptare

Pushteti osman në Ballkan, gradualisht, po dobësohej. Njëri pas tjetrit, popujt ballkanikë filluan të luftonin për çlirim dhe krijimin e shteteve të tyre. Në kushte të tilla, udhëheqësit shqiptarë e kuptuan se edhe shqiptarët duhej t'i mbronin interesat e tyre në zonat ku jetonin.

Shqiptarët dhe Kriza e Madhe Lindore

Udhëheqësit shqiptarë fillimisht **nuk kërkuar pavarësi të plotë**. Ata besonin se populli nuk ishte ende mjaft i përgatitur për një hap të tillë dhe se kushtet në Evropë nuk ishin të favorshme. Prandaj, në vend të pavarësisë, ata filluan të kërkonin **autonomi në kuadrin e Perandorisë Osmane**.

Kjo do të thoshte se shqiptarët do t'i qeverisnin vetë zonat e tyre, do të kishin shkollat, zyrtarët e tyre dhe do të kishin kontroll më të madh mbi financat lokale, por do të mbeteshin nën autoritetin e sulltanit. Këto ide u zhvilluan për herë të parë në Shqipërinë Jugore, ku kishte një jetë më të zhvilluar kulturore dhe arsimore.

Në vitin 1877, në Janinë u mbajt një **takim i krerëve shqiptarë**, ku u formua **komiteti i fshehtë**. Po atë vit, në Kostandinopojë, u krijua **Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Popullit Shqiptar**. Qëllimi i tij ishte krijimi i një **vilajeti shqiptar** në kuadrin e Perandorisë Osmane. Të gjitha këto ngjarje ndodhën gjatë Luftës Ruso-Turke.

E kaluara përmes burimeve



Menjëherë pas nënshkrimit të Traktatit të Shën Stefanit, disa intelektualë shqiptarë filluan të dërgonin memorandume dhe kërkesa te përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha. Ambasadori britanik në kryeqytetin osman, Henry Austin Lajard, mori një memorandum në prill të vitit 1878 nga një, siç u shpreh vetë, zotëri shqiptar. Në memorandum, ndër të tjerë, thuhej:

“... Krahas kësaj, shqiptarët, të cilët janë të vendosur t'i thyejnë zinxhirët që i lidhin me Turqinë, kërkojnë një qeveri të veçantë, më në harmoni me nevojat dhe traditat e tyre; ata kërkojnë të drejtën e tyre për të hyrë në krahët e familjes së madhe evropiane, së cilës i përkasin nga raca dhe ngjashmëria.”

Fjalë dhe terma të panjohur



Memorandum - Dokument i shkruar që paraqet kërkesa ose qëndrime ndaj një qeverie ose përfaqësuesve të rëndësishëm politikë.



Janina



Vendi ku u formua Lidhja e Prizrenit

Kjo luftë pati pasoja të mëdha për Ballkanin. Perandoria Osmane pësoi disfatë të rëndë dhe më 3 mars të vitit 1878, u detyrua ta nënshkruante Traktatin e Shën Stefanit. Me këtë traktat ishte parashikuar krijimi i shtetit të madh bullgar. Në përbërjen e tij duhej të përfshiheshin zona në Ballkan **ku je-tonin shqiptarët**.

Në të njëjtën kohë, Serbia dhe Mali i Zi do të zgjeroheshin ndjeshëm në territoret me popullsi shqiptare. Këto vendime shkaktuan pakënaqësi të madhe në Ballkan dhe në Evropë.

Formimi dhe veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit

Shqiptarët e kuptuan se, nëse nuk do të organizoheshin dhe nuk do të vepronin vetëm, askush nuk do t'i mbroste interesat e tyre. Prandaj, Komiteti në Kostandinopojë propozoi që të mbahej një **tubim i përgjithshëm shqiptar** në Prizren.

Më **10 qershor 1878, në Prizren** filloi me punë tubimi i madh i përfaqësuesve shqiptarë. Në atë tubim u krijua **Lidhja e Prizrenit**, e cila ishte organizatë politike kombëtare shqiptare.

Në tubim u zgjodhën organet drejtuese, si Këshilli i Përgjithshëm dhe Komiteti Qendror. Në të njëjtën kohë, u miratuan dy dokumente të rëndësishme - **Kararnameja** (akti i vendimmarrjes) dhe **Talimati** (urdhri, udhëzimet). Me to u përcaktuan qëllimet dhe mënyrat e funksionimit të Lidhjes.

Njihuni me një figurë historike



Abdyl-bej Frashëri (1839–1892) ishte një figurë politike dhe rilindës shqiptar. Lindi në fshatin Frashër në jug të Shqipërisë. Ai punoi si nëpunës civil në Perandorinë Osmane, por më vonë iu përkushtua tërësisht luftës për të drejtat e shqiptarëve. Abdyl-bej Frashëri ishte në krye të Komitetit të Janinës.

Në vitin 1878 ai ishte një nga udhëheqësit kryesorë të Lidhjes së Prizrenit. Për shkak të aktiviteteve të tij, u arrestua nga autoritetet osmane dhe u dënua me burgim të gjatë. Më vonë u lirua, por shëndeti iu ligësua dhe vdiq në Kostandinopojë.



Abdyl-bej Frashëri

Qëllimi kryesor i Lidhjes së Prizrenit ishte krijimi i një vilajeti të bashkuar shqiptar me autonomi të gjerë. Që më 15 qershor të vitit 1878, Lidhja e njoftoi shtetin osman dhe Fuqitë e Mëdha se do të **mbronte territoret e saj**.

Ndërkohë, filloi Kongresi i Berlinit, në të cilin Fuqitë e Mëdha i shfuqizuan vendimet që u morën në Shën Stefan. Vendimet e Kongresit nuk përputheshin me interesat e Lidhjes së Prizrenit.

Pas Kongresit të Berlinit, Lidhja e Prizrenit i filloi **veprimtaritë aktive** dhe në të gjitha territoret e banuara nga shqiptarët u krijuan dhjetëra degë të saj. Kur ushtria osmane u tërhoq nga zona të caktuara, forcat e Lidhjes hynë menjëherë atje për të penguar hyrjen e trupave malazeze. Ky ishte rasti në **Plavë** dhe **Guci** në vitin 1879, ku forcat e organizuara nga Lidhja i mundën ushtritë malazeze. Këtu u shqua **Ali Pashë Gucia**.

Më vonë, nën presionin e madh të Fuqive të Mëdha, shteti osman u detyrua t'i pranonte vendimet e Kongresit të Berlinit. Në vitin 1880, një flotë e madhe ushtarake e përbërë nga disa vende evropiane u dërgua në **Ulqin**. Nën këtë kërcënim, ushtria osmane hyri në qytet dhe pas disa ditësh ia dorëzoi atë Malit të Zi.

Përveç luftës së armatosur, Lidhja e Prizrenit zhvilloi edhe luftë **diplomatike**. Ajo dërgoi letra, kërkesa dhe delegacione në Romë, Paris, Londër, Berlin, Vjenë dhe Sta-



Ali Pashë Gucia



Delegatët e Lidhjes së Prizrenit

mboll. Ata u shpjegonin qeverive evropiane se **shqiptarët janë një popull i veçantë** dhe se ata kanë të drejtë për vendin e tyre dhe për vetëqeverisjen e tyre.

Në fillim të vitit 1881, Lidhja e Prizrenit ndërmori një hap edhe më të guximshëm. Ajo shpalli Komitetin e saj Qendror si **Qeveri të Përkohshme, të kryesuar nga Ymer Prizreni**. Qëllimi ishte të krijonte një administratë të vërtetë dhe një ushtri të rregullt dhe ta shtrinte pushtetin e Lidhjes në të gjitha zonat e Ballkanit të banuara nga shqiptarët.

Në shumë qytete, si në Prizren, Prishtinë, Shkup, Dibër, Mitrovicë e të tjera, zyrtarët osmanë u dëbuan dhe u zëvendësuan nga përfaqësues të Lidhjes. Kështu, në këto vende u vendos pushteti i Lidhjes së Prizrenit.

Fundi i Lidhjes së Prizrenit

Këto suksese e alarmuan Sulltanin dhe qeverinë osmane, të cilët vendosën ta shtypnin lëvizjen me forcë. Në mars të vitit 1881, një ushtri e madhe u dërgua nën komandën e **Dervish Pashës**. Luftëtarët e Lidhjes së Prizrenit luftuan me trimëri dhe me vetëmohim, por nuk mundën t'i rezistonin ushtrisë së madhe osmane.

Pas luftimeve të ashpra, më 23 prill të vitit 1881, **ra Prizreni**, pastaj edhe qendrat e tjera të Lidhjes. Me këtë, **Lidhja e Prizrenit u shua**. Shumë nga udhëheqësit e saj u arrestuan, u burgosën ose u internuan. Kështu, përfundoi lëvizja e parë e madhe dhe e organizuar kombëtare shqiptare.

Edhe pse pushteti osman arriti ta shkatërronte Lidhjen, rëndësia e saj mbeti e madhe. Lidhja e Prizrenit ishte organizata e parë që i bashkoi shqiptarët. Idetë që la pas filluan të përhapeshin më gjerësisht dhe të ndikonin në zhvillimin e mëtejshëm të lëvizjes kombëtare shqiptare.



Ymer Prizreni

Mëso më shumë



Gjatë Krizës Lindore, shqiptarët jo vetëm që luftuan me armë për të drejtat e tyre, por zhvilluan edhe një luftë tjetër, shumë të rëndësishme - luftën për arsim dhe gjuhë.

Intelektualët e tyre e kuptuan se populli nuk mund të përparonte, nëse nuk do të kishte shkollat, librat dhe gjuhën e vet të shkruar.

Prandaj, në vitin 1879, u themelua **Shoqëria për Shtypjen e Shkronjave Shqipe**. Anëtarët e saj besonin se çdo popull bëhet i ditur dhe i zhvilluar vetëm kur ka gjuhën dhe shkrimin e vet. Ata besonin se një popull, që nuk ka gjuhë të shkruar, jeton në injorancë dhe prapambetje.

Kështu, përveç luftës në fushën e betejës, ata luftuan edhe me penë, sepse e dinin se arsimi dhe kultura ishin themeli i çdo shteti të lirë dhe përparimtar.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Pse udhëheqësit shqiptarë nuk kërkuar fillimisht pavarësi të plotë nga Perandoria Osmane?
2. Kur dhe ku u mbajt tubimi i parë i madh i përfaqësuesve shqiptarë dhe çfarë organizate u themelua në atë tubim?
3. Çfarë ndodhi me Lidhjen e Prizrenit dhe udhëheqësit e saj në vitin 1881?

EVROPA DHE BOTA

NGA MESI I SHEKULLIT XIX DERI NË
LUFTËN E PARË BOTËRORE

3



Pranvera e popujve dhe krijimi i shteteve kombëtare në Evropë

Shkaqet e revolucioneve të vitit 1848

Pas Kongresit të Vjenës në vitet 1814-1815, sundimtarët evropianë u përpoqën ta rivendosnin rendin që ekzistonte para Luftërave të Napoleonit. Në vend të demokracisë dhe lirive më të mëdha për qytetarët, në shumë vende, vendimet më të rëndësishme u morën përsëri nga monarkët.

Megjithatë, Revolucioni Francez tregoi se mbreti mund të rrëzohet. Prandaj, sundimtarët kërkuar ta parandalonin shpërthimin e revolucioneve të reja. U vendos **censurë e rreptë** e gazetave dhe çdo kritikë ndaj qeverisë mbytej shpejt. **Policia sekrete** i ndiqte profesorët, studentët dhe gazetarët. Shumë u arrestuan dhe u internuan në vende të largëta. Me forcë dhe frikë, autoritetet u përpoqën ta ruanin rendin jopopullor.

Por Evropa nuk ishte më aq e nënshtruar sa kishte qenë më parë. Shumë evropianë e kishin përjetuar tashmë se **çfarë do të thoshte të jesh i lirë** dhe e kishin të vështirë të pajtoheshin me kthimin e prangave të vjetra. Fshatarët e dinin se në disa vende nuk kishte detyrime feudale, kështu që kërkuar heqjen e feudalizmit edhe në vendet e tyre. Të korrat e dobëta dhe rritja e çmimeve të ushqimeve e përkeqësuan më tej situatën e më të varfërve. Në qytete, përmes broshurave dhe qarqeve sekrete, po përhapeshin **ide për kushtetutat, të drejtat civile dhe shtetet e veta kombëtare**.

Njerëz të ndryshëm kishin kërkesa të ndryshme, por të gjithë ishin po aq të pakënaqur. Një shkëndijë e vogël ishte e mjaftueshme për të ndezur ndonjë revoltë.

Pranvera e popujve

Pakënaqësia ndaj pushtetit në Francë shprehej më shpesh në tubime politike të njohura si **bankete**. Këto përfshinin fjalime kundër monarkisë dhe këndimin e “Marsejezës”, himnit



Policia sekrete i ndiqte qytetarët

Fjalë dhe terma të panjohur



Censurë - Kur shteti i ndalon ose i ndryshon informacionet me qëllim që popullsia të mos dëgjojë ose lexojë ndonjë gjë që është e padëshirueshme për autoritetet.



Banket në Paris (1847)



Përleshje në rrugë dhe barrikada në Paris



Barrikada në Vjenë

të Revolucionit Francez. Kur policia i ndaloi banketet në Paris, qytetarët të revoltuar dolën në rrugë.

Brenda një kohe të shkurtër, u ngritën barrikada me kalldrëm, mobilie dhe dru, ndërsa në qytet shpërthyen **përleshje të ashpra në rrugë** midis parisienëve dhe ushtrisë. Disa nga ushtarët refuzuan të qëllonin mbi bashkëqytetarët e tyre. Menjëherë pas kësaj, autoritetet e humbën kontrollin e Parisit. Nën presionin e ngjarjeve, mbreti Luis Filipe iku nga vendi dhe revolucionarët e shpallën **Republikën e Dytë Franceze**.

Suksesi i francezëve i inkurajoi kombet e tjera të ngriheshin në kryengritje. Në pranverën e vitit 1848, shpërthyen revolucione në disa vende të Evropës, të njohura me emrin e përbashkët si **Pranvera e popujve**.

Në **Perandorinë Austriake**, revolucioni filloi në mars të vitit 1848 në Vjenë, ku studentët, punëtorët dhe qytetarët e tjerë dolën në rrugë dhe u përleshën me ushtrinë. Për ta shuar pakënaqësinë, autoritetet miratuan një dekret që i **shfuqizonte taksat feudale** dhe premtoi kushtetutë dhe të drejta civile. Megjithatë, luftimet në rrugë vazhduan, pas të cilave Perandori Ferdinandi I dhe oborrtarët e tij ikën nga Vjena.

Lufta u përhap shpejt në pjesën më të madhe të Perandorisë Austriake. Në **Hungari**, revolucionarët e krijuan qeverinë e tyre, e cila fillimisht kërkoi autonomi dhe më pas pavarësi të plotë nga Austria. Në Pragë u mbajt një **Kongres Sllav**, në të cilin përfaqësuesit e shumicës së popujve sllavë paraqitën idenë e pansllavizmit.

Sfidë për hulumtim



Në vitin 1848, Johan Shtraus ati e kompozoi "Marshin e Radetckit", kushtuar Feldmarshal Josef Radetckit.

Dëgjoje marshin me mësuesin tënd të muzikës dhe më pas përpiku të kuptosh vetë se cilës ngjarje nga Pranvera e popujve i kushtohet.

Mëso më shumë



Fshatarët që nuk donin më revolucion

Në Perandorinë Austriake, kërkesa më e rëndësishme e popullsisë fshatare ishte heqja e feudalizmit. Kur qeveria i hoqi taksat feudale në vitin 1848, shumë fshatarë thanë: "Kjo na mjafton" dhe e ndërprejnë mbështetjen për revolucionarët.

Në fakt, revolucionin u dobësua sepse uniteti midis revolucionarëve u shpërbë, pasi një pjesë e popullsisë e kishte fituar tashmë atë që donte dhe ishte tërhequr nga lufta.

Fjalë dhe terma të panjohur



Pansllavizëm - Ideja për lidhje, solidaritet dhe bashkëpunim midis popujve sllavë.

Në të njëjtën kohë, shpërthyen trazira në vendet gjermane dhe italiane, me kërkesa për bashkim kombëtar.

Në verën e vitit 1848, filloi një **kundërrevolucion**, i udhëhequr nga autoritetet dhe ushtria. Kryengritësit nuk ishin të bashkuar dhe populli i paarmatosur nuk mundi t'u rezistonte gjatë ushtrive profesionale. Në fillim të vitit 1849, shumica e revolucioneve ishin shtypur.

Në Hungari, lufta vazhdoi deri në vitin 1849. Megjithatë, kur revolucionarët hungarezë ishin afër fitores, Czar Nikollai I vendosi t'i ndihmonte austriakët. I shqetësuar se trazirat do të përhapeshin në Rusi, ai dërgoi një ushtri të madhe ruse, e cila e **shtypi revolucionin hungarez**.

Përveç në Francë, lëvizjet revolucionare të vitit 1848 përfunduan kudo me disfatë ushtarake. Megjithatë, ato lanë pasojë afatgjatë në Evropë. Në Perandorinë Austriake dhe në disa shtete gjermane, feudalizmi u shfuqizua dhe ideja e lirisë dhe e shteteve të veta kombëtare vazhdoi të jetonte në dekadat në vijim.

Bashkimi i Italisë dhe krijimi i Perandorisë Gjermane

Pas Pranverës së popujve, Italia ishte ende e ndarë. Pengesa kryesore për bashkimin e popullit italian ishte Perandoria Austriake, e cila kishte pushtet mbi një pjesë të madhe të Italisë veriore.

Rolin kryesor midis shteteve italiane e luajti shteti i Piemontit. Me ndihmën e Francës, ai arriti t'i mposhtë austriakët dhe të bashkojë një pjesë të madhe të Italisë veriore dhe qendrore. Ky proces shpesh quhet **bashkimi i vogël i Italisë**. Në vitin 1861, u shpall **Mbretëria e Italisë**, e cila e bashkoi shumicën e tokave italiane në një shtet të vetëm.

Një nga figurat kryesore në bashkim ishte revolucionari **Xhuzepe Garibaldi**. Ai udhëhoqi një grup vullnetarësh të njohur si "Këmishat e Kuqe" dhe e pushtoi Italinë e Jugut.

Deri në vitin 1870, Venediku dhe Roma iu bashkuan Mbretërisë së Italisë. Me këtë përfundoi **bashkimi i madh i Italisë** dhe u krijua shteti kombëtar i popullit italian.



Nikollai I

Mëso më shumë



Kur Xhuzepe Garibaldi filloi të rekrutonte vullnetarë për të luftuar për bashkimin e Italisë, ai nuk kishte para për uniforma të vërteta ushtarake. Ushtria e tij përbëhej nga njerëz të zakonshëm që vinin me çfarëdo rrobash që kishin. Për t'i veshur të paktën në të njëjtën mënyrë, Garibaldi bleu këmisha të kuqe që më parë ishin përdorur si rroba pune në Amerikën e Jugut. Ato ishin të lira dhe ngjyra e kuqe e bënte të vështirë ta shihje gjakun.

Sipas interpretimeve të mëvonshme dhe historive popullore, kur luftëtarët shfaqeshin në fushën e betejës të veshur me të njëjtat këmisha, armikut i krijohej përshtypja se po përballej me një ushtri të organizuar, madje edhe se luftëtarët e saj nuk gjakosen dhe ishin të pamposhtur.



Xhuzepe Garibaldi

Bashkimi i Gjermanisë u udhëhoq nga Prusia. Një rol të madh në këto ngjarje luajti burrështetasi prusian **Oto fon Bismark**. Ai besonte se bashkimi nuk mund të arrihej nëpërmjet demokracisë dhe revolucioneve, por nëpërmjet diplomacisë së aftë dhe luftërave.

Bismarku e dinte se pengesa më e madhe për bashkimin gjerman ishte Perandoria Austriake, e cila kishte një ndikim të fuqishëm midis shteteve gjermane. Prandaj, ai besonte se konflikti me Austrinë duhej të zgjidhej me luftë.

Lufta midis Prusisë dhe Perandorisë Austriake filloi në vitin 1866. Prusia e fitoi luftën dhe e mori rolin udhëheqës midis shteteve gjermane.

Megjithatë, kjo e shqetësoi Francën, e cila nuk donte një shtet të fuqishëm gjerman në kufijtë e saj lindorë. Prandaj, në vitin 1870, shpërtheu lufta midis Prusisë dhe aleatëve të saj gjermanë nga njëra anë, dhe Francës nga ana tjetër. Fitorja e shteteve gjermane shkaktoi eufori të fuqishme kombëtare midis gjermanëve.

Në vitin 1871, në Pallatin e Versajës, Mbreti Prusian Vilhelmi I u shpall Perandor Gjerman (**Kaiser**). Kështu u krijua **Perandoria Gjermane**, një shtet i ri dhe i fuqishëm në zemër të Evropës.



Oto fon Bismark (karikaturë)

E kaluara përmes burimeve



Në vitin 1862, Oto fon Bismarku deklaroi para parlamentit prusian:

“Çështjet e mëdha të kohës sonë nuk zgjidhen me fjalime dhe vendime të shumicës... por me hekur dhe gjak.”

Çfarë nënkuptonte Bismarku me shprehjen “hekur dhe gjak” dhe cilën mënyrë të zgjidhjes së problemeve e mbështet ai?



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Pse filloi Pranvera e popujve?
2. Çfarë roli luajtën Xhuzepe Garibaldi dhe „këmishëkuqtë“ në bashkimin e Italisë?
3. Cili shtet dhe cili burrështetas e udhëhoqi bashkimin e Gjermanisë?

Lufta Civile në SHBA

Shkaqet e Luftës Civile në SHBA

Me shpalljen e pavarësisë në vitin 1776, nga trembëdhjetë kolonitë britanike në bregdetin lindor të Amerikës së Veriut u krijua një shtet i ri - Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në dekadat në vijim, SHBA-të u zgjeruan me shpejtësi drejt perëndimit dhe territore të reja iu bashkuan **federatës** si **shtete federale**.

Deri në vitin 1860, SHBA-të përbëheshin nga 33 shtete dhe disa territore, që shtriheshin nga Atlantiku në Oqeanin Paqësor. Në shikim të parë, vendi dukej i qëndrueshëm. Megjithatë, nën sipërfaqe fshiheshin përçarje të thella të brendshme.

Dallimet midis pjesëve veriore dhe jugore të SHBA-ve kanë ekzistuar që nga periudha koloniale, por pas pavarësisë ato u bënë gjithnjë e më të dukshme.

Veriu u zhvillua si një **rajon industrial**. Atje u ndërjuan fabrika, u zgjerua rrjeti hekurudhor dhe punëtorët paguheshin për punën e tyre. Çdo ditë nga Evropa vinin emigrantë të rinj, duke u vendosur më shpesh në qytete.

Jugu po ndryshonte më ngadalë. Ekonomia e tij bazohej ende në **bujqësi dhe plantacione të mëdha**, të cilat prodhonin pambuk dhe e shfrytëzonin punën e skllavërve. Për shkak të kësaj, **skllavëria** ishte shumë e rëndësishme për Jugun. Shumë shtete jugore besonin se idetë e lirisë dhe heqjes së skllavërisë, që dominonin në Veri, e kërcëno-



SHBA-të në vitin 1860 (shtetet federale tregohen me të gjelbër, ndërsa territoret me gri)

Fjalë dhe terma të panjohur



Luftë civile - Luftë e zhvilluar midis qytetarëve të të njëjtit shtet dhe që zhvillohet në territorin e atij shteti.

Federatë - Bashkim shtetesh që së bashku formojnë një shtet të vetëm.

Shtete federale - Shtete që janë të bashkuara në një shtet të vetëm. Çdo shtet federal e ka qeverinë e vet, por ekziston edhe një qeveri e përbashkët për të gjitha shtetet federale.

Qeveri federale - Qeveri e përbashkët për të gjitha shtetet federale, e cila vendos për çështjet më të rëndësishme në federatë. Për shembull: Kongresi ose Presidenti i SHBA-ve.

Mëso më shumë



Me zgjerimin e SHBA-ve drejt perëndimit, kolonët evropianë u vendosën në territoret e reja. Megjithatë, në këto hapësira për shekuj me radhë jetonin fiset indiane. Për ta përvetësuar tokën, në vitet 1830, autoritetet amerikane i detyruan anëtarët e të ashtuquajturve "Pesë Fise të Civilizuara" të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Gjatë zhvendosjeve të detyruara, indianët, shumë prej të cilëve ishin të moshuar, gra dhe fëmijë, ecnin rreth 1,500 kilometra, shpesh në dimër, pa ushqim të mjaftueshëm ose strehim. Mijëra prej tyre vdiqën nga uria, të ftohtit dhe sëmundjet. Këto ngjarje njihen si "**Shtegu i Lotëve**". Të mbijetuarit u vendosën në "Territorin indian" në Oklahoma, ku jetonin larg qyteteve dhe me qasje të kufizuar në tokë pjellore.

nin mënyrën e jetesës së Jugut. Prandaj, ata argumentuan se qeveria federale nuk kishte të drejtë të ndërhynte në punët e tyre të brendshme.

Ndërkohë që SHBA-të zgjeroheshin drejt perëndimit, lindi një problem serioz: çdo shtet i ri duhej të vendoste nëse do të ishte i lirë apo skllavopronar. Nga kjo çështje varej nëse Veriu apo Jugu do të kishin ndikim më të madh në hartimin e ligjeve.

Zgjedhja e **Abraham Linkolnit** si president në vitin 1860 e përkeqësoi më tej situatën. Edhe pse nuk e kërkoi heqjen e skllavërisë, ai e kundërshtoi zgjerimin e saj. Shtetet jugore e panë këtë si një kërcënim për mënyrën e tyre të jetesës.

Prandaj, nga fundi i vitit 1860 dhe gjatë vitit 1861, njëmbëdhjetë shtete jugore vendosën të shkëputeshin nga SHBA-të dhe ta krijonin shtetin e tyre, të quajtur **Shtetet e Konfederatës së Amerikës**.


Fillimi dhe rrjedha e luftës

Veriu nuk e pranoi shkëputjen e shteteve jugore dhe mosmarrëveshja midis dy palëve u përshkallëzua shpejt në konflikt të armatosur. Në prill të vitit 1861, ushtria e shteteve jugore e sulmoi fortesën Fort Samter. Me këtë filloi **Lufta Civile në SHBA**.

Veriu, i njohur edhe si **Union**, luftoi për t'i ruajtur SHBA-të si një shtet të vetëm. Kundër tij ishte Jugu, ose **Konfederata**, e përbërë nga njëmbëdhjetë shtete të shkëputura. Ne e quajmë këtë Luftë Civile, sepse u zhvillua midis vetë amerikanëve.



Emigrantët evropianë në rrugën e tyre drejt SHBA-ve



Abraham Linkoln



Betejë midis ushtrive të Unionit dhe Konfederatës



“Shtegu i Lotëve”

Lufta Civile zgjati nga viti 1861 deri në vitin 1865 dhe ishte një nga luftërat më të përgjakshme të shekullit XIX. Në beteja të shumta, ushtri me qindra mijëra ushtarë u përleshën dhe luftimet u zhvilluan në një territor të gjerë në të gjithë SHBA-të. Për herë të parë, **hekurudhat** dhe **telegrafi** u përdorën në një shkallë të gjerë, gjë që mundësoi lëvizje dhe furnizim më të shpejtë të ushtrive, si dhe komunikim më të shpejtë. **Industria** ishte gjithnjë e më e rëndësishme në luftë, veçanërisht për Veriun, i cili kishte shumë fabrika dhe prodhonte në masë armë e pajisje ushtarake.

Përveç fuqisë industriale, Veriu kishte edhe avantazhin e një popullsie më të madhe. Prandaj, ushtria e Unionit ishte në gjendje të zhvillonte një luftë të gjatë dhe ta rraskapiste armikun. Konfederata, nga ana tjetër, shpresonte për një luftë të shkurtër dhe një fitore të shpejtë, pasi nuk kishte burime të mjaftueshme për një luftë të gjatë.

Në vitet e para të luftës, as Veriu dhe as Jugu nuk arritën ta thyenin rezistencën e armikut. Betejat ishin të gjata dhe rraskapitëse, me suksese të ndryshme. Pika e kthesës ishte **Beteja e Getisburgut** në vitin 1863, në të cilën ushtria Veriore doli fitimtare dhe forcat Jugore filluan të tërhiqeshin.

Lufta mori një kuptim të ri kur në vitin 1863 Presidenti Linkoln e shpalli **“Proklamatën e emancipimit”**. Ky dokument e shpalli lirinë e skllëvërve në shtetet e rebeluara jugore. Si rezultat, Jugu mbeti pa forcën e tij më të rëndësishme punëtore. Disa nga skllëvërit e liruar u larguan nga territori i Konfederatës dhe u bashkuan me ushtrinë e Veriut.



Ushtarë me prejardhje afrikane në ushtrinë e Veriut

E kaluara në të tashmen



Telegrafi u shpik në vitin 1837 nga Samuel Mors. Linja e parë telegrafike u vu në shërbim në vitin 1844, midis qyteteve të Uashingtonit dhe Baltimorit.

Telegrafi funksiononte, duke transmetuar mesazhe nëpërmjet sinjaleve elektrike nëpër tel, duke e përdorur kodin (alfabetin) Mors, në vend që të transmetoheshin nga korrierë ose pëllumba siç kishte ndodhur më parë. Kjo mundësonte që lajmet të udhëtonin nga një vend në tjetrin brenda disa minutash, në vend të ditëve. Telegrafi luajti një rol, veçanërisht, të rëndësishëm gjatë Luftës Civile në SHBA.

Sot telegrafi nuk përdoret më. Cilat mjete moderne komunikimi kanë të njëjtin rol si telegrafi në shekullin XIX?

Ndërlidhi njohuritë



Gjatë Luftës Civile në SHBA, pati raste kur vëllezër, madje edhe baballarë e bij, luftuan në ushtri të ndryshme - disa për Unionin, të tjerë për Konfederatën.

Bisedo me mësuesin tënd të historisë dhe zbullo, nëse ka pasur raste në historinë e popullit dhe vendit tënd, kur të afërm të ngushtë e kanë gjetur veten në anët e kundërta të një lufte.

Çfarë mendon, pse lufta civile, në të cilën luftojnë njerëz nga i njëjti vend, shpesh lë pasoja më të rënda dhe më afatgjata sesa lufta kundër një armiku të jashtëm?

Deri në pranverën e vitit 1865, ushtria jugore ishte mundur në të gjitha frontet. Në prill të atij viti, ushtria kryesore e Konfederatës u dorëzua, duke i dhënë fund Luftës Civile. SHBA-të mbetën një vend i bashkuar.

Pasojat e Luftës Civile

Lufta Civile në SHBA mori mbi **600,000 jetë** njerëzish dhe la plagë të thella në shoqërinë amerikane. Fundi i luftës nuk solli pajtim të plotë dhe përçarjet e krijuara gjatë konfliktit vazhduan të ndiheshin edhe në të ardhmen.

Një nga çështjet më të ndjeshme ishte skllavëria. Në vitin 1865, ajo **u shfuqizua në të gjithë vendin**, por liria nuk nënkuptonte barazi të plotë, pasi pabarazitë sociale dhe racore vazhduan të ekzistonin.

Fitorja e Veriut e konfirmoi **rëndësinë e industrisë**, si një faktor kyç në luftë dhe në zhvillimin e shtetit. Ishte pikërisht supremacia industriale, që u mundësoi SHBA-ve të imponohesh, si një nga qendrat kryesore të Revolucionit të Dytë Industrial në fund të shekullit XIX.



Vrasja e Abraham Linkolnit

Sfidë për hulumtim



Disa ditë pas përfundimit të Luftës Civile në SHBA, Presidenti Abraham Linkoln u vra, ndërkohë që po shihte një shfaqje teatrale në Uashington. Ai ishte presidenti i parë në historinë e SHBA-ve që u vra.

Hulumto se kush e vrau Abraham Linkolnin dhe pse e bëri këtë?



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Renditi shkaqet kryesore të Luftës Civile në SHBA.
2. Kush e fitoi Luftën Civile dhe cila ishte arsyeja e fitores?
3. Cilat ishin pasojat e Luftës Civile në SHBA?

Revolucioni i Dytë Industrial

Energjia elektrike dhe zhvillimi industrial

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, zhvillimi industrial, që filloi në Britaninë e Madhe, u përhap në vende të tjera evropiane, si dhe në SHBA dhe Japoni. Industria hyri në një fazë të re, të cilën historianët e quajnë **Revolucioni i Dytë Industrial**.

Një nga ndryshimet më të rëndësishme gjatë kësaj periudhe ishte përdorimi i burimeve të reja të energjisë, ndër të cilat **energjia elektrike** u bë më e rëndësishmja.

Motori me avull, i cili ishte baza e industrisë në Revolucionin e Parë Industrial, po e humbiste, gradualisht, rolin e tij kryesor. Deri atëherë, prodhimi varej nga qymyri dhe uji, dhe për këtë arsye fabrikat shpesh ndërtoheshin pranë lumenjve. Një problem shtesë ishte se ndonjë defekt i motorit me avull mund ta ndalonte punën në të gjithë repartin industrial.

Me energjinë elektrike, kjo varësi u kapërcye. Fabrikat mund të ndërtoheshin në vende të ndryshme dhe çdo makinerie e kishte motorin e vet elektrik dhe ajo funksiononte në mënyrë të pavarur.

Energjia elektrike çoi në prodhim më të shpejtë, por për zhvillimin e industrisë nevojiteshin edhe materiale më të forta.



Punëtor-fëmijë (rreth vitit 1900)



Nikolla Tesla

Njihuni me një figurë historike



Nikolla Tesla

Shpikës dhe shkencëtar nga Ballkani, i lindur në vitin 1856. Ai e kaloi pjesën më të madhe të jetës së tij në SHBA, ku punoi në përmirësimin e sistemeve për transmetimin dhe përdorimin e energjisë elektrike. Kontributi i tij më i rëndësishëm ishte zhvillimi dhe zbatimi i sistemit të rrymës alternative, i cili e mundësoi transmetimin efikas të energjisë elektrike në distanca të gjata. Me zbatimin e rrymës alternative, filloi ndriçimi masiv elektrik i qyteteve.

Shkolla, institutet shkencore dhe rrugët e shumta në vende të ndryshme janë emëruar për nder të Nikollës Teslës, dhe makinat elektrike janë emëruar gjithashtu sipas tij. Njësia e induksionit magnetik - tesla - është emëruar, gjithashtu, sipas tij (T).

Revolucioni i Dytë Industrial u karakterizua nga përdorimi i çelikut dhe zhvillimi i **industrisë së çelikut**, veçanërisht në SHBA dhe Gjermani. Ndryshe nga hekuri i farkëtuar, çeliku ishte më i qëndrueshëm dhe më i lirë për t'u prodhuar në masë. Ai u përdor për të ndërtuar ura, hekurudha dhe makineri më të forta. Në vend të drurit dhe hekurit, trenat dhe anijet u ndërtuan prej çeliku, gjë që i bëri ato më të forta, më të shpejta dhe më të sigurt.

Në dekadat e fundit të shekullit XIX, edhe **industria kimike** u zhvillua ndjeshëm. Ajo e mundësoi prodhimin e plehrave kimike, ngjyrave artificiale dhe ilaçeve, të cilat gjetën zbatim në bujqësi, industrinë tekstile dhe mjekësi. Industria kimike mbështetej në kërkimet shkencore dhe në kuadro të arsimuar. Në këtë mënyrë, ajo e forcoi **lidhjen midis shkencës dhe industrisë**, e cila ishte një nga karakteristikat kryesore të Revolucionit të Dytë Industrial.

Industria kimike dhe e çelikut kishin një ndikim të fuqishëm në **industrinë ushtarake**. Çeliku përdorej për të prodhuar armë dhe municione më të fuqishme, si dhe anije të blinduara dhe nëndetëse. Industria kimike, nga ana tjetër, siguronte eksplozivë dhe materiale të tjera të nevojshme për luftë moderne.

Transporti, komunikimet dhe prodhimi masiv

Përparim i madh u bë, gjithashtu, në **transport dhe komunikim**. Zhvillimi i industrisë e krijoi nevojën për mënyra më të shpejta dhe më të lira për të transportuar lëndë të para, produkte dhe njerëz. Kjo krijoi kushte për zgjerimin dhe modernizimin e rrjeteve të transportit, si dhe zhvillimin e tregtisë.

Nga fundi i shekullit, u prodhuan **automobilot e parë** me motorë me djegie të brendshme. Kjo e rriti kërkesën për naftë dhe kontribuoi në zhvillimin e **industrisë së naftës**.

Në disa qytete të Evropës dhe SHBA-ve u vunë në përdorim tramvajet elektrike dhe hekurudhat elektrike nëntokësore. Linja e parë publike e tramvajit elektrik u hap në vitin 1881 në Berlin, ndërsa hekurudha e parë elektrike nëntokësore (metro) u ndërtua në Londër në vitin 1890.

Sfidë për hulumtim



Në vitin 1912, u ndërtua anija më e madhe e pasagjerëve në botë, Titaniku. Më 10 prill të vitit 1912, Titaniku u nis nga Sautemptoni (Angli) me destinacion Nju-Jorkun. (SHBA).

Hulumto se çfarë i ndodhi Titanikut gjatë udhëtimit të tij dhe cili ishte fati i pasagjerëve të tij.



"Peshkaqeni" - një nga nëndetëset e para ruse (1907)



Makina e parë e Karl Benzit



Tramvaj në Berlin (1881)

Në të njëjtën kohë, telegrafi vazhdoi ta mundësonte transmetimin e informacionit në distanca të gjata, dhe në vitin 1876 u patentua mjeti i ri i komunikimit - **telefoni**. Telegrafi dhe telefoni e ndryshuan ndjeshëm jetën e përditshme dhe të biznesit.

Në fillim të shekullit XX, ndryshimet në industri çuan gjithashtu në një mënyrë të re të organizimit të punës. Në fabrikat e mëdha, prodhimi u nda në detyra më të vogla dhe më të thjeshta. Çdo punëtor kryente të njëjtën punë, ndërsa produkti lëvizte përgjatë një shiriti transportues nëpër fabrikë. Kjo e shënoi fillimin e **prodhimit masiv**. Për shkak të metodës më të shpejtë të prodhimit, shumë produkte (makina, biçikleta etj.) u bënë më të lira dhe të arritshme për një pjesë më të gjerë të popullsisë, dhe jo vetëm për më të pasurit.

Industria dhe urbanizimi

Zhvillimi industrial, gjithashtu, e përshpejtoi **urbanizimin**, veçanërisht në SHBA dhe në Evropën Perëndimore.

Përdorimi i plehrave artificialë i rriti rendimentet, që do të thoshte se më pak njerëz mund të prodhonin më shumë ushqim. Si rezultat, një pjesë e popullsisë rurale nuk ishte më e nevojshme në bujqësi dhe filloi të migronte në qytete, ku u krijuan vende të reja pune.

Nga ana tjetër, energjia elektrike e ndryshoi jetën e përditshme. **Dritat elektrike** ndriçonin në shtëpi dhe ndërtesa publike, kurse ndriçimi rrugor e rriti ndjenjën



Ndriçimi rrugor (1883)



Model i hershëm telefoni nga viti 1876 (kopje)

Mëso më shumë



Automjetet dhe nafta

Kur gjermani Karl Benz e testoi makinën e tij të parë në vitin 1886, automjeti tërhoqi shumë vëmendje, frikë dhe mosbesim. Makina bënte zhurmë, mbante erë karburanti dhe lëvizte pa kuaj, gjë që ishte diçka, krejtësisht, e re për të gjithë. Ndërhynte madje edhe policia, e cila ndonjëherë e ndalonte drejtimin e automjeteve.

Historia e automobilave është e lidhur ngushtë me naftën. Përpara ardhjes së automjeteve, nafta përdorej kryesisht për ndriçim, më shpesh në formën e vajgurit. Me zhvillimin e motorit me djegie të brendshme, ajo u bë lëndë djegëse kyçe për transportin dhe industrinë.

Si mendon, pse vendet e pasura me naftë u bënë të rëndësishme në fillim të shekullit XX, por mbeten të rëndësishme edhe sot?

E kaluara në të tashmen



Gjatë Revolucionit të Dytë Industrial, u shfaqën shumë inovacione teknologjike dhe industriale.

Cilat inovacione nga Revolucioni i Dytë Industrial edhe sot luajnë rol të rëndësishëm në jetën e përditshme?

Cilat gjëra, që sot i konsiderojmë të zakonshme dhe të domosdoshme, nuk ekzistojnë ende në atë kohë?

e sigurisë. Qytetarët mund të lëviznin, të punonin dhe të takoheshin në orët e mbrëmjes, gjë që përbënte një ndryshim të madh krahasuar me periudhën e mëparshme.

Përveç rritjes në sipërfaqe, qytetet filluan të rriteshin në lartësi. Industria e çelikut dhe zhvillimi i ashensorit elektrik me fren sigurie e bënë të mundshëm ndërtimin e **ndërtesave shumë më të larta**. Rrokaqiejt e parë u ndërtuan në Çikago, kurse më vonë në qytete të tjera në SHBA.

Nëpër qytetet më të mëdha qarkullonin tramvaje elektrike, trena dhe ndonjëherë makina. Rrugët, gradualisht, u shtruan dhe disa prej tyre madje u asfaltuan.

Prodhimi masiv çoi në rritjen e numrit të fabrikave dhe të punëtorëve. Në të njëjtën kohë, ashtu si gjatë Revolucionit të Parë Industrial, kushtet e punës dhe të jetesës ishin të vështira dhe pagat ishin të ulëta. Për këtë arsye, punëtorët filluan të organizoheshin në **sindikata**, përkatësisht shoqata që i përfaqësonin interesat e tyre. Sindikatat mbështetën të **drejta më të mëdha të punëtorëve**, të tilla si paga më të larta, orar më të shkurtër pune dhe kushte më të sigurta pune.

Megjithatë, qytetet moderne nuk ishin karakteristikë e pjesës më të madhe të botës, ku popullsia nuk i kishin gëzuar ende përfitimet e revolucioneve industriale.

Revolucioni i Dytë Industrial i hodhi themelet për shumë gjëra që janë pjesë e jetës sonë të përditshme, por pati edhe pasoja negative. Zhvillimi i shpejtë industrial çoi në një nevojë në rritje për lëndë të para dhe tregje të reja, të cilat krijuan kushte për përhapjen e kolonializmit dhe të imperializmit.



“Flatiron” në New York - një nga rrokaqiejt e parë në botë

Ndërlidhi njohuritë



Përmend dy ngjashmëri dhe ndryshime midis urbanizimit gjatë Revolucionit të Parë dhe të Dytë Industrial.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Cili ishte burimi më i rëndësishëm i energjisë në Revolucionin e Dytë Industrial dhe si e ndryshoi ai jetën e përditshme dhe industrinë?
2. Çfarë ndryshimesh ndodhën në transport dhe komunikim gjatë Revolucionit të Dytë Industrial?
3. Përshkruaj se si dukej një qytet modern në SHBA në fillim të shekullit XX.

Epoka e kolonializmit dhe imperializmit

Gjatë shekullit të ri, disa vende evropiane e zgjeruan ndikimin e tyre përtej kontinentit. Ato pushtuan dhe kontrolluan territore në Amerikë, Afrikë, Azi dhe Australi. Kjo mënyrë sundimi mbi vendet dhe popujt e tjerë quhet **kolonializëm**.

Kolonializmi filloi gjatë Epokës së Zbulimeve, kur Spanja dhe Portugalia pushtuan pjesë të mëdha të Amerikës. Më vonë, edhe vende të tjera krijuan koloni, midis të cilave u dalluan Britania e Madhe dhe Franca.

Gjatë revolucioneve industriale, shtetet evropiane kishin nevojë për lëndë të para për fabrikat e tyre, tregje të reja për produktet e tyre dhe fuqi të lirë pune. Si rezultat, në shekullin XIX, ato filluan të vendosnin pushtet dhe kontroll mbi një numër gjithnjë e në rritje të territoreve.

Kjo fazë e re e kolonializmit, karakteristike për fundin e shekullit XIX, quhet **imperializëm**. Imperializmi është politika e Fuqive të Mëdha për të sunduar popuj dhe vende të tjera nëpërmjet forcës ushtarake dhe nënshtërimit ekonomik.



Tregu i skllëvërve në Brazil



Simon Bolivari

Kolonializmi në Amerikën Latine dhe në Afrikë

Kolonializmi në Amerikën Latine filloi në shekullin XVI, kur pjesë të mëdha të Amerikës Qendrore dhe Jugore u shndërruan në koloni.

Në fillim të shekullit XIX, sundimi kolonial kishte filluar të dobësohej. Nën udhëheqjen e figurave të tilla si **Simon Bolivari**, shpërthyen lëvizje revolucionare dhe shumica e vendeve e fituan pavarësinë. Kjo i dha fund sundimit të drejtpërdrejtë evropian në këtë pjesë të botës.

Megjithatë, ndikimi i huaj nuk u zhduk plotësisht. Shumë nga shtetet e reja në Amerikën Latine mbetën të varura ekonomikisht nga vendet më të fuqishme, veçanërisht nëpërmjet tregtisë dhe eksportit të lëndëve të para.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, Afrika u bë një obje-

Sfidë për hulumtim



Në tre dekadat e para të shekullit XIX, shumica e vendeve në Amerikën e Jugut e fituan pavarësinë nga sundimi kolonial evropian.

Hulumto dhe përgjigju:

Cili shtet i Amerikës së Jugut i ditëve të sotme u emërua sipas Simon Bolivarit?

Çfarë gjuhësh fliten sot në Amerikën e Jugut? Çfarë lidhje ka kjo me kolonizimin në shekullin e ri?



Kolonitë në Afrikë në vitin 1913



Biznesmeni britanik Sesil Rods –simbol i imperializmit në Afrikë

ktiv kryesor i imperializmit. Ndër vendet më të fuqishme evropiane filloi gara për ta pushtuar kontinentin, e njohur si “**Gara për Afrikën**”.

Moment kyç ishte **Konferenca e Berlinit** (1884–1885), në të cilën vendet evropiane e ndanë, pothuajse, të gjithë Afrikën. U vendosën kufij artificialë dhe u krijuan koloni të reja, pa i marrë parasysh karakteristikat etnike, kulturore dhe historike të popullsisë vendase.

Në shumë pjesë të Afrikës, sundimi kolonial u karakterizua nga dhuna dhe shfrytëzimi. Edhe pse **skllavëria** zyrtarisht u hoq në shekullin XIX, autoritetet imponuan punë të detyrues, e cila në shumë mënyra i ngjante skllavërisë.

Kompanitë evropiane i kontrollonin burimet natyrore, të tilla si arin, diamantet, gomën dhe kakaon, ndërkohë që popullsia lokale rrallë përfitonte nga puna e saj.

Si rezultat i këtyre kushteve, shpërthyen **kryengritje dhe forma të tjera të rezistencës**. Disa popuj rezistuan me armë, ndërsa të tjerë rezistuan përmes refuzimit të veshjeve evropiane, gjuhëve evropiane dhe krishterimit. Edhe pse rezistenca ishte e guximshme, popujt afrikanë u përballën me vështirësi serioze, për shkak të superioritetit ushtarak dhe industrial të fuqive evropiane.

Nëse ti do të ishe atje...

Nëse do të jetoje në vitin 1885, si do të reagoje ndaj lajmit se një vend ishte ndarë dhe ishte vendosur nën sundimin e një shteti të huaj pa pëlqimin e popullsisë? A mendon se kjo ishte e drejtë? Shpjegoje qëndrimin tënd.

Mëso më shumë

Vetëm dy vende afrikane arritën ta ruanin pavarësinë e tyre gjatë “Garës për Afrikën”.

Etiopia mbeti e pavarur pasi i mundi forcat italiane dhe i rezistoi pushtimit nga Italia.

Liberia, nga ana tjetër, u themelua si shtet për ish-skllavërit nga SHBA-të dhe e mori emrin nga fjala latine liber (liri). Prandaj, Liberia shpesh quhet “vendi i të lirëve”.

Kolonializmi në Azi dhe Australi

Në shekujt XVIII dhe XIX, Britania e Madhe e vendosi, gradualisht, pushtetin mbi **Indinë** dhe filloi ta shfrytëzonte atë për nevojat e veta. Në vend që të prodhonin ushqim për vete, shumë fshatarë indianë u detyruan të kultivonin pambuk dhe indigo për eksport në Evropë. Si rezultat, ushqimi u bë më i shtrenjtë dhe gjithnjë e më i vështirë për t'u siguruar për popullsinë vendase.

Revolta u nxit më tej nga ndërhyrja britanike në traditë dhe fe, si dhe diskriminimi ndaj popullsisë vendase. Kjo çoi në **Kryengritjen e Sipajit** të vitit 1857, revoltën më të madhe indiane kundër sundimit britanik në shekullin XIX. Kryengritja zgjati rreth një vit dhe u shua me shumë viktima civile.

Edhe pse nuk ishte një koloni klasike, **Kina** vuajti pasoja të rënda nga imperializmi evropian. Në shekullin XIX, Britania e Madhe bleu sasi të mëdha çaji nga Kina, por tregtarët kinezë nuk donin të blinin produkte britanike dhe e kërkonin pagesën në argjend. Meqenëse Britania nuk kishte mjaftueshëm argjend, ajo filloi me shitje masive të opiumit në Kinë. Kjo drogë e rrezikshme u përhap shpejt në të gjithë vendin dhe shkaktoi një varësi të madhe në mesin e popullsisë.

Kur autoritetet kineze u përpoqën ta ndalonin tregtinë e opiumit, shpërtheu një konflikt i armatosur me Britaninë e Madhe, i njohur si **Lufta e Parë e Opiumit** (1839-1842). Kjo u pasua nga **Lufta e Dytë e Opiumit** (1856-1860), në të cilën përveç Britanisë mori pjesë edhe Franca. Pas disfatave, Kina u detyrua të nënshkruante traktate të papërshtatshme, të cilat u dhanë fuqive të huaja privilegje të rëndësishme tregtare.



Perandoria Britanike duke e shfrytëzuar pasurinë e Indisë (karikaturë)

Ndërlidhi njohuritë



Në vitin 1850, shpërtheu Kryengritja e Taipingut - një revoltë masive kundër dinastisë sunduese në Kinë. Ajo u udhëhoq nga një burrë që pretendonte të ishte vëllai i vogël i Jezu Krishtit dhe bënte thirrje për krijimin e një shoqërie të re dhe më të drejtë. Shumë fshatarë të varfër, të revoltuar nga uria, taksat e larta dhe korrupsioni, iu bashkuan atij. Kryengritja zgjati për më shumë se dhjetë vjet dhe mori mbi 20 milionë jetë, duke e bërë atë një nga konfliktet më vdekjeprurëse në historinë botërore.

Cilat revolucione dhe kryengritje në shekullin e ri, që i ke studiuar deri më tani, mund të thuash se ishin të lidhura me urinë, varfërinë dhe taksat e larta?



Autoritetet kineze duke e asgjësuar opiumin



Beteja midis ushtarëve kinezë dhe britanikë (1842)

Fuqitë evropiane vendosën sundim kolonial edhe në pjesë të tjera të Azisë. Franca e pushtoi Vietnamin dhe rajonin më të gjerë të Indokinës, ndërsa Holanda e kontrollonte Indonezinë. Filipinet, fillimisht, ishin nën sundimin spanjoll dhe në fund të shekullit XIX kaluan nën kontrollin e SHBA-ve, të cilat iu bashkuan garës për koloni.

Nga fund i shekullit XVIII dhe gjatë shekullit XIX, Britania e Madhe e kolonizoi **Australinë**. Popullsia vendase u shtyp dhe kolonët britanikë u vendosën në toka, që më parë ishin në pronësi të popujve indigjenë.



Të burgosur britanikë në Australi

Pasojat e sundimit kolonial

Kolonializmi ka pasur **pasojat të thella dhe afatgjata** në shumë pjesë të botës. Në disa zona, të tilla si Amerika Qendrore dhe Jugore, popullatat vendase janë shkatërruar nga sëmundjet, dhuna dhe kushtet e vështira të jetesës. Pushtetarët evropianë u imponuan kolonive **gjuhë dhe vlera evropiane**. Misionarët e përhapën krishterimin, pa i marrë parasysh fetë dhe kulturat lokale. Kolonizatorët ndërtuan rrugë dhe hekurudha, por këto shpesh shërbyen për ta lehtësuar kontrollin dhe eksportin e burimeve natyrore.

Në Afrikë, Amerikën Latine dhe Azi, pasojat e sundimit kolonial ndihen ende sot. Varësia ekonomike afatgjatë dhe zhvillimi i pabarabartë kanë krijuar varfëri, duke bërë që shumë njerëz të largohen nga atdheu i tyre dhe të emigrojnë në ish-metropole.

E kaluara në të tashmen



Kolonët e parë evropianë në Australi ishin, kryesisht, të dënuar të dërguar nga Britania e Madhe. Më vonë, me zbulimin e burimeve natyrore dhe zhvillimin e bujqësisë, filloi emigracioni vullnetar i njerëzve të lirë nga Evropa.

Nga një ish-koloni për të dënuarit, Australia, gradualisht, është shndërruar në një nga vendet më të zhvilluara moderne, ku jetojnë njerëz me prejardhje të ndryshme etnike dhe kulturore.

A tregon shembulli i Australisë se një vend mund ta kapërcejë të kaluarën e tij të vështirë? Shpjegoje përgjigjen tënde me një shembull nga teksti.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Çfarë do të thotë imperializëm dhe kur u zhvillua ai?
2. Çfarë përfaqëson „Gara për Afrikën“?
3. Çfarë pasojash pati sundimi kolonial mbi popujt e pushtuar?

Marrëdhëniet ndërkombëtare në botë (1870–1914)

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, bota po ndryshonte me shpejtësi dhe po bëhej e panjohur për brezat e vjetër. Hekurudhat, anijet moderne, telegrafi dhe migrimi lidhën hapësira të largëta dhe i afruan vendet dhe popujt më shumë me njëri-tjetrin.

Në të njëjtën kohë, midis **Fuqive të Mëdha** u intensifikua gara për koloni dhe armatime. Rivaliteti midis shteteve më të fuqishme çoi në ndarjen e Evropës në blloqe kundërshtarë, me pasojë që u ndien edhe në pjesë të tjera të planetit.

Prandaj, në ndërrimin e shekujve, bota nuk ka qenë kurrë kaq e lidhur dhe, në të njëjtën kohë, kaq thellësisht e ndarë.

Fuqitë e mëdha dhe interesat e tyre

Në dekadat e fundit të shekullit XIX, bota ishte eurocentrike. Vendimet kryesore në marrëdhëniet ndërkombëtare merreshin në Evropë, nga ana e disa shteteve.

Pas bashkimit të Gjermanisë dhe Italisë, në Evropë ekzistonin **gjashhtë Fuqi të Mëdha**: Britania e Madhe, Franca, Rusia, Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia. Disa prej tyre kishin flota të fuqishme dhe ishin **fuqi detare**, ndërsa të tjerat mbështeteshin në ushtri të mëdha dhe konsideroheshin **fuqi tokësore**.

Gjatë kësaj periudhe, **Britania e Madhe** ende luante një rol udhëheqës në marrëdhëniet ndërkombëtare. Si fuqia më e rëndësishme detare me një industri të zhvilluar dhe koloni të shumta, ajo nuk donte ta lejonte shfaqjen e një rivali, që do ta kërcënonte supremacinë e saj.



Politikanët evropianë e ndajnë Afrikën në Konferencën e Berlinit (1884)

Fjalë dhe terma të panjohur



Bllok - Grup vendesh që bashkohen në një aleancë bazuar në interesa të përbashkëta.

Eurocentrizëm - Pikëpamje sipas së cilës Evropa konsiderohet si qendra e botës dhe shtetet evropiane kanë rol udhëheqës në marrëdhëniet ndërkombëtare.



Mbretëresha Britanike Viktoria

Ndërlidhi njohuritë



Gjermania filloi të krijonte koloni vetëm në vitin 1884. Zotërimet e saj koloniale ndodheshin në pjesë të Afrikës dhe në disa ishuj në Oqeanin Paqësor.

Pse Gjermania, pavarësisht se ishte fuqia më e madhe industriale në Evropë pas vitit 1870, kishte kaq pak koloni?



Franz Jozefi I dhe gruaja e tij Elizabet (Sisi), sundimtarë të Austro-Hungarisë



Cari rus Aleksandri III dhe krerët e fshatrave

Franca, nga ana tjetër, ishte një fuqi tokësore dhe detare. Gjëja më e rëndësishme për të ishte ruajtja dhe zgjerimi i zotërimeve të saj koloniale dhe kufizimi i fuqizimit të fqinjit të saj të ri - Gjermanisë.

Rusia mbeti prapa në zhvillimin industrial dhe ende kishte mbeturina të rendit feudal. Megjithatë, për shkak të territorit të saj të gjerë dhe popullsisë së madhe, ajo konsiderohej si fuqi tokësore. Politika e saj e jashtme ishte e drejtuar, kryesisht, drejt Evropës Lindore dhe Ballkanit, ku ajo paraqitej si mbrojtëse e popujve sllavë.

Deri në fund të shekullit XIX, **Gjermania** u ngrit shpejt, duke u bërë fuqia më e madhe industriale në Evropë. Bumi industrial e shtyu atë të kërkonte koloni dhe tregje të reja, si dhe të investonte në forcimin e ushtrisë dhe marinës së saj.

Perandoria Austriake, e cila që nga viti 1867 quhet **Austro-Hungari**, ishte një fuqi tokësore. Ajo u përball me probleme të brendshme serioze, për shkak të lëvizjeve kombëtare të popujve të ndryshëm. Në frontin e jashtëm, prioriteti i saj ishte zgjerimi i ndikimit në Ballkan.

Italia, si fuqi e re, e orientoi politikën e saj drejt fitimit të kolonive në Afrikë dhe rolit më të madh në Detin Mesdhe.

Përveç vendeve evropiane, nga fundi i shekullit XIX, në skenën botërore u shfaqën fuqi të reja: **SHBA-të dhe Japonia**, të cilat u ngritën falë zhvillimit të shpejtë industrial.

Sfidë për hulumtim



Në fillim të shekullit XX, Rusia u përpoq ta zgjeronte ndikimin e saj në Azinë Lindore, gjë që çoi në konflikt me Japoninë. Në vitin 1904, shpërtheu Lufta Ruso-Japoneze. Japonia kishte një ushtri dhe marinë më moderne dhe në vitin 1905 arriti fitore.

Në radhët e ushtrisë ruse luftuan edhe vullnetarë nga një shtet ballkanik. Megjithatë, Japonia dhe shteti ballkanik nuk ishin zyrtarisht në luftë dhe, për këtë arsye, nuk nënshkruan kurrë një traktat paqeje. Megjithatë, disa historianë e kanë interpretuar këtë si një shenjë, se lufta midis dy vendeve nuk u ndal kurrë.

Kur shteti ballkanik e rifitoi pavarësinë në vitin 2006, pas shumë vitesh, Japonia konfirmoi, zyrtarisht, se më tepër nuk ekziston gjendje teknike lufte.

Hulumto se cili vend ballkanik "harroi" të nënshkruante traktat paqeje me Japoninë pas Luftës Ruso-Japoneze!

Rivaliteti midis Fuqive të Mëdha

Në fillim të shekullit XX, Fuqitë e Mëdha nuk ishin në luftë me njëra-tjetrën, por midis tyre ekzistonte rivalitetet dhe mosbesim i madh.

Një nga arsyt kryesore për konkurrencën midis vendeve kryesore të botës ishte **lufta për kolonitë**. Rivaliteti midis fuqive të vjetra koloniale dhe shteteve të reja - Gjermanisë dhe Italisë - ishte, veçanërisht, i ashpër. Ndërsa Britania e Madhe dhe Franca donin ta ruanin ndarjen ekzistuese të botës, Gjermania dhe Italia kërkonin t'i rindanin kolonitë.

Interesat e fuqive evropiane u përplasën edhe në **Ballkan**, ku Austro-Hungaria dhe Rusia garonin për ndikim. Në të njëjtën kohë, shtetet e reja ballkanike donin ta zgjeronin territorin e tyre në kurriz të Perandorisë Osmane. Për këtë arsye, Ballkani shpesh quhej **“fuçi baruti”**, gati për të shpërthyer në çdo moment.

Formimi i aleancave në Evropë

Në varësi të ngjashmërive dhe ndryshimeve në qëllimet e tyre, vendet evropiane u grupuan në blloqe dhe formuan aleanca.

Në vitin 1882, me iniciativën e Oto Fon Bismarkut, u formua **Aleanca Trepalëshe**. Ajo e përfshinte Gjermaninë, Italinë dhe Austro-Hungarinë. Italia dhe Gjermania kishin një armik të përbashkët - Francën - nga e cila ndiheshin të kërcënuara. Për më tepër, si shtete të reja, ato ishin të vonuara në garën për koloni dhe ishin në disavantazh në



Aleanca Trepalëshe. Gjermania (majtas), Austro-Hungaria (në mes), Italia (djathtas) – Karikaturë



Rivaliteti midis Fuqive të Mëdha për rindarjen e kolonive (karikaturë)

E kaluara përmes burimeve



“Edhe pse Ballkani është quajtur ‘fuçi baruti e Evropës’, shkëndija që e ndez atë, pothuajse, gjithmonë vjen nga jashtë.” - Karol Davila, ish-diplomati rumun në SHBA, 7 tetor të vitit 1943.

Çfarë donte të thoshte Karol Davila kur tha se shkëndija që ndizte fuçinë e barutit, pothuajse, gjithmonë vinte nga jashtë Ballkanit?



Gjermania dëshiron ta pushtojë botën (karikaturë britanike)

raport me fuqitë e vjetra koloniale. Nga ana tjetër, Austro-Hungaria po luftonte kundër Rusisë për ndikim në Ballkan dhe kishte nevojë për një mbrojtës, të cilin e gjeti te Gjermania.

Në përgjigje të Aleancës Trepalëshe, u formua një aleancë midis Rusisë, Francës dhe Britanisë së Madhe. Së pari, Franca dhe Rusia formuan një aleancë në vitin 1894 për shkak të kërcënimit që paraqiste fqinji i tyre i fuqishëm, Gjermania. Britania e Madhe kishte besuar prej kohësh se ishte mjaftueshëm e fuqishme dhe nuk kishte nevojë për një aleancë me vendet e tjera. Megjithatë, kur Gjermania filloi ta zhvillonte në mënyrë intensive marinën e saj, kjo shkaktoi shqetësim në Britani. Prandaj, në vitin 1907, ajo e përfundoi marrëveshjen me Rusinë dhe u bashkua me Francën, duke e formuar kështu **Antantën Trepalëshe**.

Aleancat kishin për qëllim ta garantonin sigurinë, por në praktikë ato e rritën rrezikun e luftës. Filloi një **garë armatimesh**, në të cilën Fuqitë e Mëdha investuan burime të mëdha në ushtri moderne dhe armë të reja.

Në atë kohë, u ndez edhe **nacionalizmi**. Nëpërmjet medias përhapej ideja e superioritetit të kombit të vet. Në të njëjtën kohë, më shpesh në formën e karikaturave, armiqet u paraqitën si të rrezikshëm ose më pak të vlefshëm.

Edhe pse zyrtarisht në paqe, bota po përgatitej për Luftën e Parë Botërore.



Vendet anëtare të Aleancës Trepalëshe dhe Antantës Trepalëshe

E kaluara në të tashmen



Në mësim, lexove se Fuqitë e Mëdha u grupuan në blloqe dhe formuan aleanca ushtarake për hir të interesave dhe sigurisë së përbashkët.

A ka sot ende aleanca ushtarake ose ekonomike në botë? Jep dy shembuj.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Cilat vende e luajtën rolin kryesor në marrëdhëniet ndërkombëtare në periudhën nga viti 1870 deri në vitin 1914?
2. Pse marrëdhëniet ndërkombëtare (1870-1914) u karakterizuan nga rivaliteti dhe mosbesimi midis vendeve?
3. Pse disa vende evropiane iu bashkuan Aleancës Trepalëshe dhe të tjera Antantës?

Shkenca dhe kultura në Evropë dhe në botë nga mesi i shekullit XIX deri në Luftën e Parë Botërore

Shkenca dhe zbulimet më të rëndësishme shkencore

Lidhja midis shkencës dhe industrisë ishte një nga karakteristikat kryesore të Revolucionit të Dytë Industrial. Industria e stimuloi zhvillimin e shkencës, por pa shkencë, përparimi i industrisë do të kishte qenë i pamundshëm.

Energjia elektrike kishte një rëndësi të madhe për industrinë dhe jetën e përditshme. Megjithatë, në fillim nuk ishte e qartë se si duhej të prodhohej dhe përdorej. Pikërisht për këtë çështje u përplasën shkencëtarët dhe shpikësit. Më të famshmit midis tyre ishin **Nikolla Tesla** dhe **Tomas Edison**. Tesla e zhvilloi sistemin e rrymës alternative, ndërsa Edison e mbështeti përdorimin e rrymës së vazhdueshme. Kjo përplasje idesh njihet si **“Lufta e Rrymave”**.

Përparim i madh u bë edhe në fusha të tjera shkencore. **Çarls Darvini** e publikoi **teorinë e evolucionit**, sipas së cilës gjallesat ndryshojnë gradualisht dhe përshtaten me mjedisin e tyre nëpërmjet përzgjedhjes natyrore. Ky zbulim e ndryshoi rrënjësisht kuptimin e origjinës së jetës.

Mjekësia, nga ana tjetër, përparoi me zhvillimin e vaksinit. Kjo e bëri të mundshëm parandalimin e shumë sëmundjeve infektive dhe zgjatjen e jetëgjatësisë. **Lui Pastëri** e krijoi vaksinën kundër tërbimit, e cila ishte vakcina e

Ndërlidhi njohuritë



Kujto zbulimet shkencore që i mësove në mësimin e shkencës dhe kulturës nga mesi i shekullit XVII deri në mesin e shekullit XIX. Si mendon, a e ndryshuan botën zbulimet e reja shkencore dhe teknologjike pas vitit 1850 krahasuar me periudhën e mëparshme?

E kaluara përmes burimeve



Thirrja e parë e dokumentuar telefonike u bë nga shpikësi i telefonit, Aleksandër G. Bell, më 10 mars të vitit 1876. Gjatë një eksperimenti, ai kishte nevojë për ndihmë dhe, nëpërmjet pajisjes që sapo kishte testuar, iu drejtua asistentit të tij me fjalët:

“Zoti Uotson, ejani këtu, dua t’ju shoh.”

Fjala është regjistruar në shënimet e Bellit dhe u konfirmua nga asistenti i tij Tomas Uotson, i cili ishte në një dhomë tjetër dhe i dëgjoi fjalët përmes një pajisjeje të lidhur telefonike.



Tomas Edison me modelet e hershme të llambave elektrike



Mari Kyri

parë e suksesshme e krijuar në laborator. Një tjetër zbulim i madh ishte zbulimi i **rrezeve X** nga Vilhelm Röntgen. Mjekët më në fund mund ta ekzaminonin pjesën e brendshme të trupit të njeriut, pa ndërhyrje kirurgjikale.

Dmitri Mendeleev e krijoi **sistemin periodik të elementeve**, ku i renditi elementet kimikë në një rend të qartë, duke i bërë ato më të lehta për t'u studiuar. Deri në vitin 1914, zbulime të rëndësishme ishin bërë edhe në **fizikë**, të lidhura me punën shkencore të Mari Kyrisë, Henri Bekereleit dhe Albert Ajnshtajnit.

Nga fundi i shekullit XIX, automobili dhe telefoni e ndryshuan gradualisht mënyrën e lëvizjes dhe të komunikimit. Në vitin 1903, **vëllezërit Rait** e bënë fluturimin e parë të kontrolluar me **aeroplan**, duke nisur një epokë të re në transportin ajror. Komunikimi pa tel ishte, gjithashtu, në rritje, i lidhur me zbulimet e italianit **Markoni**, të cilat mundësuan transmetimin e sinjaleve pa tela dhe e shënuan lindjen e **radios**.

Kultura moderne

Në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, qytetet e mëdha pulsonin me energji të re. Rugët ishin të ndriçuara, kafenetë ishin plot dhe mëngjeset fillonin me leximin e lajmeve të fundit në gazeta. Qytetarët gjithnjë e më shumë largoheshin nga shtëpitë e tyre në kërkim të argëtimit dhe përvojave të reja. Gjatë **Belle Époque** (Epoka e Bukur), lindi **kultura moderne**, e cila ishte kultura e qytetit. Ajo u përhap përmes gazetave dhe formave të reja të argëtimit dhe ishte menduar për një audiencë të gjerë, jo vetëm për rrethin e ngushtë të njerëzve të pasur dhe të arsimuar.

Që nga mesi i shekullit XIX, në **art** janë zhvilluar disa drejtime të reja, që e përshkruanin botën në mënyra të ndryshme.

Realizmi synonte ta përshkruante realitetin ashtu siç ishte, me artistë që pikturonin fshatarë, punëtorë dhe skena nga jeta e përditshme. **Impresionizmi** përqendrohej në mënyrën se si dukej bota në një moment të caktuar dhe në një dritë të caktuar, shpesh duke e përshkruar natyrën ose të njëjtin motiv në kohë të ndryshme të ditës. Në **post-impresionizëm**, ndjenja personale e artistit u bë gjëja më e rëndësishme. Një nga përfaqësuesit më të famshëm të kësaj lëvizjeje ishte **Vincent van Gogu**.

Sfidë për hulumtim



Pas vitit 1887, qytetarët më të pasur të SHBA-ve dhe të Evropës Perëndimore filluan të dëgjonin muzikë në shtëpi, në një pajisje të quajtur gramafon.

Hulumto se si dukej gramafoni dhe si përdorej për të dëgjuar muzikë.



Fluturimi i parë i suksesshëm me avion me motor, dhjetor 1903.

E kaluara në të tashmen



Vincent van Gogu krijoi më shumë se 800 piktura gjatë jetës së tij, por arriti të shiste vetëm një. Ai e shiti pikturën për rreth 400 franga belge, që ishte një shumë tepër modeste edhe për atë kohë. Sot, pikturat e Van Gogut konsiderohen kryevepra dhe arrijnë vlera të jashtëzakonshme.

- Cilat ngjarje ose fenomene mendon se nuk i konsiderojmë të rëndësishme sot, por që brezat e ardhshëm mund t'i studiojnë në tekstet shkollore të historisë?



Vincent van Gog – “Nata me yje” (1889), post-impresionizëm

Realizmi e përshkruante botën ashtu siç është, impresionizmi ashtu siç shihet për momentin dhe post-impresionizmi ashtu siç ndihet.

Gjatë së njëjtës periudhë shkrimtarët shkruan për problemet e shoqërisë moderne. Librat e përshkruanin jetën në qytetet e mëdha, varfërinë, kushtet e vështira të punës dhe marrëdhëniet midis njerëzve. Romanet nuk ishin më thjesht histori argëtuese. Ato shërbenin, gjithashtu, për të nxjerrë në pah padrejtësitë dhe nevojën për ndryshim. Ndër shkrimtarët më të rëndësishëm të kësaj epoke ishin **Leon Tolstoi, Çarls Dickens, Fjodor Dostojevski dhe Emil Zola.**

Në vitet e fundit të shekullit XIX, **kinemaja** u shfaq si një formë e re e kulturës moderne. Ndryshe nga arti i destinuar për elitën, kinemaja ishte e arritshme për një audiencë të gjerë dhe shpejt u bë argëtim popullor në qytete. Momenti kyç në zhvillimin e saj ndodhi në vitin 1895, kur **vëllezërit Lumiere** e organizuan shfaqjen e parë publike në kinema në Paris.

Në të njëjtën kohë, **sporti** pushoi së qeni një argëtim i elitës dhe u bë pjesë e jetës së përditshme të miliona njerëzve. Në qytetet industriale, veçanërisht në Britaninë e Madhe, **futbolli** u bë sporti më i popullarizuar midis punëtorëve dhe të rinjve.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, vendet i prezantuan publikisht arritjet e tyre më të reja në industri, shkencë, teknologji dhe kulturë në ekspozita të mëdha ndërkombëtare. Më e famshmja prej tyre ishte **Ekspozita Botërore në Paris në vitin 1889**, e organizuar për të shënuar 100-vjetorin e Revolucionit Francez. Për këtë rast u ndërtua **Kulla Eifel**, e cila ishte ndërtesa më e lartë në botë në atë kohë.



Ndeshje futbolli në vitin 1872



Moda në fillim të shekullit XX

Mëso më shumë



Moda ishte një pjesë e rëndësishme e kulturës moderne në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX. Te gratë dominonin fustanet e gjata, korsetë dhe fundet e gjera, ndërsa moda e burrave dominohej nga kostumet - pantallonat, këmbisha, jeku dhe xhaketa.

Rol të madh në zhvillimin e modës, gjatë kësaj periudhe, luajti stilisti i famshëm Çarls Frederik Uorth, i cili konsiderohet si “babai i modës së lartë”. Ai ishte i pari që i prezantoi koleksionet sezonale në Paris.



Ekspozita Botërore në Paris (1889), poster

Lufta për të drejtat e grave

Një nga qëllimet më të rëndësishme të lëvizjes së grave në fillim të shekullit ishte lufta për **të drejtën e votës**, e njohur si sufraxhe. Gratë, që e mbronin të drejtën e votës, quheshin **sufraxhete**. Ato organizonin takime publike dhe disa prej tyre përdornin edhe metoda më radikale, siç ishin grevat e urisë dhe prishja e ngjarjeve politike. Shumë sufraxhete u arrestuan dhe u tallën publikisht, por ato nuk hoqën dorë nga lufta.

Suksesi i parë i rëndësishëm u arrit në Zelandën e Re, ku gratë e fituan të drejtën e votës në vitin 1893.

Rol të rëndësishëm në procesin e emancipimit luajti **arsimimi**, duke krijuar kushte, që gratë të merrnin pjesë në shkencë, kulturë dhe jetën publike. Përveç kësaj, ato luftuan për **pavarësi ekonomike** dhe **të drejtat e punëtorëve**.



Sufraxhete



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Përmend disa nga zbulimet më të rëndësishme shkencore në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe fillimin e shekullit XX!
2. Cila formë e re argëtimi u shfaq në vitin 1895 dhe cili sport u bë më i popullarizuari midis punëtorëve dhe të rinjve?
3. Cili ishte qëllimi kryesor i luftës për të drejtat e grave në shekullin e ri dhe ku e fituan gratë për herë të parë të drejtën e votës?

BALLKANI

NË FUND TË SHEKULLIT XIX
DHE NË FILLIM TË SHEKULLIT XX



Perandoria Osmane deri në Traktatin e Pages së Bukureshtit

Sundimi i Sulltan Abdyl Hamitit II dhe shfaqja e Lëvizjes së Xhonturqve

Kriza e Madhe Lindore shkaktoi probleme serioze në Perandorinë Osmane dhe e dobësoi pozicionin e saj ndërkombëtar. Kryengritjet dhe luftërat në Ballkan u dhanë mundësi fuqive evropiane të ndërhyjnë përsëri në punët e brendshme të Perandorisë. Ato kërkuan **reforma të reja** dhe **përmirësimin e pozicionit të popullsisë jomyslimane** në Perandorinë Osmane.

Në kushte të tilla, lindi Lëvizja **Xhonturke**, ithtarët e së cilës më vonë u bënë të njohur si **xhonturq** (turq të rinj). Këta ishin njerëz të rinj, të arsimuar që kishin studiuar në vendet e Evropës Perëndimore. Gjatë shkollimit të tyre, ata u bënë të vetëdijshëm për prapambetjen e vendit të tyre në raport me vendet evropiane.

Xhonturqit besonin se vetëm nëpërmjet reformave të thella mund të parandaloheshin shpërbërja e Perandorisë. Prandaj, ata organizuan protesta në Kostandinopojë dhe kërkuan kufizim të pushtetit të sulltanit. Nën presionin e këtyre protestave, ndodhën disa ndryshime të shpejta në fronin osman, pas të cilave sulltani i ri u bë **Abdyl Hamiti II**.

Për t'u çliruar nga presioni i jashtëm për reforma, Abdyl Hamiti menjëherë pas ngjitjes në fron njoftoi se në Perandori ishte miratuar **kushtetuta**. Në këtë mënyrë, shteti osman u bë **monarki parlamentare**, por absolutizmi i Sulltanit ishte i kufizuar. Megjithatë, ky sistem ishte jetëshkurtër. Pas vetëm dy seancash, Sulltani e shpërndau parlamentin, e shfuqizoi kushtetutën dhe e rivendosi **absolutizmin**. Kështu filloi sundimi i tij i gjatë, i cili zgjati më shumë se tre dekada (1876-1909).

Abdyl Hamiti vendosi një **sistem të rreptë mbikëqyrjeje dhe kontrolli**. U krijua një polici sekrete me informatorë që monitoronin çdo fjalë publike dhe sjelljen e nëpunësve civilë, gazetarëve dhe intelektualëve. Çdo dyshim për mosbesnikëri ndaj Sulltanit ndëshkohej me burgim ose dëbim nga vendi. Kryengritjet dhe trazirat në Perandori u shtypën rëndë. Për shkak të këtij stil sundimi, Sulltan Abdyl Hamiti II, nga publiku evropian, u quajt „**Sulltani i Kuq**“.

Mëso më shumë



Midis mbështetësve të Lëvizjes së Xhonturqve ishte edhe princi i ri osman Abdyl Hamiti, i cili më vonë u ngjiti në fron. Si sulltan, Abdyl Hamiti u shndërrua në armikun e tyre më të madh. Ai i akuzoi ata për tradhti të traditave dhe besimit.



Sulltan Abdyl Hamiti II – portret nga viti 1899



Fjala përshëndetëse e Sulltanit me rastin e fillimit të punimeve të parlamentit osman



Sulltan Abdyl Hamiti arrin për namazin e xhumasë në xhaminë Jildiz në Kostandinopojë (e ngjyrosur)

Megjithatë, gjatë sundimit të Abdyl Hamitit, u bënë hapa të mëdhenj drejt **modernizimit të vendit**. U ndërtuan hekurudha të reja, shkolla dhe lloje të ndryshme të objekteve mjekësore. Rrjeti telegrafik u zgjerua, ndërsa ushtria u riorganizua sipas modelit evropian.

Xhonturqit në pushtet

Xhonturqit u persekutuan nga qeveria e Sulltanit, por ata nuk hoqën dorë nga idetë e tyre. Ata e mbështetën **kthimin e kushtetutës** dhe të **parlamentit**. Për ta arritur këtë qëllim, ata në emigracion e formuan komitetin **“Bashkim e përparim”**. Në vitin 1905, selia e komitetit u transferua në Selanik. Lëvizja e Xhonturqve fitoi një numër të madh mbështetësish midis **oficerëve në ushtrinë osmane**. Xhonturqit vendosën, gjithashtu, kontakte me **popullsinë e nënshtuar** në pjesët evropiane të Perandorisë dhe filluan të përgatiteshin për veprim.

Në korrik të vitit 1908, oficerët xhonturq në ushtrinë osmane të stacionuar në **Maqedoni** ngritën krye kundër sulltanit. Njësitë, që sulltani i kishte dërguar për ta shtypur revoltën, u bashkuan me kryengritësit. Shpejt, pjesë të tjera të ushtrisë iu bashkuan revoltës. I përballur me këtë situatë, sulltani u detyrua të dorëzohej. Kushtetuta u rivendos, kurse parlamenti u rimblodh. Kështu, vendi u bë përsëri **monarki parlamentare**.

Grushtshteti i xhonturqve u prit me entuziazëm nga popullsia në pjesën evropiane të vendit. Slogani për liri, barazi dhe vëllazëri e arriti efektin e dëshiruar. Me futjen e parlamentarizmit, u krijuan kushtet për **aktivitet të ligjshëm politik**

Sfidë për hulumtim



Gjatë sundimit të Abdyl Hamitit II, kontrolli mbi informacionet ishte, veçanërisht, i rreptë. Gazetat, revistat dhe librat kontrolloheshin para botimit, dhe u ndalua përdorimi i fjalëve të tilla si “liri”, “kushtetutë” dhe “revolucion”. Në vitin 1903, për shkak të lëvizjes çlirimtare maqedonase, u ndalua edhe fjala “Maqedoni”. Disa gazeta botoheshin me hapësira bosh, atje ku censorët kishin fshirë fjali të tëra nga teksti. Shumë shkrimtarë dhe gazetarë u detyruan të largoheshin nga vendi.

Edhe sot në disa vende, fjala publike kontrollohet. Mundohet të gesh ndonjë shembull të tillë dhe përgjigju:

Pse disa vende nuk duan që njerëzit të kenë qasje në të gjitha informacionet? Cila e drejtë themelore e njeriut shkelet nga një kontroll i tillë?



Kongresi i parë i shoqërisë „Bashkim e përparim“ (Paris, 1902)



Pullë postare e vitit 1908 që i paraqet udhëheqësit e rebelimit ushtarak, Enver Beun dhe Nijazi Beun.

të organizatave që më parë ishin ilegale. Çetat dhe grupet e ndryshme të armatosura, të cilat deri vonë kishin luftuar kundër sundimit të Sulltanit, u pajtuan me oficerët osmanë. Në të gjitha qytetet mbretëronte atmosferë festive.

Megjithatë, menjëherë pas euforisë fillestare, u shfaq **pakënaqësia me sundimin e xhonturqve**. Reformat e pritura nuk ndodhën dhe vendi u përball me sfida të reja në kufijtë e tij perëndimorë. Duke përfutur nga paqëndrueshmëria në Perandori, Austro-Hungaria e aneksoi Bosnjën dhe Hercegovinën, Bullgaria e shpalli pavarësinë ndërsa Kreta e shpalli bashkimin e saj me Greqinë.

Të gjitha këto ngjarje u dhanë mundësi mbështetësve të sulltanit të përpiqeshin ta shfuqizonin kushtetutën dhe ta rivendosnin absolutizmin. Megjithatë, një përpjekje e tillë u shtyp shpejt nga xhonturqit. Në shtypjen e revoltës morën pjesë edhe përfaqësues të popujve të tjerë në shtet. Abdyl Hamiti II u rrëzua nga froni dhe në fron u vendos vëllai i tij **Mehmeti V**.

Pasi e vendosën pushtetin, në vend të reformave që i priste populli, xhonturqit u rikthyen te **represioni** i kohës së Abdyl Hamitit II. Regjimi i xhonturqve filloi ta zhvillonte idenë e **“Otomanizimit të shtetit”**. Masa të tilla e rritën më tej pakënaqësinë në pjesët evropiane të Perandorisë. Në këtë mënyrë, xhonturqit jo vetëm që dështuan të sillnin reforma, por edhe e përshpejtuan fundin e sundimit osman në Evropë.

Perandoria Osmane në Luftërat Ballkanike

Atmosfera në Ballkan në fillim të shekullit XX tregonte se sundimi osman mbi këto territore nuk kishte më të ardhme. Prandaj, politika e jashtme e shteteve të reja ballkanike (Greqi, Serbi, Bullgari) e synonte **ndarjen midis tyre të sundimeve osmane të mbetura në Ballkan**. Pas secilit prej këtyre shteteve qëndronin interesat e një pjese të Fuqive të Mëdha. Kështu, ndërsa xhonturqit po përpiqeshin të krijonin një “komb osman”, shtetet ballkanike i filluan negociatat për të formuar një aleancë, që do t’i dëbonte osmanët nga Ballkani.

Pas bisedimeve të gjata dhe mosmarrëveshjeve të mëdha mbi çështjen e ndarjes së Maqedonisë, në vitin 1912 u formua **Lidhja Ballkanike**. Në të u përfshinë **Bullgaria, Serbia, Greqia dhe Mali i Zi**. Katër shtetet ballkanike i filluan përgatitjet për sulm ndaj Perandorisë Osmane.



Abdyl Hamiti II i rrëzuar nga froni për herë të fundit kalon nëpër rrugët e Kostandinopojës

Fjalë dhe terma të panjohur



Otomanizëm /Osmanizëm

Ideologjia zyrtare e shtetit osman gjatë regjimit të xhonturqve. Ajo e promovonte krijimin e një kombi të vetëm osman, të përbërë nga kombësitë e veçanta në shtet. Megjithatë, ky projekt dështoi sepse popujt e Perandorisë e kishin zhvilluar tashmë vetëdijen e tyre kombëtare.



Nënshkrimi i Traktatit të Paqes në Londër (maj viti 1913)

Në tetor të vitit 1912, aleatët ballkanikë e sulmuan Perandorinë Osmane. Kështu filloi **Lufta e Parë Ballkanike**. Territorët osmane në Ballkan u shndërruan në fushëbetejë të madhe dhe aleatët menjëherë filluan të shënonin suksese të mëdha. **Forcat serbe** pushtuan pjesë të Sanxhakut, Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë Veriore. **Ushtria bullgare** hyri në Maqedoninë Lindore dhe Traki, por u ndal para portave të kryeqytetit osman - Kostandinopojës. **Forcat greke** e pushtuan Epirin, një pjesë të Maqedonisë së Jugut dhe ishujt e tjerë të Egjeut, ndërsa **ushtria malazeze** pati veprime të suksesshme ushtarake në Sanxhak dhe Kosovë. Osmanët u mundën dhe me **Traktatin e Paqes së Londrës** u njohën ndryshimet e reja territoriale në Ballkan.

Menjëherë pas përfundimit të luftës, filluan mosmarrëveshjet e para midis ish-aleatëve në lidhje me ndarjen e Maqedonisë. Këto mosmarrëveshje ishin shkaku i **Luftës së Dytë Ballkanike** në vitin 1913. Në këtë luftë, **Bullgaria** luftoi kundër **Serbisë** dhe **Greqisë**. Pas katastrofës që përjetoi ushtria bullgare, osmanët iu bashkuan luftës kundër Bullgarisë. Kështu, ata arritën të rimarrin një pjesë të vogël të zotërimeve të tyre të mëparshme në Traki. Lufta përfundoi me humbjen e Bullgarisë. Në gusht të vitit 1913, u nënshkrua **Traktati i Paqes i Bukureshtit**, i cili i rishpërndau territoret midis aleatëve ballkanikë. Osmanët, nëpërmjet një marrëveshjeje të veçantë me Bullgarinë, e mbajtën shumicën e territoreve të kthyera në Traki. Megjithatë, Luftërat Ballkanike e **shënuan fundin e dominimit osman në Ballkan**.



Ballkani para Luftërave Ballkanike



Ballkani pas Luftërave Ballkanike



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Cilat forca ishin bartëse të ideve për ndryshim në Perandorinë Osmane?
2. Përkrahja ngritjen në pushtet të xhonturqve dhe sundimin e tyre.
3. Cilat ishin rezultatet e Luftërave Ballkanike për Perandorinë?

Serbia nga pavarësia deri në Luftën e Parë Botërore

Fitimi i pavarësisë së Serbisë shkaktoi entuziazëm te populli. Princi Millan dhe politikanët serbë donin ta përdornin këtë gjendje shpirtërore për ta forcuar pozicionin e tyre. Vendi, i cili deri atëherë kishte qenë nën sundimin e huaj, po përballej me detyra dhe vështirësi të reja. Ai e kishte rritur territorin e tij, por ishte ende i vogël dhe ekonomikisht i dobët, prandaj nuk mund të zhvillohej shpejt.

Serbia bëhet mbretëri

Princi serb **Millan Obrenoviq**, që nga fillimi i mbretëritë të tij, u përpoq ta forconte, gradualisht, pushtetin e tij. Ashtu si paraardhësit e tij nga dinastia Obrenoviq, ai tregoi aftësi për ta qeverisur shtetin, por në të njëjtën kohë u përpoq ta mbante pushtetin në duart e veta. Millani e shfrytëzoi marrëveshjen me Austro-Hungarinë, e cila i siguroi mbështetje politike dhe ushtarake, për ta shpallur Serbinë mbretëri. Në **vitin 1882**, me festime të mëdha dhe një akt solemn, Serbia u **shpall mbretëri**. Millan Obrenoviq u bë **mbreti i parë i Serbisë**.

Pasi Millani u bë mbreti i parë i Serbisë moderne, ai **e shfuqizoi ushtrinë kombëtare dhe e futi shërbimin e rregullt ushtarak**. Ai besonte se ushtria kombëtare ishte e vjetëruar dhe nuk mund ta mbronte shtetin në mënyrë

E kaluara përmes burimeve



Mbreti Millan Obrenoviq e njoftoi popullin se Serbia nga principatë ishte shndërruar në mbretëri. Në shpallje, ai theksoi se ky akt konsiderohej përmbushje e dëshirave të kahershme të popullit serb dhe se mbretëria e re do ta niste rrugën e përparimit, lirisë, rendit dhe drejtësisë. Millani i kujtoi edhe meritat e sundimtarëve të mëparshëm, si dhe luftën për pavarësi. Duke vepruar kështu, ai theksoi se Serbia do të fitonte prestigj më të madh në Evropë dhe do të kishte një të ardhme më të sigurt.

A do të thotë shpallja e një mbretërie në vetvete liri më të madhe dhe një jetë më të mirë për njerëzit? A mund ta ndryshojë ndryshimi i titullit realitetin e njeriut të zakonshëm? Shpjegoje përgjigjen tënde.



Shpallja e Serbisë si mbretëri në vitin 1882



Kryengritja e Timokut e vitit 1883 – monument për viktimat në Zajëçar (Serbi)

të sigurt. Në vitin 1883, këto masa shkaktuan pakënaqësi dhe një revoltë, e cila u shtyp nga ushtria e re. Millani u përpoq ta rifitonte popullaritetin e tij mes popullit dhe disa politikanëve, por disfata e Serbisë në **luftën me Bullgarinë në vitin 1885** e përkeqësoi më tej pozicionin e tij në vend.

Në kushte të tilla, mbreti Millan Obrenoviq vendosi të tërhiqej nga fronti dhe të largohej nga Serbia. Para tërheqjes së tij, ai miratoi një kushtetutë të re, me të cilën donte ta qetësonte situatën në vend. Kushtetuta u votua nga kuvendi serb në vitin 1888. Kështu, Serbia u bë **monarki parlamentare** me liri civile të garantuara.

Fundi i dinastisë Obrenoviq

Pas tërheqjes së Millanit, në Serbi u krijua një situatë e re politike. Meqenëse djali i tij, **Aleksandër Obrenoviq**, nuk ishte ende në moshë madhore, Serbia u qeveris, përkohësisht, nga një regjencë tre-anëtarëshe, e përbërë nga politikanë të shquar. Ata u përpoqën ta qetësonin krizën politike dhe ta përmirësonin ekonominë.

Princi i ri i kurorës i ndiqte ngjarjet nga afër. Me kalimin e kohës, ai donte ta merrte pushtetin personalisht. Edhe pse ishte i mitur, Aleksandri besonte se politikanët po e kufizonin qëllimisht rolin e tij në qeverisjen e shtetit. Prandaj, ai vendosi të qëndronte vetë në krye të Serbisë.

Në fillim të sundimit të tij, mbreti i ri e kishte mbështetjen e popullit. Ai ishte i arsimuar dhe inteligjent, por nuk donte ta ndante pushtetin me politikanët, njësoj si paraardhësit e tij nga dinastia Obrenoviq. Prandaj, ai e **shfuqizoi kushtetutën** e miratuar gjatë kohës së babait të tij. Kështu, ai ra në konflikt me, pothuajse, të gjithë politikanët e rëndësishëm në vend.

Aleksandër Obrenoviqi u përpoq të mbante marrëdhënie të mira me Austro-Hungarinë dhe Rusinë, por gradualisht e humbi besimin e tyre. Jeta e tij private gjithashtu shkaktonte pakënaqësi publike. Në maj të vitit 1903, oficerët e ushtrisë serbe organizuan **grusht shteti**, të njohur si Grushtshteti i Majit, i cili e rrëzoi nga fronti dinastinë Obrenoviq.

Dëshmi historike



Në një letër drejtuar perandorit gjerman Vilhelmi II, mbreti Millan e shpjegoi pozicionin e tij në vend para se të largohej nga fronti:

“Unë këtu nuk mund të mbështetem te asnjë parti apo individ. Është e pamundur të sundosh me forcë brutale gjatë gjithë kohës; madje edhe ushtria e bën detyrën e saj nga detyrimi, jo nga bindja. Gjatë këtyre 20 viteve, jam detyruar të shtyp dy revolucione të mëdha, për të mos përmendur shumë komplete të tjera, më të mëdha dhe më të vogla. Është e neveritshme të vrasësh dhe burgosësh njerëz. Çdo individ që del nga burgu bëhet menjëherë një figurë politike popullore, e dashur dhe e respektuar nga shumë njerëz.”

Lexoje tekstin dhe përgjigju: pse Millani vendosi të tërhiqej nga fronti serb?



Mbreti Aleksandër Obrenoviq



Grushtshteti i majit

Serbia bëhet shtet i fortë ballkanik

Kuvendi Serb i bëri thirrje **Petar Karagjorgjeviqit** për ta marrë fronin. Ai ishte djali i ish-princit Aleksandër dhe nipi i Karagjorgje Petroviqit, udhëheqësit të Kryengritjes së Parë Serbe.

Sundimtari i ri solli më shumë demokraci në jetën politike të vendit. Nuk kishte më presion mbi politikanët që nuk pajtoheshin me mbretin. Në vend u miratua kushtetuta e re, e cila e **kufizoi ndjeshëm rolin e mbretit** në qeverisjen e shtetit. Gjatë viteve të ardhshme, qeveritë serbe zbatuan ndryshime të rëndësishme në ekonomi, politikë, ushtri dhe shoqëri. Këto ndryshime çuan në **përkeqësimin e marrëdhënieve me Austro-Hungarinë**. Prandaj, përmes formave të ndryshme të presionit, kjo fuqi evropiane u përpoq ta kontrollonte shtetin e ri serb.

Një nga qëllimet kryesore të politikanëve serbë gjatë kësaj periudhe ishte çlirimi i territoreve të konsideruara si serbe, por që ishin nën sundimin osman. Edhe pse Serbia ishte forcuar ndjeshëm gjatë mbretërimit të Petar I Karagjorgjeviqit, asaj ende i mungonte forca e mjaftueshme ushtarake për t'u përballur e vetme me osmanët. Prandaj, ajo u përfshi në Lidhjen Ballkanike.

Serbia mori pjesë në të dy Luftërat Ballkanike. Pas përfundimit të luftërave, ajo fitoi territore të konsideruesh-

Mëso më shumë



Më 1 prill të vitit 1893, megjithëse nuk ishte ende 17 vjeç, Aleksandër Obrenoviç i ftoi regjentët dhe ministrat në një darkë gala në pallatin e tij. Pas darkës, ai e ngriti gotën dhe të gjithë të pranishmit prisnin që ai të ngrinte dolli. Në vend të kësaj, Aleksandri i informoi se ishin arrestuar dhe se po e merrte në dorë të gjithë pushtetin në vend. Në të njëjtën kohë, ushtria e mori kontrollin e ndërtesave të institucioneve më të rëndësishme shtetërore dhe të telegrafit.

Ndërlidhi njohuritë



Në vitin 1903, mbreti Aleksandër Obrenoviç dhe mbretëresha Draga Mashin u vranë nga një grup oficerësh serbë.

Kujtohu se cilët sundimtarë të tjerë në shekullin e ri u vranë dhe në këtë mënyrë u rrëzuan nga pushteti?



Mbreti Petar Karagjorgjeviq



Ushtarët serbë në Luftërat Ballkanike

me - Sanxhakun, një pjesë të madhe të Kosovës dhe territorin e shtetit të sotëm maqedonas, duke e përjashtuar qytetin e Strumicës. Kështu, Serbia u rrit nga një principatë e vogël në një shtet të madh ballkanik.



Kurorëzimi i mbretit Petar I Karagjorgjeviq



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Kur u shpall Serbia mbretëri dhe kush u bë mbreti i saj i parë?
2. Si sundoi mbreti Millan Obrenoviq dhe pse në fund u tërhoq nga froni?
3. Çfarë territoresh fitoi Serbia pas Luftërave Ballkanike?

Greia nga fundi i Krizës së Madhe Lindore deri në Luftërat Ballkanike

Pas përfundimit të Krizës së Madhe Lindore, Greia, megjithëse nuk mori pjesë ushtarakisht, e fitoi në mënyrë diplomatike Thesalinë dhe **qytetin e Artës në Epir**. Ky ishte zgjerimi i dytë territorial i shtetit pa konflikt ushtarak. Megjithatë, tokat e reja nuk nënkuptonin forcim të shpejtë të shtetit. Greia ende kishte probleme serioze. Ekonomia ishte e dobët dhe e pazhvilluar, administrata shtetërore nuk i plotësonte nevojat e një vendi modern dhe ushtria mbeti e dobët.



Harilaos Trikupis



Theodoros Delianis

Koha e Trikupisit

Në njëzet vitet e fundit të shekullit XIX, në Greqi mbizotëruan dy grupe politike kundërshtare. Partia që e mbështeste përparimin e vendit drejtohej nga **Harilaos Trikupis**. Përballë tij ishte partia që i mbronte vlerat tradicionale dhe e paraqiste veten si më të afër me popullin. Ajo drejtohej nga **Theodoros Delianis**. Të dy partitë përdorën mëto të ndryshme, për ta bindur popullin në anën e tyre.

Trikupis besonte se Greia nuk mund të zgjerohej në mënyrë territoriale pa u modernizuar dhe forcuar më parë. Prandaj, ai filloi **reforma** të mëdha në vend.

Një nga çështjet më të rëndësishme për të ishte zhvillimi i rrjetit të transportit, veçanërisht atij **hekurudhor**. Greia nuk kishte lidhje hekurudhore madje as me Perandorinë Osmane, edhe pse e vetmja rrugë tokësore nga Greia për në Evropë kalonte nëpër territoret osmane. Prandaj, Trikupis investoi shumë para në ndërtimin e një rrjeti modern hekurudhor në të gjithë vendin. Ai, gjithashtu, e filloi ndërtimin e **Kanalit të Korintit**. Ndërtimi i tij e shkurtoi kohën e lundrimit nga Egjeu në Detin Jon.

Mëso më shumë



Gjatë kësaj periudhe, politikanët grekë shpesh përpiqeshin t'i fitonin votuesit me para dhe dhurata të tilla si verë ose raki. Vetëm burrat kishin të drejtë vote. Ata, gjithashtu, kërkonin mbështetje përmes kumbarisë. Meqenëse shoqëria greke ishte tradicionale, pagëzimi ishte një ngjarje shumë e rëndësishme për çdo familje. Prandaj, politikanët donin të bëheshin kumbarë për sa më shumë fëmijë, në mënyrë që të fitonin më shumë mbështetës përmes lidhjeve familjare. Kështu, politikan i Dimitrios Rallis ishte kumbari i rreth 1,000 fëmijëve, ndërsa Stefanos Dragumis ishte kumbari i rreth 200 fëmijëve.



Ndërtimi i Kanalit të Korintit



Emigrantë grekë në rrugëtimin e tyre për në SHBA

Në të njëjtën kohë, iu kushtua vëmendje e madhe modernizimit dhe forcimit të **ushtrisë greke**, në mënyrë që ajo të mund t'i kundërvihet ushtrisë osmane. Oficerët morën trajnim më të mirë, u blenë armë dhe anije të reja luftarake.

Modernizimi nuk u kufizua vetëm në transport dhe ushtri. Pati edhe përpjekje për ndryshime në fusha të tjera, veçanërisht në arsim dhe kulturë. U hapën shkolla të reja dhe u rrit numri i studentëve në **Universitetin e Athinës**. Në vend filloi arsimi profesional dhe teknik, i cili ishte i nevojshëm për funksionimin e një shteti modern.

Greqia u zhvillua më ngadalë se vendet e tjera të Ballkanit. Për zbatimin e reformave dhe ndërtimin e hekurudhave nevojiteshin shumë para, por shteti nuk kishte



Harilaos Trikupis e takson verën (karikaturë)

E kaluara në të tashmen



Në fund të shekullit XIX, shumë grekë emigruan, kryesisht në SHBA, sepse nuk kishte vende pune dhe të ardhura të mjaftueshme në vend. Vlerësohet se rreth 350,000 grekë, kryesisht burra, u larguan nga Greqia. Disa prej tyre u larguan me qëllimin për t'u kthyer pas disa vitesh me kursimet e tyre, por shumë mbetën në vendet e tyre të reja. Paratë që ata dërgonin në shtëpi ishin shumë të rëndësishme për ekonominë greke.

Emigrimi nga Greqia vazhdon edhe sot, kryesisht për arsye ekonomike dhe dëshirë për një jetë më të mirë.

Emigrantët edhe më tej vazhdojnë t'u dërgojnë para familjeve të tyre, gjë që ka rëndësi edhe për vendin.



Borxhet e Greqisë ndaj bankave perëndimore (karikaturë)

fonde të mjaftueshme. Prandaj, qeveria mori kredi të mëdha nga bankat e huaja dhe i rriti taksat, gjë që shkaktoi pakënaqësi të madhe tek popullsia. Për shkak të borxheve të akumuluar, **shteti e shpalli falimentimin**, ndërsa Trikupis u largua nga politika.

Nga humbja deri në rimëkëmbje

Largimi i Trikupisit nga politika nuk i zgjidhi problemet në Greqi. Në vitin 1897, shpërtheu **lufta midis Greqisë dhe Perandorisë Osmane**. Shkaku i luftës ishte kryengritja në ishullin e Kretës. Ushtria osmane e mundi ushtrinë greke.

Vendi ra në një krizë të thellë. Në kushte të tilla, mbi Greqinë u intensifikua presioni nga fuqitë evropiane. Bankat evropiane nuk donin të hiqnin dorë nga borxhi grek, por kërkonin siguri më të madhe se ai do të shlyhej. Prandaj, në Greqi u fut kontrolli financiar ndërkombëtar. Qëllimi i tij ishte që t'i kufizonte shpenzimet shtetërore dhe të siguronte që shteti ta shlyente rregullisht borxhin e tij.

Kontrolli i Fuqive të Mëdha pati një efekt pjesërisht pozitiv. Edhe pse vendi vazhdoi të përballej me probleme të mëdha dhe varfëri, falë kontrollit evropian, fondet filluan të rrjedhin përsëri në thesarin grek. Si rezultat, situata financiare filloi gradualisht të stabilizohej. Kjo bëri të mundur që të bëhej një përpjekje tjetër për modernizimin e ushtrisë.

Vendi filloi të rimëkëmbej, por procesi ishte i ngadaltë. Bujqësia po përballej me probleme të mëdha dhe **shumica e popullsisë jetonte në fshat**.

Venizelosi dhe ngritja e Greqisë

Grushti i shtetit i xhonturqve pati ndikim edhe në Greqi. Shumë prisnin që **Kreta** t'i aneksohej shtetit grek dhe qeveria në Athinë, madje e njoftoi një mundësi të tillë. Por, qeveria e xhonturqve në Perandorinë Osmane e bëri të qartë se nuk do ta lejonte këtë. Së shpejti midis oficerë-



Beteja e Farsalës në Luftën Greko-Otomane të vitit 1897



Athina në fund të shekullit XIX



Eleftherios Venizelos

ve të ushtrisë greke shpërtheu revoltë. Ata kërkuan ndryshime të mëdha, veçanërisht për ta zvogëluar ndikimin e partive politike dhe familjes mbretërore. Si rezultat, vendi hyri në një krizë të re.

Mbreti pranoi disa lëshime për oficerët e revoltuar. Më pas u mbajtën zgjedhje, të cilat u fituan nga **Elefterios Venizelosi**. Ai e mbështeti forcimin e shtetit dhe modernizimin e tij. Së pari, u ndryshua kushtetuta. U fut arsimi fillor i detyrueshëm dhe falas. Nëpunësit civilë punësoheshin, duke kaluar një provim dhe merrnin siguri më të madhe në punë, kurse oficerëve u ndalohej të ishin anëtarë të parlamentit. Me këto masa, për herë të parë në historinë e Greqisë, shteti filloi të mbledhë më shumë para, sesa shpenzonte.

Venizelosi ishte një politikan, që u përpoq të krijonte një shtet të madh dhe të fortë grek. Për këtë qëllim, ai i kushtoi vëmendje të veçantë forcimit të ushtrisë dhe marinës. Në Greqi ishin ftuar **këshilltarë të huaj për trajnim**, ndërsa shteti siguronte **armë dhe anije luftarake moderne**.

Në Luftërat Ballkanike, ushtria greke e pushtoi **Epirin jugor, ishullin e Kretës dhe pjesën më të madhe të Maqedonisë**. Terri-tori i Greqisë, pothuajse, u dyfishua dhe Venizelosi u bë një nga politikanët më të famshëm grekë.



Osmanët ua dorëzojnë Selanikun ushtrive greke

E kaluara përmes burimeve



Pasi u bë kryeministër, Venizelosi i shpjegoi qëllimet e tij për të ardhmen e Greqisë:

“Besoja fuqimisht se forcat materiale dhe morale të popullit janë të mjaftueshme, nëse janë në duart e njerëzve të përkushtuar, për ta bërë përsëri Greqinë të denjë për botën moderne. Një Greqi e tillë do të ketë respektin e kombeve të tjera dhe do të jetë në gjendje të zërrë një vend të rëndësishëm midis tyre. Kur të bëhet e fortë, do të jetë në gjendje të kontribuojë për paqen dhe përparimin e popujve të Lindjes.”

A po flet Venizelosi për të tashmen apo për të ardhmen e Greqisë? Shpjegoje përgjigjen me një shembull nga teksti.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Çfarë fitoi Greqia pas Krizës së Madhe Lindore dhe me çfarë problemesh u përball pas këtij zgjerimi?
2. Çfarë reformash zbatoi Trikupisi dhe pse ato çuan në krizë financiare dhe në falimentimin e shtetit?
3. Çfarë territoresh pushtoi Greqia në Luftërat Ballkanike?


Bullgaria nga shtet autonom në shtet të pavarur

Pas Luftës Ruso-Turke të viteve 1877-1878, u krijua Principata Autonome e Bullgarisë. Në zonat e çliruara, fillimisht **pushteti rus krijoi një administratë të përkohshme**. Detyra e saj ishte që t'i hidhte themelet e shtetit të ri. Administrata e përkohshme krijoi organe të qeverisjes vendore, gjykata, shkolla dhe ushtri. Në administratë morën pjesë edhe shumë bullgarë. Në këtë mënyrë, u hodhën themelet e **shtetit të ri bullgar**.

Në vitin 1879, në Tërnovë u mbledh **Asambleja Kushtetuese**. Detyra e saj kryesore ishte ta miratonte kushtetutën - ligjin më të rëndësishëm të shtetit. Me miratimin e kushtetutës, Bullgaria u bë **monarki kushtetuese**, si shumë vende të tjera evropiane. Kushtetuta ishte konfirmuar më parë nga cari rus, i cili besonte se Bullgaria duhet të kishte një ndarje të qartë të pushtetit. Sipas kushtetutës, pushteti ndahej midis princit dhe Asamblesë Kombëtare. Kushtetuta e garantonte lirinë e shtypit dhe të fjalës, si dhe të drejtën e shoqërimit. Çdo mashkull i rritur e kishte të drejtën e votës.



Aleksandër Batenbergu me gruan e tij Johana dhe djalin Krum-Asen



Asambleja e parë e madhe kombëtare në Tërnovë të Madhe

Menjëherë pas kësaj, u zgjodh sundimtari i parë i shtetit të ri - Princi **Aleksandër Batenberg**. Ai e mori mbështetjen e carit rus. Kështu filloi jeta e pavarur e Bullgarisë si një shtet modern evropian.

Bullgaria filloi të funksiononte si shtet. U formuan **parti politike** për të përfaqësuar interesat e qytetarëve. Rusia kishte ndikim të madh në vend. Përfaqësuesit rusë donin ta kontrollonin politikën bullgare. Ushtria stërvitej nga oficerë rusë dhe përdoreshin armë ruse. Gradualisht, lindi pakënaqësia nga përzierja ruse në drejtimin e shtetit. Princi Aleksandër hyri në konflikt me përfaqësuesit rusë. Politikanët u ndanë në dy grupe. Disa donin bashkëpunim me të ngushtë me Rusinë, ndërsa të tjerë besonin se Bullgaria duhet të ishte më e pavarur.

Bashkimi i Bullgarisë dhe ndërrimi i fronit princëror

Me vendimet e Kongresit të Berlinit, përveç Principatës autonome të Bullgarisë, u krijua edhe rajoni autonom i **Rumelisë Lindore**. Bullgarët nuk e pranuan këtë ndarje si të përhershme, kështu që krijuan një organizatë të fshehtë qëllimi i së cilës ishte bashkimi i Rumelisë Lindore me Principatën e Bullgarisë.

Më 6 shtator të vitit 1885, në Plovdiv u shpall **bashkimi i Rumelisë Lindore me Bullgarinë**. Bashkimi shkaktoi pakënaqësi midis disa prej Fuqive të Mëdha dhe vendeve fqinje. Rusia nuk donte që Princi Aleksandër Batenberg ta udhëhiqte shtetin e bashkuar, kështu që i tërhoqi zyrtarët dhe oficerët e saj nga Bullgaria. E pakënaqur me bashkimin, Serbia i shpalli luftë Bullgarisë. Megjithëse e përgatitur dobët, ushtria bullgare korri fitore në **Betejën e Slivnicës** dhe e mbrojti vendin. Në mars të vitit 1886, bashkimi u njoh edhe zyrtarisht.

Menjëherë pas bashkimit, oficerët e ushtrisë bullgare, të cilët dëshironin marrëdhënie më të mira me Rusinë, organizuan grusht shteti dhe e detyruan princin Aleksandër Batenberg të largohej nga vendi. Së shpejti ai u thirr të kthehej përsëri në Bullgari, por Batenbergu vendosi të jete dorëheqje.

Njihu me një figurë historike



Aleksandër Batenbergu lindi në vitin 1857. Ai ishte një aristokrat gjerman me lidhje familjare me dinastinë perandorake ruse. Ai u arsimua në Dresden dhe u diplomua në një shkollë ushtarake në Kasel. Ai mori pjesë në Luftën Ruso-Turke (1877-1878). Në vitin 1879 ai u zgjodh Princ i Bullgarisë dhe sundoi deri në vitin 1886. Për bullgarët ai u bë simbol i shtetit të lirë bullgar. Vdiq në vitin 1893 dhe, sipas dëshirës së tij, u varros në Sofje.



Aleksandër Batenbergu në Slivnicë

Ndërlidhi njohuritë



Princi Aleksandër Batenberg, në vitin 1886 e njoftoi popullin bullgar se jep dorëheqje nga froni. Ai besonte se largimi i tij do t'i përmirësonte marrëdhëniet midis Bullgarisë dhe Rusisë. Në fjalimin e tij, ai tha se e kishte bërë këtë për të mirën e vendit dhe e falënderoi popullin për mbështetjen e tij. Para se të largohej, ai u bëri thirrje qytetarëve që ta ruanin paqen dhe rendin.

Krahasojë tërheqjen e Aleksandër Batenbergut me tërheqjen e mbretit grek Oto. Çfarë ngjashmëri mund t'i vësh midis këtyre dy ngjarjeve?

Koha e Stambollovit

Largimi i Aleksandër Batenbergut e la fronin princëror të Bullgarisë bosh. Në vitin 1887, **Ferdinandi** u zgjodh si princi i ri bullgar, por nuk u njoh nga Fuqitë e Mëdha. Rusia konsideronte se zgjedhja e tij nuk ishte në interesin e saj dhe i ndërpreu të gjitha marrëdhëniet me Bullgarinë.

Ferdinandi arriti në Bullgari dhe **Stefan Stambollovi** u bë kryeministër. Ai u përpoq ta përmirësonte situatën në vend. Nën sundimin e tij, vendi filloi të modernizohej me shpejtësi: u ndërtuan rrugë dhe hekurudha; u mbështet prodhimi bullgar; u lidhën marrëveshje tregtare me vendet evropiane. Vëmendje e madhe iu kushtua **arsimit**. Shteti dërgoi shumë bullgarë të rinj për të studiuar në të gjithë Evropën.

Në politikën e jashtme, qeveria e Stambollovit ndoqi një politikë më pajtuese ndaj Perandorisë Osmane. Ajo besonte se në këtë mënyrë Ekzarkia Bullgare do të kishte **peshkopë të rinj në Maqedoni dhe Traki**.

Stambollovi pati suksese, por edhe shumë kundërshtarë të mbështetur nga Rusia. Fillimisht, ai e pati mbështetjen e Princit Ferdinand. Megjithatë, për t'u njohur nga Fuqitë e Mëdha si princ trashëgimtar bullgar, Ferdinandi u bashkua me kundërshtarët e Stambollovit dhe e detyroi atë të tërhiqej nga pushteti. Rusia dhe fuqitë e tjera evropiane më pas e njohën **Ferdinandin si princ bullgar**.

Në rrugën drejt pavarësisë dhe Luftërat Ballkanike

Pasi u njoh si princ bullgar, Ferdinandi filloi të luante një rol më të madh në shoqërinë dhe politikën bullgare. Deri në fund të shekullit XIX, ishin hedhur themelet e partive politike në vend. Ato ishin thellësisht të përçara për çështjen e bashkëpunimit me Rusinë: disa e mbështetnin bashkëpunimin, ndërsa të tjerat e kundërshtonin atë.

Gjatë kësaj periudhe, u rivendos demokracia parlamentare, e cila ishte shtypur gjatë sundimit të Stambollovit.

Megjithatë, pavarësisht krizave politike, Bullgaria po përparonte. **Portet detare** të Bullgarisë u modernizuan. Në disa pjesë të vendit **u fut në përdorim energjia elektrike**, kurse në kryeqytetin Sofje u vu në funksionim edhe **tramvaji**. Ushtria forcohej vazhdimisht dhe kishte trajnim të shkëlqyer. Për sa i përket arsimit, Bullgaria ishte ndër vendet më të përparuara në Ballkan.



Stefan Stambolli



Princi bullgar Ferdinand

Mëso më shumë



Që të njëjhej nga Fuqitë e Mëdha si princ bullgar, Ferdinandi duhej ta pagëzonte të birin dhe trashëgimtarin e fronit, Borisin, në Kishën Ortodokse. Kjo ishte një kërkesë nga Rusia. Ferdinandi dhe gruaja e tij, Maria Luisa, ishin katolikë, kështu që ajo nuk u pajtua me këtë kërkesë. Megjithatë, për shkak të nevojës për njohje ndërkomëtare, Ferdinandi pranoi që i biri të pagëzohej në Kishën Ortodokse. Në këtë mënyrë, ai arriti ta siguronte njohjen nga Rusia.

Suksesi më i madh i sundimit të Ferdinandit ishte shpallja e pavarësisë së Bullgarisë. Duke përfituar nga situata e re në Perandorinë Osmane, në shtator të vitit 1908 **Bullgaria e shpalli pavarësinë e saj dhe u bë mbretëri**. Fuqitë e mëdha e njohën pavarësinë e vendit disa muaj më vonë. Rol të madh për këtë luajti Rusia.

Pas pavarësisë, Bullgaria donte ta zgjeronte territorin e saj dhe ta arrinte qëllimin e saj për ta marrë Maqedoninë dhe Trakinë, të cilat i konsideronte vende të veta. Shteti lidhi marrëveshje me Serbinë dhe Greqinë. Në Luftën e Parë Ballkanike, **ushtria bullgare korri fitore të mëdha kundër forcave osmane**, gjë që shkaktoi habi dhe respekt në Evropë. Megjithatë, keqkuptimet me aleatët mbi ndarjen e Maqedonisë, së bashku me llogaritjet e gabuara dhe pasionin për fitoret e mëparshme, çuan në **disfatë të rëndë në Luftën e Dytë Ballkanike**. Bullgaria fitoi një pjesë të vogël të Maqedonisë dhe Trakisë, me dalje në Detin Egje, por nuk i arriti qëllimet e saj.



Ilustrim francez për pjesëmarrjen bullgare në Luftën e Parë Ballkanike



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Cili ishte roli i administratës së përkohshme ruse në krijimin e shtetit bullgar?
2. Cili ishte roli i Stefan Stambollovit në modernizimin e Bullgarisë?
3. Kur e fitoi Bullgaria pavarësinë dhe u bë mbretëri?

Shqipëria në rrugën drejt pavarësisë

Shkatërrimi i Lidhjes së Prizrenit nuk do të thoshte fundi i luftës së shqiptarëve për autonomi dhe liri. Ajo vazhdoi në dy drejtime - nëpërmjet zhvillimit të arsimit dhe kulturës, por edhe nëpërmjet kryengritjeve të armatosura.

Lufta për arsim dhe krijimi i alfabetit

Intelektualët shqiptarë e kuptuan se populli mund të përparonte, vetëm nëse kishin shkolla dhe libra në gjuhën e tyre amtare. Prandaj, ata filluan të botonin gazeta, tekste shkollore dhe vepra letrare në gjuhën shqipe. Meqenëse autoritetet osmane shpesh i ndalonin këto aktivitete, shumë libra dhe gazeta u shtypën edhe jashtë Perandorisë Osmane.

Në Egjipt, **Thimi Mitko** botoi një libër me poezi popullore dhe historike të quajtur **“Bleta Shqiptare”**, i cili fliste për dashurinë për atdheun dhe shpresën për një të ardhme më të mirë.

Rol të rëndësishëm kishte edhe **Jeronim de Rada**, një nga shkrimtarët më të famshëm arbëreshë. Në veprat e tij, ai shkroi për jetën e lirë të shqiptarëve, para ardhjes së osmanëve dhe për luftërat e tyre kundër sundimit turk. Përveç librave, De Rada botonte edhe një revistë nëpërmjet së cilës ai ia prezantoi publikut evropian popullin shqiptar, duke e paraqitur atë si një popull të veçantë që meritonte liri dhe pavarësi.

Intelektualët shqiptarë u përfshinë edhe në **hapjen e shkollave në gjuhën shqipe**. Ata besonin se arsimi ishte mënyra më e rëndësishme për ta ruajtur gjuhën, kulturën dhe identitetin kombëtar.

Shkolla e parë në gjuhën shqipe u hap në **Korçë**, ndërsa më vonë shkolla të tilla u hapën edhe në qytete dhe fshatra të tjera. Në to, nxënësit mësonin të lexonin dhe të shkruanin në gjuhën e tyre amtare, gjë që ishte një hap i madh përpara për popullin shqiptar.

Më vonë, u hap edhe një **shkollë për vajza**, e cila përfaqësonte një risi të rëndësishme për kohën. Gjatë kësaj periudhe, gratë luajtën një rol të rëndësishëm në rilindje - ato morën pjesë në arsim, punuan si mësuese dhe kontribuan, aktivisht, në përhapjen e shkrimit dhe leximit.

Mëso më shumë



Në jug të Shqipërisë, vepronin mësueset Sevasti dhe Parashqevi Kiriazi, të cilat kontribuan në zhvillimin e arsimit të vajzave. Ato ishin gra të arsimuara dhe progresive që ia kushtuan jetën e tyre arsimit të vajzave shqiptare. Elena Gjika, e njohur edhe si Dora D'Istria, ishte një princeshë rumune me origjinë shqiptare. Ajo shkruante për historinë e Shqipërisë, mbante kontakte me intelektualët shqiptarë dhe e mbështeste idenë e mëvetësisë së Shqipërisë.



Jeronim de Rada



Elena Gjika

Në fund të shekullit XIX, shqiptarët nuk kishin një alfabet të vetëm. Myslimanët në Shqipërinë qendrore dhe jugore që nga viti 1879 e përdornin **alfabetin e Stambollit**, të krijuar nga **Sami Frashëri**. Katolikët në Shkodër dhe disa organizata shqiptare në Evropë nuk e pranuan këtë alfabet. Ata përdornin një alfabet të ndryshëm, thjesht latin.

Çështja e alfabetit u bë një problem i madh. Prandaj, u vendos të organizohej një kongres për ta zgjidhur problemin e alfabetit. Kongresi u organizua nga Klubi Shqiptar në Manastir dhe u mbajt nga **14 deri më 22 nëntor të vitit 1908**. Në të morën pjesë përfaqësues të shqiptarëve nga Perandoria Osmane, si dhe nga komunitetet shqiptare jashtë vendit. Në kongres u formua një komision për ta zgjidhur problemin e alfabetit. Komisioni diskutoi, nëse do të zgjidhej një nga alfabetet ekzistuese, do të krijohet një alfabet i ri nga pjesë të tyre, apo do të krijohet një alfabet krejtësisht i ri. Në fund, u mor një **vendim kompromisi**: u pranuan **dy alfabetet** - një plotësisht latin dhe alfabeti i Stambollit.

Forcimi i rezistencës kundër pushtetit osman

Nga fundi i shekullit XIX, situata në pjesët evropiane të Perandorisë Osmane ishte shumë e tensionuar. Figurat politike shqiptare e konsideruan si të nevojshëm riorganizimin. Në Pejë u krijua një organizatë e re, e njohur si **Lidhja e Pejës**, e kryesuar nga **Haxhi Zeka**, me qëllim mbrojtjen e territoreve dhe kërkimin e vetëqeverisjes më të madhe. Aktivitetet e Lidhjes provokuan një reagim nga autoritetet osmane, të cilat morën masa për ta shkatërruar atë.

Dështimi i Lidhjes së Pejës nuk e nënkuptonte fundin e aktiviteteve të veprimtarëve shqiptarë, të cilët filluan të organizoheshin gjithnjë e më shumë për luftë të armatosur. Në vitin 1905, Bajo Topulli e themeloi komitetin e fshehtë në Manastir, të quajtur "Për Lirinë e Shqipërisë". Më vonë, u formuan edhe komitete të tjera të fshehta.

Përveç krijimit të komiteteve, u formuan edhe grupet e para të armatosura. Në vitin 1906, në afërsi të Korçës u formua çeta e parë nën udhëheqjen e **Bajo Topullit**, kurse më vonë u krijuan çeta të tjera, të cilat i filluan përleshjet me ushtrinë osmane. Të tilla ishin grupet e **Çerçiz Topullit** dhe **Mihal Gramenos**.



Sami Frashëri me gruan e tij Emine

Njihuni me një figurë historike



Sami Frashëri ishte një nga shkrimtarët dhe figurat kulturore më të rëndësishme shqiptare. Ai i mbështeste të drejtat e shqiptarëve dhe autonominë e tyre. Frashëri punoi për krijimin e alfabetit të gjuhës shqipe dhe mori pjesë në formimin e komiteteve dhe shoqërive për botimin e librave dhe gazetave në gjuhën shqipe.

Ai shkroi shumë libra, tekste shkollore dhe fjalorë, dhe vepra e tij më e famshme politike është "Shqipëria – ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet", e cila e paraqet idenë e tij për autonominë dhe zhvillimin e kulturës shqiptare.



Pjesëmarrësit e Kongresit të Manastirit

Intelektualët dhe revolucionarët shqiptarë ranë në kontakt me xhonturqit. Ata u premtuan atyre se do t'i njihnin të drejtat e shqiptarëve nëse do të vinin në pushtet. Prandaj, disa shqiptarë e mbështetën lëvizjen xhonturke. Megjithatë, xhonturqit nuk i sollën rezultatet e pritura dhe shumë shpejt udhëheqësit shqiptarë ranë në konflikt me autoritetet xhonturke.

Në vitin 1910, shpërtheu **kryengritja në Kosovë**. Forcat osmane u përpoqën ta shtypnin kryengritjen, por hasën në rezistencë të ashpër. Vitin pasardhës, një kryengritje e re shpërtheu në veri të Shqipërisë, e udhëhequr nga **Dedë Gjon Luli**.


Për shkak të rezistencës së fuqishme, autoritetet osmane u detyruan të hynin në negociata me kryengritësit. Udhëheqësit shqiptarë të kryengritësve mbajtën një takim **në fshatin Greçë**, ku u miratua një memorandum me kërkesa për autonomi, përdorimin e gjuhës shqipe në administratën dhe shërbimin ushtarak vendas.

Autoritetet në Stamboll nuk i pranuan këto kërkesa. Kriza në marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe autoriteteve osmane vazhdoi të përkeqësohej.

Pak para fillimit të Luftërave Ballkanike, në vitin 1912, shpërtheu një kryengritje e re nën udhëheqjen e **Hasan Prishtinës**. Kryengritja u përhap në shumë zona të banuara me shqiptarë. Edhe pse këto kryengritje nuk çuan në krijimin e një shteti autonom, ato e paralizuan administratën osmane dhe e forcuan aspiratën e shqiptarëve për pavarësi.



Kryengritës shqiptarë



Hasan Prishtina

Krijimi i shtetit shqiptar

Fillimi i Luftës së Parë Ballkanike shkaktoi shqetësim dhe një reagim të shpejtë midis politikanëve dhe intelektualëve shqiptarë. Pushtimi i ushtrive serbe dhe greke i detyroi ata të organizoheshin, urgjentisht, për ta shpallur pavarësinë e Shqipërisë, përpara se vendi të pushtohej plotësisht. Në këto ngjarje një aktivitet të madh treguan Ismail Qemali dhe Luigj Gurakuqi. Qemali mbërriti në Vlorë, ku u zhvillua një takim me përfaqësuesit shqiptarë, që kishin arritur në qytet.

Më **28 nëntor të vitit 1912**, Ismail Qemali e ngriti flamurin shqiptar në Vlorë dhe e shpalli **pavarësinë e Shqipërisë**.

Rruga drejt njohjes së plotë nuk ishte e lehtë. Në Vlorë u formua një **qeveri e përkohshme**, me qëllim kërkimin e njo-

E kaluara përmes burimeve



Baronesha gjermane Marie Amelie von Godin qëndroi në Shqipëri në periudhën 1912–1913 dhe vetë ishte dëshmitare e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë.

Sipas përshkrimit të saj, kur u ngrit flamuri, populli e këndoi me gëzim himnin “Për atdheun”. Atmosfera ishte shumë solemne dhe emocionale. Një burrë i moshuar, i cili qëndronte në hyrje të shtëpisë, tha me zë të emocionuar se ishte i lumtur që e kishte përjetuar atë ditë. Shumë nga të pranishmit e kishin pritur këtë moment për një kohë të gjatë dhe kishin bërë sakrificat të mëdha, për të qenë dëshmitarë të ngjarjes.



Ismail Qemali



Shpallja e Pavarësisë në Vlorë



Vilhelm Vidi

hjes ndërkombëtare dhe fillimin e organizimit të pushtetit shtetëror, aty ku ishte e mundshme. Qeveria e përkohshme i krijoi edhe institucionet e para në shtetin e ri.

Detyra e saj kryesore ishte ta fitonte njohjen nga Fuqitë e Mëdha dhe të kërkonte tërheqjen e ushtrive të huaja. Në Londër u mbajt konferenca e Fuqive të Mëdha, në të cilën më **29 korrik të vitit 1913 u njoh pavarësia e Shqipërisë.**

Në nëntor të vitit 1913, Fuqitë e Mëdha e emëruan Princin Vilhelm Vid si Princ të Shqipërisë. Ai arriti në vend në mars të vitit 1914 dhe Shqipëria u bë **shtet sovran nën garancinë e Fuqive të Mëdha.** Megjithatë, vendi po përballëj me probleme dhe revolta serioze. Princi u përpoq ta vendoste pushtetin, veçanërisht në jug të vendit, si dhe t'i zgjidhte problemet me kryengritjet, por nuk pati sukses.

Për shkak të fillimit të Luftës së Parë Botërore dhe pamundësisë për të marrë mbështetje nga forcat, që e garantonin pavarësinë e Shqipërisë, princi u largua nga vendi më 3 shtator të vitit 1914.



Zef Serembe – poet arbëresh që e promovoi kulturën dhe folklorin shqiptar



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Ku u hap shkolla e parë në gjuhën shqipe?
2. Çfarë roli luajtën gratë në zhvillimin e arsimit dhe kulturës shqiptare?
3. Ku u shpall pavarësia e Shqipërisë dhe kush ishte princi i parë shqiptar?

Arsimi, kultura dhe sporti në Ballkan në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX

Ndryshimet në jetën e përditshme në Ballkan ndikuan, gjithashtu, në arsim, kulturë dhe sport. Shtetet e reja filluan të hapnin sistematikisht shkolla dhe teatro, të organizonin aktivitete sportive dhe ta përhapnin mënyrën evropiane të jetesës. Shkenca, arti dhe kultura fizike fituan rëndësi gjithnjë e më të madhe dhe qytetet gradualisht u shfaqën si qendra të modernizimit dhe zhvillimit kulturor.

Krijimi i shteteve të pavarura dhe autonome në Ballkan shkaktoi ndryshime të rëndësishme në jetën e popullsisë. Në qytetet më të mëdha, dhe veçanërisht në kryeqytete, banorët filluan të përvetësonin një mënyrë veshjeje dhe jetese të ngjashme me atë evropiane. Në të kundërtën, në qytetet dhe fshatrat më të vogla, mënyra tradicionale e jetesës u ruajt për një kohë të gjatë.

Arsimi në Ballkan

Arsimi kishte një rëndësi të veçantë për shtetet e reja ballkanike, të cilat me vetëdije kërkonin ta zhvillonin atë. Në vitet e para, shumë të rinj dërgoheshin për të studiuar në vendet evropiane. Me t'u kthyer në atdheun e tyre, ata u morën me mësimdhënie dhe i përcollën njohuritë e fituara.

Në vende të ndryshme u miratuan ligje për **arsim të detyrueshëm fillor**. Pavarësisht kësaj, për shkak të traditave të rrënjësura thellë, shumë vajza nuk e përfunduan arsimin e tyre.

Fëmijët në qytete kishin më shumë mundësi për arsimim, kurse familjet më të pasura punësonin mësues privatë për fëmijët e tyre. Në të njëjtën kohë, vendet përballëshin me prapambetje dhe varfëri, të cilat e pengonin seriozisht zhvillimin e arsimit.

Vëmendje e veçantë iu kushtua **arsimit të lartë**. Në Athinë, kryeqytetin e Greqisë, në vitin 1837 u themelua **universiteti i parë** në vend. Në Beograd, që në vitin 1863 u hap **Shkolla e Madhe**, e cila më vonë u zhvillua në universitet. Në Sofje, në vitin 1888, u themelua **Shkolla e Lartë**, e cila më vonë u bë universitet.

Deri në dekadat e fundit të shekullit XIX, vetëm djemtë kishin të drejtë studimi. Nga fundi i shekullit, edhe **vajzat**



Moda midis elitës serbe në shekullin XIX

E kaluara përmes burimeve



Pas çlirimit të Serbisë, arsimi u përball me vështirësi të shumta. Përveç mungesës së shkollave, kishte edhe mungesë serioze të mjeteve mësimore. Librat në atë kohë ishin të pakët dhe ishte e vështirë për t'i siguruar, ndërkohë që nevojat e nxënësve ishin shumë modeste.

“Edhe letra e zakonshme nuk ishte e disponueshme në sasi të mjaftueshme... Dërrasat e zeza me vija, mbi të cilat mund të shkruhej dhe llogaritej, rrallëherë i kishte ndonjë nxënës... Nëse kushtet në Beograd ishin të tilla, mund të imagjinohet se si ishte në vendet në brendësi të Serbisë.”

Çfarë zbulon ky burim historik rreth kushteve në të cilat u zhvillua arsimi pas çlirimit të Serbisë?



Shkollë në Athinë në shekullin XIX



Universiteti në Beograd



Godina e Shkollës së Lartë në Sofje

filluan të regjistroheshin në universitete. Atje studioheshin më shpesh drejtësia, mjekësia, filozofia, historia dhe studimet fetare. Më vonë, me zhvillimin e shteteve, në programet mësimore u përfshinë edhe shkencat natyrore si biologjia, kimia dhe fizika. Universitetet luajtën një rol të rëndësishëm në arsim dhe prej tyre dolën shumë shkencëtarë të famshëm.

Jeta kulturore

Pas çlirimit të vendeve të Ballkanit, **arti dhe kultura** u gjendën në një periudhë ndryshimesh. Artistët e rinj shpesh shkonin për të studiuar në shkollat evropiane të artit, ku njiheshin me teknika dhe stile të reja.

Piktura dhe skulptura përjetuan një rritje të ndjeshme. Shumë artistë studiuan jashtë vendit. Me t'u kthyer në vendet e tyre, ata i sollën trendet artistike bashkëkohore evropiane. Në të njëjtën kohë, e kaluara dhe traditat e popullit vazhduan të kishin një vend të rëndësishëm në veprat e tyre.

Shfaqjet teatrale në vendet e Ballkanit u ndikuan shumë nga teatrot evropiane. Në vendet nën sundimin osman, ekzistonte një traditë e zhvilluar e **teatrit të kukullave** me hije, me personazhet kryesore Karagjozin dhe Haxhivatin. Ndërsa Haxhivati i përfaqësonte klasat e larta dhe të arsimuara Karagjozi e përfaqësonte njeriun e zakonshëm. Falë dinakërisë së tij, ai gjithmonë dilte më i zgjuar se Haxhivati.

Mëso më shumë



Teatrot shtetërore dhe grupet e vogla teatrale private nga shtetet ballkanike filluan të bënin turne më shpesh në vendet fqinje. Teatri i Sofjes, i udhëhequr nga Penço Sllavejkov, dha disa shfaqje në Maqedoninë Osmane. Në gjysmën e parë të vitit 1909, Teatri Mbretëror Serb nga Beogradi bëri turne në Shkup.

Çfarë mendon, pse grupet teatrale udhëtonin jashtë vendeve të tyre dhe jepnin shfaqje për publikun në vendet fqinje?



Ndërtesa e Teatrit të Sofjes në vitin 1908

Pas krijimit të shteteve të reja, autoritetet filluan të krijojnë sistematikisht teatro. Programi shpesh përfshinte vepra nga autorë të huaj. Më vonë, u prezantuan gjithnjë e më shumë drama nga autorë vendas, të cilat u pranuan më lehtë nga publiku. Shumë nga aktorët vendas u shkolluan në vendet evropiane. Me zhvillimin gradual të **teatrit** në shtetet ballkanike, u shfaqën edhe grupe të vogla teatrale amatore private, të cilat udhëtonin nëpër qytete dhe jepnin shfaqje para një publiku më të gjerë.



Skenë nga filmi serb i xhiruar në vitin 1911, kushtuar udhëheqësit të Kryengritjes së Parë Serbe - Karagjorgje

Nga fundi i shekullit XIX, vetëm një vit pas projeksionit të parë në kinema të filmit nga vëllezërit Lumi-ere në Paris, **filmi dhe kinemaja** arritën edhe në qytetet ballkanike. Shfaqjet e filmave shpesh mbaheshin në restorante, hotele dhe në hapësira të hapura. Kinematë udhëtuese u shfaqën në shumë qytete, duke e argëtuar popullsinë.

Më vonë, u ndërtuan kinema të posaçme për të shfaqur filma të huaj. Në fillim të shekullit XX, u realizuan filmat e parë vendas, ndërsa filmat edukativë u bënë pjesë e sistemeve arsimore të vendeve.

Sfidë për hulumtim



Projeksionet e para në kinema në Ballkan u mbajtën në Stamboll, Beograd, Athinë, Sofje dhe Selanik.

Hulumto se cilët dy vëllezër, me origjinë nga Maqedonia Osmane, konsiderohen si pionierë të kinematografisë ballkanike dhe si quhet kuadri i parë filmik që ata realizuan!

Sporti në Ballkan

Zhvillimi i **sportit** në Evropë pati një ndikim të fuqishëm në Ballkan. Mundja tradicionale, siç është gara e përlivaneve, gradualisht u zëvendësua nga sporte të reja. Kjo nuk përfaqësonte një modë jetëshkurtër, por ishte rezultat i besimit në rritje se sportet kontribuojnë në shëndetin e njerëzve.

Në Ballkan filluan të krijoheshin **shoqata të ndryshme gjimnastikore**. Shtetet e mbështetën gjimnastikën me qëllim edukimin e të rinjve të shëndetshëm dhe të fortë, ndërsa shkolat e futën atë si lëndë të detyrueshme. Klubet e gjimnastikës morën



Klub sportiv nga Greqia (1906)

pjesë edhe në gara në vende të tjera evropiane.

Nga fundi i shekullit XIX, në Ballkan u shfaq edhe **biçikleta**. Në fillim, njerëzit ishin skeptikë ndaj kësaj risie, por shpejt ajo u bë një mjet popullor transporti dhe sporti. Gara e parë me biçikleta në Ballkan u organizua në Beograd. Më pas u bë popullor edhe **futbolli**. U themeluan klube futbolli në shumë qytete. Luhej edhe tenis, por ishte i disponueshëm, kryesisht për qytetarët më të pasur dhe të huajt, që jetonin në vendet e Ballkanit.

Nga fundi i shekullit u realizua ideja e francezit Pierre de Koubertin për t'i rinovuar **Lojërat e lashta Olimpike**. Në vitin 1896, në Athinë u mbajtën Lojërat e para Olimpikë moderne, kurse kryeqyteti i Greqisë u dallua si qendra sportive e botës në atë kohë.



Lojërat e para moderne Olimpikë në Athinë

Sfidë për hulumtim



Sot zhvillohen Lojëra Olimpikë dimërore dhe verore. Ballkani ka pritur dy gara të tjera olimpikë. Bëni kërkime dhe renditni qytetet ballkanike ku u organizuan Lojërat Olimpikë Dimërore të vitit 1984 dhe Lojërat Olimpikë Verore të vitit 2004.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Si ndikuan ndryshimet në jetën e përditshme në arsim, kulturë dhe sporte në vendet e Ballkanit?
2. Si u zhvillua arsimi dhe çfarë pengesash ekzistonin për vajzat dhe fëmijët nga familjet e varfëra?
3. Përshkruaje jetën kulturore në vendet e Ballkanit në kapërcyell të shekujve XIX dhe XX.
4. Cilat sporte të reja u bënë të njohura në Ballkan?

5

MAQEDONIA

NË **FUND** TË SHEKULLIT **XIX**
DHE NË **FILLIM** TË SHEKULLIT **XX**



Organizatrat dhe shoqatat maqedonase në emigracion

Arsyet e emigrimit nga Maqedonia

Gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, një numër i madh maqedonasish u larguan nga Maqedonia. Më shpesh, ata emigruan në vendet përreth Ballkanit, por ndonjëherë edhe në vende më të largëta evropiane dhe përtej oqeanit. Disa prej tyre më vonë u kthyen në atdheun e tyre të vjetër, të tjerë mbetën atje përgjithmonë.

Arsyet e largimit nga atdheu i tyre ishin më shpesh **ekonomike**. Këta emigrantë maqedonas u larguan nga Maqedonia me shpresën, për të gjetur të ardhura më të mira për veten dhe familjet e tyre. Ky fenomen quhej **kurbet**. Të tjerë u detyruan të largoheshin për arsye **politike** për ta shmangur persekutimin nga qeveria dhe fatkeqësi të tjera. Një grup i tretë emigrantësh ishin intelektualë të rinj maqedonas, të cilët shkuan jashtë vendit për ta vazhduar **arsimin** e tyre.

Sfidë për hulumtim



Kurbeti ishte një pjesë e rëndësishme e jetës së përditshme dhe traditës popullore maqedonase. Mundohu të gjesh ndonjë këngë popullore rreth kurbetit dhe analizoje përmbajtjen e saj!

Hulumto dhe përgjigju:

- Si ishte jeta për emigrantët maqedonas jashtë Maqedonisë?

- Çfarë ndjenjash ngjall kurbeti në traditën popullore maqedonase?



Refugjatë nga Maqedonia pas Kryengritjes së Ilindenit (viti 1903)

Edhe pse ndodheshin jashtë Maqedonisë, emigrantët maqedonas nuk e harruan atdheun e tyre. Ata ishin të interesuar për fatin dhe të ardhmen e tij. Për t'i ndihmuar bashkatdhetarët e tyre në Maqedoni, ata u bashkuan në **organizata** dhe **shoqata** të ndryshme. Këto shoqata ishin të ndryshme sipas fushës së tyre të veprimtarisë dhe u formuan me qëllime kulturore, arsimore, politike dhe të tjera. Aktiviteti i tyre ishte, veçanërisht, i theksuar nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XIX.

Organizatrat dhe shoqatat maqedonase në Bullgari dhe Serbi

Pas Kongresit të Berlinit, një numër i madh emigrantësh maqedonas u nisën për në Bullgari. Atje ata u organizuan në shoqata dhe organizata të ndryshme. Të shqetësuar për të ardhmen e atdheut të tyre, një grup studentësh maqedonas në Sofje e formuan **Shoqatën Studentore Maqedonase** (SHSM). Qëllimi i shoqatës ishte të formonte një organizatë revolucionare në Maqedoni, të ndihmonte në çlirimin e saj dhe t'i kthente studentët maqedonas në atdheun e tyre pas përfundimit të arsimit. Pasi shoqata u shpërbë, disa nga anëtarët e saj morën pjesë në formimin e **Shoqatës së Re Letrare Maqedonase** (SHRLM) në vitin 1891. Ajo vazhdoi të përpikëj për arritjen e qëllimeve të Shoqatës Studentore Maqedonase.

Shoqata e Re Letrare Maqedonase në Sofje e botonte revistën **“Lloza”**. Kjo është arsyeja pse ithtarët e saj quheshin **Llozarë**. Redaktor i revistës ishte **Petar Pop Arsovi**. Llozarët në revistë përdornin drejtshkrim dhe gjuhë specifike, të ndryshme nga bullgarishtja. Në të theksoheshin disa nga veçoritë maqedonase. Qëllimi i tyre ishte që ajo të shërbente si bazë për gjuhën e ardhshme letrare të Maqedonisë. Në një nga tregimet e shkurtra të Petar Pop Arsovit, vihet re edhe një shënim i veçantë grafik i bashkëtingëlloreve të buta maqedonase (ќ, ѓ, њ, љ). Kështu, në një mënyrë shumë të aftë, u paraqit karakteri i veçantë historik dhe kulturor i Maqedonisë. Pas një kohe të shkurtër, aktivitetet e shoqërisë u ndaluan nga autoritetet bullgare.



Faqja e parë e revistës „Lloza“

E kaluara përmes burimeve



“Shoqata Maqedonase beson se atdheu i tyre është Maqedonia, se kjo e fundit është e banuar nga një fis i veçantë sllav i quajtur maqedonas, se atje janë mbledhur të gjitha llojet e elementëve të jashtëm, d.m.th. bullgarë, grekë, serbë... se qëllimi i tyre është të na japin rezistencë të fortë dhe të mbrohen nga zaptimet tona grabitqare... – gazeta zyrtare e qeverisë bullgare “Svoboda” rreth qëllimeve të Shoqatës së Re Letrare Maqedonase.

- Si i përshkroi gazeta “Svoboda” qëllimet e “Llozarëve”?

Mëso më shumë



Risia e prezantuar nga Petar Pop Arsovi ishte në mënyrën e shënimit të bashkëtingëlloreve të buta maqedonase к' (кук'а = кук'а); г' (луг'е = луѓе); н' (кон' = коњ) dhe л' (л'убов = љубов).

Dhjetë vjet më vonë, Kërste Petkov Misirkovi i shënoi këto bashkëtingëllore në të njëjtën mënyrë në librin e tij “Mbi çështjet maqedonase”. Ky libër më vonë shërbeu si bazë për standardizimin e gjuhës maqedonase.

Në vitin 1895, një grup emigrantësh maqedonas në Sofje e formuan **Komitetin Maqedonas (KM)**, i cili më vonë u riemërua në **Komiteti Vërhovist (Suprem) Maqedonas (KVM)**. Shumë nga anëtarët e kësaj organizate ishin patriotë dhe atdhedashës të sinqertë maqedonas. Megjithatë, me kalimin e kohës, shumë individë të afërt me udhëheqjen shtetërore bullgare iu bashkuan udhëheqjes së saj. Në këtë mënyrë, Komiteti Vërhovist Maqedonas u bë një instrument për realizimin e interesave bullgare në Maqedoni. Mbështetësit e Komitetit Vërhovist Maqedonas quheshin **vërhovistë**.

Pas ndalimit të Shoqatës së Re Letrare Maqedonase, nxënësit dhe studentët maqedonas në Serbi e themeluan Shoqatën e Nxënësve **“Vardar”**. Ndër anëtarët më të famshëm të kësaj shoqërie ishin **Kërste Petkov Misirkov** dhe **Dimitrija Çupovski**. Shoqata synonte ta studionte Maqedoninë nga aspekti gjeografik, historik dhe etnografik. Pas një kohe të shkurtër, aktivitetet e shoqatës u ndaluan nga autoritetet serbe.

Në fillim të shekullit XX, kurbetçinjtë dhe studentët maqedonas në Beograd e formuan **Klubin Maqedonas**. Organi jozyrtar i kësaj shoqate ishte gazeta **“Lajmëtari i Ballkanit”**. Në faqet e gazetës promovoheshin publikisht idetë e shoqatës për autonominë e Maqedonisë dhe për një gjuhë dhe kishë të veçantë maqedonase. Për shkak të këtij aktiviteti, gazeta u ndalua dhe mbështetësit e klubit u dëbuan nga Serbia. Shumica e tyre e vazhduan aktivitetet e tyre në Rusi.

Organizatrat dhe shoqatat maqedonase në vendet evropiane dhe përtej oqeanit

Nga fundi i shekullit XIX, një grup emigrantësh maqedonas në Zvicër e formuan **Komitetin e Fshehtë Revolucionar Maqedonas (KFRM)**. Ai e mbështeti çlirimin e Maqedonisë duke kryer veprime terroriste kundër objekteve me rëndësi strategjike të fuqive të mëdha në Perandorinë Osmane. Mënyra e tyre e veprimit ishte e ndikuar nga idetë e anarkizmit. Ata i shprehnin idetë e tyre në gazetën **“Hakmarrje”**. Nga ky grup më vonë dolën atentatorët e Selanikut.

Pas ndalimit të Klubit Maqedonas në Beograd, anëtarët e tij e vazhduan punën e tyre në Rusi. Në vitin 1902, ata e formuan **Shoqatën Shkencore dhe Letrare Maqedonase** me seli në Shën Petërburg. Rol kryesor në këtë shoqatë luajtën

Fjalë dhe terma të panjohur



Vërhovizëm – ideologjia e vërhovistëve bazuar në pikëpamjet bullgare mbi Maqedoninë. Edhe pse zyrtarisht mbështesnin autonominë e Maqedonisë, vërhovistët besonin se çlirimi ishte i mundshëm vetëm me ndihmën e Bullgarisë. Ata kërkonin që ta merrnin kontrollin e lëvizjes çlirimtare maqedonase dhe ta drejtonin atë në përputhje me interesat bullgare.



Kërste Petkov Misirkov në moshë të re

Fjalë dhe terma të panjohur



Anarkizëm – Ide politike sipas së cilës njerëzit mund të jetojnë pa pushtet shtetëror dhe pa sundimtarë nëpërmjet marrëveshjes dhe ndihmës së ndërsjellë. Megjithatë, kjo ide është kritikuar gjerësisht, sepse në realitet është e vështirë të ruhet rendi dhe siguria e njerëzve pa ligje dhe pushtet.



Stefan Dedov – një nga themeluesit e Klubit Maqedonas në Beograd



Mihail Gerxhikov - përfaqësuesi më i shquar i KFRM-së



Dimitrija Čupovski

Kërste Petkov Misirkov dhe **Dimitrija Čupovski**. Organi i shtypur i shoqatës ishte revista **“Zëri maqedonas”**. Shoqata angazhohej për njohjen e maqedonasve si komb i veçantë, rivendosjen e Kryepeshkopatës së Ohrit dhe përkujdesjen për veçantinë e gjuhës maqedonase.

Pas Kryengritjes së lindenit të vitit 1903, një numër i madh maqedonasish emigruan në vendet e huaja (SHBA dhe Kanada). Atje, ata filluan t’i krijonin shoqatat e tyre për të ndihmuar njëri-tjetrin. Shoqatat u formuan në **baza lokale** nga emigrantët që vinin nga i njëjti vend në Maqedoni. Ndonjëherë ata mbledhnin para që i dërgonin për të bërë ndërtime publike (çezma, ujësjellës etj.) në vendbanimet e mëparshme. Në këtë mënyrë, ata i ndihmonin bashkatdhetarët e tyre në Maqedoni.

Mëso më shumë



Shumica e emigrantëve, që mbërritën në SHBA, nuk ishin në gjendje të komunikojnin në anglisht.

Prandaj, Byroja e Imigracionit e SHBA-ve punësoi përkthyes. Ata duhej të flisnin, të lexonin dhe të shkruanin në gjuhët përkatëse. Në një listë nga viti 1911 midis përkthyesve nga gjuhë të huaja gjendet edhe një përkthyes nga maqedonishtja.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Renditi arsyet e emigrimit nga Maqedonia!
2. Cili ishte qëndrimi i autoriteteve bullgare dhe serbe ndaj organizatave maqedonase në ato vende?
3. Për çfarë angazhohej Shoqata Shkencore dhe Letrare Maqedonase në Shën Petërburg?
4. Përpiku t’i gesh ngjashmëritë dhe dallimet në aktivitetet e organizatave të ndryshme maqedonase në emigracion!

Organizata Revolucionare Maqedonase

Supozime rreth shfaqjes së Organizatës Revolucionare Maqedonase

Nga fundi i shekullit XIX, Perandoria Osmane ndodhej në një krizë të rëndë socio-ekonomike, e cila u manifestua edhe në Maqedoni. Për shkak të kësaj, popullsia kishte pakënaqësi ndaj qeverisë. Përveç kësaj, popullsia maqedonase, kryesisht ajo e krishterë, ishte e ekspozuar ndaj propagandës kishtare-arsimore që stimulohej nga vendet fqinje. Kjo, nga ana tjetër, shkaktoi përçarje dhe mosmarrëveshje midis popullsisë.

Intelektualët e rinj maqedonas, të cilët vinin kryesisht nga zonat e ekzarkisë, e kuptuan se çlirimi i Maqedonisë ishte i mundur vetëm me forcat e tyre përmes metodave revolucionare. Prandaj, shumica ishin të fiksuar pas idesë së një Organizate Revolucionare. Kjo ide ishte veçanërisht e pranishme midis njerëzve që gravitonin rreth Shoqatës së Re Letrare Maqedonase.

Formimi dhe qëllimi i Organizatës Revolucionare Maqedonase (ORM)

Nismëtari kryesor i formimit të ORM-së ishte **Damjan Gruevi**. Në verën e vitit 1893, ai u lidh me bashkëpunëtarët e tij në Selanik. Mbledhja themeluese u mbajt më **23. X** (kalendari Julian), pra më **4. XI** (kalendari Gregorian) **1893 në Selanik**. Përveç D. Gruevit, në mbledhje morën pjesë Petar Pop Arsovi, Hristo Tatarçevi, Ivan Haxhi Nikollovi, Andon Dimitrovi dhe Hristo Batanxhievi. Në këtë mbledhje nuk u morën vendime konkrete.

Themelimi ndodhi në fillim të janarit të vitit 1894. Në atë kohë, u vendos që Organizata të quhej **Organizata Revolucionare Maqedonase**. Organi më i lartë drejtues quhej **Komiteti Qendror Revolucionar Maqedonas**. Ai përbëhej nga gjashtë themeluesit. **Hristo Tatarçevi u zgjodh kryetar i Komitetit Qendror (KQ) të ORM-së**, kurse **Damjan Gruevi u zgjodh sekretar dhe arkëtar**. Qëllimi i Organizatës ishte **“autonomia politike e Maqedonisë”** në kuadër të Perandorisë Osmane. Si një mjet për ta arritur qëllimin ishte parashikuar **“kryengritja e përgjithshme”**. Në të njëjtën kohë, autonomia e Maqedonisë kuptohej si një **fazë**

Ndërlidhi njohuritë



Kujtohu për qëllimet e Shoqatës së Re Letrare Maqedonase dhe zbulo se cilët nga themeluesit e Organizatës Revolucionare Maqedonase morën pjesë në të. Gjithashtu, përpiku të zbulosh se cilat nga figurat e shquara të ORM-së, të cilat nuk ishin ndër themeluesit, gravituan në SHRLM.



Themeluesit e Organizatës Revolucionare Maqedonase



Faksimile e vulës së ORM-së me nënshkrimet e H. Tatarçevit dhe D. Gruevit

kalimtare drejt një **shteti të lirë dhe të pavarur maqedonas**. Me kalimin e kohës, motoja kryesore e Organizatës u bë slogani **“Maqedonia e maqedonasve”**.

Struktura organizative dhe përhapja e ORM-së

ORM-ja bazohej në **parimin centralist**. Organi më i lartë drejtues ishte **Komiteti Qendror**. Pastaj vinin komitetet e qarqeve, rretheve dhe së fundmi **komitetet e fshatrave**. Anëtarët e organizuar ndaheshin në dhjetëshe, të kryesura nga një udhëheqës. Anëtarët e dhjetëshes njiheshin vetëm nga anëtarët e grupit të tyre dhe udhëheqësi, por jo nga udhëheqësit më të lartë. Ata duhej të ishin të kujdesshëm për sjelljen e tyre dhe ta ruanin me përpikëri sekretin e besuar. Me anëtarësimin në Organizatë, bëhej betimi. Udhëheqja e Organizatës e praktikonte **shkrimin sekret (shifrat)**, ndërsa udhëheqësit dhe vendet më të rëndësishme kishin **pseudonime**.

Ngritja fillestare e rrjetit organizativ ishte e kujdesshme. Bërthamat bazë u krijuan nga mesi i vitit 1896. Në fillim ndaj agjitacionit u ekspozuan nxënësit nga klasat e larta, si dhe mësuesit e rinj nga rrethet e ekzarkisë. Një rol të rëndësishëm në zgjerimin e ORM-së luajtën anëtarët e sapo pranuar si: Goce Dellçevi, Pere Toshevi, Gjorçe Petrovi dhe të tjerë. Më vonë, agjitacioni u përhap edhe në bashkësitë e tjera kishtarë, pra midis patriarkëve.

Me rëndësi të veçantë për zgjerimin e platformës së ORM-së dhe rrjetit të saj ishte **Kongresi i Selanikut (1896)**. Në atë kohë, ajo u riemërua si **Organizata e Fshehtë Revolucionare Maqedonase-Odrinase (OFRMO)**. Sipas Kushtetutës së re, anëtar i organizatës mund të ishte çdo maqedonas dhe odrinas, pavarësisht nga kombësia. Organizata theksoi se do të luftonte kundër propagandës shoviniste.

Fjalë dhe terma të panjohur



Autonomi politike e Maqedonisë - Krijimi i një njësie të vetme administrative të Maqedonisë, të kryesuar nga një guvernator i krishterë. Përveç kësaj, vetëqeverisja lokale duhet të ketë autonomi në vendimmarrje për çështje me natyrë lokale, në fushën e arsimit, shpërndarjen e të ardhurave tatimore, ta marrë parasysh përfaqësimin e duhur të krishterëve në administratë, të drejtën për ta përdorur gjuhën lokale, etj.

Sfidë për hulumtim



Në ORM u përdorën pseudonime. Kështu, për Selanikun u përdor pseudonimi *Mali i Shenjtë* (Atos); për Manastirin - *Jerusalem*; për Strumicën - *Virova*, etj. Ndër personatitetet, D. Gruevi e përdorte pseudonimin *Brajan Mitrev*; Hristo Tatarçevi - *Svetomirov*; Gjorçe Petrovi - *Marko*, etj.

Bëj pak kërkime dhe zbulohet se cili ishte pseudonimi i Goce Dellçevit?

Dëshmi historike



Me kalimin e kohës, sekretin e Organizatës u dekonspirua. Ndërkohë, jozyrtarisht ajo filloi të quhej Organizata e Brendshme. Ja çfarë shkroi gazeta “Pravo” për të në vitin 1902:

“Organizata e brendshme revolucionare do t’ua bëjë të qartë të gjithëve se po punon për unitetin dhe pavarësinë e Maqedonisë si shtet i lirë në Gadishullin Ballkanik. Ajo Organizatë... nuk është agjent i asnjërit prej shteteve ballkanike, por është vetëm agjent i lirisë dhe pavarësisë maqedonase. Me prova të tilla, ajo gradualisht do t’i eliminojë dallimet fisnore në Maqedoni dhe do ta organizojë popullin maqedonas, edhe pse të larmishëm, por të aftë për vetëqeverisje në mënyrë paqësore dhe të qetë.”

Me këtë koncept qytetar, Organizata u hap ndaj të gjithë elementëve të pakënaqur me qëllim që t'i bashkonte ata rreth idesë së një Maqedonie autonome. Territori i Maqedonisë u nda në pesë qarqe revolucionare, dhe qarqet u gjashtë ndodhej në rajonin e Odrinit. Në të njëjtën kohë, u vendos të hapej një **Përfaqësi matanë kufirit** me seli në Sofje. Detyra e përfaqësuesve matanë kufirit ishte të mbledhnin ndihmë materiale midis emigrantëve maqedonas dhe qytetarëve bullgarë për kauzën çlirimtare. Si përfaqësues të parë matanë kufirit u emëruan Goce Dellçevi dhe Gjorçe Petrovi.


Formimi i çetave të ORM-së

Anëtarët e parë të armatosur të organizatës u organizuan në treshe. Ata transportonin armë, shërbenin si korrierë, por ndonjëherë i likuidonin edhe armiqtë e Organizatës. Çetat e para u shfaqën në **vitin 1897**. Me kalimin e kohës, numri i tyre filloi të rritej. Rolin kryesor në krijimin e institutit të çetave e luajti Goce Dellçevi, i cili ishte **inspektor i çetave**. Në krye të çdo çete qëndronte një **vojvodë**, i cili pranë tij kishte sekretar. Ky i fundit ishte përgjegjës për agjitacion revolucionar midis popullsisë.

Çetat luajtën një rol të rëndësishëm në zgjerimin e rrjetit të ORM-së. Ato e ngritën autoritetin e Organizatës midis popullsisë, por edhe midis armiqve të saj. Ato transportonin armë, likuidonin hajdutë dhe armiq, mbledhnin para dhe, nëse ishte e nevojshme, rrëmbenin njerëz për shpërblim. Çetat fshiheshin në male dhe fshatra dhe lëviznin, kryesisht, natën. Detyra kryesore e çetave ishte përgatitja e popullsisë për kryengritjen. Gjatë kryengritjes, ato duhej të përfaqësonin një bërthamë rreth së cilës do të mbledheshin luftëtarë të tjerë. Të drejtat dhe detyrimet e çetave përcaktoheshin me rregullore të veçanta.

Sfidat dhe rreziqet në zhvillimin e ORM-së dhe të veprimtarisë çlirimtare

Sipas qëllimit dhe metodave të veprimit të saj, ORM-ja ishte kundër rendit dhe integritetit territorial të shtetit. Aktivitetet e saj ishin të paligjshme. Prandaj, qeveria e kishte detyrimin dhe legjitimitetin për t'i persekutuar dhe ndëshkuar.



Struktura organizative e ORM-së

E kaluara përmes burimeve



Nga Kushtetuta e OFRMO-së:

Neni 1. Organizata e fshehtë revolucionare maqedonase-odrinase synon t'i bashkojë në një tërësi të gjithë elementët e pakënaqur në Maqedoni dhe Odrin, pavarësisht nga kombësia, me qëllim që nëpërmjet revolucionit, të arrijë autonomi të plotë politike për këto dy zona.

Neni 4. Anëtar i OFRMO-së mund të jetë çdo maqedonas dhe odrinas... i cili nuk është i kompromentuar nga asgjë e pandershme dhe pa karakter para shoqërisë...



Rregullorja për çetat e OFRMO-së

Gjatë ekzistencës së saj, ORM-ja shpesh përballej me autoritetet osmane. Arsyet më të zakonshme për këtë ishin aktivitetet e paligjshme. Në fillim, ORM-ja financohej vetë nëpërmjet tarifave të anëtarësimit dhe kontributeve vullnetare. Kur nevojat financiare u rritën, ajo filloi të përdorte kërcënime dhe madje edhe rrëmbime për shpengim. Në situata të tilla, shpesh kishte bastisje, gjatë të cilave shumë u burgosën. Disa afëra dhe bastisje u shkaktuan nga zbulime aksidentale të armëve, letrave, tradhtive etj.

Përveç kësaj, ORM-ja haste në pengesa nga institucionet e propagandës së vendeve fqinje. Prandaj, ajo u përpoq të konfrontohej me përfaqësuesit e tyre. Organizata nuk toleronte organizata të tjera në territorin e Maqedonisë dhe shpesh konfrontohej me to. Në mënyrë të ngjashme vepronte edhe me organizatat e jashtme që përpiqeshin të depërtonin në Maqedoni.

Vendi, roli dhe rëndësia e ORM-së

ORM-ja zë një vend të rëndësishëm në historinë e popullit maqedonas dhe të luftës së tij për shtetin e vet. Me institucionet dhe ndikimin që e kishte, ajo përfaqësonte pushtet paralel. Prandaj, shpesh trajtohej si “shtet brenda shtetit”, ose siç quhet edhe ndryshe, një “Republikë nëntokësore”. Arritjet e saj më të larta ishin Kryengritja e Ilindenit dhe Republika e Krushevës.



Misionarja amerikane Miss Stone – rrëmbimi më i famshëm për shpagim (Ilustrim nga viti 1902)



Vula e Komitetit Revolucionar të Qarkut të Selanikut

E kaluara në të tashmen



Në himnin maqedonas përmenden deri në katër emra nga periudha e Ilindenit. Gjithashtu, institucione të ndryshme në vend mbajnë emra të veprimtarëve nga gjenerata e Ilindenit. Seanca e parë e KAÇKM-së u mbajt më 2 gusht.

Përpiqu të shpjegosh pse kjo ngjarje ndodhi në atë kohë? Dhe pse disa njësi partizane gjatë LNÇ-së mbanin emra të figurave nga periudha e Ilindenit?



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Cili ishte qëllimi i ORM-së dhe me çfarë mjete u përpoq ta arrinte atë?
2. Renditi vendimet më të rëndësishme të Kongresit të Selanikut të vitit 1896.
3. Cili ishte roli i çetave të ORM-së?

Veprimtarë të shquar të Organizatës Revolucionare Maqedonase

Damjan (Dame) Gruev (1871-1906)

Dame Gruevi lindi në Smilevë. Babai i tij ishte murator, dhe nëna e tij vdiq kur ai ishte i ri. Ai u shkollua në Smilevë, Manastir, Selanik, Beograd (Mbretëria e Serbisë) dhe Sofje (Principata e Bullgarisë). Në Sofje, ai studioi histori në shkollën e lartë, por nuk u diplomua. Ai ishte aktiv në Shoqatën e Studentëve Maqedonas, nga e cila doli më vonë SHRLM-ja.

Punoi si mësues, në një shtypshkronjë dhe si inspektor shkolle. D. Gruevi **ishte nismëtari kryesor për formimin e ORM-së**. Ai i formoi komitetet e para në brendësi të Maqedonisë. Zotëronte **aftësi të larta organizative**. Ishte **agjikator i flaktë** dhe afrohej lehtësisht me njerëz nga shtresa të ndryshme, duke kontribuar kështu në përhapjen e kauzës çlirimtare.

Përveç kësaj, Gruevi ishte një **udhëheqës i shquar dhe pragmatik** i ORM-së. Ai mori pjesë dhe i kryesoi punimet e disa kongreseve, si dhe në marrjen e vendimeve më të rëndësishme të Organizatës. Për shkak të aktivitetit të tij revolucionar, ai u dënua me dhjetë vjet burg, por vazhdoi të **jepte udhëzime edhe nga burgu**. Ai ishte amnistuar.

Si anëtar i **Shtabit të Përgjithshëm**, luajti rol kyç gjatë Kryengritjes së Ilindenit. Ai dha disa intervista për gazetarë të huaj, përfshirë ata rusë dhe amerikanë, duke e afirmuar kështu luftën e ORM-së për autonominë e Maqedonisë. Ai ra në betejë me ndjekësit osmanë pranë fshatit Rusinovë, rajoni i Berovës. Emri i tij është i lidhur pazgjidhshmërisht me Organizatën që nga krijimi i saj deri në vdekjen e tij. Gjatë Kryengritjes së Ilindenit, në kushte maqedonase, ai e riafirmoi moton prusiane nga koha e Luftërave të Napoleonit: **“Më mirë një fund i tmerrshëm sesa një tmerr i pafund”**.

Petar Pop Arsov (1868-1941)

Petar Pop Arsovi lindi në fshatin Bogomillë në një familje me traditë priftërore. Ai u shkollua në Bogomillë, Veles, Selanik, Beograd (Mbretëria e Serbisë) dhe Sofje (Principata e Bullgarisë). Gjatë shkollimit të tij ai pati mundësinë që t'i kuptojë pikëpamjet e jashtme ndaj Maqedonisë.



Damjan Gruev

Dëshmi historike



“Gruevi është maqedonas me origjinë dhe vazhdimisht jeton në Maqedoni; ai ka ardhur këtu (Sofje) një muaj më parë për të trajtuar një plagë që mori në një përleshje aksidentale me trupat turke. Ai tani është pothuajse i shëruar dhe duket se së shpejti do të kthehet në Maqedoni. Ka ndikim të madh, jo vetëm në Maqedoni, por tek ai mbështeten edhe qeveritë serbe dhe bullgare. Qeveria turke e ka vlerësuar kokën e tij në 5,000 lira turke. Z. Gruev është një burrë relativisht i ri, me pamje të bukur biblike; gjendja e tij shpirtërore është e qëndrueshme dhe me humor... është e qartë se stuhitë dhe shqetësimet e vazhdueshme të jetës nuk e kanë thyer këtë natyrë.”

K. Barbenko, korrespondent i “Novoe Vremja” për D. Gruevin, 1906.

Ai u diplomua në Shkollën e Lartë të Sofjes me diplomë në degën e filologjisë. Forca e tij qëndron në fjalën e shkruar. Tipari i tij dallues është kapela.

Petar P. Arsovi e dëshmoi veten si **revolucionar, ideolog, publicist dhe filolog**. Që në moshë të re, ai luajti një rol të rëndësishëm në SHRLM, ku ishte redaktor i **revistës “Lloza”**.

Petar P. Arsovi ishte ndër gjashtë themeluesit e ORM-së. Ai i përgatiti dokumentet e para të Organizatës. Me urdhër të Komitetit Qendror, ai botoi një broshurë përmes së cilës i ekspozoi qëllimet e propagandës bullgare në Maqedoni. Ishte anëtar i Komitetit Qendror të ORM-së, udhëheqës i qarkut, si dhe përfaqësues matanë kufirit.

Veçanërisht është e njohur motoja e tij: **“Kushdo që do të na e japë lirinë nga jashtë do të na e marrë vendin”**. Për shkak të aktiviteteve të tij revolucionare, ai **u dënua me 101 vjet burg**, por më vonë **u amnistua**. Si intelektual, ai e njihte fuqinë propagandistike të institucioneve kishtar-arsimore. Për këtë arsye, ai e mbështeste hapjen e një Shkolle të Lartë Pedagogjike në Shkup, me statusin e një fakulteti shtetëror. Petar P. Arsovi ishte një kundërshtar i ashpër i ndarjes së Maqedonisë. Sipas tij, edhe nëse Maqedonia nuk do të ekzistonte, diplomacia duhej ta kishte krijuar atë për të mirën e Ballkanit. Ai vdiq në Sofje në vitin 1941.

Ndërlidhi njohuritë



Kujtohu se cilat ishin qëllimet e SHRLM-së dhe për çfarë është karakteristike revista “Lloza”?

Kujtoni se çfarë risish drejtshkrimore takohen në tregimin e Petar P. Arsovit!



Petar Pop Arsov

Goce (Gjorgji) Dellçev (1872-1903)

Goce Dellçevi lindi në Kukush në një familje të klasës së mesme me shumë fëmijë. Ai u shkollua në vendlindje, në Selanik (gjimnazin e ekzarkisë) dhe në Sofje, ku u diplomua në Shkollën Ushtarake Princorë. Ai nuk e mori gradën e oficerit sepse u kap duke lexuar libra me përmbajtje socialiste, të cilat ishin të ndaluara.

Në radhët e ORM-së u përfshi personalisht nga Dame Gruevi në Shtip (1894). Dellçevi në një kohë të shkurtër tregoi **aftësi të jashtëzakonshme organizative dhe agjitu-ese**. Përveç kësaj, ai e dëshmoi veten si ideolog i idesë çlirimtare maqedonase. Për shkak të kësaj, ai fitoi respekt të jashtëzakonshëm, si në Organizatë ashtu edhe në popull. Së bashku me Gj. Petrovin, ai e hartoi Kushtetutën dhe Rregulloren e Punës së OFRMO-së. Ishte anëtar i Komitetit Qendror, përfaqësues matanë kufirit dhe **inspektor i çetave të OFRMO-së**.



Goce Dellçev

Ai është një **promovues i gjykatave organizative**. I këshillonte fshatarët që të mos shkonin në gjykatat turke, por t'i zgjidhnin vetë problemet e tyre para gjykatave organizative. G. Dellçevi e mbështeste **“revolucionin moral”**, domethënë revolucionin në mendje. Sipas tij, skllavi do të pushojë së qeni skllav pasi ta çlirojë mendjen e tij. Dellçevi i kundërshtoi me ashpërsi të gjitha përpjekjet për ndikim të jashtëm në veprimtarinë çlirimtare maqedonase.

Dellçevi ishte organizatori i punishtes së parë ilegale për prodhimin e bombave për nevojat e Organizatës. Si inspektor i çetave, ai shpesh ndërmernte udhëtime nëpër Maqedoni dhe Odrin, pavarësisht nga shëndeti i tij i ligë. Rrugëtimi i tij më i gjatë nëpër Maqedoni zgjati nga vjeshta e vitit 1901 deri në pranverën e vitit 1902. Njihet si **Fushata e Madhe**. Vdiq më 4 maj të vitit 1903, në përleshje me ushtritë osmane në fshatin Banicë (Ser). Për shkak të aktivitetit të tij të palodhur, singëritetit, ndershmërisë dhe përkushtimit ndaj kauzës së çlirimit, ai u pranua si **apostull i idesë çlirimtare maqedonase**.

Gjorçe Petrov (1865-1921)

Gjorçe Petrovi lindi në Varosh të Prilepit, në një familje të vogël tregtare. Ai u shkollua në Prilep dhe në gjimnazin e ekzarkisë në Selanik. U përjashtua që andej për pjesëmarrje në revoltën e nxënësve. Arsimin e tij e përfundoi në Plovdiv (Rumelia Lindore).

Edhe pse iu bashkua ORM-së pas krijimit të saj, ai u ngrit shpejt në radhët e saj. Ishte anëtar i Komitetit Qendror dhe përfaqësues matanë kufirit. Së bashku me G. Dellçevin, ai e përgatiti Kushtetutën dhe Rregulloren e OFRMO-së. Falë aftësive të tij në bindje, ai pati ndikim të konsiderueshëm midis esnafëve dhe qytetarëve.

Gjorçe Petrovi shquhet si **ideolog dhe teoricien** i lëvizjes çlirimtare maqedonase. Ai zotëronte **cilësi diplomatike** dhe dallohej për qasjen e tij analitike. Kjo është arsyeja pse ai nga rrethet e udhëheqësve vërvohistë quhej **“dinaku maqedonas”**. Si demokrat me bindje, ai e mbështeti demokratizimin dhe decentralizimin e Organizatës.

Gjorçe Petrovi ishte mbështetës i tezës së një kryengritjeje të përhershme, në vend të një kryengritjeje

E kaluara përmes burimeve



“Çlirimi i Maqedonisë qëndron në kryengritjen e brendshme. Kushdo që mendon se Maqedonia do të çlirohet në ndonjë mënyrë tjetër, po e mashtron veten dhe të tjerët... Nëse një kryengritje do të bëhej me 1-40 vetë, atëherë Maqedonia do të kishte qenë një shtet i lirë shumë kohë më parë... Duhet që ky popull të zgjohej nga gjumi i thellë pesëshekullor, i cili e ka bërë maqedonasin mjaft injorant për të drejtat e njeriut.”

Nga letra e G. Dellçevit drejtuar Efremit Karanovit, 1895

Trashëgimi për brezat



Goce Dellçevi, relativisht herët hyri në panteonin e heronjve kombëtarë maqedonas. Në këtë frymë, “Gazeta e Goces” botuar nga Vëllazëria Bamiçë e Kukushit në Sofje, në vitin 1937, ndër të tjera, shkruante:

“Është një detyrë e shenjtë për popullin maqedonas dhe për emigracionin që çdo vit ta përkujtojnë heroin e paharrueshëm kombëtar maqedonas Goce Dellçev dhe plejadën e luftëtarëve revolucionarë... Në këtë mënyrë, do ta shprehim respektin dhe mirënjohjen tonë ndaj mësuesit tonë besnik dhe të përkushtuar dhe ndaj luftëtarëve të panumërt që ia kushtuan rininë dhe e dhanë jetën e tyre për Maqedoninë.”



Gjorçe Petrov

të përgjithshme masive. Kështu, ai besonte se çështja maqedonase mund të mbahej e hapur për diplomacinë evropiane për një periudhë më të gjatë kohore. Gjatë Kryengritjes së Ilindenit, ai mori pjesë me një çetë në Qarkun Revolucionar të Manastirit.

Si teoricien dhe publicist, ai shkroi disa studime mbi lëvizjen çlirimtare maqedonase. Gjithashtu, la pas edhe kujtime të vlefshme që janë një burim i rëndësishëm për historinë e lëvizjes çlirimtare maqedonase. U vra në Sofje nga vrasës me pagesë.

Pere Toshev (1865-1912)

Pere Toshevi lindi në Prilep në një familje të pasur. Ai u shkollua në Prilep dhe në gjimnazin e ekzarkisë në Selanik, nga i cili u përjashtua për pjesëmarrje në revoltën e nxënësve. Gjimnazin e mbaroi në Plovdiv (Rumelia Lindore).

Ai dha mësim në disa vende në Maqedoni. Ishte ndër **themeluesit e komiteteve të para të ORM-së në Qarkun Revolucionar të Manastirit** (1894). Menjëherë pas kësaj, u bë anëtar i Komitetit Qendror. Nga natyra, ishte **i qetë, modest dhe i ndrojtur, me karakter dhe vullnet të fortë**, por kurrë nuk e impononte veten. Në fillim, ai besonte më shumë në fuqinë e bombave dhe dinamitit, sesa në forcën e popullit të organizuar.

Për shkak të aktivitetit të tij revolucionar, ai u dënua me 101 vjet burg, por shpejt pas kësaj u amnistua. Mori pjesë në punimet e disa kongreseve të organizatës. Gjatë Kryengritjes së Ilindenit, ishte aktiv në rajonin e Mariovës. Ishte një **mbështetës i shquar i demokratizimit** dhe decentralizimit të Organizatës Revolucionare. Përveç kësaj, ai e mbështeti futjen e arsimit të detyrueshëm fillor, si dhe ngritjen e nivelit ekonomik dhe kulturor të popullsisë. Vdiq më 4 maj 1912 në Grykën e Drenovës.

Jane Sandanski (1872-1915)

Jane Sandanski lindi në fshatin Vllahi, Mellnik. Babai i tij ishte flamurtar në Kryengritjen Maqedonase. Shpejt familja e tij emigroi në Dupnicë (Principata e Bullgarisë).

Ai u përfshi në lëvizjen maqedonase nëpërmjet Komitetit Suprem Maqedonas (KSM). Pasi i vuri re intrigat e KSM-së me lëvizjen çlirimtare maqedonase, nën ndikimin



Pere Toshev



Jane Sandanski

e Goce Dellçevit, u bashkua me OFRMO-në. Që atëherë, u bë **kundërshtar i ashpër i vërhovistëve dhe luftëtar i papur për autonominë dhe pavarësinë e lëvizjes çlirimtare maqedonase dhe të Maqedonisë.**

Sandanski ishte udhëheqës dhe autoritet i padiskutueshëm në Qarkun Revolucionar të Serit. Ai u bë veçanërisht i famshëm pas rrëmbimit të misionares protestante amerikane **Miss Stone**. Kjo çështje kontribuoi në përhapjen e së vërtetës rreth veprimtarisë çlirimtare maqedonase në SHBA.

Sandanski ishte i guximshëm dhe i vendosur në luftë, si kundër osmanëve ashtu edhe kundër armiqve të Organizatës. Me çetën e tij ai mori pjesë në fushatën kundër Stambollit gjatë shtypjes së kundër-grushtit të shtetit (1909). U vra në një pritë në malin Pirin. Ai ishte i respektuar nga populli për bëmat e tij, prandaj këndohet në shumë këngë popullore. Për shkak të autoritetit të tij, ai njihet edhe si **“Cari i Pirinit”**.

Mëso më shumë



Jane Sandanski shpesh i sfidonte vërhovistët në debate publike para popullsisë. Gjatë një debati të tillë, ai theksoi: *“Ne iu kundërvumë me vendosmëri oficerëve Tuaj, sepse e dinim edukimin e tyre... Ata janë njerëz që i janë betuar për besnikëri princit bullgar dhe shtetit bullgar, prandaj nuk mund të jenë asgjë tjetër përveç veglave të tyre të verbëra dhe të bindura. Dhe, nga ana tjetër, ne nuk duam ta zëvendësojmë tiraninë turke dhe sulltanët turq me të tjerë si ata, madje as me tiraninë bullgare dhe princin bullgar. Ne duam që Maqedonia të jetë autonome, e pavarur, e lirë, Maqedonia e maqedonasve... Ju e doni autonominë e Maqedonisë si mjet, si një etapë për pushtim dhe aneksim të ardhshëm, ndërsa tek ne liria, autonomia është vendosur si qëllim. Këtu qëndron dallimi i madh midis nesh të Brendshmeve dhe jush - Vërhovistëve.”*



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Çfarë kupton me moton „Më mirë një fund i tmerrshëm, sesa një tmerr i pafund“? Cila është lidhja e saj me sloganin „Liri ose vdekje“?
2. Krahoso dhe shpjego se çfarë mesazhi përcjellin deklaratat „Kushdo që do të na e japë lirinë nga jashtë, do të na e marrë vendin“ dhe „Çlirimi i Maqedonisë qëndron në kryengritjen e brendshme“?
3. Bazuar në tekstin nga seksioni „Mëso më shumë“, shpjegoje ndryshimin në kuptimin e autonomisë së Maqedonisë midis vërhovistëve dhe mbështetësve të OFRMO-së!

Kryengritja e Ilindenit

Shkaqet e kryengritjes

Tashmë e dini se Organizata Revolucionare aspironte dhe përgatitej të arrinte autonomi politike për Maqedoninë nëpërmjet një kryengritjeje të përgjithshme. Në më pak se një dekadë, Organizata arriti t'i krijonte njësitë e veta, shërbimin e korrierëve, të siguronte sasi të caktuara armësh, si dhe ta ngrinte moralin e një pjese të popullsisë. Për shkak të kësaj, autoritetet ndërmorën masa të ndryshme për ndjekjeje. Kjo e rriti pakënaqësinë e popullsisë, por edhe padurimin e disa udhëheqësve dhe vojqodëve për ta filluar kryengritjen.

Situata u bë veçanërisht e tensionuar pas **provokimit të vërhovistëve për kryengritje** në vitin 1902. Përveç kësaj, vërhovistët kërcënuan se pranverën e ardhshme (1903) ata do të rihynin në Maqedoni. Kjo përbënte rrezik për shkretime dhe rajoneve të reja, humbjen e armëve të mbledhura me shumë mund, por edhe për demoralizimin e popullsisë. Nga ana tjetër, në qarqet diplomatike tashmë flitej për reforma në Maqedoni.

Në rrethana të tilla, nga fundi i vitit 1902, në OFRMO u ngrit çështja e kryengritjes për pranverën e ardhshme (1903). Kjo ide u mbështet veçanërisht nga kryetari i Komitetit Qendror të OFRMO-së - **Ivan Garvanov**, si dhe kryetari i Qarkut të Manastirit - **Anastas Lozancev**.

Kongresi i janarit në Selanik dhe Çështja e Kryengritjes së vitit 1903

Me iniciativën e Komitetit të Qarkut të Manastirit dhe me kërkesën e Ivan Garvanovit, në mesin e **janarit të vitit 1903** u mbajt një kongres në Selanik. Në atë kohë, u mor vendimi për **kryengritje të përgjithshme**, pa e specifikuar kohën e saktë të fillimit të saj. Argumentet kryesore për këtë vendim ishin: situata e padurueshme, veçanërisht në rajonin e Manastirit; rreziku i një provokimi të ri nga vërhovistët; situata ndërkombëtare gjoja e favorshme si dhe disa premtime për ndihmë të mundshme nga Bullgaria. Në këtë kongres nuk mori pjesë asnjë nga veprimtarët e shquar të Organizatës.

Në të njëjtën kohë, **në Sofje u mbajtën disa ditë konsultime mbi çështjen e kryengritjes**. Në to morën pjesë: G. De-



Ivan Garvanov



Mësueset që e qëndisën flamurin e kryengritjes të Shtabit të Përgjithshëm

llçev, Gj. Petrov, H. Tatarçev dhe figura të tjera të shquara. Mendimi mbizotërues ishte se në vend të një kryengritjeje të përgjithshme, siç ishte vendosur nga Komiteti Qendror, do të ishte më mirë të intensifikoheshin aktivitetet e çeta-ve, të cilat do të pasoheshin nga veprime me dinamit, pa e tërhequr popullsinë në kryengritje masive. Në këtë mënyrë, do të arrihej një **kryengritje e përhershme**, pa u shpallur zyrtarisht. Në fund, të gjithë ranë dakord që kryengritja duhet të kishte **karakter partizan**. Ndërkohë, që po e promovonte konceptin e tij për kryengritje, Goce Dellçev e humbi jetën në fshatin Banicë.

Atentatet e Selanikut

Në mes të përgatitjeve për kryengritjen, **nga fundi i prillit të vitit 1903**, bënë jehonë **atentatet e Selanikut**. Ato ishin vepër e disa idealistëve të rinj, të cilët e quanin veten **gjëmixinj**. Ata nuk besonin në fuqinë e popullit të organizuar, por besonin se me vetëmohim individual mund të arrinin efekte më të mëdha. Gjëmixinjtë besonin se nëpërmjet atentateve me dinamit mbi objekte në të cilat ishte investuar kapitali evropian, ata do ta tërhiqnin vëmendjen e fuqive evropiane në favor të Maqedonisë.

Gjëmixinjtë kryen disa sulme ndaj ndërtesave publike. Midis tyre, spikatin djegia e vaborit francez **Guadalkivir** dhe ngritja në ajër e **Bankës Osmane** në Selanik, nën themelet e së cilës ishte vendosur paraprakisht eksploziv. Disa nga gjëmixinjtë vdiqën në përleshje me ushtrinë, disa kryen vetëvrasje dhe të tjerë u kapën dhe u dënuan. Në të njëjtën kohë, autoritetet osmane kryen reprezalje të ashpra kundër popullsisë civile.



Guadalkiviri në flakë



Ndërhyrja e ushtrisë gjatë atentateve të Selanikut

Mëso më shumë



Shpërthimi në Guadalkivir u shkaktua nga Pavel Shatev, i cili hipi në anije me pasaportë me një emër tjetër. Anija u dogj plotësisht, por të gjithë pasagjerët shpëtuan. Të nesërmen, P. Shatev u kap në stacionin hekurudhor në Shkup. Prej andej, ai u kthye në Selanik dhe u soll në gjykatë. Gjatë gjyqit, babai i tij u soll nga Kratova për ta konfirmuar identitetin e të birit. Megjithatë, Shatevi pretendonte se nuk e njihte burrin dhe se ai nuk ishte Pavli, por Gjorgji Manas-kov, pra personi, emri i të cilit ishte në pasaportë. Ai u dënua me burgim të përjetshëm, por më vonë u amnistua.

Lajmi për atentatet e Selanikut bëri jehonë në të gjithë botën, por nga ana tjetër, ato e ndërlikuan më tej situatën në Maqedoni duke e intensifikuar frymën kryengritëse.

Përgatitjet për kryengritjen dhe Kongresi i Smilevës

Nga fundi i janarit të vitit 1903, çetat filluan të hynin me shpejtësi në Maqedoni, kryesisht nga Principata e Bullgarisë. Ato mbanin me vete sasi të konsiderueshme armësh dhe mjedesh shpërthyes. Në Maqedoni u formuan trupa të reja dhe përbërja e atyre ekzistuese u rrit. Kurbetçinjtë filluan të ktheheshin për të marrë pjesë në kryengritje. U hartua një plan për kryengritjen, sipas të cilit ajo do të kishte karakter partizan. Theksohej se **qëllimi nuk ishte që kryengritësit t'i mposhtnin osmanët, por të mos lejonin që ata të mposhteshin**. Qëllimi ishte që kryengritja të zgjaste më shumë, me qëllim që të provokohej ndërhyrja e Fuqive të Mëdha.

Gjatë këtyre përgatitjeve, në fillim të majit të vitit 1903 u mbajt **Kongresi i Smilevës**. Ai u kryesua nga Damjan Gruevi. Vendimet e këtij kongresi vlenin kryesisht për Qarkun Revolucionar të Manastirit. Kongresi e zgjodhi një **Shtab të Përgjithshëm (SHP)**, i cili **do ta udhëhiqte kryengritjen. Në të përfshiheshin: Dame Gruev, Anastas Lozançev dhe Boris Sarafov**. Në të njëjtën kohë, u hartua Kushtetuta Disiplinore Kryengritëse.



Muzeu memorial i Kongresit të Smilevës



Flamuri kryengritës i rrethinës së Ohrit



Shtabi i Përgjithshëm i Kryengritjes: Damjan Gruev, Anastas Lozançev dhe Boris Sarafov

Me të ishin rregulluar të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë pjesëmarrësve në kryengritje. Kongresi vendosi t'i përshpejtojë përgatitjet në drejtim të mbledhjes së armëve, municioneve, veshmbathjeve, ilaçeve, prodhimit të flamujve etj. Kongresi e ndaloi çfarëdo lloj dhune kundër popullsisë civile myslimane. Shtabi i Përgjithshëm, bazuar në autorizimin e marrë nga Kongresi, më vonë vendosi ta fillonte kryengritjen në festën e Shën Ilias, natën e 2 gushtit në të gdhirë të 3 gushtit. Kjo është arsyeja pse quhet Kryengritja e Ilindenit.

Kryengritja e Ilindenit në Qarkun Revolucionar të Manastirit

Fillimi i kryengritjes u njoftua me një Proklamata të veçantë nga Shtabi i Përgjithshëm, ndërsa data e fillimit u mbajt sekret deri në momentin e fundit.

Në mbrëmjen e 2 gushtit të vitit 1903, u njoftua fillimi i kryengritjes. Ajo filloi me ndezjen e zjarreve të mëdha të kryengritësve, rënien e kabanave, ndërprerjen e linjave telefonike dhe telegrafike, shenjtërimin e flamujve kryengritës, fjalimet revolucionare dhe sulmet ndaj zonave të populluara. **Qendra e kryengritësve ndodhej në fshatin Smilevë.** Ai u çlirua dhe u organizua një qeveri kryengritëse, që zgjati rreth njëzet ditë. Së shpejti u çlirua **Krusheva**. Kryengritësit arritën, gjithashtu, suksese të konsiderueshme në rajonet e Kosturit dhe Follorinës. Në këtë rajon, u çliruan qytetet e **Klisurës** dhe **Neveskës**. Luftime të ashpra u zhvilluan në rajonet e Ohrit, Prespës, Kërçovës dhe Demir Hisarit.

Në Qarkun Revolucionar të Manastirit, në shumë vende **popullsia iu bashkua kryengritësve në mënyrë masive.** Kjo e bëri situatën e luftëtarëve më të vështirë, pasi ata duhej të kujdeseshin për sigurinë e popullsisë civile. Prandaj, u organizuan të ashtuquajturat **strehime**. Në Qarkun Revolucionar të Manastirit, gjatë dhjetë ditëve të para, kryengritësit patën iniciativë të konsiderueshme në terren. Ata çliruan disa zona të populluara, ndërsa në disa rajone dominimi i kryengritësve u ndje për më shumë se njëzet ditë.

E kaluara përmes burimeve



Nga proklamata e Shtabit të Përgjithshëm për shpërthimin e kryengritjes:

"Vëllezër, më në fund erdhi dita që e kemi pritur kaq gjatë për t'u përballur me armikun tonë shekullor... Mjaft më me këto mundime, mjaft me këtë turp! Një mijë herë më mirë vdekje, sesa një jetë e turpshme dhe mizore. Dita e caktuar, në të cilën populli i të gjithë Maqedonisë dhe i Odrinit do të duhet të dalë publikisht me armë në dorë kundër armiqve, është 20 korriku i vitit 1903."

Data 20 korrik është sipas kalendarit Julian. Mendo dhe përgjigjuni se cilës date në kalendarin Gregorian i korrespondon?

Fjalë dhe terma të panjohur



Strehime - Vende të vështira për t'u arritur në rajonet malore, ku fshihej popullsia civile e paaftë për luftë (gra, fëmijë, të moshuar). Në to ishte organizuar ushqimi për popullsinë. Gjatë shtypjes së kryengritjes, ushtritë osmane kryen masakra brutale, kur hasën në strehime të tilla.



Çetat e bashkuara të Kosturit (vitit 1903)

Aktivitetet kryengritëse në qarqet e tjera revolucionare

Ndryshe nga qarku i Manastirit, në qarqet revolucionare të Shkupit, Selanikut dhe Strumicës nuk u mbajtën kongrese qarkore, as nuk ndodhi ndonjë kryengritje masive. Në këto zona, aktiviteti i çetave u intensifikua, gjë që e lehtësoi pjesërisht pozicionin e kryengritësve në qarkun e Manastirit. Në të njëjtën kohë, në hekurudhën Selanik-Shkup u kryen disa aksione sabotimi, të cilat e penguan transportin e ushtrive osmane. Përleshje më të rëndësishme midis çetave dhe ushtrive u zhvilluan në zonën midis Kukushit, Gjevgjelisë dhe Enixhe Vardarit.

Në Qarkun Revolucionar të Serit u mbajt një kongres, në të cilin u vendos që kryengritja atje të fillonte në **festën e Lartësimit të Kryqit të Shenjtë** (27 shtator). Gjatë aktiviteteve kryengritëse në këtë rreth, ndodhi një **pajtim i përkohshëm** midis njësive të OFRMO-së dhe vërhovistëve. Në të njëjtën kohë, luftime më të ashpra u zhvilluan në zonat e Nevrokopit dhe Razlovit.

Dëshmi historike



Henri N. Breilsford, i cili pas Kryengritjes së Ilindenit qëndroi në Maqedoni si udhëheqës i një misioni humanitar, për Kryengritjen shkruan:

“Kryengritja e vitit 1903 ishte shumë më tepër, sesa një lëvizje aktive ushtarake. Ishte një demonstratë masive, në të cilën mori pjesë e gjithë popullsia sllave, burra, gra dhe fëmijë. Kryengritja ishte vërtet një lëvizje shumë e pastër maqedonase, e përgatitur nga maqedonasit, e drejtuar prej tyre dhe e mbështetur nga simpatia e zjarrtë e popullsisë sllave. Surpriza e parë për mua ishte se kjo popullsi u ngrit me armë dhe u ngrit në mënyrë masive.”



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Renditi arsyet e Kryengritjes së Ilindenit!
2. Cilat ishin argumentet e Komitetit Qendror gjatë marrjes së vendimit për kryengritje?
3. Pse gjemixhinjtë i drejtuan veprimet e tyre kundër kapitalit të huaj në Maqedoninë Osmane?
4. Renditi vendimet më të rëndësishme të Kongresit të Smilevës!
5. Çfarë shihni si ndryshim midis kryengritjes në rrethin e Manastirit krahasuar me rrethet e tjera në Maqedoni?

Republika e Krushevës

Përgatitjet për kryengritje dhe çlirimi i Krushevës

Në Qarkun Revolucionar të Manastirit, suksesi më i rëndësishëm i kryengritësve ishte **çlirimi i Krushevës**. Kjo u dedikohet përgatitjeve serioze, terrenit malor, numrit të madh të kryengritësve dhe vendosmërisë së udhëheqjes së atjeshme. Përgatitjet u udhëhoqën nga e ashtuquajtura **Kryesia e maleve**, e drejtuar nga **Nikolla Karev**.

Kryesia e maleve e Krushevës e organizoi mbledhjen e armëve, municioneve, veshmbathjeve, ushqimit dhe ilaçeve. Për luftëtarët e rinj u organizuan ushtrime stërvitore në përdorimin e armëve dhe njohuritë bazë të aftësive ushtarake. Njëkohësisht, u hartua një plan i detajuar për sulmin dhe çlirimin e Krushevës. Për këtë qëllim, u angazhuan rreth **800 kryengritës**.

Sulmi ndaj Krushevës filloi në mbrëmjen e **2 gushtit në të gdhirë të 3 gushtit të vitit 1903**. Fillimi i kryengritjes u shënua simbolikisht nga rënia e kabanave. Sulmi u drejtua ndaj objekteve kryesore osmane, siç ishin kazerma, komuna dhe posta. Beteja më e ashpër dhe më e gjatë ishte për kazermën. Pasditën e **3 gushtit, Krusheva ishte e lirë**. Kryengritësit, me flamujt e tyre të valëvitur, marshuan triumfalisht nëpër qytet, ku popullsia i priti me entuziazëm. Përpjekjet fillestare osmane për ta rimarrë qytetin u zbrapsën.

Republika e Krushevës

Pas çlirimit të Krushevës, në qytet u organizua **pushteti i përkohshëm kryengritës**, i njohur si **Republika e Krushevës**.

Ideologu dhe organizatori i Republikës së Krushevës ishte Nikolla Karev. Organi më i lartë i pushtetit civil ishte **Këshilli i Republikës**. Ai përbëhej nga 60 anëtarë (20 nga secila bashkësi etnike). Këshilli zgjodhi një **Qeveri të Përkohshme** prej 6 anëtarësh, të kryesuar nga Dinu Vangjeli. Ata ishin përgjegjës për sigurimin e qetësisë dhe rendit, gjyqësorin, sigurimin e ushqimit për kryengritë-



Kryesia e maleve e Krushevës

Mëso më shumë



Për zhvillimin me sukses të kryengritjes, Kongresi i Smilevës vendosi që Qarku i Manastirit të ndahej në dhjetë rrethe revolucionare. Për secilin rreth, u zgjodh një udhëheqje e veçantë, e ashtuquajtur **Kryesia e maleve**, e përbërë nga disa anëtarë. Ata ishin përgjegjës për menaxhimin e përgatitjeve për kryengritjen, si dhe të vetë kryengritjes. Kryesitë e maleve ishin në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të Qarkut Revolucionar të Manastirit.



Nikolla Karev

sit shërbimet sanitare etj. Në qytet u hap një punishte për riparimin e armëve dhe mbushjen e fishekëve. Për ta mbrojtur qytetin, u hapën llogore dhe u ndërtuan fortifikime, si dhe u bënë disa **topa prej qershie**. Autoriteti ushtarak përfaqësohej nga **Kryesia e maleve - Shtabi**. Ajo ndodhej në zonën e **Gumenjës**, nga ku kishte pamje mbi qytetin dhe rrethinën më të gjerë.

Për ta neutralizuar dhe për ta fituar mbështetjen e myslimanëve nga fshatrat përreth, atyre iu dërgua një Proklamata, e njohur si **"Manifesti i Krushevës"**. Ishte një lloj deklarate e qëllimeve të kryengritjes dhe një thirrje drejtuar myslimanëve, nëse nuk mund ta mbështesnin hapur luftën për autonominë e Maqedonisë, të paktën të mos e pengonin atë.

E kaluara përmes burimeve

"Ejani, vëllezër myslimanë, tek ne, le të shkojmë kundër armiqve tanë dhe tuaj! Ejani nën flamurin e Maqedonisë Autonome! Maqedonia është nëna jonë e përbashkët dhe thërret për ndihmë... Nëse edhe ju na keni si vëllezërit tuaj, ... nëse doni të jetoni përsëri me ne, siç keni jetuar deri më tani dhe nëse jeni bij besnikë dhe të denjë të nënës Maqedoni, mund të na ndihmoni vetëm me një gjë - dhe kjo është një ndihmë e madhe: të mos bashkohemi me armiqet, të mos na dilni kundër me armë dhe të mos ushtroni dhunë në fshatrat e krishtera!"

Nga Manifesti i Krushevës

Fundi i Republikës së Krushevës dhe shtypja e Kryengritjes së Ilindenit

Autoritetet osmane reaguesh për gjatë shtypjes së Kryengritjes së Ilindenit. Qëllimi ishte që kryengritja të shtypej sa më shpejt të ishte e mundur, në mënyrë që ajo të mos shndërrohej në luftë guerile afatgjatë. Me këtë do ta shmangej ndërhyrja më serioze e Fuqive të Mëdha. Për këtë qëllim, u angazhuan forca të konsiderueshme ushtarake dhe bashibozukë.

Forcat osmane fillimisht e sulmuan Krushevën. Duke e rivendosur kontrollin mbi të, do të rikthehej prestigji i Sulltanit. Prandaj, Krusheva u rrethua nga të gjitha anët nga njësi të mëdha ushtarake. Kështu iu kërkua kryengritësve që të dorëzoheshin, por Kryesia e maleve e hodhi poshtë propozimin.

Dëshmi historike



Zakonisht thuhet se termi "Republika e Krushevës" u shpik më vonë, për të treguar qeverinë kryengritëse në Krushevë. Megjithatë, termi u përdor që gjatë kryengritjes, në artikullin *"Tmerret në Krushevë - dëshmi e një dëshmitari okular"*, botuar më datë 31.8.1903 në gazetën "Vistina", e cila botohej në Bukuresht (Rumani).



Top qershie

Sfidë për hulumtim



Deri më tani, është ruajtur vetëm një top original prej qershie nga koha e Kryengritjes së Ilindenit.

Bëj kërkime në internet se ku ndodhet sot dhe si përfundoi atje!



Pitu Guli

Në mbrojtjen e Krushevës u përfshinë rreth 1200 kryengritës. Pas disa orësh luftime, rezistenca e kryengritësve u thye. Në rrethana të tilla, Shtabi urdhëroi që kryengritësit të tërhiqeshin. Gjatë tërheqjes së forcave kryengritëse nga qyteti, një betejë e ashpër u zhvillua pranë zonës së **Slivës**, ku u vra një njësi e tërë. Drama e fundit e luftimeve rreth Krushevës u zhvillua në **“Meçkin Kamen”**, ku ishte vendosur njësia e **Pitu Gulit**. Ai vdiq heroikisht me shumicën e shokëve të tij. Më 13 gusht, ushtritë osmane e pushtuan Krushevën. Qyteti u plaçkit dhe u dogj, ndërsa një pjesë e madhe e popullsisë iu nënshtrua torturave të ndryshme.

Pas pushtimit të Krushevës, ushtritë osmane vazhduan t’i rrethonin vatrat e kryengritësve në Qarkun Revolucionar të Manastirit. Deri në fund të gushtit, ushtria kishte vendosur kontroll kudo. Disa fshatra maqedonase e pësuan fatin e Krushevës. Ato u dogjën dhe u plaçkitën. Me sulmin e ashpër ndaj vendbanimeve kryengritëse dhe sulmin ndaj popullsisë civile, autoritetet besonin se do t’i detyronin kryengritësit të dorëzoheshin më shpejt. Megjithatë, përleshjet me çetat vazhduan deri në fund të shtatorit. Shtabi i Përgjithshëm, duke e kuptuar situatën pa rrugëdalje, **në fillim të tetorit të vitit 1903 mori vendim për ndërprerjen e kryengritjes dhe çmobilizimin e kryengritësve.**

Rëndësia dhe jehona e Kryengritjes së Ilindenit

Kryengritja e Ilindenit në atë kohë zuri një vend të rëndësishëm në shtypin evropian dhe botëror. Gjatë kryengritjes, shumë reporterë nga vende të ndryshme ishin në territorin e Maqedonisë. Nën ndikimin e tyre, u organizuan manifestime të ndryshme pro-maqedonase në disa qytete evropiane për ta mbështetur luftën e kryengritësve maqedonas. Në të njëjtën kohë, u formuan komitete për të mbledhur ndihma humanitare për popullsinë që po vuante në Maqedoni.

Në të njëjtën kohë, Kryengritja e Ilindenit zuri një vend të rëndësishëm në raportet e përfaqësuesve diplomatikë. Kjo, nga ana tjetër, e afirmoi

Fjalë dhe terma të panjohur

Bashibozuk

Grupe të parregullta të armatosura, të njohura për mungesën e disiplinës së tyre, si dhe për dhunën dhe plaçkitjet që kryenin kundër popullsisë në zonat kryengritëse.



Monument për Betejën e Slivës



Krusheva e shkatërruar



Indiferenca e Fuqive të Mëdha ndaj ngjarjeve në Maqedoni (karikaturë)

çështjen maqedonase në skenën ndërkombëtare. Nga këtu dolën iniciativa të reja për reforma në Maqedoninë Osmane.

Kryengritja e Ilindenit dhe Republika e Krushevës kanë një rëndësi të veçantë në historinë e popullit maqedonas dhe të luftës së tij për shtet të pavarur maqedonas. Heroizmi dhe vetëmohimi i heronjve të Ilindenit u bënë frymëzim dhe udhërrëfyes për vazhdimin e luftës nga brezat e ardhshëm.

Gjenerata e ilindenaseve maqedonas e shpalli dhe e përcaktoi rrugën drejt **Ilindenit të dytë**. Prandaj, epoka e Ilindenit ka një vend të rëndësishëm në krijimtarinë kulturore maqedonase (letërsi, arte figurative, folklor etj.).

Historia - udhërrëfyes për të ardhmen



Revolucionari maqedonas i epokës së Ilindenit, Dimo Haxhi Dimov, me rastin e 21-vjetorit të Kryengritjes së Ilindenit, do të shkruajë si profet:

“Maqedonia e pati Ilindenin e saj të parë, i ndjekur nga ditë të përgjakshme disfate dhe vuajtjesh të rënda gjatë një çerek shekulli. Ajo do ta ketë edhe Ilindenin e saj të dytë, por tashmë në një epokë të re dhe të sigurt të fitoreve të afërta dhe të çlirimit. Ky Ilinden i dytë është afër, po vjen. Dhe atëherë qytetarët e vjetër dhe të rinj të Ilindenit, që kanë mbetur gjallë, do të përqafohen, vëllazërisht, dhe do të festojnë me idealin e arritur, ndërsa shpirtrat e shokëve të tyre të rënë... do të takohen në paqe dhe solemnisht dhe do të fluturojnë mbi Maqedoninë e lirë dhe të pavarur.”



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Përshkruaje çlirimin e Krushevës.
2. Çfarë është Manifesti i Krushevës?
3. Pse ushtritë osmane e përqendruan peshën e sulmit të tyre në zonat e populluara?
4. Përshkruaje rëndësinë e Kryengritjes së Ilindenit.

Situata në Maqedoni pas Kryengritjes së Ilindenit

Pasojat e kryengritjes

Shtypja e Kryengritjes së Ilindenit la pasoja të rënda, veçanërisht në qarkun e Manastirit. Atje, edhe pasi kryengritja kishte mbaruar, qeveria vazhdoi të zbatonte masa shtypëse nën pretekstin e mbledhjes së armëve. Situata u ndërlikua edhe më shumë nga dimri i ashpër që kishte filluar. Kur kryengritja u shtyp, shumë familje mbetën pa strehë mbi kokë, pa ushqim, pa veshmbathje dhe pa bagëtinë e tyre. Vlerësohet se rreth **70,000 njerëz mbetën pa strehë**. Ishte një **katastrofë e vërtetë humanitare**. Ndihma humanitare, që mbërriti përmes organizatave bamirëse, e lehtësoi vetëm pjesërisht situatën.

Ndërkohë, shumë u dënuan dhe ishin në burgje. Të tjerë, për t'i shpëtuar persekutimit ose në kërkim të një jete të sigurt dhe të ardhurave më të mira, filluan të shpërnguleshin. Si rezultat, rreth 30,000 njerëz u larguan nga vendi. Shumica shkuan në vendet fqinje, kryesisht në Bullgari. Të tjerë kërkuan shpëtim më larg, në vendet evropiane dhe të huaja, veçanërisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Reformat e Mirtzstegut

Kryengritja e Ilindenit i detyroi Fuqitë e Mëdha të ndërmerrnin reforma vetëm për Maqedoninë Osmane. Fjalën kryesore për këtë çështje e kishin Rusia dhe Austro-Hungaria. Për këtë qëllim, perandorët e tyre u takuan në qytetin austriak të **Mirtzstegut** në fillim të **tetorit të vitit 1903**. Kjo është arsyeja pse reformat e miratuara u quajtën **Reformat e Mirtzstegut**. Reformat u mbështetën nga fuqitë e tjera evropiane. Për më tepër, ndryshe nga më parë, këtë herë zbatimi i reformave do të mbikëqyrej nga përfaqësuesit e fuqive evropiane.

Këto reforma parashikonin përmirësime në funksionimin e xhandarmërisë osmane në Maqedoni, në administratë, në gjyqësor, në financa etj. Perandoria Osmane ishte e detyruar të siguronte fonde për rindërtimin e shtëpive dhe ndërtesave të tjera të djegura. Përveç kësaj, autoritetet osmane ishin të detyruara të krijonin kushte për kthimin e popullsisë së zhvendosur brenda vendit dhe atyre që kishin ikur përtej kufijve të Perandorisë Osmane.



Zagoriçani i djegur (viti 1903)

Nga arkivat diplomatike



Me dispozitën e gjashtë të reformave të Mirtzstegut, Perandoria Osmane është e detyruar të sigurojë shumën e veçanta për:

- a) kthimin në shtëpi të familjeve të krishtera që ikën në Bullgari ose në vende të tjera si refugjatë;
- b) ndihmë për të krishterët që i humbën pronat dhe shtëpitë e tyre;
- c) riparimin e shtëpive, kishave dhe shkollave të shkatërruara nga osmanët gjatë kryengritjes.



Vila Perandorake në Mirtzsteg

Popullsia e fshatrave të djegura u përjashtua nga të gjitha taksat për një vit. OFRMO-ja i konsideroi këto reforma të pamjaftueshme, prandaj i dënoi dhe i injoroi ato. Nga ana tjetër, popullsia nuk ndjeu ndonjë përmirësim të veçantë në situatën e tyre. Reformat, megjithëse supozohej se do të kontribuonin në qetësimin e situatës në Maqedoni, e ndërlikuan atë edhe më tej.

Situata në Organizatë

Gjatë kryengritjes së vitit 1903, u vranë udhëheqës dhe komandantë të shquar. Disa nga çetat, për ta shmangur persekutimin, u larguan nga Maqedonia, kryesisht në Bullgari. Disa udhëheqës të Organizatës vepruan në mënyrë të ngjashme. Gjatë Kryengritjes, komunikimi midis komiteteve të veçanta dhe Komitetit Qendror u ndërpre. Në prill të vitit 1904, **Komiteti Qendror u vetëshpërbë** dhe pak më vonë edhe Përfaqësia përtej kufirit pushoi së funksionuari. Organizata ra në krizë.

Ndërkohë, midis udhëheqësve të shquar organizativë filloi një debat rreth dështimit të kryengritjes dhe strukturës së ardhshme të Organizatës. Kështu, **u kritikua struktura centraliste e Organizatës**. Gjatë këtyre debateve, **mbizotëroi qëndrimi për decentralizimin dhe demokratizimin** e Organizatës. Kjo do të thoshte që iniciativat duhet të vinin nga poshtë (nga baza), dhe jo, siç kishte ndodhur deri atëherë, të imponoheshin nga lart (nga Komiteti Qendror). Këto çështje u diskutuan në disa kongrese qarkore të mbajtura gjatë viteve 1904-1905. Në disa prej tyre, u tha se Organizata duhet të punonte për vetëdijësimin kombëtar të maqedonasve.

Kongresi i Rilës

Pasi përfunduan kongreset e qarqeve, në **tetor të vitit 1905**, u mbajt një **kongres i përgjithshëm** i Organizatës. Ai u mbajt në Manastirin e Rilës, prandaj njihet si **Kongresi i Rilës**. Punimet e kongresit zgjatën një muaj të tërë. U shqyrtuan aktivitetet e kaluara të Organizatës, situata aktuale, por vëmendje e veçantë iu kushtua veprimtarive të ardhshme. Kongresi u kryesua nga Dame Gruev.

Debati më i gjatë ishte rreth strukturës së ardhshme të Organizatës. Shumica e delegatëve u deklaruan në favor të **reformave, demokratizimit dhe decentralizimit** të Or-



Oficerë austriakë në Shkup të përfshirë në reformat e Mirzstegut

Dëshmi historike



Inspektori i Përgjithshëm Husein Hilmi Pasha për Kongresin e Dytë të Qarkut të Selanikut:

"Protokolli... i cili është një shpjegim i detajuar dhe i mrekullueshëm i aktiviteteve të Organizatës deri më sot, është shkruar me kompetencë, me korrektësi të madhe dhe logjikë të fortë... Hilmi Pasha më tha disa herë se ishte i mahnitur nga mendimet dhe parimet e shprehura në Protokoll dhe se nuk do ta kishte besuar kurrë se midis atyre mësuesve të rinj të fshatit, në duart e të cilëve është Organizata e Brendshme, ka njerëz me mendime dhe parime kaq të shëndosha."

Raporti konfidencial i agjentit tregtar bullgar Atanas Shopov.



Manastiri i Rilës

ganizatës. Ndër përfaqësuesit e shquar të këtij grupi ishin: Gjorçe Petrov, Jane Sandanski dhe Pere Toshev.

Nga ky kongres, OFRMO-ja u riemërua në **Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase-Ordinase (OBRMO)**. Në kongres u miratuan Kushtetuta dhe Rregullorja e re e Organizatës. Ato e përfshinin strukturën dhe orientimin e ri të Organizatës. U përcaktua që çdo banor i Turqisë Evropiane mund të ishte anëtar i OBRMO-së. Në të njëjtën kohë, u zgjodhën anëtarët e Komitetit Qendror dhe të Përfaqësuesitë matanë kufirit.

Kongresi e dënoi propagandën e huaj në Maqedoni dhe aktivitetet e Komitetit Vërhovist. Reformat e Mirzstegut u vlerësuan si të pamjaftueshme. U vendos që Organizata t'i injoronte plotësisht ato. Vëmendje e konsiderueshme në këtë Kongres iu kushtua rritjes së nivelit kulturor, arsimor dhe ekonomik të popullsisë. Kjo nënkuptonte ndërmarrjen e masave të ndryshme, të cilat supozohej se do ta përmirësonin jetën e përditshme të njerëzve.

Uniteti i arritur në Kongresin e Rilës ishte jetëshkurtër. Shpejt, mosmarrëveshjet dolën përsëri në pah. Si rezultat, kongresi i përgjithshëm i radhës nuk u mbajt. Që atëherë (fundi i vitit 1906), Organizata u nda në dy grupe kundërshtarë.

Propagandat e armatosura në Maqedoni

Pas Kryengritjes së Ilindenit, në Maqedoni pati një intensifikim të propagandës serbe, greke dhe bullgare. Ndryshe nga më parë, kur kjo propagandë kishte vepruar kryesisht nëpërmjet institucioneve kishtarë dhe arsimore, pas Kryengritjes ajo mori **karakter të armatosur**. Ky kurs i ri u nxit nga reformat e Mirzstegut, të cilat, ndër të tjera, parashikonin riorganizim të ri administrativ të territorit të Maqedonisë, pasi vendi të qetësohej.

Këto vende filluan të organizoheshin dhe të dërgonin trupa në Maqedoni. Përveç kësaj, ata, nga ana tjetër, nëpërmjet ryshfetit, tërhoqën individë nga brendësia, si dhe dezertorë të ndryshëm nga Organizata. Këto çeta, me forcën e armëve, e detyronin popullsinë të deklarohej serbe, greke ose bullgare. Për shkak të kësaj, shpesh ndodhnin përleshje midis tyre në fshatrat maqedonase. Në këto përleshje, pa vullnetin e tyre, u përfshinë edhe çetat e Organizatës, të cilat kërkonin ta mbronin territorin e tyre.



Kushtetuta e OBRMO-së

E kaluara përmes burimeve



Në Kongresin e Rilës, OBRMO-ja u shpreh edhe në lidhje me Ekzarkinë Bullgare. Lidhur me këtë, thuhet:

“Të gjitha dukuritë në aktet dhe veprimet e Ekzarkisë, të cilat drejtohen në frymën e nacionalizmit shtetëror bullgar, Organizata i konsideron keqdashëse për qëllimet e saj dhe i kundërshton ato.”

Nga vendimet e Kongresit të Rilës të OBRMO-së



Husein Hilmi Pasha

Pasojat e veprimeve të propagandave të armatosura më rëndë i ndjeu popullsia maqedonase. Ajo jo vetëm që iu nënshtrua presionit të përditshëm, frikësimit, vrasjeve individuale dhe djegies së pronës, por ndonjëherë edhe masakrave masive. Përveç kësaj, propagandat e armatosura i thelluan përçarjet dhe padurimin midis popullsisë maqedonase. Nga ana tjetër, këto çeta përfaqësonin një armik të ri për OBRMO-në dhe luftën e saj për autonomi në Maqedonisë.

Mëso më shumë



Përfaqësuesit e çetave greke njiheshin si Andartë. Ata kryesisht vepronin në rajonet jugore dhe qendrore të Maqedonisë Osmane. Një rol të rëndësishëm në aktivitetin e tyre luajti Peshkopi i Patrikanës së Kosturit - Germanos Karavangelis. Në pranverën e vitit 1905, Andartët kryen një sulm të egër në fshatin Zagoriçan (rajoni i Kosturit). Kështu, ata vranë mbi 60 banorë (gra, fëmijë dhe pleq) dhe e dogjën pjesën më të madhe të fshatit.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Përshkruaje katastrofën humanitare pas Kryengritjes së Ilindenit!
2. Çfarë debati u hap në Organizatë pas Kryengritjes së Ilindenit?
3. Renditi dispozitat më të rëndësishme të reformave të Mirzstegut!
4. Çfarë nënkupton me demokratizim dhe decentralizim të Organizatës?
5. Cili është ndryshimi në veprimin e propagandave të jashtme para dhe pas Kryengritjes së Ilindenit?

Maqedonia gjatë grushtit të shtetit dhe regjimit të xhonturqve

Maqedonia si shkak dhe motiv për grushtin e shtetit të xhonturqve

Pas Kongresit të Berlinit, në qendër të sundimeve evropiane të osmanëve u gjend Maqedonia. Me shfaqjen e lëvizjes revolucionare maqedonase, ajo u bë një zonë e pasigurt. Nën presionin e Fuqive të Mëdha, Perandoria Osmane u detyrua të zbatonte reforma të ndryshme. Në të njëjtën kohë, pretendimet e hapura të shteteve fqinje ballkanike, të cilat e konsideronin Maqedoninë pjesë të “trashëgimisë së tyre historike”, po bëheshin gjithnjë e më të dukshme. Përveç kësaj, Austro-Hungaria pretendonte dalje në Selanik.

Edhe pse ishte i vetëdijshëm për mundësinë e humbjes së Maqedonisë, Sulltani e preferonte politikën **“përça dhe sundo”**. Ai besonte se për shkak të interesave kontraktore të palëve të interesuara, do të ishte në gjendje ta mbante kontrollin. Përkundrejt kësaj, aktivistët e lëvizjes së xhonturqve besonin se duke e rivendosur Kushtetutën do të ishin në gjendje ta ruanin integritetin e Perandorisë. **Në vitin 1905, qendra e lëvizjes së xhonturqve u transferua në Selanik.** Xhonturqit kishin një ndikim të fuqishëm midis oficerëve në ushtrinë osmane në Maqedoni dhe ata mbanin lidhje të fshehta me disa qarqe të lëvizjes revolucionare maqedonase.

Në fillim të **qershorit të vitit 1908**, Cari rus Nikollaj II dhe Mbreti britanik Eduardi VII u takuan në Reval (Talin i sotëm, Estoni). Në takimin e Revalit, ndër të tjera, u diskutua edhe futja e **administratës autonome në Maqedoni.**

Ndërkohë, xhonturqit u paraqitën Memorandum përfaqësuesve të fuqive evropiane. Në të, ata tregonin se Maqedonia ishte pjesë integrale e Perandorisë Osmane. Ata gjithashtu u tregonin Fuqive të Bashkuara se nëse donin sinjerisht të ndihmonin, duhej ta mbështesnin luftën e xhonturqve kundër absolutizmit të Sulltanit.

Duke e kuptuar rrezikun e humbjes së Maqedonisë, xhonturqit vendosën ta **përdornin ushtrinë për ta bindur Sulltanin që ta rivendoste Kushtetutën** e vitit 1876. Ata besonin se, duke vepruar kështu, do ta shmangnin ndërhyrjen e Fuqive të Mëdha dhe kështu do ta ruanin integritetin e Perandorisë.

Ndërlidhi njohuritë



Konsultu to me një hartë historike dhe kujto ndryshimet që ndodhën në hartën politike të Ballkanit pas përfundimit të Krizës Lindore dhe Kongresit të Berlinit.

Analizoje dhe përcaktoje vendndodhjen e Maqedonisë në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane!



Mbreti Eduardi VII dhe Cari Nikollaj II, Reval 1908

E kaluara përmes burimeve



Nga Memorandumi për Bashkim e Përpërim drejtuar konsujve të Fuqive të Mëdha:

“Në fakt, qëllimi i Evropës është të krijojë një lloj shteti maqedonas, ose një provincë autonome maqedonase... Nëse situata në Maqedoni po e shqetëson Evropën deri në atë masë dhe nëse Evropa dëshiron vërtet t'i bëjë maqedonasit të lumtur... na ndihmoni ta shkatërrojmë absolutizmin ekzistues, ta arrijmë lirinë dhe të dalim në dritë.”

Kujtimet e Nijazi Beut

Maqedonia – qendra e grushtit të shtetit të xhonturqve

Ndërhyrja ushtarake e xhonturqve filloi më 3 korrik të vitit 1908, me dezertimin e **Nijazi Beut**, komandantit të garnizonit të Resnjës. Në mënyrë të ngjashme vepruan shumica e njërive ushtarake me komandantët e tyre në Maqedoni. Situata u përshkallëzua pasi njësitë e revoltuara e morën kontrollin e Manastirit. Pastaj u liruan të gjithë të burgosurit. Reagimi i forcave të Sulltanit kundër rebelëve ishte i dobët. Nga ana tjetër, edhe ata që u dërguan iu bashkuan xhonturqve.

Në Selanik dhe qytete të tjera, filluan të mbahehin tubime të mëdha në mbështetje të kërkesave të xhonturqve. Për popullsinë ishte veçanërisht tërheqës sloganin **“liri, vëllazëri, unitet”**. Për ta fituar mbështetjen e popullsisë së krishterë në Maqedoni u lëshua një proklamata e posaçme.

Nën presionin e xhonturqve, Sulltani Abdyl Hamit II e rivendosi Kushtetutën. Kështu, Perandoria u bë monarki kushtetuese parlamentare. Megjithatë, Sulltani edhe më tej mbetej sundimtar i padiskutueshëm.

Grushti i shtetit i xhonturqve u pranua dhe u mbështet nga shumica e aktorëve të lëvizjes revolucionare maqedonase. Kështu, **Jane Sandanski** foli në disa tubime publike, me ç'rast ai dërgoi në Selanik një **“Manifest për të gjithë bashkatdhetarët në Perandori”**. Çetat e ndryshme, si dhe ato të OBRMO-së, të cilat deri atëherë kishin qëndruar në male, zbritën në qytete dhe morën pjesë në të gjitha demonstratat publike. Në të njëjtën kohë, u shpall një amnisti e përgjithshme për të gjithë të burgosurit.



Festimi i kushtetutshmërisë në Shkup, viti 1908



Nijazi Beu

Dëshmi historike



Nga Proklamata për Bashkim e Përparim drejtuar të krishterëve në Maqedoni:

“Për më shumë se një çerek shekulli, Bullgaria dhe Greqia, por që prej disa kohësh edhe Serbia, duke e ndjekur të njëjtin qëllim, përkatësisht duke ju shtrirë dorën e ndihmës, përkatësisht maqedonasve, ju gënjejnë me premtime se do t’ju çlirojnë dhe do t’ju dhurojnë liri. Jo vetëm që nuk po ju ndihmojnë, por këto shtete, qëllimi i të cilave është t’ju nënshtrojnë dhe t’ju robërojnë, krijuan përçarje midis jush. Ata kanë mbjellë farë përçarjeje, që atdheun tonë e shndërroi në një det gjaku... Nuk ka ndarje dhe dallim midis nesh. Të gjithë jemi osmanë. Çështja e besimit është një çështje tjetër. Ajo nuk lidhet me atdheun.”

Pluralizmi politik dhe përpjekja kundër grushtit të shtetit

Me rivendosjen e Kushtetutës në Perandorinë Osmane, u krijuan kushte për shprehje dhe organizim të lirë politik. Për këtë qëllim, filluan të formoheshin **parti politike**, organizata dhe shoqata të tjera. Forca politike dominante ishte Komiteti Xhonturk “**Bashkim e Përparim**”, i cili e mori kontrollin politik të shtetit.

Në Maqedoni, shumica e përfaqësuesve nga rrethet revolucionare të Serit, Strumicës dhe Selanikut u organizuan në **Partinë Federative Popullore (PFP)**. Ajo drejtohej nga **Dimitar Vllahov**. Në fillim, figura të shquara në të ishin: Jane Sandanski dhe Hristo Çernopeeve. Edhe pse nuk ishte e kënaqur me xhonturqit, prapëseprapë PFP-ja u dha atyre mbështetje të konsiderueshme. PFP-ja e mbështeti veçanërisht zgjidhjen e **çështjes agrare** dhe arsimit fillor falas. Përfaqësuesi i saj më i shquar në parlamentin osman ishte Dimitar Vllahov.

Si kundërpeshë ndaj PFP-së, doli në pah **Bashkimi i Klubeve Kushtetuese Bullgare**. Ai përfshinte mbështetës nga krahu kundërshtar i OBRMO-së, si dhe elitën e përfaqësuesve të ekzarkisë. U krijuan edhe organizata politike me orientim grek dhe serb. Gjithashtu, u shfaqën edhe **klube shqiptare**, të cilat e mbronin autonominë rajonale dhe krijimin e alfabetit shqip. Përveç kësaj, u shfaqën sindikata dhe shoqata të ndryshme punëtorësh.

Pasi e morën pushtetin, xhonturqit filluan të bënin kompromise me regjimin e vjetër. Nga ana tjetër, forcat konservatore antikushtetuese, të cilat ishin të afërta me Sulltanin, në prill të vitit 1909 kryen një **kundër-grusht shteti** në Stamboll. Prandaj, xhonturqit u nisën me një ushtri të fortë nga Selaniku drejt Stambollit. Në këtë fushatë kundër kryeqytetit morën pjesë edhe Jane Sandanski, Hristo Çernopeeve dhe Todor Panica me 1200 vullnetarë maqedonas. Brenda një kohe të shkurtër, forcat reaksionare u mundën dhe u rivendos Kushtetuta. Sulltan Abdyl Hamiti II u rrëzua nga fronin dhe në vend të tij u vendos Mehmeti V.



Dimitar Vllahov



Jane Sandanski dhe bashkëpunëtorët e tij në shoqërinë e xhonturqve

Përkeqësimi i regjimit të xhonturqve

Pas rivendosjes së Kushtetutës dhe konsolidimit të pushtetit, xhonturqit nuk ndërmorën masa vendimtare për modernizim dhe ndryshime serioze. Përpyekjet e tyre për të ndërtuar një **komb osman** ishin të vonuara dhe nuk dhanë rezultate. Nga ana tjetër, pasi e morën pushtetin, ata miratuan disa ligje kufizuese me të cilat i kufizuan të drejtat dhe liritë.

Në të njëjtën kohë, u miratua një ligj që i ndalonte të gjitha organizatat dhe shoqatat mbi baza etnike. Lista e ligjeve kufizuese përfshin ligjin mbi grevat, sindikatat dhe ligjin mbi të papunët. Pasi u miratua ligji kundër çetave, filluan bastisjet masive në fshatrat maqedonase. Si rezultat, shumë ish-revolucionarë që kishin lënë përko-hësisht armët dhe e kishin mbështetur grushtin e shtetit të xhonturqve u kthyen kundër tyre dhe u angazhuan në aktivitete të paligjshme. Si rezultat, situata në Maqedoni u tensionua përsëri. Nëse mbajtja e Maqedonisë brenda Perandorisë ishte arsyeja dhe rasti për grushtin e shtetit të xhonturqve, zhvillimi i shpejtë i ngjarjeve do të tregojë se xhonturqit dështuan në këtë drejtim.



Sulltan Mehmeti V



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Përshkruaje ndryshimin midis Sulltanit dhe xhonturqve në aspektin e ruajtjes së integritetit të Perandorisë!
2. Pse takimi i Revalit e përbënte motivin për grushtin e shtetit të xhonturqve?
3. Pse grushti i shtetit i xhonturqve mori mbështetje të fortë në Maqedoni?
4. Emërtoji subjektet më të rëndësishme politike në Maqedoni pas vendosjes së parlamentarizmit kushtetues!

Maqedonia në Luftërat Ballkanike

Maqedonia në politikat e vendeve të Ballkanit

Maqedonia Osmane, për shkak të vendndodhjes së saj, zinte një vend të rëndësishëm në planet politike të vendeve fqinje ballkanike (Serbisë, Greqisë dhe Bullgarisë). Të tre vendet kishin pretendime, por asnjëri prej tyre nuk ishte i aftë të zhvillonte vetë një luftë të suksesshme kundër osmanëve. Secili prej tyre ishte i vetëdijshëm se interesat e tij në Maqedoni përplaseshin me interesat e dy vendeve të tjera.

Prandaj, shtetet ballkanike u detyruan të negocionin midis tyre. Nga fundi i shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, pati disa përpjekje për marrëveshje të ndërsjella. Megjithatë, për shkak të orekseve të tepërta, negociatat nuk patën sukses. Është interesante se të tre shtetet pretendonin se toka dhe populli i Maqedonisë u përkisnin atyre, dhe në të njëjtën kohë negocinuan midis tyre për ndarjen e saj.

Në mars të **vitit 1912**, me ndërmjetësimin rus, Bullgaria dhe Serbia përkohësisht i kapërcyen mosmarrëveshjet e tyre dhe nënshkruan një traktat aleance dhe miqësie. Duke vepruar kështu, ato i përcaktuan interesat e tyre në Maqedoni me një dokument të veçantë. Menjëherë pas kësaj, u nënshkrua një traktat mbrojtjeje midis Bullgarisë dhe Greqisë, si dhe midis Serbisë dhe Greqisë. Në dy traktatat e fundit, interesat territoriale nuk u përcaktuan. Kjo çështje u shmang qëllimisht. Bullgaria dhe Serbia nënshkruan, gjithashtu, traktate të veçanta edhe me Malin e Zi. Me këtë u përfundua krijimi i të ashtuquajturës **Aleancë Ballkanike**. Ajo u drejtua **kundër Perandorisë Osmane**, përkatësisht kundër sundimeve të saj evropiane, në qendër të të cilave ishte Maqedonia.

Maqedonia në Luftën e Parë Ballkanike

Pasi i dhanë një ultimatum Perandorisë Osmane, në tetor të vitit 1912, aleatët ballkanikë i shpallën luftë asaj. Kështu filloi **Lufta e Parë Ballkanike**. Gjatë luftës kundër forcave osmane, ushtritë serbe, bullgare dhe greke vep-



Ballkani –fuçi baruti
(karikaturë, viti 1912)



Aleanca Ballkanike
(poster propagande)

ruan në territorin e Maqedonisë. Në ushtrinë osmane u mobilizua edhe popullsia e krishterë. Por ishte pikërisht ajo që ndër të parët dezertoj.

Nën presionin e ushtrive aleate ballkanike, forcat osmane u mundën dhe u shpartalluan në më pak se një muaj. Disa prej tyre filluan të tërhiqeshin në drejtim të lindjes drejt kryeqytetit të tyre, të tjerë në drejtim të perëndimit, përmes Shqipërisë.

Gjatë kësaj lufte, ushtritë serbe në jug arritën në Follorinë, Gjevgjeli dhe Strumicë. Ushtritë bullgare, të cilat vepronin, kryesisht, përgjatë luginës së Strumës, në jug arritën në Selanik, pothuajse njëkohësisht me ushtritë greke, të cilat vepronin nga jugu, ndërsa në veri arritën deri në Follorinë dhe Gjevgjeli.

Gjatë luftës, në disa vende ishin të pranishme ushtritë e dy ose edhe tre shteteve. Kështu, në Gjevgjeli ishin të pranishme njëkohësisht ushtritë serbe, greke dhe bullgare. Një rol të rëndësishëm në bindjen e komandantëve osmanë që të largoheshin nga disa qytete pa luftë luajtën përfaqësuesit diplomatikë të Fuqive të Mëdha. Kështu, konsulli rus në Shkup i bindi osmanët të largoheshin nga qyteti pa luftë. Nën ndikimin e konsujve të huaj në Selanik, qyteti iu dorëzua ushtrive greke.

Gjatë Luftës së Parë Ballkanike, në disa vende në Maqedoni u vendos sistem i dy pushteteve, kurse në disa vende madje edhe sistemi i tre-pushteteve. Kjo i nxori në sipërfaqe keqkuptimet e vjetra midis aleatëve.

Për t'i zgjidhur problemet midis Perandorisë Osmane dhe aleatëve ballkanikë, u thirr **Konferenca e Paqes në Londër**. Gjatë konferencës, Perandoria Osmane propozoi **autonomi për Maqedoninë** nën patronazhin e Sulltanit. Megjithatë, ky propozim nuk u mor në konsideratë. Konferenca përfundoi me nënshkrimin e të ashtuquajturit **Traktati i Paqes i Londrës** (1913). Sipas tij, territori i Maqedonisë, si dhe një pjesë e sundimeve evropiane të osmanëve, u ndanë midis aleatëve.



Ushtritë serbe hyjnë në Shkup



Pallati Sent Xhejms në Londër – vendi i nënshkrimit të Traktatit të Paqes në Londër



Zgjerimi territorial i shteteve ballkanike pas Luftës së Parë Ballkanike

Maqedonia në Luftën e Dytë Ballkanike

Mosmarrëveshjet midis aleatëve ballkanikë mbi ndarjen e Maqedonisë Osmane çuan në shpërthimin e **Luftës së Dytë Ballkanike**, e njohur edhe si **Lufta Ndëraleate**. Vetëm një ditë pas nënshkrimit të Traktatit të Londrës, Serbia dhe Greqia nënshkruan një marrëveshje për veprime të përbashkëta ushtarake kundër Bullgarisë. Më pak se një muaj më vonë, Bullgaria i sulmoi ushtritë serbe dhe greke. Mali i Zi u rreshtua në anën e Serbisë dhe Greqisë.

Gjatë Luftës së Dytë Ballkanike, u zhvilluan betejat të ashpra në lumin Bregallnicë, në Ovçe Pole dhe përgjatë lumit Struma, si dhe në zonën midis Dojranit, Gjevgjeli dhe Kukushit.

Në luftën kundër Bullgarisë u bashkuan edhe Rumania dhe Perandoria Osmane. E rrethuar nga të gjitha anët, Bullgaria kërkoi armëpushim. Këtë herë, negociatat për paqe u zhvilluan në **Bukuresht** (Rumani). Fituesit e diktuan traktatin e paqes. Ai njihet si **Traktati i Paqes i Bukureshtit** (10 gusht 1913). Sipas tij, Bullgaria humbi një pjesë të zonave në Maqedoni, që i kishte pushtuar gjatë Luftës së Parë Ballkanike.

Pjesëmarrja e maqedonasve në Luftërat Ballkanike

Për shkak të aktiviteteve propagandistike të aleatëve ballkanikë, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë maqedonase besonte se po fillonte çlirimi nga sundimi osman. Në atë kohë, pothuajse askush nuk mendonte se bëhej fjalë për një luftë për ndarjen e trashëgimisë osmane në Maqedoni. Prandaj, popullsia bashkëpunoi në mënyrë aktive dhe u dha ndihmë të konsiderueshme ushtrive aleate.

Kontributi i vullnetarëve maqedonas ishte veçanërisht i rëndësishëm. Më të shumtë ishin në ushtrinë bullgare. Ata ishin të organizuar në të ashtuquajturën **milicia maqedonase-odrinase** (vullnetarë). Shumica e këtyre njësive u dërguan në frontin e Trakisë. Maqedonasit që vepruan në anën serbe ishin të organizuar në të ashtuquajturën **Mbrojtje Popullore**. Një pjesë e popullsisë e gjeti veten në radhët e ushtrisë greke. Vullnetarët zakonisht vepronin si pararojë e ushtrive aleate ose, si alternativë, në prapavijë të forcave osmane.



Karikaturë italiane për epilogun e Luftës së Dytë Ballkanike

E kaluara në të tashmen



Në shtetet ballkanike (ish-aleatë), Luftërat Ballkanike në historiografi paraqiten si luftëra çlirimtare. Në historiografinë maqedonase, turke dhe shqiptare, Luftërat Ballkanike paraqiten si luftëra pushtuese.

Mendo pse Luftërat Ballkanike interpretohen ndryshe në historiografitë e lartpërmendura!

Mëso më shumë



Vullnetarët maqedonas në "Milicinë Maqedonase-Odrinase" fillimisht besuan se po luftonin për çlirimin e Maqedonisë. Por gjatë Luftës së Dytë Ballkanike, ata e kuptuan se Luftërat Ballkanike kishin të bënin me ndarjen e Maqedonisë. Në këtë drejtim, Todor Pop Antovi shkruan:

"Ishte e vështirë për vullnetarin maqedonas të mendonte se atdheu i tij, për të cilin u bënë sakrifica të panumërta në luftëra epike revolucionare për ta realizuar idealin e lirisë për të gjithë Maqedoninë brenda kufijve të saj gjeografikë, tani, me Luftërat Ballkanike, po copëtohej në pjesë, të cilat po u jepeshin si pre aleatëve ballkanikë."

Çetat vullnetare kontribuan në marrjen e disa vendeve. Kështu, vojvoda **Petar Çaulev hyri në Ohër** para ushtrive serbe. **Jane Sandanski** me çetën e tij **hyri në Mellnik** para ushtrisë bullgare, ndërsa më vonë edhe në Selanik. Atje ai u gjend në një situatë të pakëndshme midis oficerëve bullgarë gjatë dollisë për **një Maqedoni autonome dhe të pavarur**.

Në Luftën e Dytë Ballkanike, një pjesë e popullsisë maqedonase u mobilizua në ushtritë e palëve ndërluftuese.

Kërkesat për shtet të pavarur maqedonas

Në **nëntor të vitit 1912**, me iniciativën e Dimitrija Çupovskit, Petar Pop Arsov organizoi një **konferencë pan-maqedonase** në Veles. Në konferencë u vendos që të ndërmerret iniciativa para fuqive evropiane për **krijimin e një shteti të pavarur të Maqedonisë**. Për këtë qëllim, ishte planifikuar të dërgohej një delegacion në konferencën e ardhshme të paqes. Ky veprim do të shtrihej në të gjithë Maqedoninë. Megjithatë, autoritetet pushtuese serbe dhe bullgare e penguan atë.

Dimitrija Çupovski u kthye në Rusi dhe që andej e vazhdoi luftën për një Maqedoni të pavarur. Me iniciativën e tij, **kolonia maqedonase në Shën Petërburg** u dërgoi një **Memorandum për Maqedoni të pavarur** përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Konferencën e Londrës. Përveç Memorandumit, u dorëzua edhe një **hartë etno-gjeografike e Maqedonisë**, e përgatitur nga D. Çupovski. Memorandum me përmbajtje të ngjashme iu dërgua edhe qeverive të shteteve fqinje ballkanike. Për t'i përhapur idetë e një Maqedonie të pavarur, kolonia maqedonase e botoi revistën **“Zëri Maqedonas”**.



Petar Çaulev



Harta e Maqedonisë e bërë nga Dimitrija Çupovski

Pasojat e Luftërave Ballkanike

Luftërat Ballkanike i dhanë fund sundimit osman mbi Maqedoninë. Qeveri të reja (serbe, greke dhe bullgare) u vendosën në zonat e pushtuara. Kjo i ndërpreu lidhjet ekonomike midis rajoneve. Gjatë periudhës osmane, lidhjet ekonomike nga brendësia e Maqedonisë ishin drejtuar kryesisht drejt Selanikut dhe anasjelltas. Në kushtet e reja, ato duhej të orientoheshin drejt qendrave të tjera. Disa drejt Beogradit, të tjera drejt Sofjes, kurse të tretat drejt Athinës.

Gjatë Luftërave Ballkanike, shumë qytete dhe fshatra u shkatërruan. Në të njëjtën kohë, një pjesë e konsiderueshme e popullsisë u zhvendos. Për shkak të pakënaqësisë me pjesën që mori, Bullgaria pas vetëm dy vitesh do të përfshihet në një luftë të re për Maqedoninë.

E kaluara përmes burimeve



Nga Memorandumi i kolonisë maqedonase në Shën Petërburg:

“Tani në Maqedoni mbretëron terror i tmerrshëm, ‘liria’ e aleatëve nuk ka kufij... Robëria turke është zëvendësuar nga robëria e krishtere, por ajo ditë e kobshme nuk është larg... kur maqedonasit do t’i thonë hapur të gjithë botës: ‘Është më mirë të vdesim duke luftuar për lirinë tonë sesa të jetojmë përsëri në robëri...”

Popullit maqedonas i nevojitet:

1. Maqedonia, brenda kufijve të saj gjeografikë, etnografikë, ekonomikë dhe politikë, të mbetet një shtet i vetëm, i pandashëm dhe i pavarur ballkanik.

2. Sa më shpejt që të jetë e mundur, mbi bazën e një votimi të përgjithshëm, duhet të mblihet në Selanik një kuvend kombëtar maqedonas, i cili do ta përpunojë në detaje strukturën e brendshme të shtetit dhe do t’i përcaktojë marrëdhëniet e tij me vendet fqinje.”



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Kundër kujt ishte drejtuar Aleanca Ballkanike?
2. Pse propozimi osman për Maqedoninë nuk u pranua në Konferencën e Paqes në Londër?
3. Cili ishte shkaku i Luftës së Dytë Ballkanike?
4. Cilat ishin motivet e vullnetarëve maqedonas për t’u bashkuar me ushtritë aleate?
5. Çfarë aktiviteteve ndërmori Dimitrija Çupovski pas Konferencës Pan-Maqedonase në Veles?

Shfaqja dhe zhvillimi i maqedonizmit

Termi maqedonizëm

Termi maqedonizëm e përfaqëson dashurinë dhe ndjenjën e përkatësisë ndaj Maqedonisë si atdhe. Maqedonizmi përfaqëson një shprehje të vetëdijes për Maqedoninë si një hapësirë e përbashkët historike, kulturore, ekonomike dhe shoqërore. Kjo ndjenjë e përkatësie mund të jetë personale, kolektive dhe historike.

Maqedonizmi është aspiratë për krijimin e një shteti dhe kombi maqedonas. Ai i nënkupton aktivitetet e vetëdijshme të popullit të Maqedonisë, i cili, nëpërmjet gjuhës, kulturës dhe luftës revolucionare, është përpjekur të krijojë një ndjenjë bashkësie dhe një shtet maqedonas. Pra, maqedonizmi është lëvizja që i paraprin shtetit dhe kombit maqedonas.

Maqedonia si atdhe

Njerëzit e arsimuar që vinin nga Maqedonia, pavarësisht faktit që ajo ishte pjesë e Perandorisë Osmane, në mesin e shekullit XVI e përjetonin atë si vendin dhe atdheun e tyre, duke e konsideruar Sulltanin si mbretin e tokës maqedonase.

Identifikimi i njerëzve me Maqedoninë si vend dhe atdhe i tyre u bë më i theksuar gjatë shekullit XVIII. Shumë emigrantë nga Maqedonia pas Kryengritjes së Karposhit e çuan këtë ndjenjë në veri në Monarkinë e Habsburgëve dhe në Rusi. Kështu, Hristofor Zhefaroviçi, i cili e ka prejardhjen nga Dojrani, krijoi një stemë të Maqedonisë. Ndërsa, në Rusi, nga emigrantët maqedonas u formua një Regjiment Husar (kalorësie) Maqedonas, i cili e kishte stemën e vet.

Gjatë shekullit XIX, veçanërisht në gjysmën e dytë të shekullit, ndjenja për Maqedoninë si atdhe i përbashkët i maqedonasve ishte e përhapur gjerësisht. Kjo u predikua nëpërmjet shtypit, letërsisë dhe luftës revolucionare.

Gjatë kësaj periudhe, Gjorgjija Pulevski filloi ta përhapte idenë se Maqedonia ishte atdheu i popullit maqedonas.

Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, emri maqedonas lidhet me Maqedoninë si një atdhe i përbashkët. Kështu,

Mëso më shumë



Në të ashtuquajturën Letra e Slepçes (mesi i shekullit XVI), rekomandohej që kur i shkruhet letër Sulltan Sulejmanit të Madhërisëm, atij t'i drejtohen si *“perandori i të gjitha tokave”*, duke përmendur edhe atë *“maqedonase”*.

- Jakobi i Kamena Rekës, i cili kishte një shtypshkronjë në sllavishten kishtare në Venedik, në librin e tij *“Çasoslov”* shkruan: *“E lashë Maqedoninë, atdheun tim, dhe hyra në vendet perëndimore”*.



Stema e Regjimentit Maqedonas

Dëshmi historike



Gjorgjija Pulevski, në fjalorin e tij tri gjuhësh në vitin 1875, shkruan:

“Popull quhen njerëzit që janë të së njëjtës race dhe flasin të njëjtën gjuhë, që jetojnë dhe shoqërohen me njëri-tjetrin, që kanë të njëjtat zakone, këngë dhe festa. Këta njerëz quhen popull, ndërsa vendi ku jeton populli quhet atdheu i atij populli. Kështu, edhe maqedonasit janë një popull dhe vendi i tyre është Maqedonia.”

kryengritësit e Kryengritjes Maqedonase e quanin veten maqedonas dhe e konsideronin Maqedoninë atdheun e tyre. Me theksimin e motos “Maqedonia e maqedonasve” nga OFRMO-ja, ndjenja e Maqedonisë si atdheu i maqedonasve u bë edhe më e fortë.

Disa intelektualë maqedonas e shihnin rrezikun për të ardhmen e Maqedonisë të shkaktuar nga propaganda me përçarje të ndryshme midis popullsisë. Prandaj, revista “Lloza” bën thirrje për bashkimin e të gjitha forcave popullore dhe dhënien e rezistencës së përbashkët “për ta ruajtur të ardhmen e atdheut tonë”.

Në të njëjtën kohë, u ndje edhe rreziku i ndarjes së Maqedonisë midis vendeve fqinje ballkanike. Prandaj, OBRMO-ja theksoi se do t'i kundërshtonte të gjitha përpjekjet për ta ndarë dhe pushtuar atdheun e Maqedonisë.



Gjorgjija Pulevski

Identifikimi me të kaluarën e lavdishme

Duke e ndjekur shembullin e popujve fqinjë, në gjysmën e dytë të shekullit XIX, intelektualët maqedonas filluan t'i referoheshin të kaluarës së lavdishme të mbretërisë antike të Maqedonisë. Kjo u bë me qëllim që të vërtetohej, mbi bazën e së kaluarës, se maqedonasit ishin një popull me traditë, prandaj ata e kishin të drejtën e shtetit të tyre maqedonas. Kjo u pasqyrua në poezi, letërsi, shtyp, në kërkesat drejtuar përfaqësuesve të huaj, si dhe në deklaratat personale.

Në vitin 1878, Gjorgjija Pulevski e botoi poemën “Zana Maqedonase”. Përmes saj, ai u kujton maqedonasve të kaluarën e lavdishme të Mbretërisë së Maqedonisë dhe heroizmin e Filipit II dhe Aleksandrit të Madh. Njëkohësisht, u bën thirrje që ta ndjekin shembullin e tyre dhe të mos kenë turp ta kërkojnë të vetën, madje edhe nëse duhet të vdesin për të. Në një stil të ngjashëm dhe me mesazhe të ngjashme është dhe antologjia e tij me poezi “Përmbledhje me Këngë Maqedonase”.

Pas shumë vitesh pune, Gjorgjija Pulevski e përfundoi dorëshkrimin e tij “Historia e Përgjithshme Sllavo-Maqedonase” në vitin 1892, i cili ishte shkruar në “dialektin sllavo-maqedonas”. Përmes këtij dorëshkrimi, Pulevski kërkoi të provonte se maqedonasit ishin popull i veçantë që rridhte nga maqedonasit e lashtë, të cilët, sipas tij, ishin me origjinë sllave. Gj. Pulevski nuk është historian dhe tezat e tij nuk janë të bazuara shkencërisht. Sidoqoftë, ai luajti

E kaluara përmes burimeve



Lidhur me aspiratat e shteteve ballkanike për ndarjen e Maqedonisë, në letyrën e qarkut të Komitetit të Follorinës të datës 1 janar të vitit 1906, thuhet:

“Maqedonia, atdheu ynë i dashur, foleja e regjimit pesëshekullor... turk, ka qenë gjithmonë subjekt i orekseve të pangopura luftarake të shteteve fqinje ballkanike. Ata me agresivitet po e vëzhgojnë shpërbërjen e shtetit të Hamitit kurse, në sytë e shprehur të diplomatëve të tyre, është parë prej kohësh si pre e tyre... Sidoqoftë, Organizata Çlirimtare Maqedonase-Odrinase, e cila mbi nga gjaku i tokës maqedonase, në themelet e së cilës është hedhur parimi i ‘Maqedonisë autonome’, u deklarua në kohën e duhur kundër të gjitha ndërhyrjeve të huaja.”

САМОВИЛА МАКЕДОНСКА

58. Да ли сто турци Македонци, стари збоји не гонети.
Одъ Македонци по-кучица пазъ нѣтъ не им.
59. Царъ Александъръ Македонски, триста збои турци
Крѣсто,
Со Македонци сукозанау коларѣтъ. (Славѣ).

Fragment nga „Zana Maqedonase“

një rol të madh në inkurajimin e maqedonizmit dhe patriotizmit maqedonas.

Identifikimi me trashëgiminë e lashtë u bë edhe për ta nxjerrë në pah ndryshimin me popujt fqinjë, që e mohonin identitetin maqedonas dhe kërkonin t'u impononin atyre një tjetër.

Gjuha si shenjë dalluese

Gjuha është një nga shenjat dalluese të popujve. Në historinë dhe në botën moderne, shumë popuj dhe kombe moderne flasin gjuhë të tjera ose shkruajnë në gjuhën e tyre me alfabet të huaj. Por kjo nuk e mohon veçantinë e tyre.

Në mesin e shekullit XIX, nën ndikimin e Iluminizmit dhe luftërave për pavarësi nga Patrikana e Kostandinopojës, lindi edhe çështja e gjuhës. Në të njëjtën kohë, lindi ideja e një gjuhe të përbashkët letrare maqedonase-bullgare. Për këtë përpiquej Partenij Zografski. Sipas tij, dialektet jugperëndimore maqedonase duhet të merren si bazë për këtë gjuhë. Ideja e tij nuk u pranua nga bullgarët.


Pas formimit të Ekzarkisë, në shkollat nën juridiksionin e saj, mësimi zhvillohej në bullgarisht. Për shkak të kësaj, herë pas here shpërthenin revolta të nxënësve. Në të njëjtën kohë, kërkohej që mësimi të zhvillohej në gjuhën amtare maqedonase.

Kontribut të madh në idenë e ngritjes së gjuhës maqedonase në nivelin e një gjuhe letrare dha Kërste Petkov Misirkov. Kjo ide u përpunua në librin e tij “Mbi çështjet maqedonase” të botuar në vitin 1903 në Sofje. Libri u konfiskua menjëherë pas botimit të tij.

Në vitin 1905, Dimitrija Çupovski e mori iniciativën për të hapur shkolla në gjuhën maqedonase. Megjithatë, kushtet në Maqedoninë Osmane nuk ishin të favorshme për realizimin e kësaj ideje.

Me kalimin e kohës, njerëzit e thjeshtë në Maqedoni u lodhën nga mësuesit dhe priftërinjtë në gjuhët e huaja. Prandaj, ata folën hapur për dëshirën e tyre për të pasur maqedonas si mësues dhe priftërinj.

Ndërkohë, disa sllavistë evropianë filluan ta studionin gjuhën maqedonase. Në vitin 1911, autoritetet e emigracionit në SHBA e punësuan përkthyesin e parë zyrtar të gjuhës maqedonase.



“Përmbledhje me Këngë Maqedonase” nga Gjorgjija Pulevski



Kërste Petkov Misirkov

Trashëgimi për brezat:



K. P. Misirkov për gjuhën letrare maqedonase:

“Ne e kemi si detyrë që ta lëvrojmë gjuhën tonë, sepse është e jona, ashtu siç është i yni edhe atdheu ... Ne e zgjedhim maqedonishten qendrore, pra dialektin Veles-Prilep, Manastir-Ohër, si gjuhën tonë të përgjithshme letrare... Është e nevojshme që me marrëveshje të përgjithshme ta zgjedhim një dialekt për gjuhën letrare të përgjithshme maqedonase... Krijimi i një gjuhe letrare është një nevojë shpirtërore për ne, e cila synon t'u japë fund abuzimeve të propagandave me interesat tona...”

Përpiqu të dallosh elementë të dialekteve moderne maqedonase në gjuhën në të cilën shkroi Misirkovi!

Lufta për shtetin maqedonas

Krijimi i shtetit të vet e përfaqëson arritjen më të lartë të idealit kombëtar të çdo populli. Shtetet që dolën nga trashëgimia osmane në Ballkan u krijuan si rezultat i kryengritjeve, ndërhyrjeve të jashtme ushtarake dhe presionit diplomatik nga Fuqitë e Mëdha. Me një përjashtim, këto shtete të sapokrijuara kaluan nëpër faza të ndryshme të autonomisë.

Faktori më i fuqishëm në luftën për “autonominë e Maqedonisë” ishte Organizata Revolucionare Maqedonase. Autonomia kuptohej si fazë kalimtare drejt shtetit të pavarur maqedonas. Gjatë aktivitetëve të saj, Organizata arriti të mobilizojë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë maqedonase. Arritja e saj më e lartë ishte Kryengritja e Ilindenit. Megjithatë, ajo nuk çoi në qëllimin e dëshiruar.

Përveç ORM-së, qëllime të ngjashme kishte edhe Grupi Socialist Maqedonas i Vasil Gllavinovit. Ai përpiqej për një “republikë të pavarur maqedonase”. Shumica e anëtarëve të tij më vonë u bashkuan me ORM-në.

Gjatë Luftërave Ballkanike, promotori më i madh i kërkesës për një shtet të pavarur maqedonas ishte kolonia maqedonase në Shën Petërburg, e kryesuar nga Dimitrija Çupovski. Ai i shprehu idetë e tij rreth veçantisë së popullit maqedonas dhe të drejtës së tij për shtetin e vet përmes faqeve të revistës “Zëri Maqedonas”.

Nga arkivat diplomatikë



Nga raporti i përfaqësuesit diplomatik rus N. Petrajev, në vitin 1907:

“Në Kazanë e Kosturit... erdhën delegacione nga fshatrat dhe deklaruan se nuk donin as mësues dhe priftërinj grekë dhe as bullgarë; ata këmbëngulën që të ishin maqedonas. Kur u pyetën për kombësinë e tyre, ata u përgjigjën se ishin maqedonas.... Këto deklarata, të cilat nuk janë fenomene të izoluar, tregojnë se... po fillon të zgjohet vetëdija kombëtare, e ndryshme nga ato që u imponohen nga jashtë.”



Dimitrija Çupovski



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Çfarë nënkupton me termin maqedonizëm?
2. Shpjegoje lidhjen midis emrit Maqedoni dhe termit atdhe?
3. Çfarë donin të arrinin njerëzit nga Maqedonia kur i referoheshin të kaluarës së lavdishme?
4. Mendo pse u konfiskua libri „Mbi Çështjet Maqedonase“ i K. P. Misirkovit?

Jeta në Maqedoninë Osmane

Fshatrat – ruajtësit e traditës

Nga fundi i shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, pjesa më e madhe e popullsisë në Maqedoninë Osmane jetonte në fshatra. Jeta në fshat bazohej në **rregulla fetare, zakone dhe tradita popullore**. Shtëpitë e fshatit ishin modeste. Ato ndërtoheshin prej guri ose druri dhe shpesh jetonin disa breza nën të njëjtën çati.

Në fushat pjellore, jeta ishte e lidhur ngushtë me **buj-qësinë**. Familjet kultivonin ngastra të vogla toke, të cilat zakonisht u përkisnin çifligjeve më të mëdha. Kultivoheshin **drithëra** dhe **kultura industriale**. Veçanërisht i rëndësishëm ishte **duhani**, i cili eksportohej në tregjet ndërkombëtare. Toka kultivohej me ndihmën e veglave të punës dhe bagë-tive.

Në fshatrat malore, aktiviteti kryesor ekonomik ishte **blegtoaria**. Mbarështoheshin dele dhe dhi, të cilat siguro-nin qumësht, mish, lesh dhe lëkurë. Përveç ushqimit dhe veshmbathjes, ato ishin produkte të rëndësishme edhe për **tregti**. Në varësi të stinëve, barinjtë i zhvendosnin kopetë e tyre nga kullotat malore në zonat më të ngrohta fushore dhe anasjelltas.

Në familje ekzistonte një ndarje e qartë e punës: burrat punonin në ara, gratë në shtëpi dhe kopsht, ndërsa fëmijët ndihmonin me punët e shtëpisë. Përveç familjes, njerëzit e kalonin jetën të rrethuar nga të afërmit, fqinjët dhe bashkë-fshatarët e tyre. Veshjet **bëheshin në kushte shtëpiake**. Ato përbëheshin nga këmisha leshi, jelekë, gëzofë etj.

Fshatrat funksiononin si bashkësi me **lidhje të forta ko- lektive**. Njerëzit më të respektuar në fshatra ishin **mësuesit** dhe **priftërinjtë**. Të gjithë e njihnin njëri-tjetrin dhe uniteti ishte veçanërisht i dukshëm gjatë festave fetare, ngjarjeve të rëndësishme të jetës (dasma, funerale, etj.) dhe periudha- ve të vështira. Zakonet, këngët popullore dhe gojëdhënat e ruanin **kujtesën kolektive** të njerëzve.

Organizata revolucionare maqedonase ishte e **lidhur ngushtë me jetën e përditshme** të popullsisë dhe bazohej në mbështetjen e saj. Populli, nga ana tjetër, shihte në figu- rën e vojtodës së vet një mbrojtës nga dhuna dhe padrejtë- sia. Organizata e mbështeste ngritjen kulturore, arsimore dhe ekonomike të popullsisë. Ndërmernte masa për ta futur arsimin e detyrueshëm fillor, për ta përmirësuar higjienën

Ndërlidhi njohuritë



Kujtoni se çfarë ishte sistemi çifligar dhe çfarë lloj marrëdhëniesh kishin çifligarët me pronarët e çifligjeve?



Shtëpi fshati në Maqedoninë Osmane



Fshati i Galichikut – panoramë

dhe shëndetin. Ajo e mbështeste çrrënjosjen e dukurive imorale, martesave të detyruara dhe me të mitura, shpenzimeve të tepërta të dasmave dhe besëtytnive.

Mundësi të reja transporti dhe komunikimi

Trendi global i ndërtimit të hekurudhave në gjysmën e dytë të shekullit XIX ndikoi edhe në Maqedoninë Osmane. Në vitin 1873, u hap linja e parë hekurudhore **Selanik-Shkup**. Linja u lidh më pas me hekurudhën serbe, dhe përmes saj me Evropën. Kështu, në vitin 1888, treni i parë nga Parisi arriti në Selanik. Disa vite më vonë, Selaniku u lidh me hekurudhë edhe me Manastirin. Ndërtimi i hekurudhës krijoi kushte për transport **më të shpejtë, më të lirë dhe më të rregullt**.

Futja në përdorim e motorëve me avull çoi në ndryshime të mëdha në transportin detar. Deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX, Maqedonia Osmane ishte e lidhur me destinacione evropiane dhe të huaja me anë të linjave të rregullta të vaporeve nëpërmjet portit të Selanikut. Kjo mundësoi përfshirje në tregtinë globale dhe një rrjedhë më të shpejtë të njerëzve dhe ideve.

Me zhvillimin e tregtisë, përparuan edhe **sistemet postare dhe të komunikimit**. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, në Maqedoninë Osmane u krijua **rrjeti telegrafik**. Ai i mbulonte pothuajse të gjitha qytetet e mëdha dhe të vogla.

Qytetet - bartëse të modernizimit

Qytetet më të rëndësishme në Maqedoninë Osmane ishin **Selaniku, Manastiri dhe Shkupi**. Ato ishin qendra administrative, tregtare dhe kulturore. Ekonomia e qytetit bazohej në **zejtari dhe tregti**. Shumica e punishteve artizanale dhe dyqaneve tregtare ndodheshin në pazarin e qytetit. Qyteti i Selanikut, me portin e tij, ishte një qendër e madhe tregtare. Kryesisht eksportoheshin produkte bujqësore, ndërsa importoheshin **produkte industriale** (tekstile, vegla dhe orendi shtëpiake). Një nga familjet e famshme tregtare ishte familja **Robevci** nga Ohri. Nga fundi i shekullit XIX, produktet industriale gjithnjë e më shumë i zëvendësonin sendet e punuara me dorë. Si rezultat, shumë zeje tradicionale u zhdukën.



Stacioni hekurudhor në Voden në vitin 1899

Mëso më shumë



Që nga viti 1899, porti i Selanikut është lidhur drejtpërdrejt me Nju-Jorkun nëpërmjet një linje me vapor, që operonte nga Nju-Jorku në Stamboll, duke u ndaluar në Selanik dhe Smirnë.



Le Bosphore – vapori i kompanisë franceze Messageries Maritimes që operonte nëpërmjet portit të Selanikut



Qyteti i Manastirit

Nga mesi i shekullit XIX, në qytete u shfaqën **kapacitete modeste industriale**, më shpesh në industrinë ushqimore dhe tekstile. Më të zakonshmet në industrinë ushqimore ishin **mullinjtë**, ndërsa në industrinë tekstile, **punishtet e tjerres** dhe të endjes. Në të njëjtën kohë, u vendos **sistemi bankar**. Disa banka kishin degët e tyre në qytetet maqedonase, më e rëndësishmja prej të cilave ishte Banka Osmane.

Gjatë shekullit XIX, u zhvillua fuqishëm **arkitektura urbane**. Tregtarët dhe zejtarët më të pasur ndërtuan shtëpi të mëdha dhe luksoze me stil të dallueshëm. Kjo është veçanërisht e dukshme në Ohër, Manastir, Kratovë dhe vende të tjera. Megjithatë, shumë nga rrugët mbetën me baltë dhe higjiena ishte në një nivel të ulët. Për shkak të kësaj, **epidemitë** masive ishin një dukuri e shpeshtë.

Ndërsa fshatrat e ruajtën kryesisht traditën e tyre, qytetet ishin bartës të **modernizimit**. Ritmi i jetës në qytete ishte shumë më dinamik. Së bashku me pazarin, **kafenetë** dhe **tavernat** ishin zemra e jetës urbane. Ato ishin një hapësirë për shoqërim, bisedë dhe jetë shoqërore. **Teatri** u bë gjithashtu një pjesë e rëndësishme e jetës urbane. Me futjen e **energjisë elektrike** u mundësua që kafenetë dhe teatrot të funksiononin pas përdimit të diellit. Në këtë mënyrë, shëtitjet në mbrëmje, mbledhjet dhe ngjarjet kulturore u bënë pjesë e jetës së përditshme.



Teatri në Shkup



Ndërtesa e Bankës Osmane në Shkup



Shtëpia e familjes Robevci në Ohër

E kaluara në të tashmen



Nga gjysma e dytë e shekullit XIX, u shfaqën planet e para urbane në qytete. Në këtë mënyrë, hapësira urbane filloi të planifikohej dhe organizohej në një mënyrë të ngjashme me sot.

Mendo dhe përgjigju: Pse është i rëndësishëm planifikimi urban për cilësinë e jetës në qytete sot?

Ndryshimet shoqërore dhe modernizimi ishin veçanërisht të dukshme në **veshjet** e popullsisë urbane. Ndërsa fshatrat i ruajtën kostumet tradicionale, qytetet e përvetësuan **modën evropiane**. Burrat vishnin kostume, këpucë lëkure dhe kapele, ndërsa gratë vishnin fustane, korse, kapele republikë dhe aksesore mode (çadra, çanta, doreza). Në dallim nga prerjet e gjera orientale, veshjet ishin më të ngushta dhe simetrike, me ngjyra të qeta dhe diskrete.

Nga fundi i shekullit XIX, **fotografia** u bë pjesë e rëndësishme e kulturës urbane dhe shenjë e të qenit modern. Hapja e studiove të para fotografike u mundësoi shumë njerëzve të qëndronin para një aparati fotografik për herë të parë në jetën e tyre. **Vëllezërit Manaki** ishin veçanërisht të rëndësishëm, pasi ata e dokumentuan jetën e përditshme përmes fotografive dhe **filmave** të tyre të shkurtër. Puna e tyre përfaqëson një dëshmi të paçmuar të jetës në Maqedoninë Osmane në kapërcyell të shekujve XIX dhe XX.



Moda urbane në
Maqedoninë Osmane

Sfidë për hulumtim



Vëllezërit **Janaki** dhe **Milton Manaki** janë ndër fotografët dhe **kameramanët e parë në Ballkan**. Ata lindën në fshatin vllah Avdela në Maqedoninë Osmane dhe në fund të shekullit XIX u vendosën në Manastir, ku hapën një studio fotografike. Në vitin 1905 ata e sollën kamerën e parë filmike në Ballkan. Puna e tyre e lidh Maqedoninë me fillimet e kinemasë evropiane dhe botërore. Përpiqu të gjesht informacione rreth jetës së tyre dhe të paktën një nga filmat e tyre që i tregon festimet me rastin e grushtit të shtetit të xhonturqve dhe vizitës së Sulltan Mehmetit V në Manastir.

Çfarë tregojnë pamjet filmike që i gje, kur janë bërë dhe pse janë të rëndësishme si burim historik?

Ku mbahet kamera e tyre sot dhe cili festival e mban emrin e tyre?



Vëllezërit Janaki dhe Milton Manaki

Zhvillimi i gdhendjeve në dru

Gjatë shekullit XIX, në Maqedoninë Osmane u rinovuan dhe u ndërtuan disa **kisha** dhe **manastire**. Kjo kontribuoi në zhvillimin e **pikturës afreske** dhe **gdhendjes në dru**. Mjeshtrit më të famshëm të këtij zanati erdhën nga fshatrat e mijakëve në Maqedoninë Perëndimore. Ata i bënë ikonostaset në Manastirin e Lesnovës, Kishën e Shën Spasit në Shkup, Manastirin e Shën Jovanit të Bigorrit dhe të tjerë. Ikonostasi në Kishën e Shpalljes së Shenjtë në Prilep, gjithashtu, dallohet për vlerën e tij. Me motive gdhendjeje ishin dekoruara edhe tavanet e shtëpive të qytetarëve më të pasur. Një shembull i tillë është shtëpia e familjes Robevci në Ohër.



Kisha e Shpalljes së Shenjtë në Prilep - ikonostasi është ruajtur në formën e tij origjinale

Mëso më shumë



Gdhendësit e drurit punonin në ekipe të përbëra nga mjeshtërit dhe ndihmësit. Për t'i bërë gdhendjet ata përdornin vegla të posaçme prej hekuri, të quajtura dalta dhe çekiçë druri. Më shpesh punonin me dru të fortë arre, të tharë për vite me radhë. Gdhendja bëhej nga një copë e vetme e madhe druri, e cila, fillimisht, gdhendej në mënyrë të përafërt, pastaj gdhendej imët.



Kontrollo çfarë ke mësuar:

1. Përshkruaje modernizimin e jetës urbane në Maqedoninë Osmane!
2. Çfarë shpikjesh të rëndësishme teknike dhe teknologjike arritën në Maqedoninë Osmane në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX?
3. Cilat janë ndryshimet në jetën e përditshme në fshatra dhe qytete?

